

LIDERSHIPI I SUKSESSHËM

(sipas vizionit kur'anor dhe studimeve bashkëkohore)

Prof. Dr. Hfz. Hajredin HOXHA

SHKUP

2022

Titulli në origjinal:	القيادة الناجحة – تأصيلها في ضوء الآيات القرآنية والدراسات المعاصرة <i>El Kijadetu el-Naxhihatu –Te’sijluha fi dou’i el Ajat el Kur’anijeti va el Dirasat el Muasireti</i>
Autor:	تأليف: أ.د. خيرالدين خوجة Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha
Përkthyes:	Dr. Sedat Islami
Recensentë:	Prof. Dr. Milazim Krasniqi Prof. Dr. Naser Ramadani Dr. Musli Verbani
Redaktor gjuhësor:	Radije Hoxha
Redaktor teknik:	Autori & Përkthyesi
Botues:	AUTORI
Tirazhi:	1000 copë
Shtypi:	FOKUS - PRINT
Shkup:	2022

Katalogizimi i librit gjendet në bibliotekën kombëtare në SHKUP.

ISBN: ©Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, përkthimit apo shpërndarjes në çfarëdo formati qoftë, i takojnë vetëm autorit, përveç në rastet kur individët ose institucionet përkatëse marrin leje me shkrim nga autori.

<https://www.drhafezi.net/>

LIDERSHIPI I SUKSESSHËM

(sipas vizionit kur'anor dhe studimeve bashkëkohore)

Prof. Dr. Hfz. Hajredin HOXHA

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿ وَقَالَ الَّذِينَ آمَنُوا يَتَّبِعُونَ آيَاتِنَا وَيَتَّبِعُونَ سَبِيلَ الرَّشَادِ ﴿٣٨﴾ يَتَّقُونَ إِنَّمَا هَذِهِ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا مَتَعٌ وَإِنَّ الْآخِرَةَ هِيَ دَارُ الْقَرَارِ ﴿٣٩﴾ مَنْ عَمِلَ سَيِّئَةً فَلَا يُجْزَى إِلَّا مِثْلَهَا ۖ وَمَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أَنَّىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ يُرْزَقُونَ فِيهَا بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٤٠﴾ ﴾ [غافر: 38 - 40]

“Ai që ishte besimtar tha: “O populli im, më pasoni, që unë t’ju udhëzoj në rrugën e drejtë! 39. O populli im, në të vërtetë, jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e përkohshme, ndërsa jeta tjetër është Shtëpi e përhershme. 40. Ata që bëjnë vepra të këqija, do të dënohen vetëm sipas veprave të bëra; ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, qofshin meshkuj apo femra, do të hyjnë në Xhenet. Aty do të begatohen pa kufizim.”

[Kur’ani: Gafir, 38 - 40]¹

¹ Përkthimi i kuptimeve të ajeteve është marrë kryesisht nga vepra e Hasan ef. Nahit, e botuar në Tiranë më 2006 nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam. **Përkthyesi.**

TIPARE TË LIDERËVE MYSLIMANË

- 1) *Janë ithtarë të një libri të shpallur dhe të një feje hyjnore.*
- 2) *Nuk e kanë pranuar detyrën e prijësit pa edukim paraprak moral e fetar.*
- 3) *Nuk i kanë shërbyer një race të caktuar, një kombi a një populli (por të gjithëve).*
- 4) *Dallohen për ekuilibrim, si jo, kur ata janë ithtarë të një qytetërimi shpirtëror e material.*
- 5) *Jetën nuk e shohin si kafaz të hekurt apo si litar në fyt që ta shkatërrojë dhe këpusin.*
- 6) *Nuk e shohin po kështu as si shans për dëfrim, luks e argëtim që mbase një herë të vjen kah dera, kështu që duhet ta shfrytëzojnë patjetër sa janë në fron.*
- 7) *Dynjanë nuk e shohin si tryezë të shtruar që ta mbysin njëri-tjetrin për të, dhe as depot e mirësitë e dynjasë si diçka për të cilën duhet ta luftojnë njëri-tjetrin.*
- 8) *Popujt e dobët nuk i shohin si pre për përvetësimin e së cilës garojnë ndërmjet vete.*
- 9) *Liderët myslimanë botën e shohin si mbretëri të Allahut xh.sh., në të cilën ata janë emëruar si mbikëqyrës.*

[Ebu el-Hasen Ali el-Haseni en-Nedvi, *Ma dha hasire el-alem bi'nhitati el-muslimine*, f. 130-135]

Allahu e mëshiroftë!

PËRMBAJTJA

Fjala e autorit me rastin e botimit në shqip	13
Fjala e recensentit Prof. dr. Milazim Krasniqi.....	19
Fjala e recensentit Prof. dr. Naser Ramadani.....	21
Fjala e recensentit Dr. Musli ef.Verbani.....	25
Fjala e përkthyesit	29
Parathënie	31
Prezantim kur'anor i disa modeleve të suksesshme dhe të tjera të dështuara në lidhshp.....	32
Shkaqet e përcaktimit për këtë temë studimi	43
Objektivat e studimit	43
Metodologjia e ndjekur gjatë studimit.....	44
Kush janë <i>target grup</i> i këtij studimi?	44
Problematika e studimit.....	45
Si ta aplikojmë këtë studim që të përfitojmë prej tij.....	46
Studime paraprake.....	48
Terminologjia e studimit.....	51

Kapitulli I:

KORNIZA TEORIKE E LIDERSHIPIT MODERN

.....	55
1.HYRJE NË TEORITË E LIDERSHIPIT MODERN	57
1.1. Qasja e mbështetur në tipare	60
1.2. Qasja kontingjente.....	66
1.3. Qasja situacionale e lidershipit	72
1.4. Trendet bashkëkohore të lidershipit	74
2. KOMPONENTËT E LIDERSHIPIT	85
2.1. Komponentët thelbësorë të lidershipit	85
2.2. Nivelet e lidershipit	93
2.3. Dallimi ndërmjet liderit dhe kryetarit.....	95
3. BURIMET E FUQISË SË LIDERSHIPIT DHE TIPARET E LIDERIT TË SUKSESSHËM	101
3.1. Burimet e fuqisë së liderit	101
3.2. Kur'ani paraprin studimet moderne	104
3.3. Virtytet morale dhe shpirtërore të liderit të suksesshëm. 107	
3.4. Tiparet administrative dhe menaxheriale të liderit të suksesshëm	111

Kapitulli II:
PËRKUFIZIMI I LIDERSHIPIT:
KONTEKSTI DHE KONOTACIONET KUR'ANORE

..... 115

1. Kuptimi literal dhe terminologjik i lidershipit dhe lidhjet ndërmjet tyre..... 117
 - 1.1. *El-kijade* ndërmjet kuptimit literal dhe terminologjik..... 117
 - 1.2. Konotacioni i konceptit *el-usvetu el-haseneh*: autenticiteti dhe vazhdimësia e tij në Kur'anin Fisnik..... 127
 - 1.3. Terminologjia e lidershipit në kontekstin kur'anor 134
2. Lidershipi edukativ dhe fushat e tij në Kur'anin Fisnik..... 146
 - 2.1. Fusha e kredis e manifestuar në njëshmërinë e Allahut xh.sh. - monoteizmin 151
 - 2.2. Fusha e meditimit në gjithëpërfshirjen e dijes së Allahut xh.sh. dhe mundësitë e pakufizuara të Tij, dhe vetëvëzhgimin tonë si rezultat i këtij meditimi 159
 - 2.3. Fusha shoqërore e manifestuar në urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja..... 163
 - 2.4. Fusha personale e moralit dhe sjelljes..... 175

Kapitulli III:
SHEMBUJ TË LIDERSHIPIT TË SUKSESSHËM
DHE TË DËSHTUAR NGA PRIZMI KUR'ANOR

.....	191
1. Lidershipi i drejtë në zbatimin e rregullave të fesë dhe shtetit	192
1.1. Shtigjet e ripërtëritjes së kërkuar	192
1.2. Komponentët e sheriatit islam dhe kushtet e vendosjes së tij si autoritet në tokë.....	196
1.3. Harta e rrugës që çon në fitimin e pushtetit dhe epërsisë në tokë.....	204
2. Shembuj të lidershipit të suksesshëm nga prizmi kur'anor	214
2.1. Lidershipi <i>muhamedan</i> në fushën ushtarake dhe civile.....	215
2.2. Lidershipi <i>jusufian</i> në fushën financiare	232
2.3. Lidershipi <i>musajian</i> në fushën e këshillimit dhe konsulencës	240
2.4. Lidershipi <i>sulejmanian</i> dhe <i>belkizian</i> në fushat e besimit dhe sigurisë.....	251
2.5. Modeli <i>dhulkarnejnian</i> i lidershipit.....	287
3. Lidershipe të dështuara nga prizmi kur'anor	315
3.1. Pesë shembuj të lidershipit të dështuar	315
3.2. Distancimi i liderëve dështakë nga pasuesit e tyre	323

Kapitulli IV:	
TIPARET PERSONALE DHE FORMAT E LIDERSHIPIT TË SUKSESSHËM	
.....	329
1. Tiparet personale.....	331
Shembuj të personaliteteve të dështuara në administratë dhe lidership të cilët i kam njohur nga afër, kam bashkëjetuar me ta dhe kam shkruar për ta	331
1.1. Përkufizimi i personalitetit individual	337
1.2. Komponentët dhe parametrat e personalitetit individual	340
1.3. Teoritë e personalitetit individual	343
1.4. Faktorët që ndikojnë tek personaliteti individual	351
1.5. Llojet e personalitetit individual.....	353
2. Format e lidershipit	401
2.1. Lidershipit autokratik apo diktatorial: pikat e forta dhe të dobëta	402
2.1.1. Sjelljet e liderit autokrat	402
2.1.2. Meritat e liderit autokrat.....	406
2.1.3. Mangësitë e liderit autokrat.....	407
2.2. Lidershipi demokratik dhe shtyllat e tij	411
2.2.1. Zhvillimi i raporteve njerëzore	416
2.2.2. Marrja e përbashkët e vendimeve	417
2.2.3. Delegimi i pushtetit	418

2.2.4. Defektet e lidershipit demokratik.....	418
3. Lidershipi kaotik	421
Krahasim ndërmjet tre stileve të lidershipit.....	424
PËRMBLEDHJE ME RËNDËSI TË MADHE.....	427

Kapitulli V:

PËRMBLEDHJE TË SHKURTËRA BIOGRAFIKE DHE UDHËHEQËSE TË DISA PREJ LIDERËVE MË TË SUKSESSHËM DJE DHE SOT

.....	431
Lideri i parë: EBU BEKRI R.A.	433
Lideri i dytë: OMER BIN HATTABI R.A.	436
Lideri i tretë: HALID BIN VELIDI R.A.	439
Lideri i katërt: OMER MUHTARI	442
Lideri i pestë: ALIJA IZETBEGOVIÇ	444
Lideri i gjashtë: REXHEP TAJJIP ERDOGAN	447
Përfundim	452
Literatura.....	458
Fjalorthi.....	470



FJALA E AUTORIT ME RASTIN E BOTIMIT TË LIBRIT NË SHQIP

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërsit!

Në radhë të parë më duhet ta falënderoj nga thellësia e shpirtit Allahun xh.sh., Krijuesin, Ndihmësin dhe Furnizuesin tonë për ndihmën e Tij të pakufizuar në përfundimin dhe realizimin e këtij libri brenda një periudhe kohore jo të shkurtër këtu në Doha të Katarit. Atë e falënderoj ashtu si e ka falënderuar Ai veten e Tij në Kur'anin fisnik, e falënderoj Atë si i ka hije Lartmadhërisë së Tij, qoftë gjithmonë i lartmadhëruar në qiej e në tokë. Atij duhet t'i mbështetemi dhe ndihmën e Tij duhet kërkuar gjithmonë, e veçmas kur ndihemi të dobësuar apo kur jemi në situata të rënda dhe ndihemi të zhgënjyer e braktisur prej të tjerëve. Pra elhamdulillah me zemër!

Në radhë të dytë dërgojmë salavate dhe selame, përshëndetje dhe lutje për më të dashurin tonë, për krijesën më të mirë dhe më të bukur, Muhamedin a.s., familjen e tij të pastër, shokët e tij të ndershëm e të sinqertë dhe të gjithë ata të cilët e ndoqën dhe e ndjekin rrugën dhe synetin e tij në këtë jetë përderisa te jenë gjallë.

Të dashur lexues,

Libri që keni para jush në origjinal është në arabisht, si pjesa dërrmuese e veprave tjera të mia. Për shkak të angazhimit tim akademik në universitete arabe në shtetet e Gjirit dhe në Azinë Juglindore, librat dhe hulumtimet i kam realizuar në gjuhët arabe dhe angleze por si shqiptar që jam kam dashur që munda

dhe angazhimi im të jetë edhe në gjuhën time amtare, andaj e kam angazhuar studentin dhe përkthyesin tim, hoxhën Dr. Sedat Islamin që edhe këtë libër, sikur edhe shumë libra tjerë më herët, ta përkthej në shqip, të cilin e falënderoj shumë për punën profesionale, aftësinë dhe mjeshtërinë e tij në përkthim, me një gjuhë të bukur, të ëmbël e të mirë, të kuptueshme dhe të rrjedhshme, me fjalë dhe terme të zgjedhura si inxhi, pa kompleksitet e filozofi. Mashallah për këtë dhunti nga i Madhi Allah për të dashurit e Tij.

Nuk është thjesht përkatësia ime ajo që më ka shtyrë ta sjell në shqip këtë libër timin por edhe përmbajtja, tematikat dhe koha e shpenzuar për përpilimin e tij. Siç kanë dëshmuar edhe recensentët, ky libër është i rrallë në shqip. Tematika të cilën e trajton nga perspektiva kur'anore dhe profetike është pothuajse e parrahur më parë në trojet tona. Andaj nevoja për këtë libër dhe rëndësia e këtij libri është përtej listimit të një veprë time në vargun e veprave në shqip. Për ta kuptuar këtë rëndësi më mirë na duhet ta bëjmë një diagnozim të gjendjes sonë. Ne jemi dëshmitarë se si shtete të shumta anekënd globit vuajnë nga mungesa e liderëve të suksesshëm si në aspektin politik, fetar, akademik, ushtarak dhe ekonomik etj. Fatkeqësisht, këtu bëjnë pjesë edhe shumë shtete arabe dhe islame, e edhe shtetet tona në Ballkan. E them këtë sepse ne disponojmë me çdo resurs të mundshëm, human, material dhe shpirtëror që na mundëson me pas një lider të duhur, me tipare dhe karakteristika të dalluara, por ja që nuk kemi. Pothuajse në të gjitha fushat e lartpërmendura mungon lidershipi i mirëfilltë. Dëshmi mund të marrësh katrahurën shoqërore, varfërinë, papunësinë, krimin e organizuar, narkomaninë, vetëvrasjen, divorcin, prapambetjen në infrastrukturë, teknologji, industri, në zhvillim dhe në ekonomi, gjëra këto që kanë provokuar migrimin e të rinjve dhe ikjen nga vendi i tyre.

Çka të të them për hallin e shumë liderëve bashkëkohore në trojet tona dhe në botën islame e më gjerë? Reprizë e gjendjes së gjeneratave, sistemeve dhe regjimeve diktatoriale, autokratike, totalitare të hershme në çdo fushë por me ngjyra dhe stile moderne! Të korruptuar, jo të denjë, vasal të imperializmit, shkurtpamës, pa vizione, pa tipare të lidërshiptit të duhur, jo të trajnuar, jo të përgatitur me principe dhe aftësi të duhura, të edukuar e shkolluar nëpër institucione të ndryshme që janë armiq historik të betuar të vendit, të popullit e të fesë.

Institucionet arsimore dhe edukative, fetare apo jofetare qofshin, si në botën arabe dhe më gjerë, ashtu dhe në trojet tona shqiptare, fare nuk i kanë kushtuar rëndësi kësaj tematike në plan programet shkollore dhe as që trajtohen ndonjëherë tema të këtilla në ligjëratat javore fetare – hytbe. Është me të vërtetë për tu çuditur dhe për tu habitur! Shtrohet pyetja pse? Përgjigjja është e shkurtë dhe dihet. Sepse armiku, okupatori, imperialisti po dëshiron kështu. Ai nuk dëshiron me pa një lider syçelë, besnik, jo të korruptuar, të moralshëm, të pastër dhe të sinqertë, dhe si pasojë e mungesës së lidërshiptit të suksesshëm është situata çfarë është. Lideri na zbret “nga qielli” i panjohur për pjesën më të madhe, i pavlerësuar për ndonjë meritë a kontribut, zë vendin sikur ta kishte trashëguar nga të parët. Nepotizmi dhe interesat e ngushta grupore e klanore janë ato që kanë fjalën e fundit për liderët. Shkelen vullneti dhe dëshira e popullit në përzgjedhjen e liderit të votuar nga populli!! Agjenda speciale të diktuar. Deri kur kështu do të vuaj populli?

Kur do ta shohim dritën e drejtësisë dhe të civilizimit islam si mysliman me një vend ku përkatësia islame e popullit është mbi 90%!?

Liderë të pa vizion dhe pa suksese konkrete. Kemi dështuar me futjen e mësimbesimit nëpër shkolla, pavarësisht se për cilin mësimbesim bëhet fjalë, islam apo të krishterë, dhe për pasojë

fëmijët tanë po infektohen nga ide ateiste e degjeneruese, po bëhen viktimë të shturjes dhe degradimit moral. Mediat kanë marrë guximin që të mos lënë shenjtëri pa e prekur. E frikshme liria që ndjejnë për ta etiketuar e përbaltur Islamin. Nga kjo perspektivë dhe si shërim të kësaj gjendje të rëndë që diagnostifikua, këtë vepër timen e shoh si kontribut serioz në këtë drejtim dhe si shlyerje të një pjese të borxhit që ia kam këtij vendi dhe këtij popullit në përgjithësi, e studentëve, shokëve, hoxhallarëve dhe xhematit në veçanti. Edhe pse jetoj larg, mijëra kilometra më ndajnë fizikisht nga vendi im, mendja dhe shpirti im rrojnë me ju dhe janë në mesin tuaj sa të jem gjallë. Deri në botim të këtij libri, i kam kaluar plot katër vite hulumtim dhe angazhim të pandërprerë. Kam hulumtuar literaturë burimore fetare dhe referenca të ndryshme, në arabisht dhe anglisht. Rëndësia e liderit të mirë, të qëlluar, të suksesshëm është e pakontestueshme. Edhe pse si individ, por mos harroni se lideri i suksesshëm mund të ndryshojë edhe rrjedhën historike fetare, politike, akademike. Andaj, kam dashur që nëpërmjet skicimit të një sistemi të mirëfilltë lidërshepi, të studiuar dhe të hartuar akademikisht sipas burimeve tona fetare islame dhe teorive bashkëkohore, si popull dhe si ymet mysliman, ta rikthejmë pozitën tonë historike të grabitur nga fuqitë e mëdha imperialiste dhe kolonialiste që e kemi poseduar me shekuj dikur gjatë historisë sonë, dhe që na përket tash, respektivisht t'i udhëheqim popujt në shkencë e humanizëm, në civilizim e kulturë, në zhvillim dhe paqe, duke respektuar lirinë e diversitetit kulturor, etnik e fetar, me drejtësi dhe barazi për të gjithë nën hijen e udhëzimeve kur'anore dhe profetike. Shtrohet pyetja e madhe, si dhe në çfarë mënyrë? Harta dhe përgjigja detale është në këtë libër.

Në fund, libri nuk do të ishte ky që është, pa marrjen në konsideratë të sugjerimeve dhe vërejtjeve konstruktive të disa

studiuesve, dijetarëve, konsulentëve, dashamirës të dijes e përparimit, dhe jam borxhli për ta që nuk kanë kursyer kohën, mundin dhe diturinë e tyre të reflektuar në këtë libër që keni sot para duarve tuaja, ku në mes tyre më duhet të veçojë konsulentët e parë shqiptarë; Dr. R. I. A. A, znj. Radije Hoxha, pastaj, tre recensentët profesionalë; Prof. Dr. Milazim Krasniqi, Prof. Dr. Naser Ramadani nga Kumanova, hoxhën Dr. Musli Vërbani. Po kështu do të doja t'i veçoj me falënderim edhe konsulentët në gjuhën arabe, si: Prof. Dr. Jasir Ismail Radi nga Malajzija, Prof. Dr. Muhamed Ikbal Ferahat nga Siria, Prof. Dr. Ibrahim Ulvani nga Egjipti, etj. Singërisht, të gjithëve ju jam shumë mirënjohës dhe ju falënderoj për çdo sekondë e minutë që keni kaluar duke lexuar e vlerësuar librin tim. Allahu ju shpërbleftë me të mirat e Tij në këtë jetë dhe në Ahiret. Le të jetë ky libër një hap themeltar drejt një reforme urgjente akademike, fetare, politike, ekonomike dhe sociale në ringjalljen dhe rikthimin e civilizimit kulturor dhe shkencor human islam në çdo sferë të jetës sonë, duke filluar me përgatitjen e një lideri të mirëfilltë dhe të suksesshëm sipas kësaj harte që keni në duar. Nuk pretendojmë ta kemi bërë më të mirën edhe pse jemi munduar. Tematika që rrah libri është e re dhe ka nevojë të shtohet në të. Unë, me lejen e Allahut, do të vazhdoj t'i shërbej popullit dhe fesë sime sa të më rrah zemra.

Velhamdulilahi Rabbi-l-alemin!

Të gjitha falënderimet janë për Allahun xh.sh.!

Ju lutem na kujtoni në lutjet tuaja të mira!

I juaji singërisht,

Prof. dr. Hfz. Hajredin Hoxha

Doha – Katar

27 tetor 2021

FJALA E RECENSENTIT PROF. DR. MILAZIM KRASNIQI

I nderuar Hafëz,

Ndonëse pa u ngutur, por me kureshtje të shtuar, librit tënd i rashë në fund, më në fund. Ishte shumë voluminoz, por edhe shumë interesant, për secilin që ka një interes minimal për këtë problematikë. Fatkeqësisht, komuniteti ynë këtu në Kosovë, në këtë fushë është dibidus. Dëgjon aty këtu tregime të shkëputura, me përmasa miti dhe e flenë mendjen. Kënaqet disi për të kaluarën, por nuk mendon fare për të tashmen e aq më pak për të ardhmen. Në këtë rreth vicioz sillemi e pështillemi, si gusat në mjegull. Prandaj, ky komunitet nëse ka dëshirë për të mësuar, në këtë libër mund ta gjejmë rastin të mësojmë shumë, për këtë problematike, e cila është kyçe në botën e sotme. Siç thotë një shprehje, nuk do të vija bast se do të ketë ndonjë interesim të shtuar, por puna jote si autor është e realizuar me mundësinë që u lë njerëzve në dispozicion, që të mësojnë gjërat që nuk i dinë e që janë të dobishme për ta. Në këtë kuptim, lus Allahun Mëshirëplotë të të shpërblejë me të mira në të dyja botët, për gjithë mundin dhe rezultatin e kësaj pune të madhe.

Lidhur me vetë objektin e studimit, siç të kam thënë, unë nuk jam kompetent që të jap vlerësime. Kam mësuar shumë prej këtij libri dhe kjo më mjafton. Dy aspekte do t'i theksoja: e para, realisht brenda librit janë dy libra, pra njëri që merret me liderin sipas vizionit kur'anor dhe libri tjetër, për liderin, sipas dijeve, studimeve bashkëkohore. Pra, efektivisht mund të funksionojnë si libra të veçantë. Integrimi në një i dy objekteve të studimit rezulton i mundshëm, edhe i suksesshëm. Natyrisht, kështu është projekt më gjigand, mbase edhe me synimin që të krijohet një lloj sinteze e studimit të problemeve, me të dyja metodologjitë, që në fakt edhe vetë përpiqem ta bëj në punën time modeste studimore dhe intelektuale...

Në fund, duke të falënderuar për mundësinë që ma afrove që ta lexoj në dorëshkrim dhe të përfitoj shumë nga ky studim i shkëlqyeshëm, lus Allahun të të shpërblejë në të dyja botët, me të mirat e Tij.

Prof. dr. Milazim Krasniqi

4 tetor 2021 - Prishtinë



FJALA E RECENSENTIT PROF. DR. NASER RAMADANI

Falënderimet e plota i takojnë Allahut të Lartmadhëruar, i Cili ka kërkuar prej njeriut ta zbaton ligjin e Tij në tokë dhe atë përmes liderëve të përgatitur për këtë çështje, salatet dhe selamet qofshin mbi Muhamedin alejhis selam modelin e një lidershipi të suksesshëm, i cili ka përgatitur kuadro për të qenë lider dhe për të bartë amanetin e Allahut në tokë, salate dhe selame edhe për familjen e tij, shokët e tij dhe gjithë ata që kanë ndjekur dhe ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Libri “Lidershipi i preferuar –sipas versionit kur’anor dhe studimeve bashkëkohore-“ i autorit prof.dr. Hajredin Hoxha, me sa di unë, është libër i parë në gjuhën shqipe i këtij lloji. Nuk kemi hasur në ndonjë libër në gjuhën shqipe me këtë tematikë dhe që trajton këtë problematikë sipas ajeteve kur’anore, haditheve pejgamberike dhe studimeve bashkëkohore,

Autori në fjalë, në këtë libër përmbledh përvojën e tij intelektuale dhe akademike. Ai nga përvoja e tij shumëvjeçare në fushën e daveit si profesor në Universitete të ndryshme të Botës Islame dhe nga ballafaqimet e tij me persona udhëheqës në institucione të ndryshme ka përmbledhur gjithë atë në këtë libër, që në një mënyrë tregon edhe përvojën e tij me njerëz udhëheqës në institucione të ndryshme.

Autori, në këtë libër, në mënyrë objektive flet për lidershpin sipas Kur’anir, sunetit pejgamberik dhe studimeve bashkëkohore. Kjo vetëvetiut flet se kësaj tematike i është qasur nga shumë anë. Në parathënie theksohet qasja metodologjike e problemit duke përfshirë shkaqet e studimit, objektivat e studimit, metodologjinë e studimit, terminologjinë e studimit etj.

Në kapitullin e parë, autori flet për teoritë moderne të lidërsipit, burimet e fuqisë së lidërsipit dhe tiparet e liderit të suksesshëm. Në kapitullin e dytë flet për kuptimin e lidërsipit në aspektin literal dhe terminologjik si dhe për lidërsipin edukativ dhe fushat e tij në Kur'anin Fisnik.

Kapitulli i tretë përfshinë shembuj të lidërsipit të suksesshëm në mesin e të cilëve thekson lidërsipin muhamedan, jusufian, musaijan, sulejmanian dhe dhulkarnejnian. Secili shembull prej tyre bazohet në ajetet kur'anore për të treguar se në Kur'an përfshihen tiparet e një lideri të suksesshëm. Përveç kësaj, në këtë kapitull përfshihen edhe shembuj të lidërsipit të dështuar, ku mes tjerash thekson pesë shembuj të tillë.

Në kapitullin e katërt, autori flet për tiparet personale të lidërsipit dhe format personale të lidërsipit. Autori thekson se ekzistojnë disa lloje të lidërsipit: autokrat, demokrat, anarkik dhe islam. Kështu përfundon se lidërsipi i llojit islam është ai që duhet të udhëheq me institucione të ndryshme ngase përfshinë gjitha tiparet e një lidërsipi të suksesshëm.

Në kapitullin e pestë dhe të fundit, autori sjell biografinë e disa prej liderëve të suksesshëm gjatë historisë njerëzore.

Vlen të theksohet se autori gjitha këto çështje i paraqet me një gjuhë të qartë, ide të argumentuara mirë dhe përfundime bindëse. Ajo që e bën edhe më të qartë këtë libër se gjitha idetë dhe cilësitë i paraqet në formë të grafikoneve, gjë që ia lehtëson shumë lexuesit kuptimin e ideve dhe çështjeve.

Ky libër është i dobishëm për lidërsipin në përgjithësi, qoftë në politikë, arsim, ekonomi dhe në çdo sferë të jetës. Me këtë kuptohet se ky libër ndihmon kryetarët e institucioneve shtetërore dhe private, udhëheqësit administrative, kryetarët e bashkësive fetare, kryetarët e komunave, rektorët e

universiteteve, dekanët e fakulteteve, drejtorët e shkollave dhe secilin që ushtron një post udhëheqës.

Lusim Allahun subhanehu ve teala që ky libër të jetë dritë për gjithë ata që synojnë suksese në punën e tyre. Gjithashtu lusim Allahun që autorin ta shpërblejë me shpërblimet e Tij më të mëdha duke uruar edhe suksese tjera në fushën e daveit islam.

Në fillim dhe mbarim, falënderimet i takojnë vetëm Allahut të Lartmadhëruar.

Prof. Dr. Naser Ramadani

16 tetor 2021, Kumanovë



FJALA E RECENSENTIT DR. MUSLI ef.VËRBANI

Tani lexuesi shqiptar mund të ketë një perlë në bibliotekën e tij nga një autor perlë i cili e ka mësuar Kur'anin përmendësh, me fjalë tjera e ka memorizuar dhe e ka fituar titullin Hafidh (Hafiz) i Kur'anit që në vegjëli, pra në moshën kur nuk e ka kuptuar gjuhën arabe, mirëpo më pastaj e ka studiuar gjuhën arabe, është specializuar në lëndën e interpretimit dhe të komentimit të Kur'anit dhe ka arrit deri në titullin më të lartë të nivelit akademik dhe shkencor.

Autori në fjalë e ka ndie në shpirt një çështje e cila i mungon jo vetëm lexuesit tonë por edhe më gjerë. Fusha e Lidërsipit nuk është e nevojshme dhe e domosdoshme vetëm për shoqërinë tonë në këtë kohë, por është e nevojshme për të gjitha kohërat në të ardhmen ashtu siç është e nevojshme për të gjitha shoqëritë dhe për të gjitha kohërat.

Autori, aq sa ka përdorë metodologji akademike në shtjellimin e kësaj teme ka përdorë edhe metodologji të lehtë edhe për lexuesin e rëndomtë. Pas çdo teme e paraqet në formë grafike ashtu që lexuesi ta ketë më të përafërt temën e shtjelluar.

Autori Librin e ka ndarë në pesë kapituj:

Në kapitullin e parë dhe të dytë autori përqendrohet në teorinë dhe në përkufizimin e termit të Lidërsipit, sjell teori dhe përkufizime të ekspertëve të ndryshëm të kësaj fushe, pastaj bën krahasime ashtu që nga secila teori dhe përkufizim lexuesi të përfiton atë e cila nuk është te teoria dhe përkufizimi tjetër.

Me theks të veçantë i qaset teorisë dhe përkufizimit të Lidërsipit në bazë të prizmit kur'anor, i cili i paraprinë përkufizimeve dhe teorisë të lidërsipit, ku vihet në pah që barrë kryesore e lidërsipit është urdhërimi për të mirë dhe parandalimi i defekteve dhe të këqijave në shoqëri.

Në kapitullin e tretë i cili është bosht i kësaj fushe, autori përqendrohet në ilustrimin të lidërsipit me shembuj nga Kur'ani Fisnik. Nga ilustrimi me shembuj, në piedestalin më të lartë të të gjitha kohëve e vendosë Muhamedin a.s., i cili është dritë për

njerëzimin, por mbi të gjitha është mostër se si duhet të jetë Lidërshtipi. Pastaj ka marrë shembuj të disa pejgamberëve të cilët edhe pse kanë qenë të dërguar janë ballafaquar me problemet shoqërore, si me familjen, pastaj edhe me sundimtarin, dhe ja kanë arritur që me aftësitë e tyre të liderit të përvetësojnë edhe zemrat e vëllezërve edhe zemrat e sundimtarit, e modelin e këtij lloji të Lidërshtipit e ka ilustruar me shembullin e Jusufit a.s. Modelin e Musait a.s. e ka sjellë më shumë si model të Lidërshtipit konsultativ edhe pse një model i këtij lloji lidërshtipi gjendet edhe te pejgamberët tjerë.

Përpos ilustrimit me shembuj të pejgamberëve, autori ilustron edhe me shembuj tjerë nga Kur'ani fisnik të cilët nuk ishin pejgamber, e njëri prej atyre shembujve ishte Taluti. Taluti ishte i lindur që të jetë lider sepse i kishte dy cilësitë kryesore të Liderit: në njërin anë ishte i fuqishëm fizikisht dhe me shëndet ndërsa në anën tjetër kishte dituri edhe pse në shoqëri njihej si i varfër. Taluti ka ditur të organizojë ushtrinë, ka ditur ta testojë ushtrinë e tij dhe në fund ka triumfuar nga ushtria e fuqishme e asaj kohe, ushtria e mizorit Xhalut.

Shembull tjetër i cili ia vlen të ilustrohet që kjo fushë të jetë atraktive është çështja e mbretëreshës Belkise, e cila ishte grua. Ajo mund të vendoste vet për popullin e saj, mirëpo pasi që konsultohet me këshilltarët e saj vendos që ta shpëtojë popullin e saj dhe veten e saj dhe i është dorëzuar Zotit së bashku me Sulejmanin a.s. i cili në ushtrinë e tij nuk kishte vetëm llojin njeri por edhe kafshët dhe shpendët dhe xhinët.

Edhe pse autori ilustron shembuj të lidërshtipit të dështuar, dëshiron të përqendron vëmendjen se ata nuk mund të quhen dhe nuk mund të llogariten për lider dhe Lidërshtip të suksesshëm, por përkundrazi ata e kanë uzurpuar këtë titull ose edhe e kanë trashëguar liderizmin e tyre e që në fakt me mënyrën e veprimtarisë së tyre jo që e kanë ngritë popullin, por përkundrazi

e kanë dërguar në shkatërrim dhe në zhdukje dhe kësisoji e kanë shkatërruar edhe veten e tyre dhe kanë mbetur si mësim për gjeneratat e tjera për lider të dështuar. Autori, liderizmin – lidershpin - e tyre e shpreh në aspektin negativ dhe jo si lider pozitiv në kuptimin e fjalës. Bazë në këtë kapitull është avancimi, riorganizimi dhe ripërtëritja e shoqërisë për të përfituar të drejtën e privilegjimit, promovimit dhe implementimin e qeverisjes në tokë dhe sundimin e paqes në tokë.

Në kapitullin e katërt të librit shtjellohen tiparet dhe format e lidershpin, të lidershpin autokratik dhe të Lidershpin demokratik me qëllim që lexuesi të përfitojë dituri për mangësitë dhe përparësitë e formave të Lidershpin. Në kapitullin e pestë dhe të fundit autori sjell disa liderë, prej kohës së pejgamberit a.s. dhe deri më sot e prej tyre. I ka renditur Ebu Bekrin, Umerin dhe Halid ibn Velidin për të vazhduar me Omer Muhtarin dhe në fund Alia Izebegoviqin dhe Rexhep Tajib Erdoganin.

Shtjellon Lidershpin nga aspekti i përgjithshëm dhe nga aspekti i veçantë dhe llojet e ndryshme të Lidershpin ashtu që këtë fushë ta bëjë më atraktive, më serioze dhe më të rëndësishme. Autori dëshiron motivimin e individëve që të bëhen liderë të suksesshëm duke filluar nga rrethi i ngushtë ku jetojnë, pastaj në atë lokal por edhe për ta shfrytëzuar aftësinë dhe potencialin në nivel qendror.

Dr. Musli Verbani

10 tetor - 2021, Kosovë



FJALA E PËRKTHYESIT

Lidershipi është një ndër temat që gëzojnë trajtimin më të madh. Kjo mbase edhe për shkak të rëndësisë së shumëfishtë që paraqet. Çdo sukses, duke filluar nga familja, biznesi, organizata, e deri tek shteti, është në varësi jetike nga lidershipi i mirëfilltë. Këtu fshihet sekreti i trajtimit të lidershipit nga këndvështrime të shumta: politike, ushtarake, akademike, biznesore, e edhe fetare. Liderët e suksesshëm konsiderohen thesari më i çmuar që mund të ketë një kompani e organizatë, çfarëdo qoftë, andaj edhe janë në hulumtim të vazhdueshëm të tyre. Lideri i suksesshëm në njëfarë forme për këto kompani dhe organizata është shndërruar në urtësinë e trupëzuar të cilën kudo që e gjejnë, e marrin.

Liderin e suksesshëm e duam edhe ne myslimanët dhe jemi në kërkim të tij, veçmas kur dihet se ne jemi ymet liderësh. Historia jonë është përplot shembuj të rrallë të liderëve të cilëve iu detyrohet njerëzimi mbarë. A nuk përmendet Omeri r.a., si një ndër njerëzit më me ndikim në gjithë historinë?! Ishte shëmbëlltyra e tij ajo që ia përjetësoi emrin dhe kujtimin. Sigurisht, Omeri r.a., është vetëm një prej shembujve, ndryshe ka dhe shumë të tjerë, madje gjatë gjithë historisë. Është premtim i Allahut xh.sh., se ky ymet nuk do të mbetet pa burra të mirë, pa të atillë që janë të pathyeshëm para çfarëdo sprove e sfide, pa të atillë që janë vazhdimësi e lozes së vlerave dhe virtyteve.

Ymeti islam, edhe tani kur ka filluar të këndellet nga gjumi shekullor, është në kërkim të liderëve. Dijetarë e studiues myslimanë, nga perspektiva e këndvështrime të shumta e të ndryshme, janë duke u munduar ta portretizojnë sërish imazhin e liderit të suksesshëm duke u shërbyer me nuancat dhe ngjyrat kur'anore e profetike. Një prej tyre është dhe hoxha jonë, profesori i studimeve islame, dr.hfz. Hajredin Hoxha, i cili, në vazhdën e shumë studimeve me thellësi shkencore, ka ofruar edhe këtë punim, të cilin, për shkak se tash e sa vite jeton e vepron në botën arabe, e ka shkruar në gjuhën arabe. Libri ka një rëndësi të veçantë.

Përveç që është referencë në këtë fushë, sepse, siç mund të kuptohet nga vet titulli, libri mëton ta rrënjëzojë këtë temë dhe t'i jep motive referenciale nga Kur'ani dhe Sunneti, ai është edhe praktik. Pra, përveç kontributit teorik, libri mëton të jetë edhe praktik, të shërbehen me të instruktorë dhe trajnues myslimanë në kurset dhe trajnimet që mund t'i mbajnë për lidërsipin.

Edhe pse jam përkthyes i më shumë se pesëmbëdhjetë librave të dr. Hoxhës në shqip, ky libër, për shkak të tematikës dhe shprehjeve, ka qenë sfidë, por sfidë e ëmbël. Në fund, pas të gjitha angazhimeve, kur sheh daljen e tij në dritë, e sheh se ia vlen barra qiranë. Ky libër, po e përsëris, është i rrallë, për nga tematika dhe vlerat. Literaturës islame i mungojnë libra të këtillë, aitorialë e referenciale sa i përket kësaj çështjeje. Ndaj, bashkë me gëzimin për botimin e këtij libri në shqip, lexuesit dua t'i marr myzhde edhe për ribotimin e veprave tjera të dr. Hajredin Hoxhës në një të ardhme të afërt.

Për liderët e sënësërme, ky libër mund të shënojë hapin tuaj fillestar drejt formimit të suksesshëm!

Dr. Sedat ISLAMI

7 nëntor 2021, Vushtëri



PARATHËNIA

- Prezantim kur'anor i disa modeleve të sukseshme dhe të tjera të dështuara të lidershipit
- Shkaqet e përzgjedhjes së studimit
- Objektivat e studimit
- Metodologjia e ndjekur në studim
- Target grupi i studimit
- Problematika e studimit
- Si të përfitojmë nga ky studim?
- Studimet e mëparshme
- Terminologjia e studimit

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, Gjithmëshirshmit, Mëshiruesit

Falënderimet dhe lëvdatat i takojnë Allahut, i Cili në Kur'anin fisnik thotë:

﴿وَإِذْ أَبْتَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ رَبُّهُ بِكَلِمَاتٍ فَأَتَمَّهُنَّ قَالَ إِنِّي جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ إِمَامًا قَالَ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي قَالَ لَا

يَنَالُ عَهْدِي الظَّالِمِينَ ﴿١٢٤﴾ [سورة البقرة: 124]

“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi, Allahu i tha: “Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!” - “Po pasardhësit e mi?” - pyeti ai. Allahu tha: “Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.”.” [Bekare: 124]

Përshëndetjet me salat dhe selam qofshin për krijesën më të dashur të Allahut, për Imamin dhe prijësin e të gjithë Pejgamberëve, për Muhammedin a.s., familjen, shokët dhe të gjithë pasuesit e tij!

Prezantim kur'anor i disa modeleve të suksesshme dhe të tjera të dështuara të lidershipit

Historia njerëzore është përplot shembuj dhe modele lidershipi të suksesshëm dhe të dështuar, dhe këtë jo vetëm në një fushë të caktuar. Evidentimi i tyre në histori ka ndodhur natyrshëm për shkak të efekteve që kanë pasur në shoqëri. Më saktë, njerëzimi ka përjetuar tmerrin në disa epoka kur protagonistë lidershipi kanë qenë dështakë e mjeranë, sikur që ka përjetuar ditë të lumtura kur liderë kanë qenë njerëz me vlera dhe virtyte. Kur'anit fisnik paraqet dy modele lidershipi: i pari, model që thërret në të mirën dhe përfillë programin hyjnor, dhe, i dytë, që thërret në të keqen dhe shpërfillë programin hyjnor. Përkitazi me të parin, sa për ilustrim, Kur'anit na rrëfen:

﴿وَجَعَلْنَاهُمْ آيَةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِمْ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ وَإِقَامَ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءَ

الزَّكَاةِ وَكَانُوا لَنَا عَبِيدِينَ ﴿٧٣﴾ [الأنبياء: 73]

“Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuan që të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin, dhe ata vetëm Ne na adhuruan.” [Enbija: 73]

﴿وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ آيَةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا وَكَانُوا بِآيَاتِنَا يُوقِنُونَ ﴿٢٤﴾ [السجدة: 24]

“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm.” [Sexhde: 24]

Ndërsa sa i përket modelit të dytë, atij të dështuar pra, Kur’ani na rrëfen dhe ne po përmendim këtu tre shembuj vetëm sa për ilustrim:

﴿وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا وَسُلْطَانٍ مُّبِينٍ ﴿٦٦﴾ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ فَأَتَّبَعُوا أَمْرَ فِرْعَوْنَ

وَمَا أَمْرُ فِرْعَوْنَ بِرَشِيدٍ ﴿٩٧﴾ [هود: 96-97]

“Na e kemi dërguar Musain me argumentet Tona dhe me dokumentet e qarta te Faraoni dhe paria e tij, por paria shkoi pas urdhrit të Faraonit, ndonëse urdhri i Faraonit nuk ishte i drejtë.” [Hud:96 -97]

﴿ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ اتَّبَعُوا مَا أَسْخَطَ اللَّهَ وَكَرِهُوا رِضْوَانَهُ فَأَحْبَطَ أَعْمَالَهُمْ ﴿٢٨﴾ [محمد: 28]

“Kjo, sepse ata pasuan atë që shkakton zemërimin e Allahut dhe urreyen pëlqimin e Tij e kështu, Ai ua zhvlerësoi atyre veprat.” [Muhammed: 28]

﴿وَلَئِكَ عَادٌ جَحَدُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ وَعَصَوْا رُسُلَهُ وَاتَّبَعُوا أَمْرَ كُلِّ جَبَّارٍ عَنِيدٍ ﴿٥٩﴾ [هود: 59]

“Ja, ky ishte fisi Ad. Ai i mohonte shenjat e Zotit të tij, nuk i dëgjonte të dërguarit e Tij dhe shkante pas urdhrit të çdo keqbërësi kokëfortë.” [Hud: 59]

Kështu duken me pak fjalë këto dy lloje lidershipi, detaje të të cilave janë shtjelluar në Kur’anin fisnik.

Ajo që konsideroj se ka rëndësi të përmendet këtu është se, studimet bashkëkohore, pavarësisht përmbajtjes së mirë që kanë, nuk është se kanë sjellë diçka të re më shumë për lidërshtipin e suksesshëm se që Kur’ani fisnik dhe Sunneti i Pejgamberit Muhammed a.s., kanë ofruar. Studimet në fjalë në fokus kanë rëndësinë e mesazhit që bartin liderët dhe i cili i shtyn të lëvizin drejt realizimit të tij, vetëbesimin dhe aftësinë për të çuar përpara gjërat, personalitetin karizmatik, guximin për të marrë vendime dhe për të sakrifikuar, sinqeritetin, pjekurinë dhe nivelin e lartë të vetëdijes, aftësinë e menaxhimit të suksesshëm, shkathtësitë e komunikimit, etj.

Që të mos keqkuptohemi, ne nuk është se nuk e çmojmë kontributin e dhënë në këtë lëmi. Assesi. Ajo që ne duam apriori ka të bëjë me prezantimin e fakteve dhe të vërtetave të mahnitshme kur’anore dhe profetike përkitazi me lidërshtipin, duke synuar, fillimisht dhe para së gjithash, përvetësimin e Kur’anit dhe Synetit si referenca për të projektuar jetën tonë fetare dhe shoqërore, si dhe për tu vetëmjaftuar me këto referenca, të cilat, për hir të së vërtetës dhe korrekhtësisë, nuk ka çështje që trajtohet në botën e lidërshtipit, e që nuk e kanë (Kur’ani dhe Syneti) trajtuar nga një ose aspekt tjetër. Së këndejmi, ne besojmë se çdokush që nuk niset nga ky shteg, do t’i ekspozohet lëshimeve dhe gabimeve, sepse, askush më mirë se Allahu xh.sh., nuk e di çfarë i duhet dhe çfarë bënë dobi më shumë njerëzve. Allahu xh.sh., thotë:

﴿ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴾ [الأعراف: 54]

“...Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!” [A’rafë: 54]

﴿ أَفَحُكْمَ الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِقَوْمٍ يُوقِنُونَ ﴾ [المائدة: 50]

“A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit paraislamik)?! E kush është gjykatës më i mirë se Allahu për njerëzit që besojnë bindshëm?” [Maide: 50]

Nëse e marrim dhe e shfletojmë Librin e Allahut xh.sh., Kur'anin fisnik, do të gjejmë se ai përmban instruksione të rëndësishme të cilat meritojnë të shkruhen madje me ngjyrë ari. Ato janë si shenjat në rrugë të cilat aludojnë në rëndësinë qenësore për kthim tek referencat islame (Kur'ani dhe Syneti), për të shmangur kështu animin e liderit kah epshet ose dobësinë e tij nga mangësia njerëzore. Allahu xh.sh., thotë:

﴿ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ ۖ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ عَمَّا جَاءَكَ مِنَ الْحَقِّ لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمَنْهَاجًا وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿٤٨﴾ وَأَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَأَحْذَرَهُمْ أَنْ يَقْتُنُوكَ عَنْ بَعْضِ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ إِلَيْكَ ۚ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَاعْلَمُوا أَنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُصِيبَهُمْ بِبَعْضِ ذُنُوبِهِمْ ۗ وَإِنْ كَثِيرًا مِنَ النَّاسِ لَفَاسِقُونَ ﴿٤٩﴾ ﴾ [المائدة: 48-49]

“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t’ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti. 49. Prandaj gjykoji sipas asaj që të ka shpallur Allahu e mos ndiq dëshirat e tyre të kota! Ki kujdes që ata mos të të nxisin të largohesh nga një pjesë e asaj që të ka shpallur Allahu! Nëse ata të kthejnë kurrizin e nuk dëgjojnë gjykimin tënd, atëherë ta dish se Allahu do vetëm që t’i dënojë për disa gjynahe të tyre. Në të vërtetë, shumë njerëz janë të pabindur.” [Maide: 48-49]

Lideri i suksesshëm sipas Kur'anit është ai që thërret në të vërtetën dhe udhëzon njerëzit në të, duke ua sqaruar dhe shpjeguar atë, sepse kjo është dhe pjesë e detyrave dhe obligimeve të tij. Allahu xh.sh., thotë:

﴿وَجَعَلْنَاهُمْ أُمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِمْ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ وَإِقَامَ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءَ

الرَّكُوعِ وَكَانُوا لَنَا عَبِيدِينَ ﴿٧٣﴾ [الأنبياء: 73]

“Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuam që të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin, dhe ata vetëm Ne na adhuruan.” [Enbija: 73]

Pra, lideri model është ai që mer iniciativë dhe lëviz, jo nga dashuria për tu shfaqur dhe reklamuar, por nga përgjegjësia dhe detyrimet që rëndojnë mbi supet e tij. Kushdo që shfleton biografitë e Pejgamberëve a.s., dhe personaliteteve të dalluara, do të gjejë këtë kod udhëheqje të mishëruar me veprimet dhe sjelljet e tyre. Lideri, sipas perceptimit kur'anor dhe pejgamberik, i nënshtrohet kontrollit dhe mbikëqyrjes hyjnore dhe shoqërore. Allahu xh.sh., thotë:

﴿وَقَفُّوهُمْ إِنَّهُمْ مَسْتُؤْنُونَ ﴿٢٤﴾ [الصفات: 24]

“Ndalini ata, se do të pyeten.” [Saffat: 24]

Këtë e gjejmë të shprehur qartë dhe tekstualisht edhe në hadithin e saktë të përcjellë nga sahabiu i nderuar, Abdullah b. Umeri r.a.: *“Të gjithë ju jeni kujdestarë dhe të gjithë do të merreni në pyetje për atë që ju është lënë nën përgjegjësi: sundimtari është kujdestar dhe do të pyetet për popullin; kryefamiljari është kujdestar dhe do të pyetet për familjen; e zonja e shtëpisë është kujdestare në shtëpinë e burrit dhe do të pyetet për familjen; shërbëtori është kujdestar dhe do të pyetet për pasurinë e zotërisë së tij dhe për ata që i ka nën kujdestari.”* Të gjitha këto i kam dëgjuar nga Pejgamberi a.s., dhe kujtoj se e kam dëgjuar edhe duke thënë: *“I biri është përgjegjës për pasurinë e të atit dhe për*

atë që ka nën përgjegjësi. Kështu, ju të gjithë jeni kujdestarë dhe të gjithë do të jepni llogari për ata që ju janë lënë në përgjegjësi.”¹

Ndjenja e përgjegjësisë së liderit karshi shoqërisë mbikëqyret nga dy forca të cilat kanë pushtet shpirtëror dhe fizik mbi liderin:

- 1) Pushteti i Kur'anit i cili e orienton liderin drejt vendimeve të mëdha dhe të rëndësishme pa mos u ndikuar aspak nga cytjet e epshit dhe interesave personale, dhe
- 2) Pushteti i urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, i cili është instrument në dorën e shoqërisë që aktivizohet me rastin e lajthitjes së liderit nga e vërteta. Fakti se është pushtet shoqëror nuk nënkupton ekzekutimin e tij në formë të brishtë dhe të shthurur. Ekziston Këshilli i Lartë Fetar Shtetëror zyrtar i cili e ushtron këtë pushtet dhe i cili ka të drejtën madje edhe të përdorimit të forcës në mënyrë që liderin ta kthejë nën pushtetin e Kur'anit dhe urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja. Në hadithin e sahabiut të nderuar, Temim Dariut, qëndron se Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Feja është nasihat², feja është nasihat, feja është nasihat!! Për kë, o i Dërguari i Allahut? – e pyetën. Tha: Për Allahun, Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, prijësit dhe masat e myslimanëve.”³*

Kur'ani fisnik na ka ofruar shembullin e një lideri të suksesshëm dhe dinamik, të fortë dhe të aftë për tu përballur me problemet dhe sfidat e çdo fushe dhe sfere. Është ky mbreti Talut, modeli i

¹ Hadithin e shënojnë Buhariu (2558) dhe Muslimi (1829).

² Në tekst preferuam ta përdorim në origjinal fjalën *nasihat*, ndryshe, si shprehje, *nasihati* nënkupton sjelljen korrekte, të sinqertë, të çiltër, pa mashtrime. Pra, nuk përkthehet këshillë, siç e gjejmë rëndom. Kjo interpretohet edhe me këtë kuptim ndaj liderit dhe popullatës masive. **Përkthyesi.**

³ Hadithin e shënojnë Ebu Davudi (4944), Ibn Hibbani në Sahih (4575), Sahih et-Tergib (1776), Musnedi i Imam Ahmedit (16945). Shuajb Arnauti thotë se hadithi përmbush kriteret e saktësisë të kushtëzuara nga Buhariu dhe Muslimi.

nevojshëm për lidërsip deri në Ditën e Kiametit. Ishte përzgjedhur nga Allahu xh.sh., që të udhëheq me izraelitët, pikërisht për shkak të cilësive dhe tipareve që dispononte, e të cilat janë ato që aq fort po i diskutojmë e dëshirojmë për liderët e kohës sonë. Allahu xh.sh., na rrëfen për të e thotë:

﴿ وَقَالَ لَهُمْ نَبِيُّهُمْ إِنَّ اللَّهَ قَدْ بَعَثَ لَكُمْ طَالُوتَ مَلِكًا قَالُوا أَنَّى يَكُونُ لَهُ الْمُلْكُ عَلَيْنَا وَنَحْنُ أَحَقُّ بِالْمُلْكِ مِنْهُ وَلَمْ يُؤْتَ سَعَةً مِنَ الْمَالِ قَالَ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاهُ عَلَيْكُمْ وَزَادَهُ بَسْطَةً فِي الْعِلْمِ وَالْجِسْمِ وَاللَّهُ يُؤْتِي مَلَكَهُ مَن يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴾ [البقرة: 247]

“Profeti i tyre u tha: “Allahu ka dërguar Talutin si mbretin tuaj.” Ata thanë: “Si mund të bëhet ai mbreti ynë, kur ne kemi më tepër merita se ai për të sunduar?! Përveç kësaj, ai nuk ka ndonjë pasuri të madhe.” Ai u përgjigj: “Allahu e ka zgjedhur atë për mbretin tuaj dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe me fuqi trupore. Allahu ia jep pushtetin e Vet kujt të dojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshtëm.” [Bekare: 247]

Modeli i liderit kur’anor duhet të jetë i ditur dhe me përvojë, të jetë në rrjedhë me ngjarjet dhe të dijë se si ta trajtojë aktualitetin dhe të aplikojë vendimet dhe urdhëresat.

Izraelitët protestuan përzgjedhjen e Talutit me pretekstin se nuk ishte i pasur. Përgjigja hyjnore ua bëri me dije se sekreti i përzgjedhjes së tij qëndronte në diturinë dhe fuqinë fizike dhe se ai nuk kishte të bënte me statusin financiar, siç ata e mendonin. Me dije të mirëfilltë lideri mund t’i qaset sfidave dhe problemeve të jetës dhe t’i gjejë mënyrat përkatëse të trajtimit të tyre. Me fuqi fizike mund të udhëheq në arenën e mposhtjes së kundërshtarëve dhe kreshnikëve. Natyrisht, sot, kjo formë e ballafaqimit nuk ekziston, kështu që rimodelohet duke ngelë fuqia fizike si strumbullar. Më saktë, mund të kërkohet nga ushtria që zhvillimit fizik të ushtarëve t’i kushtohet vëmendje e veçantë, t’iu mësohen artet marciale, të përgatiten intelektualisht për tu ballafaquar me

të tjerët dhe për të diskutuar për problemet aktuale veçmas ato që kanë të bëjnë me sigurinë dhe politikën, etj.

Pra janë dy armë që i duhen një lideri të fuqishëm: dituria dhe fuqia fizike. Nga injoranti dhe i dobëti nuk mund të priten ndryshime dhe reforma dhe ne nuk duam t'i shohim të tillët të marrin timonin e institucioneve tona, fetare, politike apo çfarëdo qofshin. Gjatë shfletimit të literaturës, kam gjetur fjalë të mëdha dhe shumë kuptimplote të prof. Sejjid Kutubit, (komentatorit të shquar të Kur'anit) të thëna me rastin e shpjegimit të ajetit të mësipërm (Bekare: 247), fjalë këto që po kam dëshirë t'i regjistroj edhe në këtë libër timin.

Pejgamberi i tyre ua zbuloi përparësinë dhe meritat e Talutit, sikur që iu foli edhe për urtësinë pse Allahu xh.sh., e kishte zgjedhur lider të tyre, e tha: *“Allahu e ka zgjedhur atë për mbretin tuaj dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe me fuqi trupore. Allahu ia jep pushtetin e Vet kujt të dojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.”* Ai është përzgjedhur nga Allahu, dhe kjo është arsyeja e parë. E dyta: I ka dhënë dituri dhe fuqi fizike...Allahu i jep pushtet kujt të dojë sepse i tërë pushteti i takon Atij dhe Ai kë të do nga robërit e përzgjedh. *“Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm”* në kuptim të asaj se mirësia e Tij është me bollëk ndërsa shpërblimeve të Tij askush nuk mund t'iu vë limit. Ai e di të mirën dhe di si t'iu vendosë gjërat në vendet e tyre...¹

Lideri i suksesshëm sipas Kur'anit e ndërton shtetin e tij mbi bazën e konsultimit, bashkëpjesëmarrjes, transparencës, të qenit i hapur dhe i drejtë me Këshillin e Lartë Shtetëror dhe me ekspertët e fushave përkatëse, në mënyrë që të jetësojë objektiven hyjnore dhe

¹ Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 1/267.

programin pejgamberik të themelimit të një shteti të dëshiruar dhe një institucioni shkencor, politik, fetar, ekonomik, social të suksesshëm. Ja çfarë na mëson Kur'ani:

﴿ وَالَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِرَبِّهِمْ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَمْرُهُمْ شُورَىٰ بَيْنَهُمْ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ ﴿٣٨﴾ ﴾

[الشورى: 38]

“Për ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre, e falin namazin rregullisht dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin; për ata që ndajnë lëmoshë prej asaj që u kemi dhënë Ne.” [Shura: 38]

﴿ فِيمَا رَحِمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ

وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ ﴿١٥٩﴾ ﴾

[آل عمران: 159]

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” [Al Imran: 159]

Koncepti kur'anor për liderin kur'anor nuk nënkupton fokusimin në një aspekt në dëm të aspektit tjetër. Më qartë, nuk përkushtohet vetëm për zhvillimin e aspektit fizik, siç hasim p.sh., në qytetërimet e vjetra e të reja të Perëndimit, ku anës shpirtërore dhe vlerave morale i kushtohet fare pak rëndësi për të mos thënë hiq. Jo. Lideri kur'anor duhet të bëjë balancimin ndërmjet materiales dhe shpirtërores, ose më saktë, atë që mund ta quajmë kombinim tredijagonalësh: *mendjen, shpirtin dhe trupin*.

Kështu, me një vizion të këtillë të kompletuar, ne mund të kemi liderin që dëshirojmë. Qytetërimet e mëhershme na kanë ofruar prova se ndarja e këtyre tre elementeve rezulton me një model monstruoz të liderit. Ndarja e këtyre tre elementeve shkakton një çrregullim dhe prishje të balancit duke i sjellë këto tre elemente (*mendjen, shpirtin, trupin*) nga një harmoni e përkryer në një përballje të ashpër me njëra tjetrën, dhe jo rrallë shpirti, që i është

mohuar e drejta e lidhjes me Allahun, di të hakmerret. Shikoni fenomenin e vetëvrasjes në shoqëritë perëndimore (dhe të tjerat që ndjekin kursin e tyre) dhe binduni për këtë që po themi.

Kur'ani, duke na folur për modelin e liderit të suksesshëm, na e ofron shembullin e Muhammedit a.s., në lidhshimin e të cilit këto tre elemente kanë qenë të koordinuara dhe në përputhshmëri të përsosur me njëra tjetrën. Ja si na e përshkruan Kur'ani këtë model:

﴿لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ
بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ﴾ [التوبة: 128]

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” [Teube: 128]

Pejgamberi a.s., ka qenë kureshtarë që:

- të ruajë mendjet nga çfarëdo elementi që mohon besimin,
- të ruajë trupin nga tejngopja, dobësimi, përtacia dhe plogështia, dhe
- të ruajë shpirtin dhe ta shtyjë drejt mbështetjes në Allahun xh.sh., në pajtimin me caktimin e Tij, ta falënderojë e madhërojë, ta do e të favorizojë nga çdokujt dhe çdo gjëje¹.

Lidershipi i preferuar sipas Kur'anit fisnik nuk bën dallim ndërmjet shpirtërores dhe materiales, personale dhe publike, teorikes dhe praktikes. Të gjitha këto punë që kryen besimtari, pavarësisht pozitës që ka a postit që mban, klasifikohen si pjesë e kësaj feje dhe asaj që parasheh ajo, kuptohet me dy kushte paraprake: që të jenë thjesht për Allahun, dhe, që të jenë në

¹ Për më shumë rreth sëmundjeve të zemrës dhe trajtimit të tyre përkatës ua rekomandoj autorët e njohur dhe ekspertët e mëdhenj të kësaj fushe, si: Imam Gazaliun dhe veprën e tij kolosale *Ihjaw Ulumi ed-Din*; Ibn Tejmijen dhe veprat e tij, veçmas shpjegimet e ofruara në përmbledhjen e fetvave; Ibn Kajjimin, nxënësin e Ibn Tejmijes dhe veprën e tij madhështore *Medarixhu essalikinë bejne ij Jake na'budu ve ij Jake neste'in*.

përputhje me fenë e Tij, ose *pikën referuese*¹ të kësaj feje (Kur'anin dhe Sunnetin). Nëse lideri ndjek këtë kurs në veprimtarinë e tij, çfarëdo qoftë ajo, atëherë sukseset nuk do të mungojnë. Për ne shpirtërorja ka rëndësi të madhe por rruga për të arritur atje i bie kah materialja. Ose, më ndryshe, për ta fituar Xhenetin, na duhet të kalojmë në testin e dynjasë dhe të joshjeve të saja. Ndryshe, do të dështojmë në të dyja botët. Rrjedhimisht, nuk lejohet të bëjmë ndarje ndërmjet fesë dhe dynjasë (*shpirtërores dhe materiales*) sepse Allahu na ka dhënë mundësi të artë që, duke qenë në këtë dynja, të fitojmë kënaqësinë e Tij duke i praktikuar ligjet kur'anore dhe ato profetike në çdo sferë të jetës sonë . Kjo pra ndodhë duke qenë i përkushtuar me tërë qenien për Allahun, duke synuar të vërtetën dhe duke iu mbajtur rendit fetar. Lideri i suksesshëm kur'anor marshon me krenari në sheshe bamirësie dhe bindje ndaj Allahut xh.sh. Ai është shembull praktik i lëvizjes, programit dhe synimit që Allahu xh.sh., dëshiron prej tij t'i realizojë në tokë, për t'i bërë vend të mirës dhe për ta përcjellë atë tek të tjerët

Me shpresë se ia kemi dalë ta përshkruajmë rëndësinë e lidërshiptit të suksesshëm sipas konceptit kur'anor, këtu po mjaftojmë me kaq, për të sjellë më vonë, në kapitujt e librit, detaje me rëndësi.

Shkaqet e përzgjedhjes së studimit

Ky punim nuk është produkt i një ideje të çastit. Janë disa faktorë që më kanë shtyrë ta përzgjedhë atë dhe t'i rrekem punës për realizimin e tij, prej të cilëve do të veçoja:

- 1) Mungesa e studimeve komparative rreth lidërshiptit të suksesshëm dhe të preferuar nga perspektiva kur'anore dhe pejgamberike, në krahasim me studimet sekulare, laike që kanë trajtuar gjerësisht këtë temë.

¹ Autori në këtë Hyrje shpjegon edhe terminologjinë që përdor në këtë vepër. *Pikë referuese* është term që nënkupton referencat kryesore të konceptit fetar, e që janë Kur'ani dhe Sunneti. Përkthyesi.

- 2) Shembuj të këqij dhe të dështuar të lidërshiptit në institucione shtetërore, fetare dhe edukativo-arsimore.
- 3) Përvoja e hidhur e autorit me modele joprofesionale dhe të dështuara lidërshipti në institucione fetare, akademike, ushtarake, dhe pasojat e tyre që kanë goditur e dëmtuar nëpunësit dhe studentët.

Objektivat e studimit

- 1) Zhvillimin e programeve trajnuese në fushën e lidërshiptit në përputhje me qasjen kur'anore dhe njohuritë bashkëkohore.
- 2) Shërbimi ndaj shoqërisë civile dhe organizatave tjera duke ndihmuar stafin e tyre të avancojnë profesionalisht nëpërmjet rezultateve të të nxënimit (njohuri, shkathtësi, aftësi) nga fusha e lidërshiptit të preferuar.
- 3) Zbardhja e rolit efektiv dhe pozitiv të njeriut nëpërmjet përmirësimit të raporteve të tij me Krijuesin dhe me njerëzit përreth.
- 4) Konfirmimi i rolit dhe kontributit paraprirës dhe themeltar të Kur'anit dhe Synefit në fushën e studimeve për lidërshiptin e suksesshëm.

Metodologjia e ndjekur në studim

Metodologjia që kemi ndjekur në këtë punim është ajo induktive, analitike, kritike, dhe krahasuese. Natyrisht, kjo metodologji, me çdo element të saj, do t'i nënshtrohet pikës sonë referuese, Kur'anit dhe Synefit. Përderisa ne jemi pajtuar që referencë t'i kemi Kur'anin dhe Synefitin, atëherë çdo model lidërshipti, qoftë nga e kaluara, qoftë bashkëkohor, do t'i nënshtrohet vlerësimit sipas kriterëve të tyre. Me këtë rast do të doja të shtoj se aspak nuk merret në konsideratë ajo që neve, nga perspektiva fetare është model i dështuar, e që për të tjerët, nga perspektiva e tyre

intelektuale ose ideologjike, mund të jetë i suksesshëm. Dikujt, mbase, nga kjo perspektivë, modeli nazist hitlerian, fashist musollian, komunist stalinian, kolonist izraelit sharonian olmertian netanjahian, racist serb, imperialist anglez, francez apo amerikan, mund t'i duken të arsyeshme, por për neve, që për kandar dhe peshoje të mendimeve dhe veprimeve kemi Kur'anin dhe Synetin, modelet e këtilla janë të dështuara dhe absolutisht të papranuara.

Target grupi i studimit

- 1) Studentët e nivelit të edukimit të mesëm dhe atij universitar (*Bachelor, Master, dhe Ph.D.*)
- 2) Trajnuesit, nëpunësit dhe kandidatët e propozuar për poste publike dhe udhëheqëse në institucione shkencore, politike, administrative, fetare, ushtarake, biznese, etj., dhe këtë pa marrë parasysh se bëhet fjalë për liderë të rinj vendorë apo ndërkombëtarë. E tëra që kërkohet në studim është mosha e liderëve, që duhet të sillet ndërmjet 15-40 vjeç.

Ky studim dhe kjo metodologji trajnuese do të jenë të shoqëruara edhe me materiale tjera të propozuara për shfletim dhe lexim, të cilat do të jenë në formë të pakove trajnuese në kapitujt vijues, dhe këtë me qëllim të përfitimit sa më të madh të rinisë sonë udhëheqëse shkencërisht dhe profesionalisht.

Problematika e studimit

Kohëve të fundit është vënë re shtimi gjithnjë e në rritje e i trajtesave (librave, disertacioneve) që për tematikë kanë lidhshpirtin. Bëhet fjalë për dhjetëra, madje edhe për qindra sosh, dhe kjo, nëse flet për diç, flet për një rizgjim në botën intelektuale, për një fenomen intelektual, për një interesim gjithnjë e më të madh intelektual, edukativ dhe shoqëror në botën tonë.

Por, pavarësisht këtij fenomeni intelektual dhe këtij përkushtimi kolosal, ka një problem serioz që vazhdon të mbetet i pazgjidhur. Është **mungesa e shëmbëlltyrës dhe modelit**. Ose mungesa e një shembulli të duhur dhe meritore për ta ndjekur dhe pasuar. Vëllimi kaq i madh i punimeve në këtë fushë është dëshmi e qartë se meseleja e mungesës së shembullit dhe modelit të lidërshiptit të duhur në shkencë, politikë, fe, siguri (ushtri) vazhdon të jetë e evidente dhe e pazgjidhur. Kjo ka shtyrë autorët dhe studiuesit që të gërmojnë thellë në histori dhe të mundohen të gjejnë tipare e virtyte të burrëshetave dhe liderëve të suksesshëm dhe shpëtimtarë të cilat janë të denja për tu përvetësuar nga liderët e kohës sonë. Pra, ne kemi nevojë të madhe për të pasur liderë shembuj dhe, kaosi që sot shohim në botën e lidërshiptit, reflekton jo vetëm nevojën për liderë por edhe përgatitjen e tyre mbi baza të shëndosha. Kjo, konsideroj, do të mungon për aq kohë sa ne të braktisim referencat (Kur'anin dhe Synetin) për tu marrë me mendimet që janë produkt i angazhimit njerëzor, të cilin e karakterizon mangësia dhe dobësia. Nëse ne nuk i referohemi Kur'anit dhe Synetit, e keqja do të vazhdojë zgjerimin dhe mbase një ditë do të na përmbyt e fundosë të gjithëve.

Ja çfarë na mëson feja për mirësitë e referencave tona dhe rrezikun e anashkalimit të tyre.

﴿إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَيِّنُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ

أَجْرًا كَبِيرًا ﴿٩﴾ [الإسراء: 9]

“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.” [Isra: 9]

﴿وَمَنْ أَعْرَضَ عَن ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَعْمَى ﴿١٢٤﴾ [طه: 124]

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.” [Taha: 124]

﴿وَإِنْ تُطِيعُوا أَكْثَرَ مَنْ فِي الْأَرْضِ لِيُضِلُّوكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ إِنَّ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنْ هُمْ إِلَّا

يَخْرُصُونَ ﴿١١٦﴾ [الأنعام: 116]

“Nëse i bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e Allahut. Ata ndjekin vetëm hamendjet. Ata vetëm gënjejnë.” [En’amë: 116]

Si të përfitojmë nga ky studim?

Që ky studim të jep efektet e dëshiruara, lipset që:

- 1) Materiali i tij të prezantohet në formë të një trajnimi intensiv dyjavor nga trajnues dhe instruktorë të shkathët.
- 2) Të lexohen kapitujt e tij dhe të përmbledhen në formë rezymesh për t’i përgatitur më pas në formë të prezantimeve.
- 3) Shfrytëzimi i këtyre informacioneve me rastin e mbajtjes së ligjëratave fetare, hutbeve, fjalimeve të ndryshme, organizimin e ndonjë aktiviteti, marrjen e ndonjë vendimi, udhëheqjen e ndonjë mbledhje a seance, pjesëmarrjen në ndonjë kamp stërvitor, etj.
- 4) Pajisja e instruktorëve dhe trajnuesve me kopje të këtij studimi.

Përfitimi shkencor nga ky studim mundëson:

- 1) Zhvillimin e kapaciteteve dhe shkathtësive udhëheqëse.
- 2) Shpjegimin e mënyrës së aplikimit dhe demonstrimit të këtyre njohurive në rrafshin praktik.
- 3) Përvetësimin e përsosur të artit të vënies së strategjive dhe kontakteve me të tjerët si dhe nxjerrjen e një vendimi.
- 4) Punën në ekip me një zell dhe përgjegjësi më të madhe.

- 5) Përvetësimin e shkathtësive të ligjërimit dhe shkrimit.
- 6) Udhëheqjen dhe menaxhimin e seancave, themelimin e komisioneve dhe administratave përkatëse të tyre.
- 7) Organizimin e konferencave dhe seminareve që kërkojnë tipare më të theksuara dhe kapacitete më të mëdha të lidershit, siç do ta shpjegojmë në grafikën vijuese:



Studimet e mëparshme

Studimet në fushën e lidërshiptit nuk mungojnë. Ka autorë dhe studiues të shumtë të cilët kanë dhënë mund dhe kontribut të çmuar, qoftë nga aspekti islam, qoftë nga ai administrativo ushtarak, për çka meritojnë falënderim dhe mirënjohje. Por ajo që karakterizon këto punime është ikja dhe devijimi nga tema, paqartësia, zyrtësia sa i përket koncepteve. Mungon me theks të veçantë brumi kur'anor ose trajtimi krahasimtar me studimet tjera duke pasur për bazë vlerësimi me këtë rast kriteret dhe parimet kur'anore. Dua ta përsëris prapë se ju jam falënderues dhe mirënjohës të gjithë atyre që kanë shkruar në këtë fushë, veçmas atyre prej të cilëve kam përfituar drejtpërdrejt në këtë punim, sikur që dua ta njoftoj lexuesin tim të nderuar se ne në këtë punim nuk do të bëjmë vlerësime të detajuara të këtyre punimeve porse do të aludojmë në to aq sa besnikëria shkencore dhe metodologjike parasheh.

- Ali Muhammed Salabi, *Ebu Bekr es-Siddik: shahsijjetuhu ve asruhu*, Egjipt: Dar etteuzië ve enneshr el-islamije, 2020.
- Dr. Ramadan Is'hak Zejan, *Hasais el-kijade el-islamije fi dav'i el-Kitabi ve es-Sunneh*.
- Dr. Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*. El-ittihad el-islamij li-l-munedhamat et-tulabije: El-ma'hed el-alemij li el-fikri el-islamij, 1995.
- Mahmud Shit Hattab, *Err-Rresulu el-kaid*. Bejrut: Dar el-fikr, ed. 5, 1974.
- Ali Muhammed Salabi, *Es-Sultan Muhammed el-Fatih ve avamilu en-nuhudi fi asrihi*. Egjipt: Dar el-Iman, 2010.
- Muhammed Xhemaluddin Mahfudh, *Sunnetu err-Rresul ﷺ fi el-kijade ve idareti el-harb*. Revista Merkez për studime të sunnetit dhe sires, nr. 3, v. 1988.
- Xhihad Muhammed Fejsal Nusajrat, *Shahsijjetu el-kaid fi dav'i sureti el-Ahzabë*. Medine Munevvere: Revista universitare.

- Tarik Suvejdan & Fejsal Bashurahjl, *Sina'atu el-kaid*. Saudi: Mektebetu Xherir, 2003.
- Abdul Aziz bin Muhammed Hunejdi, *El-askerijjetu fi-l-Islam ala dav'i ma verede fi el-Kur'ani el-kerim*.
- Ali Izetbegoviq, *Avaik en-nehdati el-islamije*, përktheu: Hasan Umer Sebahiç. Katar: Xhemijetu Katar el-hajrije, 1997.
- Ahmed Abd Rabbihi Mubarek Basbus, *Fennu el-kijade fi-l-Islam*. Jordani: Mektebet el-menar, 1988.
- Ibrahim Ali Salim Ajblu, *El-kijadetu el-idarijetu ve ref'u haleti el-ma'nevije fi el-hitabi el-kur'anij*. Libi: Universiteti Misurata.
- Fejsal b. Xhafer Bali, *El-kijadetu el-askerijjetu fi dav'i el-Kur'ani el-kerim*. Saudi: Forumi kur'anor në Ministrinë e Mbrojtjes, 2007.
- Abdul Vehhab Ismail el-A'dhamij, *El-kijadetu fi dav'i el-Kur'ani el-kerim*. Irak: Revista Hulumtime dhe studime islame, 2012.
- Hissah Muhammed Seid elo-Akrush, *El-kijadeti fi kissati Musa alejhiselam kema aradeha el-Kur'an el-kerim*. Malajzi: Qendra për hulumtime kur'anore, 2014.
- Hamd Muhamemd Tahir Nehhal, *El-kijadetu ve el-xhundijjetu fi es-Sunenti en-Nebevijeh – dirasetun meuduijjetun*. Gaza: Universiteti Islamik, tezë masteri, 2017.
- Xhihad Turbani, *Mietun min udhamai el-Islam gajjeru mexhra et-tarih*. Medine Munevvere: Dar et-takva, 2015.

Terminologjia e studimit

Lidershipi	Procesi i ndikimit tek të tjerët dhe shtyrjes së tyre drejt realizimit të synimeve dhe objektivave të organizatës. Fuqia e ndikimit në angazhimin dhe aktivitetin e një individi ose grupi individësh me qëllim të realizimit të një objektive të caktuar.
Menaxhment, komandë,	Dy shprehje të ngjashme, sinonime, kuptimin e të cilave duhet bërë sipas kontekstit. Menaxhmenti përdoret më shumë në fushën civile ndërsa komanda në atë ushtarake.
Pikë referuese	Referimi Kur'anit dhe Synefit për vlerësimin e veprave dhe mendimeve.
Modele lidershipi	Mori sjelljesh dhe praktikash të ndërmarra nga shefi i kompanisë ose organizatës, qofshin këto edukative, kulturore, ekonomike, politike apo edhe ushtarake.
Tipare¹	<ul style="list-style-type: none"> • Veçori thelbësore e një sendi, e një dukurie etj., që e dallon atë nga sendet a nga dukuritë e tjera; veti e natyrshme dhe e përhershme e diçkaje, e një grupi sendesh etj. <i>Tiparet kryesore. Tiparet e përbashkëta. Tipar dallues. Tipar cilësor. Tipar i qenësishëm (i paqenësishëm).</i> • Shenjat dalluese të fytyrës (sytë; vetullat, buzët, gojë, faqet, mjekra etj.), që i japin dikujt një pamje të veçantë e të

¹ Marrë nga fjalori i gjuhës shqipe, versioni online (www.fjale.al). **Përkthyesi.**

	<p>ndryshme nga të tjerët. <i>Me tipare të bukura (të shëmtuara). Me tipare burrërore (femërore). Me tipare të holla (të rregullta). Tiparet e fytyrës. Trashëgon disa tipare nga e ëma (nga i ati). Kanë tipare të njëjta (të ngjashme).</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vetë dalluese të karakterit a të formimit të dikujt, që shfaqen në sjelljen e në qëndrimin e tij në shoqëri, në marrëdhëniet e tij me njerëzit, në punë etj.; cilësitë me vlerë të dikujt. <i>Tiparet komuniste. Tiparet e karakterit. Tiparet e njeriut të ri. Tipare të larta morale. e tij.</i>
Personaliteti ¹	<ul style="list-style-type: none"> • Tërësia e veçorive psikike të karakterit, të sjelljes, të veprimtarisë etj. të njeriut, të cilat e dallojnë atë nga të tjerat; njeriu me këto veçori, që e dallojnë atë si individ dhe e bëjnë anëtar të vetëdijshëm të shoqërisë. <i>Personaliteti i njeriut (i fëmijës). Formimi i personalitetit...</i> • Njeri shumë i rëndësishëm a i shquar në një fushë të caktuar të veprimtarisë politike, shoqërore, ushtarake, shkencore etj. <i>Personalitet politik. Personalitet i shquar (i dëgjuar).</i>
Morali	<p>Qasje pozitive ndaj grupit dhe objektivave të punës. Model lidërshtipi i cili rezulton jo vetëm me gatishmëri të lartë për punë por edhe mbajtjen e kësaj gatishmërie në këtë pikë të lartë të nivelit². Ose, tërësia e forcave të brendshme që e shtyjnë njeriun të veprojë,</p>

¹ Marrë nga fjalori i gjuhës shqipe, versioni online (www.fjale.al). **Përkthyesi.**

² Definicioni i ofruar nga autori.

	të qëndrojë a të plotësojë një detyrë, forcë morale. <i>Gjendja morale. Ngritja(rënia) morale. Ndhimë (nxitje) morale</i> ¹ .
Introvert	<i>Tip i mbyllur, i izoluar, që nuk parapëlqen të bashkohet me të tjerët.</i>
Ekstrovert	<i>Tip i hapur, jo i mbyllur, që parapëlqen shoqërimin me të tjerët, pra që ndjek jetën shoqërore.</i>
Performanca	Rezultatet e veprimtarisë ose investimit të një institucioni gjatë një periudhe të caktuar kohe, ose është një masë e asaj që është arritur ose paraqitur nga një sistem, person, ekip, proces ose teknologji informacioni, kjo kushtëzohet të jetë në pajtim dhe përputhje me kalendarin e pagabueshëm të Kur'anit dhe të Synetit.

¹ Marrë nga fjalori i gjuhës shqipe, versioni online (www.fjale.al). **Përkthyesi.**

Kapitulli I:
KORNIZA TEORIKE E LIDERSHIPIT
MODERN

1. HYRJE NË TEORITË E LIDERSHIPIT
MODERN

- 1.1. Qasja e mbështetur në tipare
- 1.2. Qasja kontingjente
- 1.3. Qasja situacionale e lidershipit
- 1.4. Trendet bashkëkohore të lidershipit

2. KOMPONENTËT E LIDERSHIPIT

- 2.1. Komponentët thelbësorë të lidershipit
- 2.2. Nivelet e lidershipit
- 2.3. Dallimi ndërmjet liderit dhe kryetarit

3. BURIMET E FUQISË SË LIDERSHIPIT DHE
TIPARET E LIDERIT TË SUKSESSHËM

- 3.1. Burimet e fuqisë së liderit
- 3.2. Kur'ani paraprin studimet moderne
- 3.3. Virtytet morale dhe shpirtërore të liderit të suksesshëm
- 3.4. Tiparet administrative dhe menaxheriale të liderit të suksesshëm

1. HYRJE NË TEORITË E LIDERSHIPIT MODERN


Teoritë dhe qasjet mbi esencën e lidershipit dhe komponentët përbërës të tij, janë të shumta dhe të ndryshme. Këtë e dëshmojnë shkrimet që kanë trajtuar këtë çështje, të cilave, thënë të vërtetën, u mungon serioziteti shkencor! Trajtimi sipërfaqësor, digresioni (devijimi nga tema), shpërfillja e temave kyçe në këtë fushë, si: rëndësia e lidershipit, mënyra e formimit të një lideri të kërkuar, kushtet që duhet të plotësojë paraprakisht ky lider, etj, janë prova dhe dëshmi të mungesës së qasjes së duhur ndaj kësaj teme. Sipas ekspertëve të kësaj fushe, në gjashtë dekadat e fundit janë publikuar mbi gjashtëdhjetepesë (65) punime ku janë trajtuar, shpjeguar e përcaktuar dimensionet dhe botëkuptimet e lidershipit.

Në opinionin tim, ky trajtim lë shumë për të shtuar! Natyrisht, siç thuhet dhe në rregullin akademik:(për të hulumtuar, praktikuar, shkruar apo kuptuar diçka) - *Nuk braktiset tërësisht; ajo që nuk mund të arrihet tërësisht*. Së këndejmi, për të qenë objektiv në studimet dhe ligjëratat tona, ne do t'i përmendim kalimthi këto qasje që janë ma kryesore thjesht për sekuencë apo radhitje tematike dhe ideore, për të mos u larguar kështu nga thelbi i temës që po trajtojmë. Në këtë kontekst gjatë hulumtimeve tona rreth kësaj teme kemi vërejtë se:

Disa lidershipin e kanë trajtuar nga prizmi i procedurave që një lider duhet t'u përmbahet, apo tipareve dhe veçorive personale që duhet të ketë ai, apo sjelljeve dhe etikës me të cilën duhet të shquhet ai për të ndikuar më pas tek pasuesit/vartësit, apo ndaj pushtetit - si mjet për të ndikuar tek pasuesit/vartësit, apo si një transformim dhe shtyrje përpara e institucionit për të korrur

suksese përtej pritshmërisë, apo si një mori shkathtësish që duhet ti ketë që të mund të ndikojë tek të tjerët¹.


Këto qasje mbi thelbin e lidershipit dhe elementet përbërëse të tij mund t'i përshkruajmë sipas grafikut në vazhdim:



Këto ishin ato qasje më kryesore rreth temës së lidershipit që studiuesit kanë elaboruar dhe shkruar rreth saj. Tani në faqet që vijojnë do t'i shohim teoritë bashkëkohore më kryesore të lidershipit.

¹ Shih: Peter Northouse, *Leadership-Theory and Practice*, f. 5; *Army Leadership – Be, Know, Do*, Headquarters Department of the Army, Washington, DC, 1999, f. 4; Robert Taylor & të tjerë, *Military Leadership in Pursuit of Excellence*, ed. 6, f. 97; *Tevel-li el-kijade – Fennu el-kijadeti el-askerijje*, f. 15-32.

TEORITË E LIDERSHIPIT MODERN




Siç theksuam, këto janë qasjet dhe çështjet kryesore që ekspertët e lidërshiptit i kanë rrahur ndërsa kanë trajtuar esencën e lidërshiptit¹ dhe komponentët përbërës të tij. Në laboratorin tonë akademik dhe fetar islam, ne do t'i analizojmë vetëm katër qasje që i konsiderojmë si më të rëndësishmet, duke mos u ndalur në detajet më pak të rëndësishme.

Bazuar në shpjegimet më sipër, këto janë qasjet kryesore për të kuptuar dimensionet dhe kuptimet e teorive të lidërshiptit modern, që janë dhe parakushti për të kuptuar esencën dhe thelbin e lidërshiptit. Pa këto qasje, të cilat janë si gurthemel, nuk do të mund të ndërtojmë një perceptim të qartë të përmbajtjes së lidërshiptit dhe elementeve që lidhen me të. Këto katër qasje, ndonëse dallojnë në emërtime, për emërues të përbashkët kanë një qëllim. *Tiparet, sjellja, qëndrimet*, që të gjitha këto sillen rreth personalitetit të liderit, kështu që nuk ka mundësi të favorizohet një qasje ndaj tjetrës, sepse që të gjitha kanë një synim të vetëm dhe të përbashkët dhe janë të përkushtuara për realizimin e tij.

¹ Shih: Hisham, *Delil et-tedrib el-kijadij*, (Virxhinia: El-ma'hed al-alemij li el-fikri el-islamij, ed. 2, 1995), f. 52-53.

1.1. Qasja e mbështetur në tipare (The traits Approach)

Si karakteristika më të theksuara të teorisë së tipareve për shpjegimin e zhvillimit të leadershipit, një studiues i shquar i kohës sonë ka përmendur *personalitetin e liderit, tiparet dhe vetitë e tij fizike, shpirtërore (etike) dhe shoqërore*. Rrjedhimisht, nga kjo qasje kanë lindur tri nën-teori, dhe ato janë¹:



Në vitet e njézeta të shekullit të kaluar, disa hulumtues, studjuan tiparet dhe shkaqet që ndikuan në formimin e disa liderëve me ndikim në histori, si Napolon Bonaparta, Abraham Linkoln,

¹ Shih: Utejbî, Nevvaf bin Sefer bin Muflîh, *El-enmat el-kijadije ve essimat esh-shahsijje li-mudiri el-medaris ve alakatuha bi err-rruh el-ma'nevije li el-mual-limine fi muhafedhati Taif et-ta'limije- dirasetun mejdaniyetun tahlilije*, tezë masteri, (Mekkë Universiteti Umm el-Kura, 2008), f. 38.

Indira Gandhi, etj. Erdhën në përfundim se këta liderë dalloheshin për nga dhuntitë hyjnore dhe tiparet e lindura¹.

Disa studiues të tjerë, të mbështetur në studime në universitete të ndryshme të botës, kanë ardhur në përfundim se çështja e liderit të lindur, i detyrohet (varet) nga disa faktorë të jashtëm dhe situata me të cilat ballafaqohet lideri, e të cilat e bëjnë njeri dhe lider të dalluar. Pra, siç kanë konfirmuar studimet dhe hulumtimet, këtu nuk kemi të bëjmë me asgjë të lindur, respektivisht lideri nuk lind i shkathët, njeri i madh apo hero², si do ta shohim ma vonë, por lideri i suksesshëm pregaditet, edukohet, trajnohet, testohet dhe pastaj mirret vendimi për të!


Kjo qasje më duket më e qëlluar. Lidershipi i suksesshëm ndërtohet mbi baza dhe aftësi të cilat i përvetëson dhe i përsosë njeriu i përgatitur për të qenë lider. Injorimi i shkathtësive dhe i trajnimeve të domosdoshme për lidërsip të suksesshëm është gabim. Dituria, siç kanë thënë, *është me të mësuar, sabri me të duruar, ndërsa çështja e dhuntisë hyjnore mbetet relative, gjegjësisht Allahu i jep dhunti kujt të dojë prej robërve të Vet! Allahu e di më së miri!*

Disa studime të viteve 1948, 1959 dhe 1974 të gjysmës së dytë të shek. të kaluar, pra shek.XX, të kryera në universitet të ndryshme botërore me të dy gjinitë, rezultojnë se tiparet më të theksuara me të cilat dallohet një lider i suksesshëm janë ³:

¹ Shih: Peter Northouse, *Leadership - Theory and Practice*, (Western Michigan University, ed. 7) f. 44-45.

² Po aty, f. 46-47.

³ Utejbi, Nevvaf bin Sefer bin Muflih, *El-enmat el-kijadije*, vep.cit., f. 39. Shih po kështu: Peter Northouse, *Leadership*, vep.cit., f. 47.




Sipas studimeve të kryera në vitin 1959, gjithnjë sipas teorisë së tipareve, lideri i suksesshëm duhet të dallohet edhe për këto cilësi¹:



¹ Shih: Peter Northouse, *Leadership*, vep.cit., f. 47. Shih po kështu edhe librat elektronikë: Muhammed Mulla, *Idaretu ve kijadetu fireki el-amel*; Eshref bin Muhammed, *El-ixhabijje fi el-amel*.

Studimet e mëvonshme kanë përmendur dhe tipare të tjerë që duhet ti ketë një lider ¹, e që janë:



¹ Shih: Peter Northouse, Leadership, vep.cit., f. 47. Shih po kështu edhe: The Bases of Social Power, J.R.P. French; The Little Book of Leadership, libër elektronik nga: TheLeadershipHub.com

Përmbledhje

Konsideroj se trajtimi ynë për qasjen ndaj lidërshiptit sipas teorisë së tipareve duhet të përmyllet me kaq. Shpjeguar esencën e lidërshiptit dhe përmbajtjen e tij. Tiparet e nënvizuara prej autorëve të këtyre teorive i përkrahim fuqishëm dhe në tërësi sepse ato janë të konfirmuara në Kur'an dhe Sunnet dhe, po të mos ishte droja nga zgjerimi i tepërt në temë, për secilën prej tyre do të sillnim dëshmi përkatëse.

Në kapitujt që vijojnë do të flasim për modele të lidërshiptit të suksesshëm sipas Kur'anit, të cilit mund t'i kthehemi për dëshmi përkatëse. Ajo që na intereson apriori me këtë rast është se kjo teori nuk solli diçka të re apo tipar të liderit të suksesshëm që Kur'ani dhe Sunneti nuk e përmbajnë dhe nuk e kanë trajtuar¹.

Dituria, aktualiteti, vërtetësia e informacioneve, durimi, përmbajtja, nxitimi në punë të mira, vetllogaria, mëshira me vartësit, vetëbesimi, aftësia për zgjidhjen e problemeve, etj, janë cilësi që duhet t'i ketë secili përgjegjës që merr përsipër një punë a detyrë të caktuar. Kur'ani dhe Sunneti gjerësisht i kanë shtjelluar këto tipare në shumë ajete dhe hadithe, si do ta shohim më vonë, dhe Allahu e di më së miri!

¹ Për më shumë rreth tipareve dhe shkathtësive që duhet t'i posedojë një lider, shih: Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, f. 66-67. Shih po kështu edhe: Mahmud Ahmed Astal, *El-kijadetu fi dav'i el-ajat el-kur'anijeh*, f. 49-100; Tahir Hamad Muhammed, *El-kijadetu ve el-xhundijjetu si es-Sunneti en-Nebevijje*, f. 64-75.

1.2. Teoria e kontigjencës – Fiedler Contingency Theory

Kjo qasje¹ është e një rëndësie të veçantë pasi që fokusohet tek mënyra se si lideri sillet me popullin/vartësit/nëpunësit dhe i trajton ata, respektivisht fokusohet tek ana produktive dhe raportet shoqërore brenda një korporate, institucioni apo organizate. Universitete me famë botërore² kanë bërë hulumtime të shumta me fokus sjelljet e liderit dhe vartësve duke u përqendruar tek tre çështje, si më poshtë:



¹ Modeli i Kontigjencës Fiedler u krijua në mesin e viteve 1960 nga **Fred Edward Fiedler** (Korrik 13, 1922 - Qershor 8, 2017) një shkencëtar austriak-amerikan, që studioi personalitetin dhe karakteristikat e udhëheqësve.

² Shih: Utejbî, Nevvaf bin Sefer bin Muflîh, *El-enmat el-kijadije ve essimat esh-shahsijje li-mudiri el-medaris...*, vep.cit., f. 39-43.

Nga këto studime kanë dalë edhe nën-teori të cilat, në një ose formë tjetër, janë të orientuara kah tre çështjet që përmendëm në grafikun e mësipërm, për çka edhe mendojmë se nuk ia vlen t'i përmendim detajisht. Në fakt, ne do të përzgjedhim dy prej tyre, si më të rëndësishmet. Ato janë: *teoria dy-dimensionale në lidërsip* (**The Two Dimensional Theory in Leadership**) dhe *teoria e rrjetit menaxherial në lidërsip* (**The Grid Managerial Theory in Leadership**).

Teoria dy-dimensionale në lidërsip (*The Two Dimensional Theory in Leadership*)


Ky studim është realizuar në universitetin Ohajo (*Ohio State University*) në SHBA. Rezultatet e tij konfirmojnë ekzistimin e katër tipave të liderëve¹ sipas teorisë së kontigjencës, ku shkencëtarët janë fokusuar tek performanca në detyrë. Këta liderë, prej disa hulumtuesve i kanë quajtur lider të orientuar kah prodhimi (*Task Oriented Leader*) dhe liderë të orientuar kah punëtorët (*Social Emotional Leader*). Për këtë shkak quhet teoria *dy-dimensionale*², pra teoria e mbështetur në *dimensionin e performancës* dhe *dimensionin e raporteve shoqërore*. Sipas detajeve që kanë dhënë këto studime, vetëm një nga katër llojet e lidërsipit është dalluar për përfshirjen e të dy elementeve apo dimensioneve përderisa tre të tjerat kanë

¹ *a-Lider autokratik* (i cili fokusohet më shumë tek performanca, më pak tek punëtorët, mbikëqyrje e rreptë e punëtorëve dhe motivim nëpërmjet frikës), *b-lider liberal* *Laissez-Faire* (duke u lënë vartësve një shkallë të madhe lirie të përcaktojnë vet objektivat si dhe mënyrën e realizimit të tyre), *c-lider human* (që i kushton pak rëndësi performancës dhe shumë punëtorëve) dhe, *d-lider demokratik* (që i kushton shumë rëndësi performancës dhe punëtorëve, merr mendimin e vartësve dhe konsultohet me ata). **Përkthyesi** (huazuar nga ligjërrata e punime universitare).

² Shih: Utejbî, Nevvaf bin Sefer bin Muflîh, *El-enmat el-kijadije...*, vep.cit., f. 40-44.

përfshirë vetëm një nga dy dimensionet në fjalë. Ja dhe grafiku në vazhdim:

Teoria e rrjetit menaxherial në liderhsip (*The Grid Managerial Theory in Leadership*)



Kjo teori, që poashtu për origjinë ka teorinë e kontigjencës, fokusohet tek sjellja e liderit me pasuesit/vartësi/nëpunësit nëpërmjet pushtetit që ka lideri dhe liria që kanë të udhëhequrit nga ana tjetër. Nga këto studime, mënyra dhe stile lidershipi administrativ ka rezultuar shtatë lloje liderësh¹, sipas përshkrimit më poshtë:

¹ Shih: Utejbi, Nevvaf bin Sefer bin Muflih, *El-enmat el-kijadije...*, vep.cit., f. 49-51; Garib, Eshref bin Muhammed, *Ahlakijjat el-amel*, libër elektronik, ed. 1, 2013, f. 5-35. Shih edhe: Plunket, Lorne C & Hale, Guy A, *The Proactive Manager: The Complete Book of Problem Solving and Decision Making*, New York: Wiley, 1982, p:12; Bittel, Lester R. & New Strom John W, *What Every Supervisor Should Know*:

- 1) **Lideri administrativ autokrat** (*i cili merr vendimet kokë në vete dhe urdhëron zbatimin e tyre pa asnjë diskutim. Është autoritar dhe imponues.*¹)
- 2) **Lideri administrativ delegates** (*i cili merr vendimet dhe i bind nëpunësit. Poashtu autoritar.*)
- 3) **Lideri administrativ kuvendues** (*i cili merr vendimet pas shqyrtimit të mendimeve të nëpunësve. Deri diku edhe ky është autoritar.*)
- 4) **Lideri administrativ konsultues** (*është lloj eksperimentuesi, i cili hedh një vendim të përkohshëm me mundësi ndryshimi. Është një lloj lideri mes llojit demokratik dhe autoritar.*)
- 5) **Lideri administrativ analist** (*është ky udhëheqësi që e prezanton problematikën, ofron mundësinë e debateve dhe në fund, pas analizës së mendimeve, merr vendimin e duhur. Ka nivel më lartë se demokracia.*)
- 6) **Lideri administrativ këshillëdhënës e drejtues** (*i cili i ikën përgjegjësisë duke ua lënë vartësve apo nëpunësve marrjen e vendimit. Është në një shkallë më lartë se demokracia.*)
- 7) **Lideri administrativ liberal / anarkist** (*shpërfillës, i cili u jep liri të plotë vartësve në marrjen e vendimeve në suaza të kufijve dhe limiteve të proklamuar.*)

Këta shtatë shembuj lidershipi janë të ndërthurur dhe të lidhur mes vete si në aspektin procedural ashtu dhe në atë praktik, por ndryshojnë nga aspekti i implementimit.

The Complete Guide to Supervisory Management, New York: McGraw-Hill, 1990, The 60 Second Leader – Every.

¹ Shënimet brenda kllapave janë nga përkthyesi. Burim i tyre është referenca e autorit. Në fakt, autori ato i ka përmendur përmbledhtazi në grafikun e mëposhtëm, të cilat, për shkaqe teknike, ne i bartëm këtu në tekst.

Sigurisht, lideri shembullor dhe i suksesshëm nuk do të duhej ta mendonte veten kurrë në dy stilet e para të lidershimit¹. Grafiku më poshtë na i përshkruan figurativisht këto stile lidershimi:



Në përfundim të këtij diskutimi për këtë teori, dua të potencoj se secila krizë dhe problematikë, secili institucion dhe organizatë, ka rrethanat përkatëse administrative, ushtarake, emocionale e shpirtërore, shoqërore, akademike, të cilat përcaktojnë mënyrën e

¹ Shih referencat e mëparshme dhe po kështu: Ebu Sulejman Abdul Hamid, *Ishkalijjetu el-istibdad ve el-fesad fi ettarih el-islamij*, (Bejrut: El-ma'had el-alemij li el-fikri el-islamij, 2012), f. 13-19; Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, ve.cit., f. 84.

zgjdhjes së problemit dhe natyrën e vendimit përkatës¹. Do të ishte absolutisht joprofesionale sikur për të gjitha problemet të kishim një formë udhëheqje e menaxhimi! Dhe Allahu e di më së miri!

Përsa i përket konfirmimit Kur'anor dhe profetik të këtyre tipareve, do të thoshim me përgjegjësi se shumë shkrime të mbështetura në burime fetare kryesore trajtojnë këto tipare e cilësi detalisht. Në kapitullin mbi lidërshtipin e suksesshëm sipas Kur'anit Fisnik kemi sjellë dëshmi të mjaftueshme andaj kush të dojë mund t'u kthehet atyre për më shumë detaje.

¹ Shih raportin e organizatës Leaders Development sipas librit elektronik *El-kijadetu el-idarije* të publikuar në portalin www.leadership.com.sa, f. 20-25.

1.3. Qasja situacionale e lidershipit

Kjo është qasja apo teoria e tretë në botën e lidershipit. Sipas saj, lidershipi nuk ka të bëjë me tiparet apo sjelljet që duhet t'i ketë një lider. Ajo është diçka tjetër, diçka dinamike që ndryshon në vazhdimësi. Marrja e vendimit, sipas kësaj teorie, ka të bëjë me situatën dhe rrethanat ku gjendet një lider, kurse çdo lider varësisht nga gjendja, ka kërkesa dhe nevoja të veçanta.

Edhe kjo teori ka nën-teori që rrjedhin prej saj dhe të cilat, që të gjitha, sillen rreth raporteve lider¹ - pasues. Po kështu trajtojnë *besueshmërinë e liderit tek pasuesit, strukturën e detyrave, mënyrat e vlerësimeve, metodat e punës, kriteret e performancës*².

Ne, duke u bazuar në rëndësinë që kanë këto ide, kemi përzgjedhur vetëm dy prej tyre, si më të rëndësishme, e të cilat janë:


¹ *Teoria situacionale e Fidlerit (Fiedler Contingency Theory), Teoria e Hersit dhe Blanshardit (Herse & Blanchard Theory); Teoria e William Redinit (William Reddin Theory), Teoria shtegu - qëllimi (The Path - Goal Theory), etj.*

² Shih: *Tevel-li el-kijade*, f. 45-49; Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 52. Shih po kështu: Peter Northouse, *Leadership – Theory and Praticce*, p:115 – 137; *Army Leadership: Be, Know, Do, - Part Three: Organizational and Strategic Leadership*, 6-1.

Teoria situacionale e Fidlerit

Sipas kësaj teorie, nuk ka ndonjë lloj i veçantë lidërsशिpi i cili vlen për çdo kohë dhe çdo vend. Rrjedhimisht, lideri duhet të përshtatet me kushtet dhe rrethanat. Në fakt, përshtatja e rrethanave me stilin e lidërsशिpi kushtëzohet me ekzistimin e tre faktorëve esencialë:

Siç mund ta vërejmë nga grafiku, sa më të qarta detyrat aq më e lehtë bëhet zgjidhja e krizës dhe marrja e vendimit. Po kështu, kurdo që raportet e liderit me pasuesit të jenë të forta, sukseset do të jenë përtej pritshmërisë kurse lideri do të ketë mundësi të nxjerrë vendime për shpërblime apo ndëshkime, varësisht nga rasti dhe situata¹.




¹ Shih: Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 117. Shih po kështu: Tarik Suvejdan dhe Fejsal Bashurahajl, *Sinaatu el-kaid*, (Arabia Saudite: Mektebetu Xherir, ed. 3, 2004), f. 10-30.

1.4. Qasjet moderne të lidershipit

Teoria e Robert Hausit (Robert House): shtegu - qëllim

Autor i kësaj teorie është hulumtuesi Robert House ¹. Teoria pjesërisht mbështetet në idenë e parashikimit dhe motivimit, nëpërmjet ndihmës për pasuesit për të përcaktuar objektivat e tyre, sqarimit të mënyrave asistuese për realizimin e këtyre objektivave dhe eliminimin e çfarëdo pengese që mund të shfaqet në këtë rrugë². Që të realizojmë këto synime, atëherë ne kemi nevojë për një lider i cili shquhet për sjelljet dhe tiparet e mëposhtme që grafiku shpalos:




¹ E njohur gjithashtu si teoria e rrugës - qëllimit të efektivitetit të udhëheqësit ose modeli i rrugës - qëllimi, është një teori udhëheqjeje e zhvilluar nga Robert House, një i diplomuar i Universitetit Shtetëror të Ohajos, në 1971 dhe i rishikuar në 1996

² Shih: Northouse, *Leadership: Theory and Practice*, f. 115-126; Utejbî, *El-enmat el-kijadije....*, f. 54-56; Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, f. 52-53; Tashtush, Hajil Abdulmevla, *Esasijjat fi el-kijadeti ve el-idareh – ennemudexh el-islamij fi el-kijadeti ve el-iradeh*, (Jordani: 2008), f. 20-45.

Është kjo qasje e katërt përkitazi me lidërsipin, esencën dhe elementet përbërëse të tij. Teoricienët bashkëkohorë çështjen e lidërsipit e shohin si proces interaktiv ndërmjet liderit dhe pasuesve dhe si proces transformues nga një në një tjetër, respektivisht nga një gjendje e keqe në një gjendje më të mirë. E konsiderojnë si lidërsip karizmatik...

Gjatë shqyrtimit dhe analizimit të mendimeve dhe ideve të autorëve të kësaj qasje, ne, në fakt, gjejmë më shumë formalitete, gjegjësisht art në emërtime dhe tituj, ndryshe, esenca e lidërsipit nuk ndryshon shumë nga qasjet paraprake.

Për ta thjeshtësuar këtë qasje do ta ndajmë si më poshtë



Në vazhdim do të ofrojmë shpjegime të hollësishme për këto stile lidërsipi.

1. Lidershipi transaksional

Ky lloj lidershipi është i ndërtuar mbi raportet materiale ndërmjet menaxherit dhe punëtorëve, respektivisht shpërblimeve për suksese dhe ndëshkimeve për dështim apo mos kryerje të detyrave. Kjo ndodhë sipas faktorëve në vijim¹:

Shpërblime të miratuara njëzëri, me të cilat përfshihen metodat e përkrahjes dhe mbështetjes pozitive dhe të ndërsjellë ndërmjet liderit dhe punëtorëve.

Administrimi me përjashtime, kur lideri ndreq gabimet nëpërmjet shpërblimeve dhe ndëshkimeve.

Sipas këtij modeli lidershipi, lideri është vetëm një vegël a instrument², roli i të cilit përkufizohet në ekzekutimin e rregulloreve të organizatës, as më shumë dhe as më pak. Nëse punëtorët punojnë mirë - shpërblehen, nëse punojnë keq - ndëshkohen. Pra, në të dy rastet, çfarë të punojnë, për vete punojnë³.

Si shembull të këtij lloji lidershipi mund të marrim një politikan kandidat për një post të rëndësishëm shtetëror, i cili i premtun elektoratit se nëse fiton besimin e tyre dhe zgjidhet në atë pozitë, do t'ua heqë taksat. Ose profesori i cili u premtun studentëve nota

¹ Shih: Northouse, *Leadership: Theory and Practice*, f. 162; Utejbji, *El-enmat el-kijadije....*, f. 65.

² Sipas disa studimeve, ky lloj lidershipi hyn në kuadër të lidershipit autokrat sepse vetëm lideri autokrat beson se shpërblimi material i motivon punëtorët...Shih: Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, f. 56.

³ Shih për më shumë: *El-kijadetu el-idarijetu ve ref'u el-haleti el-ma'nevijeti fi el-hitabi el-kur'anij*, Ibrahim Ali Salim Iblavo, Universiteti i Masratas, Libi, f. 10-16.

të larta nëse angazhohen dhe tregojnë sukses, drejtori që motivon punëtorët për të arritura, etj¹.

Lidhur me këtë lloj lidërshipi, ekzistojnë mësimet dhe udhëzime të rëndësishme Kur'anore, të cilat duhet të merren parasysh nga lideri apo udhëheqësi, pavarësisht se për kë, për çfarë organizate bëhet fjalë. Disa studiues kanë përmendur se një administrator apo lider i suksesshëm, sipas Kur'anit Fisnik duhet t'i ketë edhe tiparet tjera: **të jetë bashkëpunues me vartësit/punëtorët/popullin, të ketë mendim të mirë për ta, të verifikojë lajmet dhe informacionet përkitazi me ta** (*ikja nga paragjykimi dhe gjykimi i nxituar*), **të jetë i drejtë në vlerësimin e tyre, të jetë i paanshëm, të krijojë një klimë vëllazërore, bashkëpunuese, të kultivojë respekt ndërmjet punëtorëve, pastaj këtu hyn dhe përhapja e frymës së tolerancës dhe fleksibilitetit, korrektësia në fjalë dhe vepra me punëtorët**², etj.

Në vazhdim do t'ju sjellim këto mësimet në formë grafikoni:

¹ Shih: Northouse, *Leadership: Theory and Practice*, f. 162.

² Shih për më shumë: *El-kijadetu el-idarijetu ve ref'u el-haleti el-ma'nevijeti fi el-hitabi el-kur'anij*, Ibrahim Ali Salim Iblavo, vep.cit., f. 10-16.




Siç mund të vërejmë, këto udhëzime apo mësimë Kur'anore kanë lidhje të drejtpërdrejtë me temën e lidershipit të suksesshëm dhe ato nuk janë në kundërthënie me teoritë moderne të lidershipit. Përkundrazi, ato përputhen pothuajse plotësisht me to.

Sa shumë kemi nevojë për këto këshilla, udhëzime e rekomandime mbi lidershipin që ushtrojmë!¹ Sa shpesh duhet t'i sjellim ndërmend dhe t'i aplikojmë, e jo t'i tkurrim ajetet dhe hadithet në kuptime të ngushta ngaqë këto rekomandime dhe këshilla nënkuptohen nga feja!

¹ Shih: El-Kebir, Ahmed bin Abdullah, *El-kijadetu el-ahlakijetu min mendhurin islamij – dirasetun nadharijetun tatbikijetun mukarenetun*, (Rijad: Mektebetu Melik Fehd). Shih edhe: Talib, Hisham, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep.cit., f. 56-57.

2. Liderhipi transformues

Thelbi i teorive transformuese është që udhëheqësit të transformojnë pasuesit përmes natyrës së tyre frymëzuese dhe personaliteteve karizmatike. Pra, lideri është ai që transformon qëndrimet negative në qëndrime pozitive dhe që përfiton nga mundësitë që ka në dispozicion. Lideri këtu ka një rol aktiv, është instrument ndryshimi i një gjendje të caktuar, nga një gjendje te keqe në një gjendje të mirë dhe këtë e bën konform mundësive që ka. Sipas kësaj teorie transformuese, lideri është ai që nxit dhe stimulon pasuesit për të lëvizur para, në realizimin e sukseseve përtej pritshmërisë¹. Grafikoni në vazhdim e shpjegon rolin e liderit transformues sipas asaj që parashohin ekspertët e kësaj fushe:



¹ Shih: Peter Northouse: *Leadership-Theory and Practice*, vep. cit., f. 5; 161; Mahmud Muhammed Astal, *El-kijadetu fi dav'i el-ajat el-kur'anijeh*, vep.cit., f.100; Nehhal, Hamad Muhammed, *El-kijadetu ve el-xhundijjetu fi es-Sunneti en-Nebevije*, tezë masteri, (Gaza: Universiteti Islamik, 2007), f. 64-84.

Siç mund të kuptohet nga titulli i këtij lloj lidershipi dhe përmbajtja e tij, lideri angazhohet me tërë kapacitetin intelektual e material për ta ndryshuar për të mire gjendjen e pasuesve dhe të organizatës, në të gjitha poret.

Nevoja jonë për liderë të tillë sot është më e madhe se kurdoherë më parë!


3. Lidershipi vizionar

Ky lloj lidershipi shquhet për aftësinë për të mbjellë dhe përçuar vizionin e vërtetë dhe të drejtë të së ardhmes së organizatës, e cila do të jetë më e zhvilluar se që është aktualisht. Liderët vizionarë, siç shprehen Robinsi dhe Decenzo, krijojnë një vizion realist, të besueshëm, tërheqës për të ardhmen, që buron prej së tashmes dhe synojnë ta përmirësojnë atë. Nëse ky vizion përmbushet në plotësi, rritet dhe aftësia e tij për të zgjuar forcat brenda pasuesve, për ta ngjallur vullnetin dhe për të shtuar mundësitë e realizimit të kësaj ardhmërie të ndritur¹.

Lideri vizionar ka një vizion të qartë të së ardhmes dhe këtë synon ta arrijë nëpërmjet përcaktimit preciz dhe të saktë të këtij vizioni dhe përcjelljes së tij tek pasuesit, të cilët i motivon dhe i nxitë ta përvetësojnë, t'i përmbahen dhe ta zbatojnë me përpikmëri.

Më qartë shohim dhe në grafikonin në vazhdim:

¹ Shih: Utejbi, *El-enmat el-kijadije....*, vep. cit., f. 66; Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 56-66; Mahmud Muhammed Astal, *El-kijadetu fi dav'i el-ajat el-kur'anijeh*, vep.cit., f. 84-100; Nehhal, Hamad Muhammed, *El-kijadetu ve el-xhundijetu fi es-Sunneti en-Nebevije*, vep. cit., f. 64-83.



4. Lidershipi karizmatik

Sipas Utejbis, lideri karizmatik është person jo i rëndomtë. Është lideri me tiparet më të theksuara, ku bëjnë pjesë largpamësia dhe objektivat shembullore. Ai ka aftësinë për t'iu futur aventurave dhe rreziqeve me qëllim të realizimit të vizionit që ka. Ka empati për hallet e punëtorëve. Për realizimin e qëllimeve aplikon metoda inovative¹. Rëndësia e këtij lloj lidershipi qëndron në lidhjen që krijohet ndërmjet liderit dhe pasuesve ku këta të fundit identifikohen me liderin.

Për më shumë, grafikoni në vazhdim sqaron detalet:



¹ Shih: Utejbi, *El-enmat el-kijadije....*, vep. cit., f. 67; Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 63-68; Mahmud Muhammed Astal, *El-kijadetu fi dav'i el-ajat el-kur'anijeh*, vep.cit., f. 49-100; Peter Northouse; *Leadership: Theory & Practice*, f. 189; 230.

Profesori ynë i lidershipit, dr. Tarik Suvejdani, nga Kuvajti, Allahu e ruajttë! dallohet për një kontribut gjigant në këtë fushë, kontribut të cilin duhet ta perceptojnë në veçanti organizatat dhe institucionet shkencore e intelektuale¹.

Sipas tij, që një lider të jetë i suksesshëm, duhet të kryeje këto tetë role: **planifikimin dhe kreativitetin, nxitjen dhe stimulimin, shëmbëlltyrën e mirë, trajnimin, marrëdhëniet, fuqizimin, delegimin, ndërhyrjen.** Këto role mundë t'i përmbledhim në grafikoni që vijon:

¹ Në një takim televiziv në programin *El-ibdaë*, në dhjetor të vitit 2015, duke folur përkitazi me shkathtësitë e lidershipit modern, foli qartë e thuktë, duke filluar me shkakun e krizës nëpër të cilën po kalon ymeti e që sipas tij përmbledhet në pesë pika: 1- kriza e sjelljes me të gjitha format e saja, 2- kriza e prapambeturisë në kritere dhe standarde ndërkombëtare në arsimim dhe administratë, 3-kriza e efikasitetit me mungesë të produktivitetit, 4-kriza intelektuale dhe, 5- kriza e lidershipit. **Këto dy të fundit janë shkak i tre krizave të para.** Pastaj vazhdoi duke përmendur një definicion të lidershipit i cili sipas tij është: *aftësia për të shtyrë njerëzit drejt qëllimit.* Pastaj vazhdoi diskutimin mbi çështjen e frymëzimit në lidership duke shpjeguar se lider frymëzues është ai që ka një ide të ndryshimit dhe që punon për hir të një kauze. Sipas disa studimeve, shton dr. Suvejdani, tiparet e liderit shkojnë përtej shifrës prej 225 sosh dhe 59 shkathtësi, prej të cilave dhjetë shkathtësi janë të rëndësishme e prej këtyre të dhjetave një është më e rëndësishmja. **Kjo është shkathtësia për të analizuar personalitetet, organizatat dhe kompanitë.** Sipas tij çdo lider njëherit është dhe drejtor dhe anasjelltas. Pastaj kaloi tek parimet në lidership dhe mos heqjen dorë prej tyre për asnjë interes, gjë kjo goxha e vështirë. **Personalisht, këtë emision e kam veçuar si më të rëndësishmin dhe më mirin.** Për këtë shkak edhe e kam bërë këtë përmbledhje.

Për ata që duan ta shikojnë emisionin në tërësi, ky është linku (*i shfletuar për herë të fundit më 18 prill 2019*): <https://www.youtube.com/watch?v=zY6UEdXBTlo>

Roli liderit të suksesshëm sipas Dr.Tarik Al Suvejdanit:




2. KOMPONENTËT E LIDERSHIPIT

Si çdo shkencë apo art që ka detajet dhe komponentët përbërës ku mbështet, edhe lidershipi ka veçoritë themelore prej të cilëve formohet dhe vepron. Shkencën dhe artin e lidershipit nuk mund t'i kuptojmë nëse paraprakisht nuk e sjellim ndërmend një trekëndësh ku bëjnë pjesë: *lideri, pasuesit dhe qëndrimet ose situata që duhet menaxhuar.*


Bazuar në këtë, lidershipi ka elemente dhe përbërës pa të cilët nuk mund të paramendohet, pavarësisht nga lloji i lidershipit. Nëse e kemi parasysh rolin dhe rëndësinë shoqërore që ka lidershipi, ushtrimi i tij nuk mund të imagjinohet në mënyrë individuale. Më qartë, lideri nuk mund të veprojë i vetëm. Patjetër duhet ta ketë një grup ku e ushtron këtë rol. Po kështu edhe në suaza të një qëndrimi a situatë të caktuar. Së këndejmi, kemi tre përbërës ku mbështetet lidershipi, e që janë:

2.1. Komponentët e lidershipit

Në vazhdim një shpjegim përkitazi me atë që synohet me këta tre përbërës që duhet t'i ketë lidershipi:



1) Në këtë kontekst, liderët kryesisht janë dy llojesh: *natyralë dhe administrativë*.



a. **Liderët natyralë;** janë ata që janë liderë nga natyra. Kanë trashëguar tipare dhe cilësi gjenetike të cilat i bëjnë të jenë liderë të dalluar.

b. **Liderët administrative;** janë ata që shkathtësitë e lidërshiptit duhet t'i përvetësojnë nëpërmjet të mësuarit.

Këtu patjetër duhet të bëjmë një sqarim;

Secili njeri lind i pastër dhe larg ndikimeve të jashtme. Pra, lind me besimin e pastër në Një Zot, me monoteizëm, jo idhujtari. Pastaj janë prindërit janë ata që e orientojnë kah feja dhe mendimi që ata e kanë përvetësuar, mu ashtu siç na shpjegohet në hadith – thënie profetike. Ky është fakt dhe e vërtetë. Pra, i sapolinduri nuk ka lidhje me dijen ose shkathtësitë. Këto i fiton me kalimin e kohës paralelisht me zhvillimin mendor, fizik, emocional e kulturor.

Kështu qëndron puna edhe me artin e lidershipit. Nuk ka njeri që lind lider apo i madh. I tillë bëhet më vonë gjatë jetës, kur përvetëson shkencën dhe artin e lidershipit, kur trajnohet, edukohet, konsultohet, lexon e studion...Kjo është e vërteta sipas mendimit tonë, dhe ky është parimi dhe besimi ynë. Në këtë kontekst, besojmë dhe nuk e mohojmë edhe faktin gjenetik pozitiv/negativ trashëgues nga prinderit apo stergjysherit që një lider mundë t'i ketë, dhe ajo trashëgimi gjenetike ndikon pjesërisht në formimin e liderit të suksesshëm, dhe Allahu e di më së miri!¹

Këtë të vërtetë e ka konfirmuar edhe reformuesi, lideri dhe teoricieni, dr. Tarik Suvejdani, me veprat e tij, ku ka realizuar një pyetësor me të dy gjinitë rreth asaj nëse **lidershipi është çështje e lindur apo përvetësohet**. Përgjigjet ishin si në vijim: *1% e të të anketuarve kanë thënë se lidershipi është çështje e lindur, 98% - se përvetësohet, ndërsa 1% tjetër kanë qenë skeptikë dhe nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje*².

Në këtë kontekst mos harroni se:

c. Përbërësi i vendit apo situatës konsiderohet pjesë e rëndësishme në formimin e komponentëve të lidershipit nga: Aspekti i përvojave dhe praktikave, njeriu arrin të kuptojë se disa individë janë liderë në raste dhe rrethana të caktuara kur duhet të marrin vendime konform llojit të lidershipit që kanë; ushtarak, civil apo akademik.

¹ Shih: Samuel Hejz de William Tomas, *Tevel-li el-kijadeh – Fennu el-kijadeti el-aslkerijje ve ilmuha*, përktheu: Samir Hisham, f. 24.

² Për më shumë shih ligjëratën treorëshe të mbajtur nga dr. Tarik Suvejdani me ftesë të Ministrisë së Arsimit dhe Arsimit të lartë në Katar në kuadër të punimeve të konferencës së arsimit në vitin 2016. Ligjërata është e postuar edhe në rrjetin social Youtube, në linkun (e shfletuar më 23 prill 2019): <https://www.youtube.com/watch?v=wnVp29oqOyw>

Hulumtuesit kanë vërtetuar që ka liderë që dallohen për fuqinë influencuese tek të tjerët (më shumë se çdokush tjetër) dhe se ata kanë mënyra dhe metoda të rralla të vërtetuara në mënyrë empirike për sa i përket ndikimit dhe influencës¹.

Sipas ekspertëve të lidershimit ushtarak, lidershimi ndikohet nga: *Një numër i pafundmë i gjendjeve dhe situatave që ndryshojnë, duke përfshirë këtu misionin, rajonin, klimën, rezistencën e armikut, kohëzgjatjen e luftimeve, viktimat, ushtarët shtesë për t'i plotësuar njësitë që kanë humbur ushtarë, pushimin, stërvitjen, mjetet dhe arsenalin ushtarak në dispozicion, furnizimet, dhe shumë e shumë faktorë tjerë që ndikojnë tek lideri (komandanti) ndërsa kryen misionin e vet e që është e pamundur të parashikohen të gjithë...², dhe mos harroni se:*

d. Komponenti i pasuesve (*varësve, punëtorëve, ushtarëve, personelit arsimor, studentëve, popullit*) është komponent jetik pa të cilin lidershimi nuk mund të paramendohet. Raportet ndërmjet tij dhe komponentit të parë, liderit, përcaktohen nga trendet dhe idetë të cilat i përjetojnë pasuesit dhe lideri dhe të cilat, rrjedhimisht, përcaktojnë pranimin ose refuzimin e të dhënave të pozicionit komandues. Kurdoherë që pasuesit përshtaten me qendrat e tyre komanduese, do t'i kuptojnë më mirë idetë e tyre dhe do t'i kenë më të qarta idetë për realizimin e të cilave janë duke u angazhuar.

Me këtë rast duhet të sillni ndërmend se ekzistojnë disa faktorë esenciale që lideri duhet t'iu bëjë terren që të arrijë sigurinë dhe kënaqësinë e pasuesve, si:

¹ Talib, Hisham, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 64.

² Shih: Samuel Hejz & William Tomas, *Tevel-li el-kijadeh – Fennu el-kijadeti el-aslkerijje ve ilmuha*, vep.cit., f. 30.

Krijimin e një klime të përshtatshme respekti dhe pranimi

- Krijimin e një klime të përshtatshme respekti dhe pranimi në raportet me vartësit sepse këta të fundit nuk ndihen të qetë derisa të mos mësojnë se janë të pranuar nga lideri.

Vetëdijesimi i individit për natyrën e punës dhe kërkesat e saja

- Individi duhet të ketë njohuri të mjaftueshme për punën që do ta kryejë dhe këtë nëpërmjet njohurive për politikën e përgjithshme të organizatës ku punon, njohjes me gjërat që parashihen e kërkohen nga puna e tij, përgjegjësia, detyrat, të drejtat dhe pozicioni që ka.

Ekzistimi i një sistemi që përcakton qartë raportet e punës

- Lideri e ka për detyrë tua shpjegojë punëtorëve rregulloren e punës, raportet që duhet të kenë me njëri tjetrin nga njëra anë dhe me liderin nga ana tjetër, kriteret mbi të cilat arrihen shpërblimet apo shqiptohen ndëshkimet. Natyrisht, duhet të vihet theksi mbi elementin e drejtësisë ndërsa flitet për shpërblime e ndëshkime që të mos shkaktojë revoltën e punëtorëve apo qoftë dhe ndonjë kundërshtim a refuzim.


Përbushja e nevojave ekonomike, shpirtërore dhe shoqërore të individëve

- Kjo nënkupton që individit (punëtorit) t'i mundësosh të kryejë punën që i përshtatet dhe ta kompensosh materialisht për punën që kryen pa ndonjë vonesë a zvarritje të pagës.

Disa hulumtues kanë përmendur edhe komponentë tjerë të lidershipit, si: *përmbajtja orarit, fokusimi në arritje apo suksese të vërteta, përqendrimi tek faktorët që rrisin fuqinë dhe ndikimin dhe largimi nga të tjerët që mund të shkaktojnë dobësi, përkufizimi në disa projekte dhe jo zgjerimi në shumë sosh prej tyre për shkak të pamundësisë për t'i realizuar¹, lidhja me Zotin e Plotfuqishëm, mbështetja tek Ai dhe kërkimi i ndihmës prej Tij, etj².*

Referuar tematikave të lidershipit që i përmendëm më parë, komponentët e lidershipit mund t'i përmbledhim në këto forma:

Grafiku në vijim përmban ajkën e komponenteve të lidershipit:



¹ Kjo çështje ka rëndësi të veçantë në mënyrë që lideri të ketë mundësi ta mbajë nën vëzhgim rrjedhën e punëve çdoherë. Hapja e fronteve të shumta sjell pak sukses. Kjo është dëshmuar edhe historikisht. Perandoria osmane në ditët e fundit të saj kishte hapur fronte të shumta në Ballkan, Azi, Evropë, por, për shkak të dobësisë ushtarake, nuk ia doli dhe për pasojë u detyrua të nënshkruajë marrëveshje me armiqtë rusë, bullgarë, etj.

² Shih: Talib, Hisham, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 57.

Ajka e komponentëve të lidershipit



2.2. Nivelet e lidershipit

Njerëzit dallojnë mes vete sipas dije, pasurisë, mendimit, pozitës, profesionit, fuqisë fizike, etj. Sekretit i këtij dallimi fshihet në këtë urtësi: të qenit i të gjithëve në shërbim i të të gjithëve. Pra, askush nuk është i panevojshëm për tjetrin. Sa bukur e ka shprehur këtë Ebu el-Ala Mearriu¹ në një prej vargjeve të tij poetike:

*Njerëzit për njerëzit, nga fshat e qytet,
janë shërbëtor të njëri-tjetrit, me të vërtet,
edhe po nuk e morën vesh këtë realitet²*

Këtë fakt Kur'ani e ka konfirmuar në disa ajete, prej të cilave do të veçojmë:

﴿أَمْ يَحْسَبُونَ أَنَّكُمْ عَلَيْهِمْ عِيشَتُهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَرَفَعْنَا بَعْضَهُمْ فَوْقَ بَعْضٍ دَرَجَاتٍ لِيَتَّخِذَ بَعْضُهُمْ بَعْضًا سُخْرِيًّا وَرَحِمْتُ رَبِّكَ خَيْرٌ مِّمَّا يَجْمَعُونَ﴾ [سورة الزخرف: 32]

“Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd? Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, me qëllim që disa t’u shërbejnë të tjerëve. Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata.”
[Kur’ani: Zuhruf: 32]

﴿وَاللَّهُ فَضَّلَ بَعْضَكُمْ عَلَى بَعْضٍ فِي الرِّزْقِ فَمَا الَّذِينَ فُضِّلُوا بِرَادِي رِزْقِهِمْ عَلَى مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَهُمْ فِيهِ سَوَاءٌ أَفَبِعَدْوٍ أَلَّيْكُمْ يَجْحَدُونَ﴾ [سورة النحل: 71]

“Disa prej jush Allahu i ka pajisur më mirë. Por, ata të cilëve u ka dhënë më shumë, nuk u japin furnizim atyre që i kanë nën vete, edhe pse janë të

¹ Abu al-Ala al- Mear-riu, 973-1057, Poet, Shkrimtar, Gramaticient dhe Mendimtar i shquar në kohën e periudhës Abasite.

² Mustafa Emijn & Ali el Xharim, El- belagatu el- Vadihatu, botoi Darul El Mearif, 1999, fq:227

barabartë në nevoja. Si po i mohoni dhuntitë e Allahut?" [Kur'ani: Nahl: 71]

﴿ أَنْظِرْ كَيْفَ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَلَآئِذَا أُنزِلَتْ آيَاتُنَا كَانُوا عَلَىٰهَا سَمِيلًا ﴾ [سورة

الإسراء: 21]

"Shiko, si Ne i parapëlqejmë-(dallojmë) disa ndaj të tjerëve. Kurse bota tjetër, në të vërtetë, do të ketë shkallëzime më të mëdha dhe parapëlqime (dallime) më të theksuara." [Kur'ani: Isra: 21]

﴿ قُلْ إِنَّ رَبِّي يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَن يَشَاءُ وَيَقْدِرُ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴾ [سورة

سبأ: 36]

"Thuaju: "Pa dyshim, Zoti im ia shton riskun ose ia pakëson kujt të dojë, por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë."" [Kur'ani: Sebe': 36]


Kështu qëndron puna edhe me lidërsipin, pavarësisht se për çfarë fushe lidërsipi bëhet fjalë.

Nivelet e lidërsipit mund të klasifikohen në nivele mbretërishe, halifësh, princërishe, kryetarësh, ministrash, deputetësh, drejtorësh shkollash e kompanish, rektorësh e dekanësh. Prej tyre ka që janë të zotë në punët që kryejnë dhe të aftë për të vënë strategji, për të bërë rekomandime, për të ekzekutuar e drejtuar, e ka edhe të tjerë që nuk ia kanë haberin fare¹.

Siç mund të shohim, dallimi ndërmjet liderëve është evident dhe pikërisht ky dallim ka përcaktuar nevojën e organit të shura-së apo **kuvendit, konsultimit**. Që një lider të jetë i suksesshëm dhe të mos gabojë, duhet të ketë rreth vetes njerëz të mençur e me përvojë, të diskutojë me ta e të merr mendimin e tyre, për të marrë më pas vendimet përkatëse.

¹Shih: Utejbi, *El-enmat el-kijadije...*, vep.cit., f. 21; Nehhal, *El-kijadetu ve el-xhundijjetu...*, vep.cit., f. 64-94; Astal, *El-kijadetu fi dav'i el-ajat el-kur'anijeh*, f. 34-44.

Nëpërmjet grafikut në vazhdim mund t'i klasifikojmë nivelet e lidershipit kësisoj:




Këtu mund të konkludojmë se lideret nuk janë të një rangu apo të një lloji, nivelet dhe llojet e tyre janë të ndryshme, fushat e tyre janë të ndryshme, mirpo mos harroni se këto parime dhe principe janë stabile dhe nuk ndryshojnë, dhe Allahu e di më mirë.

2.3. Dallimi ndërmjet lidershipit dhe presidiumit

Shumë janë ata të cilët kanë vështirësi me ba dallimin në mes lidershipit dhe presidiumit. Dallimi ndërmjet liderit dhe kryetarit dhe roleve të tyre përkatëse ka rëndësi të madhe në botën e lidershipit. Ekspertët dhe hulumtuesit kanë nënvizuar se dallimi ndërmjet tyre është goxha i madh.

Lidershipi lind nga një grup i cili e pranon pushtetin e tij, përderisa kryesia (presidenca) fuqinë e fiton jashtë grupit. Individët e pranojnë nga frika e ndëshkimit, tamam kështu siç shpjegohet në grafikun e mëposhtëm:



Pavarësisht ekzistimit të këtyre dallimeve ndërmjet lidershipit dhe presidiumit, siç po shihet qartë edhe në grafikun, shumë njerëz e kanë problem ta bëjnë këtë dallim, dhe ky ngatërrim mes tyre po ka pasoja. Për ta bërë sa më të qartë këtë dallim ndërmjet këtyre dy termeve, kemi përpiluar një tabelë, në të cilën kemi përmendur dallimet kryesore, duke e lehtësuar kështu këtë çështje¹.

¹ Shih: *Tevel-li el-kijade – Fennu el-kijadeti el-askerije ve ilmuha*, f. 18-19.

Lidershipi	Kryesimi / Presidiumi
Lidershipi mbështetet tek forca dhe shkathhtësitë e ndryshme të liderit si dhe buron nga besimi që grupi i jep liderit.	Mbështetet tek pushteti i garantuar nga sistemi, të cilin grupi duhet ta pranojë.
Lidershipi angazhohet në situata jo zyrtare, të atypëratyshme, dhe që nuk janë rutinë.	Presidiumi angazhohet në situata zyrtare, rutinë, dhe se këtë punë e bën në mënyrë të përhershme dhe të organizuar.
Burim i fuqisë së lidershipit është grupi dhe vet lideri, si p.sh., kapiteni i një skuadre futbollit apo basketbollit.	Burim i fuqisë është pozita të cilën e ushtron individi në sistemin e miratuar zyrtarisht.
Përcaktimi i objektivave të grupit bëhet nëpërmjet konsultimit me individët, ndërmjet të cilëve ekziston një lidhje respekti e dashamirësie.	Presidiumi ia përcakton grupit objektivat duke mos vlerësuar aspak angazhimin e individëve. Kjo bën që ndjenja e bashkimit dhe afrimit të rrënohet. Këtë gjë të hidhur e kemi përjetuar në institucione akademike, civile e ushtarake e fetare.

Po kështu liderët mund të klasifikohen në grupe të ndryshme sipas metodës me të cilën ata realizojnë pozitën e tyre udhëheqëse brenda grupeve zyrtare ose jozyrtare, sipas mënyrës se si ua imponojnë të tjerëve pranimin e pozitës dhe aftësive të tyre për të

udhëhequr, udhëzuar e rekomanduar si dhe për të ndikuar personalisht tek të tjerët. **Mos harro se:**

Çdo kryetar nuk është edhe lider, ndërsa çdo lider është edhe kryetar

Para se të kalojmë tutje, konsideroj se na duhet të bëjmë një ndalesë për tu marrë me një çështje të rëndësishme, me “...problemet me të cilat ballafaqohet lidershipi ushtarak-por edhe ai politik, akademik e fetar, ku - pjesa dërrmuese e të cilave janë të ngjashme me problemet me të cilat ballafaqohen liderët civilë. Edhe shkathtësitë të cilat duhet t’i përvetësojnë liderët e të dyja fushave janë pothuajse të njëjta, përveç që në rastin e parë, një lider ushtarak, për shkak të natyrës së detyrës, duhet të dallojë se... lidershipi në forcat e armatosura, për nga natyra është sikur një organizatë singa realiteti ashtu edhe nga emërimi, duke shtuar këtu edhe përgjegjësitë e rrezikshme të luftimeve dhe stërvitjes adekuate. Lideri ushtarak duhet të ushtrojë shkathtësi dhe teknika administrative, të cilat njëherësh vlejné dhe aplikohen edhe në tregti e industri e gjetiu...dhe pavarësisht dallimeve të mëdha në situata apo në sistemin organizativ, individët të cilët duhet ta marrin udhëheqjen, **kërkesat thelbësore për lidershpin mbasin të njëjta tek të gjithë.** Edhe liderët ushtarakë patjetër duhet të ndikojnë tek pasuesit (ushtarët), t’i mbajnë nën kontroll dhe t’i udhëzojnë drejt qëllimeve të caktuara...Që sot liderët të përgatiten në mënyrë profesionale, patjetër duhet të kenë njohuri rreth shkaqeve të gjërave dhe esencës së tyre. Disa njohuri e shkathtësi mund të përvetësohen nëpërmjet përvojave dhe trajnimeve por njohuritë rreth lidershpit janë element kryesor i cili ia mundëson liderit të nxjerr apo përfitojë norma të përgjithshme nga përvojat e tij, të kuptojë më thellësisht gjërat, dhe të ambientohet me situatat e ndryshme...¹”

¹ Tevel-li el-kijade – Fennu el-kijadeti el-askerijeh ve ilmuha, f. 13-14.

Për ta kuptuar më lehtë e më qartë këtë problematikë, në formë tabelare krahasuese, do të përmendim disa prej termeve të përafërta dhe të ngjashme të përmendura në fushat e lidërshipt ushtarak dhe atij civil duke shpjeguar aplikimin e secilit prej tyre në fushën përkatëse ¹.

Nr.	Termi	Përdorimi në fushën ushtarake	Përdorimi në fushën civile
1.	Komandant (Commander)	Gradë, njeri me pozitë, komandant, udhëheqës i caktuar zyrtarisht i një njësie ushtarake, ka ndikim tek të tjerët. Në këtë fushë është më pak domethënës.	Drejtor, udhëheqës i emëruar i një njësie, ka ndikim tek të tjerët, me më shumë domethënie në fushën teknike.
2.	Komandë (Command/Commande)	Udhëheqje, dominim, kontroll, pozitë me pushtet të miratuar ligjrisht të cilën komandanti e ushtron ndaj vartësve të tij (ushtarëve) falë gradës që ka dhe aftësisë për të ndikuar tek të tjerët. Ka domethënie më të gjerë se teknikat e menaxhimit.	Menaxhim, aftësi, pozitë me pushtet të miratuar ligjrisht dhe të ushtruar nga drejtori falë gradës dhe aftësisë për të ndikuar tek të tjerët. Ka rreth më të ngushtë veprimi se ai në fushën ushtarake.

¹ Rreth dallimeve terminologjike ndërmjet termeve sipër shih fjalorët:
<https://www.almaany.com/en/dict/ar-en/command/>;
<https://www.almaany.com/en/dict/ar-en/leader>

3.	Lider (Leader)	Komandant, lider, prijës i emëruar i një njësie ushtarake, influencues i madh tek të tjerët. Në fushën ushtarake ka domethënie më të ngushtë.	Lider, prijës i emëruar i një njësie, influencues i madh tek vartësit. Ka kuptim dhe domethënie më të gjerë në fushën e menaxhmentit dhe teknikave.
4.	Lidership (Leadership)	Udhëheqje, veprimtari praktike për ushtrimin e lidershipit dhe ndikimit tek vartësit. Krahasuar me fushën teknike apo ekonomike, ka përdorim më të reduktuar. Përmbledh pushtetin dhe aftësinë për të ndikuar tek të tjerët.	Menaxhim, veprimtari praktike për ushtrimin e lidershipit. Si term ka më shumë gjallëri dhe domethënie se lidershipi ushtarak. Përfshin pushtetin dhe ndikimin tek të tjerët/vartësit.
	(Menaxhment Management)	Menaxhim, veprimtari praktike për ushtrimin e lidershipit. Ka kuptim më të tkurrur se përdorimi në fushën teknike apo administrative.	Menaxhim, veprimtari praktike për ushtrimin e lidershipit. Ka përdorim më të gjerë se termi në fushën ushtarake.

3. BURIMET E FUQISË SË LIDERSHIPIT DHE TIPARET E LIDERIT TË SUKSESSHËM

3.1. Burimet e fuqisë së liderit

Për ta kuptuar këtë temë ma mirë; preferohet kjo hyrje e shkurtë. Sipas mendimit të pjesës dërmuese të dijetarëve islam, burimet e sheriatit- legjislacionit islam janë katër: *1-Kur'ani*, *2-Sunneti*, *3-Ixhmai dhe*, *4-Kijasi*. Këto katër burime kanë fuqinë e tyre juridike dhe shpirtërore për të menaxhuar me jetën fetare dhe civile të besimtarëve, respektivisht çështjet dhe rregullat që kanë të bëjnë me bindjet dhe besimin e tyre, çështjet që kanë të bëjnë me adhurimin dhe çështjet tjera nga sfera e raporteve dhe marrëdhënieve me njëri-tjetrin. Kjo nga njëra anë. Nga ana tjetër, rëndësi jetike ka edhe kuptimi i këtyre burimeve dhe mënyrës së aplikimit të tyre. Do të ishte gabim i madh dhe absolutisht e papranueshme sikur shfrytëzimi i këtyre burimeve të bëhej në mënyrë të shthurur dhe pa përfillur metodat përkatëse. Që të jemi më qartë dhe më saktë duhet të dijmë se nuk lejohet referimi në burimin e fundit nëse paraprakisht nuk i je referuar burimeve të para! Metodologjia e saktë parasheh që së pari duhet konsultuar burimin e parë (**Kur'anin**), për të kaluar tek i dyti (**Sunneti**) vetëm në rast se nuk gjen argument në të parin. Kështu vepron edhe me burimin e **tretë** dhe të **katërt**.

Myslimanët mbështeten në këto burime, prej tyre nxjerrin fuqinë ligjore dhe fetare, atyre u kthehen sa herë që kanë mospajtime. Pra, burime të pakontestuara të fuqisë juridike e fetare tek myslimanë

janë katër burimet e sipërpërmendura. Krahas këtyre, ka dhe gjashtë burime të tjerë, për të cilët nuk ka pajtueshmëri tek të gjithë dijetarët dhe që nuk është vendi të përmenden këtu.

Ajo që është thënë për fuqinë e burimeve ligjore islame, thuhet edhe për përcaktimin e burimeve të fuqisë së lidershit dhe fuqisë së tij zyrtare e ligjore.

Lideri patjetër duhet ta ketë një mbështetje, një burim të cilit i referohet, duke pasur kështu mundësinë e ndarjes së mirënjohjeve dhe shpërblimeve materiale, për vartësit e dalluar apo shqiptimit të ndëshkimeve për vartësit që shkelin rregulloret, që i garanton atij pushtet dhe ndikim të drejtpërdrejtë mbi individët dhe që i detyron këta të fundit ta respektojnë dhe të mos e kundërshtojnë.

Duke qenë se liderishi është kombinim i disa faktorëve: *ligjit, kushtetutës, personalitetit të liderit, natyrës organizative, ambientit të organizatës, individëve në këtë organizatë, atëherë, që lideri të ketë*

**1.
Fuqia e motivit dhe kompensimit**

- Nënkupton mundësinë e liderit për të motivuar materialisht ose moralisht punëtorët.

**2.
Fuqia e ndëshkimit**

- Nënkupton mundësinë e liderit për të shqiptuar ndëshkime ndaj punëtorve në vendin dhe kohën e duhur, ndryshe, nëse aplikohet kjo e drejtë në mënyrë të shthurur, pasojat mund të jenë të paparashikuara.

**3.
Fuqia e pushtetit**

- Nisur nga funksioni që ushtron, lideri gëzon kompetenca të gjëra në raport me punëtorët të cilat i bëjnë këta të fundit t'i përgjigjen liderit dhe urdhërave të tij.

ndikim dhe influencë, duhet të gëzojë disa të drejta dhe kompetenca të caktuara, të marra nga natyra e funksionit që ushtron apo tiparet e personalitetit me të cilat disponon dhe të cilat e bëjnë personalitet me ndikim tek të tjerët. Nga ajo që do të shpjegojmë më poshtë, mund të klasifikojmë burimet e fuqisë së lidërshiptit si në vijim:

4.

Pushteti i bazuar në përvojat e kaluara

- Lideri, nëpërmjet përvojave dhe shkathtësive që ka, mund ta imponojë pushtetin e tij ndaj vartësve.

5.

Fuqia e përfituar nga tiparet e personalitetit

- Kjo nënkupton personalitetin tërheqës dhe joshës të liderit, pranimin e tij nga ana e vartësve, të cilët (*me dashuri e respekt*) i nënshtrohen urdhërave të tij.

Edhe këtu duhet të bëjmë një ndalesë, për ta shpjeguar një çështje me rëndësi¹. *Shumë liderë, duke përfshirë këtu drejtorë shkollash, kompanish, dekanë, rektorë, e keqpërdorin pushtetin dhe kompetencat që i gëzojnë falë detyrës që ushtrojnë. Për pasojë, në shumë raste meritat ua ndajnë atyre që nuk i meritojnë, i privojnë meritoret prej tyre, dhe jo rrallë edhe ushtrojnë presion që të pranohen vendimet e tyre të padrejta dhe në kundërshtim me rregulloret!*

¹ Shih: Talib, Hisham, *Delil et-tedrib el-kijadij*, f. 66-67; Peter Northouse, *Leadership; Theory and practice*, f. 44-52.

Këta autoritete/liderë janë të korruptuar ligjërisht, moralisht e fetarisht, andaj duhet të kemi kujdes prej tyre. Të tillët duhet të japin përgjegjësi para autoriteteve dhe drejtësisë, në mënyrë që shkeljet e tyre ligjore të mos kalojnë pa u ndëshkuar.

3.2. Kur'ani paraprin studimet moderne

Trajtesat e studiuesve bashkëkohorë përkritazi me fuqinë e burimeve të lidërshiptit, respektivisht përmbajtjen e tyre, e gjejmë të shprehur qartë në Kur'an dhe Sunnet. Feja jonë e pastër u ka paraprirë me shekuj. Në vazhdim do të përmendim disa shembuj.

1) Fuqia e ndëshkimit

﴿لَيْسَ بِأَمَانِيكُمْ وَلَا أَمَانِي أَهْلِ الْكِتَابِ مَنْ يَعْمَلْ سُوءًا يُجْزَى بِهِ وَلَا يَحِدُّ لَهُ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا﴾ [سورة النساء: 123]

“(Shpëtimi në jetën tjetër) nuk do të jetë as sipas dëshirës suaj (o myslimanë), as sipas dëshirës së ithtarëve të Librit. Por kushdo që bën një të keqe, do të ndëshkohet për atë dhe nuk do të gjejë as mbrojtës, as mbështetës tjetër në vend të Allahut.” [Nisa: 123]

﴿الزَّانِيَةُ وَالزَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِائَةَ جَلْدَةٍ وَلَا تَأْخُذْكُم بِهِمَا رَأْفَةٌ فِي دِينِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَلْيَشْهَدْ عَذَابَهُمَا طَائِفَةٌ مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ﴾ [سورة النور: 2]

“Laviren dhe lavirin – ta rrihni çdonjërin prej tyre me nga njëqind goditje. Të mos ju pengojë kurrfarë mëshire për të kryer detyrën e fesë së Allahut, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Le ta shikojnë dënimin e tyre një grup besimtarësh!” [Nur: 2]

﴿إِنَّمَا جَزَاءُ الَّذِينَ يُحَارِبُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا أَنْ يُقَتَّلُوا أَوْ يُصَلَّبُوا أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ مِّنْ خَلْفٍ أَوْ يُنْفَوْا مِنَ الْأَرْضِ ذَلِكَ لَهُمْ خِزْيٌ فِي الدُّنْيَا وَلَهُمْ فِي الآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿٣٣﴾﴾، [سورة المائدة: 33]

“Pa dyshim se ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe që bëjnë shkatërrime në Tokë, është të vriten ose të gozhdohen, ose t’u këputen duart dhe këmbët tërthorazi, ose të dëbohen nga vendi. Ky ndëshkim është poshtërim për ata në këtë jetë, ndërsa në jetën tjetër, për ta do të ketë dënim shumë të madh.” [Maide: 33]

2) Fuqia e motivimit dhe stimulimit material

﴿أَعْمَلُوا إِالَ دَاوُدَ شُكْرًا وَقَلِيلٌ مِّنْ عِبَادِيَ الشَّاكِرِينَ ﴿١٣﴾﴾، [سورة السبأ: 13]

“...O familje e Daudit! Bëni falënderim (me gjuhë dhe me vepra) (për Allahun)!” Megjithatë, pak nga robërit e Mi, janë falënderues.”

[Sebe’: 13]

﴿فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْلَ الصَّالِحَاتِ وَهُوَ مُؤْمِرٌ فَلَا كُفْرَانَ لِسَعْيِهِ وَإِنَّا لَهُ كَاتِبُونَ ﴿٩٤﴾﴾، [سورة الأنبياء: 94]

“Atij që bën vepra të mira dhe është besimtar, përpjekja nuk do t’i mohohet. Dhe këtë Ne ia shënojmë atij.” [Enbija: 94]

3) Fuqia e pushtetit

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنكُمْ فَإِن تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهٖ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِن كُنتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الآخِرِ ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا ﴿٥٩﴾﴾، [سورة النساء: 59]

“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni

Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.” [Nisa: 59]

Këtu, siç shpjegojnë dijetarët, theksohet obligimi për të ndjekur dhe respektuar liderët, dijetarët, pushtetarët, mbretërit, etj.

﴿وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا لِمُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا مُّبِينًا﴾. [سورة الأحزاب: 36]

“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin vetë çështjen e tyre! Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri është i humbur.” [Ahzab: 36]

4) Ndërsa sa i përket fuqisë e pushtetit të bazuar në përvojat e mëhershme dhe fuqisë së bazuar në tiparet e personalitetit të liderit, sunneti profetik është përplot raste dhe dëshmi, qoftë në betejat e myslimanëve, drejtësinë në gjykime, dhënien e verdikteve fetare, etj. Po kështu edhe historia e prijësve të drejtë – *hulefairrashidinëve* - është përplot prova e dëshmi, duke filluar nga qëndrimet e Ebu Bekrit r.a., me murtedët¹, dhe ata që refuzonin dhënien e zekatit, drejtësinë e Omerit r.a, në gjykime, guximin, zgjuarsinë dhe planifikimin e Halidit r.a, në luftëra e beteja, e shumë shembuj të tjerë përgjatë gjithë historisë mijëravjeçe islame².

Si përmbledhje mund të themi se atë që kanë potencuar studimet bashkëkohore përkritazi me fuqinë e burimeve të lidërsipit, Kur’ani dhe Sunneti e kanë trajtuar hollësisht, e madje edhe kanë ofruar detaje, të cilat janë zbatuar nga liderët tanë përgjatë historisë

¹ Ata që e braktisën fenë islame pasi që ishin Muslimanë, apostat, femohuesit.

²Për më shumë shih: Nehhal, *El-kijadetu ve el-xhundijjetu...*, f. 84-100; Turbani, *Xhihad, 100 min udhamai ummeti el-Islam gajjeru mexhra et-tarih*, f. 13; 66; 92; 120; 171; 176; 251; 280; 405; 630; 694.

dhe civilizimit tonë madhështor, andaj përse të shikohen ato burime islame me skepticizëm ose përse të mos përvetësohen ato në vend të studimeve perëndimore? Përse ky largim nga Kur'ani dhe Sunneti? Përse kjo neglizhencë dhe shpërfillje ndaj Librit të Allahut dhe Sunnetit të Profetit ﷺ ?

3.3. Virtytet morale dhe shpirtërore të liderit të suksesshëm

Në këtë pjesë do të merremi me tiparet që shkencëtarët dhe ekspertët e lidërshiptit kanë përmendur ndërsa kanë trajtuar personalitetin e liderit të suksesshëm¹. Ata kanë nënvizuar disa tipare dhe karakteristika për të cilat dallohet lideri gatë punës së tij me vartësit. Përmbajtja e tyre është morale dhe profesionale. Në këtë studim theks i veçantë vihet *mbi aspektin e nxitjes dhe motivimit, gjallërisë, dinamikës, angazhimit sistematik për të realizuar synimet e përcaktuara të organizatës apo institucionit* (pavarësisht se për çfarë karakteri të organizatës bëhet fjalë: ushtarak, qytetar apo akademik), *besueshmërisë, ndjenjave personale, pranimit dhe absorbimit të rezultatit të vendimeve, mënyrës së zgjidhjeve të krizave dhe ngatërresave ndërmjet anëtarëve të institucionit apo organizatës.*

Të gjitha këto tipare dhe tërë këtë etikë që këto trajtesa bashkëkohore të lidërshiptit i kanë theksuar, në një ose formë tjetër, i gjejmë në Kur'an dhe Sunnet. Këtyre dy burimeve iu takojnë meritat e paraprirjes, edhe pse shumë njerëz nuk e dinë këtë gjë! Kjo mbase për shkak të rrënimit emocional e shpirtëror, për shkak të konfliktit të brendshëm që kanë!

¹Shih: *Tevel-li el-kijadeh...*, f. 38-39.

Ja disa prej këtyre tipareve¹:

1) Iniciativa

Lideri duhet të ketë propozime të qarta që ndihmojnë në qartësimin e sistemit dhe mbështesin strategjitë e punës.

2) Anëtarësimi

Roli aktiv që luan lideri në përhapjen e frymës bashkëpunuese ndërmjet anëtarëve të grupit brenda organizatës ose institucionit.

3) Përfaqësimi

Angazhimin vetëmohues të liderit për interesat e grupit dhe përfaqësimin e tij (grupit) çdoherë dhe në çdo situatë.

4) Integrimi, unifikimi

Angazhimin ekipor të liderit duke bërë kështu që puna t'i atribuohet të gjithëve. Pra, punon për interes të grupit, jo për interes personal.

5) Organizimi

Aftësia e liderit për të vënë një strategji të punës për vete dhe për ekipin me të cilin punon.

6) Dominimi pozitiv apo menaxhimi me urtësi

Dominimi pozitiv i liderit ndaj grupit dhe udhëheqja me urtësi duke përcaktuar formën e sjelljeve dhe politikat e punës.

7) Komunikimi

¹Rreth tipareve të liderit të suksesshëm, ua propozoj këtë material me vlerë të dr. Tarik Suvejdanit: <https://www.youtube.com/watch?v=Zd735vIKEY8>

Aftësia e liderit për ta përcjellë mesazhin apo informacionin tek anëtarët e grupit dhe për ta lehtësuar mënyrën e komunikimit ndërmjet vete.

8) Vlerësimi dhe konsiderata

Lideri duhet të ketë aftësinë për të shprehur komplimente, vlerësim dhe respekt për punën që bëjnë anëtarët e grupit të vet.

9) Produktiviteti

Është niveli i produktivitetit të punëtorëve që lideri ëndërron ta arrijë. Kjo ndodhë duke i nxitur për të vazhduar punën që të arrihen synimet e dëshiruara.

Krahas kësaj, studiuesit¹ kanë përmendur edhe disa tipare tjera morale dhe etike të cilat një institucion apo organizatë duhet t'i përvehtësojë si kritere ndërsa bëhet gati të zgjedh një lider apo prijës të saj.

Ja disa prej këtyre tipareve, të përmbledhura në formë grafikoni:

¹Shih: *Tevel-li el-kijadeh...*, vep.cit., f. 38-39; Talib, Hisham , *Delil ettedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 66-67.



Duke qenë se, në raste të caktuara, lideri nuk mund të ofrojë zgjidhje adekuate për disa probleme administrative, atëherë përgjegjësit e kanë për detyrë që të gjejnë liderë ndihmës, asistentë, duke marrë në konsideratë natyrën e liderit dhe motivimin e tij për punë, në përputhje me rregullat dhe modelet përkatëse.

Ja disa prej këtyre tipareve ¹:

¹ Shih: Talib, Hisham , *Delil ettedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 66-67. Autori ka përmendur tipare të shumta, njohuri dhe shkathtësi të cilat duhet t'i ketë lideri.

3.4. Tiparet menaxheriale të liderit të suksesshëm

Sa i përket tipareve menaxheriale të liderit të suksesshëm për t'iu qasur vështirësive dhe sfidave me të cilat ballafaqohet, do të përmendim si në vijim:

1-Idealizmi
Lideri është i përmbajtur, shquhet për vizion, përvojë jetësore, fleksibilitet, është shembull që ndiqet nga punëtorët.
2-Këshilla
Lideri angazhohet për interesin e përgjithshëm nëpërmjet këshillave, udhëzimeve dhe rekomandimeve, ngritë nivelin e cilësisë dhe performancën e punëtorëve.
3-Zbulimi
Institucionet dhe organizatat, për çështje sigurie, kanë nevojë për paralajmërime të mëhershme për rreziqet e mundshme.
4-Bërja e politikave(rregullave) dhe strategjive
Lideri duhet të ketë njohuri mbi organizatën që drejton dhe rrjedhimisht politikat(rregullat) dhe vendimet e tij të jenë të ndërtuara mbi këto njohuri dhe nevojat përkatëse. Pra, duhet të jetë i zgjuar dhe i talentuar.
5-Partneriteti
Lideri, si menaxher i shkathët, duhet ta përvetësojë punën në grup, që të nxjerr më të mirën nga secili punëtor.
6-Optimist për të ardhmen

Autori ka bërë një përmbledhje të shkëlqyer të cilën ua rekomandoj fuqishëm. Shih edhe: Utejbi, *El-enmat el-kijadije...*, vep. cit., f. 37; Nehhal, *El-kijadetu ve el-xhundijetu*, vep. cit., f. 64-70

Mënyrat e kontaktimit me të janë të shumta dhe të lehta. Ai ka vizion dhe optimizëm për të ardhmen e ndritur të organizatës.

7-Diplomacia: Tip i qetë, bashkëpunues, i aftë për të zgjidhur problemet e punëtorëve.

Për ta kuptuar më mirë e më lehtë, tërë këtë do ta përmbledhim në grafikun e mëposhtëm:



Si tipare¹ tjera administrative dhe menaxheriale do të përmendim:

¹ Shih: Talib, Hisham, *Delil ettedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 66-67; Utejbi, *El-enmat el-kijadije...*, vep. cit., f. 37; Nehhal, *El-kijadetu ve el-xhundijjetu*, vep. cit., f. 64-70



Rreth mënyrës së përzgjedhjes së liderëve të së ardhmes dhe rreth virtyteve që duhet të kenë dhe shkathtësive që duhet t'i zotërojnë, flasin hulumtimet shkencore, studimet shkencore si dhe përvoja e pasuesve.

Këto punime vlenjë për të dy gjinitë ¹ ndaj konsideroj se përvetësimi i tyre është i domosdoshëm, ku do të flasim gjerë e gjatë në kapitullin që vijon, in sha Allah., dhe Allahu e di më së miri!

¹ Shih: Talib, Hisham , *Delil ettedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 66-67; Peter Northouse, *Leadership; Theory and practice*, f. 230; 232; 341.

Kapitulli II:
PËRKUFIZIMI I LIDERSHIPIT:
KONTEKSTI DHE DOMETHËNIET KUR'ANORE

1. KUPTIMI LITERAL DHE TERMINOLOGJIK I LIDERSHIPIT DHE LIDHJET NDËRMJET TYRE

1.1. Kuptimi literal dhe terminologjik i lidershipit (ar. el- kijade)

1.2. Domethënia e konceptit el-usvetu el-haseneh:

Autenticiteti dhe vazhdimësia e tij në Kur'anin Fisnik

1.3. Terminologjia e lidershipit në kontekstin Kur'anor

2. LIDERSHIPI EDUKATIV DHE FUSHAT E TIJ NË KUR'ANIN FISNIK

2.1. Fusha e kredos e manifestuar në njeshmërinë e

Allahut xh.sh. - Monoteizmin

2.2. Fusha e meditimit në gjithëpërfshirjen e dijes së Allahut xh.sh, mundësitë e pakufizuara të Tij dhe vetëvëzhgimi ynë si rezultat i këtij meditimi

2.3. Fusha shoqërore e manifestuar në urdhërimin për të bërë mirë dhe për tu shmangur nga e keqja

2.4. Fusha personale e moralit dhe e sjelljes

1. KUPTIMI LITERAL DHE TERMINOLOGJIK I LIDERSHIPIT DHE LIDHJET NDËRMJET TYRE

1.1. *El-kijade* (lidershipi) ndërmjet kuptimit literal dhe terminologjik

1.1.1. *El-kijade* gjuhësisht

Në gjuhën arabe, fjala e përdorur për lidership është *el-kijade* (القيادة). Ajo ka disa kuptime që janë shtjelluar gjerësisht në fjalorët e gjuhës arabe¹:

Në **Mu'xhem el-meani el-xhamië**, është shpjeguar si në vijim:

Sqarim.	Ar.
<i>Kâde</i> : (folje) – <i>udhëheq</i>	قَادَ: (فعل)
Forma gramatikore të foljes kâde - <i>udhëheq</i> , si: folje në kohën e shkruar, të tashme, si formë urdhërore, infinitiv, kryefjalë, kundrinor)	قَادَ يَقُودُ، قُدٌّ، قَوْدًا وَقِيَادًا وَقِيَادَةً قِيَادًا، فَهُوَ قَائِدٌ، وَالْمَفْعُولُ مَقُودٌ <i>Kâde, jekudu, kud, kauden, ve kijaden, ve kijadeten kajden, fe-huve kaid, ve-l-mefulu mekud</i>
<i>Kâde el-feres</i> : (e udhëheq kalin): ecën para tij duke e tërhequr për freri.	قَادَ الْفَرَسَ: مَشَى أَمَامَهُ أَحَدًا بِمَقُودِهَا <i>Kade el-feres: mesha emamehu âhidhen bi-mikvediha</i>
<i>Kâde el-muxhrime ila es-sixhne</i> : e udhëheq kriminelin në burg: e çon në burg	قَادَ الْمُجْرِمَ إِلَى السِّجْنِ: ذَهَبَ بِهِ <i>Kade el-muxhrime ila es-sixhni: dhehebe bihi</i>

¹ Shih versionin online të këtyre fjalorëve në: <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar/>

Kâde es-sejjarete: e drejton makinën: e nget, e merr përsipër drejtimin e saj

Kâde el-xhejshe ve nahvehu: e udhëheq ushtrinë dhe të ngjashme: i prinë, e organizon dhe administron atë

قاد السيارَةَ ونحوها ساقها، تولى توجيهها

Kade es-sejjarete ve nahveha: sâkaha, tevel-la tevxhiheha

قاد الجيش ونحوه: ترأسه وتدبّر أمره

Kade el-xhejshe ve nahvehu:

ter'esuhu ve tudebbiru emrehu

Në fjalorin **El-mu'xhem el-vésit** udhëheqja shpjegohet kështu:

El-kijade (udhëheqja): *Fuqia e ndikimit në angazhimin dhe aktivitetin e një individi ose grupi individësh me qëllim të realizimit të një objekti të caktuar.*

Në **Lisan el-arab** të Ibn Mendhurit kjo fjalë shpjegohet si në vijim:

Inkâde: udhëhiqet, drejtohet nga dikush

Forma gramatikore të foljes **Inkâde** - udhëhiqet në kohën e shkuar, të tashme, folje në formën urdhërore, infinitiv, kryefjalë, kundrinor,

انقاد / انقاد ينقاد، انقَدَ، انقيادًا، فهو منقاد، والمفعول منقاد له

Inkâde: Inkâde, jenkâdu, inkad, inkijaden, fe huve munkadun, ve-l-mef'ulu: munkadun leh

Inkadeet-tariku: është nënshtruar
rruga: rrugë e rrahur, e lehtë për
të qarkulluar në të, e drejtë

انقاد الطريق: سهّل واستقام

Inkadeet-tariku: sehul ve'stekame

Sehlu-l-inkijad: bindet lehtë: i
pason rekomandimet dhe i
përfillë urdhërat

سهل الانقياد: متبّع للتعليمات ومطيعٌ للأوامر

Sehlu-l-inkijad: muttebeun li-t-
ta'limat ve mutiun li-l-evamir

Ka-ve-de: udhëheq, prinë

(قَوْدٌ) الْقَوْدُ: نَقِيضُ السَّوْقِ، يَقُوْدُ الدَّابَّةَ مِنْ أَمَامِهَا
وَيَسُوْقُهَا مِنْ خَلْفِهَا، فَالْقَوْدُ مِنْ أَمَامِ وَالسَّوْقُ مِنْ
خَلْفٍ.

Infinitivi *kavd*: nënkupton
prirjen duke qenë përpara,
thuhet: *jekudu eddabbete*: e
udhëheq kafshën: e tërheq për
litari duke qenë ai përpara.
Është e kundërta e fjalës *seuk*,
që nënkupton po kështu
udhëheqjen por duke qenë
mbrapa.

Ka-ve-de: el-kavdu: nekidu es-
seuki, jekudu ed-dabbete min
emamiha ve jesukuha min
halfiha; fe-l-kaudu min emam
ve-s-seuku min half.

Bazuar në këtë na del se kuptimet gjuhësore të *el-kijade*
(udhëheqjes) janë:

- ⊙ *ecja përpara,*
- ✎ *çuarja e dikujt ose diçkaje diku,*
- ✎ *marrja përsipër e udhëheqjes së një gjëje të caktuar,*
- ✎ *vendosja në krye,*

- organizimi dhe administrimi i dikujt/diçkaje,
- fuqia e ndikimit në angazhimin dhe aktivitetin e një individi ose grup individësh me qëllim të realizimit të një qëllimi të caktuar,
- lehtësimi dhe të qenit i/e drejt
- zbatues i urdhërave dhe rekomandimeve.

Shih përmbledhjen në prezantimin grafik më poshtë:



1.1.2. El -kijade (lidershipi) në kuptimin terminologjik

Ndërsa në kuptimin terminologjik, dijetarët dhe gjuhëtarët kanë përmendur disa definicione të el-Kijade-s, si:

- 1) *Arti i ndikimit tek të tjerët, për t'i udhëzuar drejt një qëllimi të caktuar me një metodë për të fituar: besimin, respektin, bindjen dhe bashkëpunimin e sinqertë.*
- 2) *Proçesi i vënies së njerëzve në lëvizje (nxitjes) drejt një qëllimi material a shpirtëror që përputhet me vlerat dhe ligjet e fesë islame.*
- 3) *Nxitja e një grupi njerëzish për të ecur nga një drejtim i caktuar dhe i planifikuar.*
- 4) *Lidershipi është aftësia e komandimit, koordinimit, kontaktimit, marrjes së vendimeve dhe mbikëqyrjes së tyre, me qëllim të realizimit të një qëllimi të caktuar, duke përdorur ndikimin dhe autoritetin si dy vegla pune ose duke përdorur pushtetin zyrtar.*
- 5) *Lidershipi nënkupton çdo person që merr përsipër ndonjë çështje të myslimanëve, si: Halifeja (lideri suprem) dhe suita e tij, forcat ushtarake dhe gjykatësit, kryepolicët (komandantët e forcave policore), ministrat dhe persona të tjerë zyrtarë të ngarkuar me punë dhe detyra të caktuara në një shtet islam apo laik.*

Hulumtuesit për gati një sheekull, respektivisht nga v. 1900 – 1999, kanë dhënë më shumë se dyqind definicione për lidershpin, duke mos u dakorduar për një definicion të vetëm. Kjo sepse secili nga ata kanë kuptuar lidershpin dhe e kanë elaboruar atë nga fusha profesionale, veprimtaria e tij apo dhe nga profili i vet intelektual, politik e ekonomik. Madje disa prej tyre kanë thënë qartë se përkundër përpjekjeve, asnjëherë nuk do të arrihet një përkufizim i unifikuar ¹ për nocionin e lidershpit !

Me gjithë respektin për autorët dhe mendimet e tyre, konsiderojmë se qasjet dhe pretendimet e tilla janë të papranueshme për më tepër kur e dime se lidershpi, përmbajtësisht, përfshin parime dhe principe fetare, humane, ligjore, profesionale dhe administrative, esenca e të cilëve nuk ndryshon kurrë sipas vendit dhe kohës, ndonëse nuk përjashton ndryshimet anësore të përkufizimit të lidershpit, konform zhvillimeve të (sfidave dhe problematikave të kohës dhe vendit)!

¹ Shih: *Tevel-lî el-kijadeh: fennu el-kijadeti el-askerijeti ve ilmuha* - Kolonel Samuel Hejz & Lieutenat Kolonel William Tomas. Përktheu: Sami Hashim. El-muesesetu el-arabijetu li eddirasat ve enneshr, ed. 2, 1989, f. 18-19. Shih edhe: *Leadership – Theory and Practice*, Peter G. Northhouse, 7th edition, Sage Publications, Los Angeles, USA, 2015, pg: 27-30; *Army leadership – Be, Know, Do*, Headquarters Department of the Army – Washington DC, 31 August 1999, pg: 1-4; *Military leadership – In pursuit of Excellence* – 6th Edition, Edited by: Robert L. Taylor, William E. Rosenbah, Eric B. Rosenbah, Part 1, pg: 7.



Lidershipi (si term i vetëm duke mos e caktuar llojin apo drejtimin); është aftësia e komandimit, koordinimit, kontaktimit, marrjes së vendimeve dhe mbikëqyrjes së tyre, dhe këtë me qëllim të realizimit të një objektive të caktuar duke përdorur influencën dhe autoritetin si dy instrumente, apo dhe pushtetin zyrtar. Profesionit, institucionit, koha, momenti dhe situata e përcakton llojin e duhur të liderhsipit

Arsyeja pse kemi zgjedhur këtë definicion qëndron në synimin që të përfshijmë çdo kuptim që ka të bëjë me lidershipin me çka përjashtojmë kuptimet që nuk kanë të bëjnë fare me lidershipin!

1.1.3. Dimensionet dhe dallimet gjuhësore dhe terminologjike ndërmjet kuptimeve të lidërshiptit

Përgjatë studimit dhe analizimit të domethënieve dhe kuptimeve të lidërshiptit, gjuhësisht dhe në terminologji, dallojmë dimensionet dhe dallimet vijuese:

1. Lidërshipti

Ecja para masës: Lidëri është përherë i pranishëm dhe i prinë popullit në çdo gjë. Ai është shembulli, modeli që e drejton popullin nga më e mira.

2. Lidërshipti

Progres dhe udhëheqje: Lidëri është udhëheqës në hartimin e planeve dhe të strategjive, në këshilla e instruksione, në organizimin dhe koordinimin e punëve, në bartjen e përgjegjësiave, në jetësimin e një lidërshipti shembullor (të nivelit akademik) në popull.

3. Lidërshipti

Menaxhimi: Menaxhon punët e shtetit dhe të popullit, duke i këshilluar dhe drejtuar nga më e mira si në jetë ashtu dhe në fe.

4. Lidërshipti

Ndikimi: Fuqia e ndikimit tek individët dhe grupet nëpërmjet:

- Njohurive që

ka për artin e lidershipit dhe mënyrat e tij,

- *Zemërgjerësinë – empatinë për hallet e njerëzve, dhe*
- *Mirësinë - për përkrahësin por edhe për kundërshtarin e tij!*

5. Lidershipi

Unifikimi i zemrave dhe qasjeve: *Qasja e lehtë dhe e drejtë në unifikimin e zemrave të njerëzve rreth programit hyjnor dhe në interes të ymetit; bashkimi i zemrave mbi bazën e dashurisë, respektit të ndërsjellë, vëllazërisë, mirëkuptimit dhe tolerancës, në mënyrë që njerëzit të realizojnë sa më mire qëllimet e tyre në jetë.*

6. Lidershipi

Nënshtrimi: *Lideri i nënshtrohet të vërtetës - e ndjek atë. Ai i pason Librin e Allahut xh.sh. – Kur'anin, dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij, Muhammedit a.s.*

1.2. Domethënia e konceptit *el-usvetu el-haseneh*: autenticiteti dhe vazhdimësia e tij në Kur'anin Fisnik

Kush shqyrton me vëmendje ajetet Kur'anore me këtë tematikë dhe shfleton historitë e profetëve a.s. kupton rëndësinë e lidërsipit në Kur'an. Ai studiues flet sipas parametrave hyjnorë, ndaj pikëreferencë ka dhe lidërsipin e drejtë. Shpallja hyjnore këtë çështje e parashtron në ajete të shumta në Kur'an, disa prej të cilave do t'i sjellim bashkë me anën e tyre argumentuese. Allahu xh.sh. thotë:

﴿لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا﴾

[الأحزاب: 21]

“Te i Dërguari i Allahut gjendet shembulli i mrekullueshëm për atë që shpreson në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe për atë që përmend shumë Allahun.” [Ahzabë: 21]

Shembulli i mirë (ar. *el-usvetu el-hasenetu*), vjen në trajtën e pashquar dhe është gjithëpërfshirës. Pra, Muhammedi a.s. është shembulli më i mirë i lidërsipit moral, shembulli më i mirë i lidërsipit shoqëror, shembulli më i mirë i lidërsipit edukativo-arsimor, shembulli më i mirë i lidërsipit familjar, shembulli më i mirë i lidërsipin ushtarak, shembulli më i mirë i lidërsipit politik. Në fakt, *shembulli i mirë* është virtyt, karakter, cilësi e vënë në praktikë, që i dallon të gjithë profetët a.s.

Allahu xh.sh., na mëson në Kur'an:

﴿لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِيهِمْ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَمَن يَتَوَلَّ فَإِنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَنِيُّ﴾

[الممتحنة: 6] الْحَمِيدُ

“Vërtet, ata njerëz janë shembullorë për ju dhe për këdo që shpreson në Allahun dhe në Ditën e Fundit. Kushdo që shpërfillë këta shembuj, le ta dijë që Allahu është i Vetëmjaftueshmi, i Denji për çdo lavd!”
[Mumtehine: 6]

Ky është një shënim i përgjithshëm për të gjithë profetët a.s.(*alejhimus selam – paqja e Allahut qoftë mbi ta*) të cilët kanë qenë fenerë drite për popujt e tyre duke i udhëhequr ata drejt më të mirës në çdo aspekt jetësor.

Me këto dy ajete u munduam të bëjmë një përshkrim referencial të rëndësisë së lidërshipt në Islam. Këtë të vërtetë e gjejmë edhe në librat autobiografikë të *hulefai rrashidinëve - katër sundues islam të njohur: Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Aliu, r.a. (radijallahu anhum – Allahu qoftë i kënaqur me ta), pas Muhamedit a.s. (alejhis selam – paqja e Allahut qoftë mbi të), dhe të reformatoreve në historinë islame.*

Duhet theksuar dhe interpretimet e disa mufessirëve-komentatorëve të Kur’anit mbi shembullin e mirë, të cilët, e kanë komentue dhe e kanë lidhë me kontekstin historik të ngjarjeve, psh. në Betejën e Hendekut (*shembull i mirë në guxim, në durim, në përballim të urisë, në bashkëpunimin me ushtarët dhe ndihmën fizike për hapjen e hendekut, në thyerjen e gurëve, bartjen e tyre, etj.*), kanë aluduar edhe në parametrat gjithëpërfshirës të shembullit të mirë që theksuam më lartë. Pas studimit të bërë të kuptimeve *el-usvetu el-hasenetu*, konsiderojmë që ky qëndrim është më i drejtë!

Prof.Sejjid Kutubi në tefsirin e tij – komentimi i tij i njohur: *Fi dhilali el-Kur’an*, (nën hijen e Kur’anit) në komentin e ajetit në fjalë, ka thënë: *“Pavarësisht frikës së llahtarshme dhe rrethanave tejet të vështira, i Dërguari i Allahut a.s. ishte adresë e sigurisë për besimtarët dhe burim i besës, shpresës dhe prehjes – qetësisë shpirtërore*

për ta. Studimi i qëndrimit të tij në këtë ndodhi të rëndë¹ liderëve të grupeve dhe lëvizjeve ua skicon rrugën që duhet ndjekur. Profeti Muhammed a.s. është shembull për atë që shpreson në takimin me Allahun, kërkon shembullin më të mirë dhe e përkuqton Allahun, nuk e harron...”²

Mufessiri i famshëm Tahir bin Ashuri duke shpjeguar ajetin e lartpërmendur ka thënë: “...Parimisht, i Dërguari i Allahut është shembull. Është thënë: “...**Tek i Dërguari i Allahut keni shembullin...**” për ta lidhur shëmbëlltyrën me qenien e tij, jo me ndonjë përshkrim tjetër të veçantë, por në mënyrë që pasimi të jetë:

- Në fjalët e tij, duke zbatuar urdhrat dhe duke shmangur ndalesat; dhe
- Në veprat e tij, me durim e guxim...

Në ajet aludohet edhe për vlerën që ka për besimtarin të pasuarit e Profetit a.s. si shembulli absolutisht më i mirë, edhe pse nuk zbulohen detajet, siç nuk përcaktohen as nivelet e pasimit- çka është obligim e çka e preferuar...”³

Një shpjegim tjetër nga interpretimet e dijetarëve është ai i Begaviut në Tefsirin e tij, ku thotë: “Në çdo vend në Kur’an,- Imam-Asimi fjalën (أُسُوَّة) e ka lexuar duke e vokalizuar elifin me damme (pra: usveh - أُسُوَّة), përderisa të tjerët e kanë vokalizuar me kesre (pra: isveh - إِسُوَّة). Janë dy variante-dialekte kur’anore- në të cilët lexohet kjo fjalë dhe që ka kuptimin: shembull i mirë. Usveh (الأسوة) rrjedh nga el-’tisa’ (الانتساء) sipas formës fu’leh (فُعلة) mu ashtu sikur që kudveh (القُدوة) rrjedh nga folja el-iktida (الاقتداء) është emër i vënë në vend të

¹ Fjala është për Betejën e Hendekut. Siç është shprehur më lartë edhe autori, mendimet e këtyre figurave islame rreth shembullit të mirë janë në kontekst të kësaj ngjarje. Përkthyesi.

² Kutub, Sejjid. Fi dhilal el-Kur’an. 5/2817.

³ Ibn Ashur, Ettahriru ve ettenviru. 22/303.

infinitivit. Kuptimi i ajetit është: Pasojeni atë drejtë dhe mirë në mënyrë që të ndihmoni fenë e Allahut, duke mbështetur të Dërguarin dhe duke mos e braktisur atë, duke duruar në çdo gjë që ju godet, ashtu siç duroi ai kur iu thyen dhëmbët në luftë, u plagos në fytyrë, iu mbyt xhaxhai dhe u ndëshkua me torrturat më të ndryshme (fizike e psikike) dhe pavarësisht nga të gjitha këto, ai gjeti forcë tju ngushëllojë të gjithë personalisht. Kështu bëni edhe ju! Ndiqni hapat e tij...”¹

Kushdo që lexon Kur’anin dhe ajetet e tij, do të konkludojë se modeli dhe shembulli janë praktikë profetike. Allahu xh.sh. e ka urdhëruar Muhammedin a.s., që t’i pasojë pejgamberët paraparak :

﴿ فَاصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُولُو الْعَزْمِ مِنَ الرُّسُلِ وَلَا تَسْتَعْجِلْ لَهُمْ كَأَنَّهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَ مَا يُوعَدُونَ لَمْ يَلْبَسُوا إِلَّا سَاعَةً مِّن نَّهَارٍ بَلَّغٌ فَمَهْلُ يُهْلِكُ إِلَّا الْقَوْمَ الْفَاسِقُونَ ﴿٣٥﴾ [الأحqاف: 35]

“Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e bindur dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ta! Ditën, kur të përjetojnë atë që u është premtuar, atyre do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) vetëm një çast të ditës. Kjo është shpallje e qartë. E kush do të shkatërrohet tjetër, pos popullit të pabindur!?” [Ahkaf: 35]

Kjo është një këshillë e drejtpërdrejtë për Muhammedin a.s. që të pajiset me durim, duke ndjekur kështu rrugën e vëllezërve të tij pejgamberë, *ulu el-azmit*: Nuhut, Ibrahimit, Musait dhe Isait a.s. të cilët përkundër sjelljeve të këqia të popujve të tyre, vazhduan misionin e tyre të pathyeshëm. Ajo që duhet theksuar këtu është këshilla e Allahut xh. dhënë Mumahedit a.s. për ti pasuar profetët tjerë, edhe pse ka qenë më i dalluari nga të tjerët:

¹ Begaviu, Ebu Muhammed el-Husejn bin Mesud bin Muhammed el-Ferra. *Mealim et-tenzil fi Tefsiri el-Kur’an*. 6/336

“...me tipare të larta dhe cilësi të pakrahasueshme, Allahu xh.sh., e përzgjedhi mbi të gjitha krijesat, e bëri dëshmitar të dëshmitarëve, zotëri të të gjithë njerëzimit, të parëve dhe të fundit, ndërmjetësues që nuk refuzohet, përgëzues dhe qortues, pronar të flamurit dhe keutherit, të nderuar me vesile dhe mekam mahmud...Si jo kur ai ka përparësi mbi të gjithë profetët ndaj popujve të tyre dhe mes besimtarëve ndaj vetvetes së tyre: gratë e tij janë nënat e tyre. Ai ishte profet atëherë kur Ademi ishte ende dhé. Ai, Ademi a.s. bashkë me të gjithë pasardhësit, në Ditën e Llogarisë do të jenë nën flamurin e tij. Ai, Muhammedi a.s. është profeti ruajtjen e të cilit e mori përsipër Allahu xh.sh. siç e mori dhe ruajtjen e fesë së Tij. Allahu u betua në të, në jetën e tij dhe në qytetin e tij. Allahu nuk i është drejtuar thjesht me emrin e tij..¹.

Grafiku në vazhdim na lehtëson mbajtjen në mend të disa veçorive të tij ndaj të gjithë profetëve tjerë:

¹ Ndër punimet më të mira që kam parë rreth kësaj çështje është ai i hoxhës dhe profesorit të njohur, kolegut tim universitar, prof.dr. Halil Ibrahim Mulla “*Adhimu kadrihi sal-laAllahu alejhi ve sel-lem ve rif’atu menziletihî inde Rabbihi azze ve xhel-le*”, botuar nga Dar el-Kible el-Islamije në Xhidde. Shih shkëputjen që kemi bërë në faqet 13-23.



Kur Profeti ynë, Muhammedi a.s me gjithë gradën profetike urdhërohet të pasojë profetët paraprakë, si shembuj të mirë, atëherë për ne të tjerët, njerëzit e thjeshtë, urdhëri për pasimin e rrugës së tij dhe të shokëve të tij duhet të jetë edhe më i vlefshëm! Sigurisht, një lider i suksesshëm dallohet nga virtytet, *durimi, këmbëngulja, dashamirësia, vetëpërmbajtja* etj. Ky ajet kur'anor: *“Te i Dërguari i Allahut gjendet shembulli i mrekullueshëm për atë që shpreson në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe për atë që përmend shumë Allahun.”* [Ahzabë: 21], argumenton trajtimin Kur'anor që i bëhet leadershipit dhe rëndësisë së tij, siç do ta shpjegojmë më poshtë.

Në formë grafiku kuptimet e shembullit të mirë në personalitetin e Muhammedit a.s. dhe profetëve para tij, do të dukeshin kështu



1.3. Terminologjia e lidershipit në kontekstin Kur'anor

Në Kur'an nuk është përmendur shprehja *leadership* (ar. *el-kijade*) si nocion dhe as ndonjë variant i tij gjuhësor. Më saktë, nuk është përmendur ndonjë shprehje që rrjedh nga rrënja foljore *ka-ve-de* (كَوَدَدَ). Por, ne mund të gjejmë diçka tjetër, një lidhje të hollë ndërmjet shprehjeve *el-kijade* dhe *el-kudveh* (*ka-de-ve* – كُوْدُوْهُ. shq. *shëmbëlltyrë, model*), për shkak të kuptimit të përafërt që kanë. Që të dy shprehjet përdoren me kuptim të *progresit, përparimit, prirjes, udhëzimit, pasimit*. *El-kijade* nënkupton prijësin që udhëheq njerëzit, që i udhëzon ata; prijësin që e pason populli. *El-kudveh* nënkupton prijësin që ka paraprirë pasuesit në diç të mirë ose të keqe; ai është prijësi, të tjerët janë pasuesit e tij dhe ndjekës të rrugës së tij.

Në Kur'an, *kudveh* përdoret në dy vende duke treguar dy kuptime të saj:

1) *Kudveh në (model për) të mirë*

Allahu xh.sh., thotë:

﴿أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ فَبِهِدَّتْهُمْ أَفْتَدَهُ قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا إِنْ هُوَ إِلَّا

ذِكْرَى لِلْعَالَمِينَ ﴿٩٠﴾ [الأنعام: 90]

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë, ndaj edhe ti (o Muhamed) ndiq rrugën e tyre. Thuaj: “Unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi për atë. Ai është vetëm këshillë për të gjithë botët (njerëzit dhe xhindet).” [En’amë: 90]

2) *Kudveh në (model për) të keq*

Allahu xh.sh., thotë:

﴿وَقَالُوا رَبَّنَا إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا فَأَصَلُّوْنَا السَّبِيلَا رَبَّنَا آتِهِمْ ضِعْفَيْنِ مِنَ الْعَذَابِ وَالْعَنُؤْمُ لَعْنًا كَبِيرًا﴾ [الأحزاب: 67-68]

“Dhe thonë: “Zoti ynë, ne i dëgjuam udhëheqësit tanë dhe të parët tanë, por ata na shmangën nga rruga e drejtë. Zoti ynë, jepu atyre dënim të dyfishtë dhe mallkoj ata si është më së keqi! ”.. [Ahzab: 67-68]

Kur’ani ka përmendur disa shprehje të ngjashme me nocionin *el-kijade*, si:

- 1) *el-imametu* (udhëheqje, (politike apo fetare), imamllëk
- 2) *el-hukmu* (sundim, pushtet),
- 3) *el-hilafetu* (kalifat -halife),
- 4) *et-temkinu* (konsolidim, përforcim, instalim i pushtetit), dhe
- 5) *el-usvetu el-hasenetu* (shëmbëlltyrë e mirë).

Natyrisht, ka edhe sinonime tjera të *el-kijade*, si:

- 1) *es-sultatu* (pushtet, organ pushtetar, autoritet),
- 2) *ez-zeâmetu* (udhëheqje, kryesim),
- 3) *err-rriâsetu* (kryesi, presidium),
- 4) *el-imaretu* (urdhër, urdhërim), shprehje këto që ofrojnë përmbajtje të ngjashme me gjithë dallimin formal që kanë.

1. *El-imametu* (الإمامة): është përmendur në disa ajete Kur'anore dhe këtë në disa variante të fjalës:

a- *Imamen* (إماماً): si në ajetet vijuese

﴿وَإِذِ ابْتَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ رَبُّهُ بِكَلِمَاتٍ فَأَتَمَّهُنَّ قَالَ إِنِّي جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ إِمَامًا قَالَ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي قَالَ لَا

يَنَالُ عَهْدِي الظَّالِمِينَ ﴿١٢٤﴾ [سورة البقرة: 124]

“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi, Allahu i tha: “Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!” - “Po pasardhësit e mi?” - pyeti ai. Allahu tha: “Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.” [Bekare: 124]

﴿أَفَمَنْ كَانَ عَلَىٰ يَتِيمَةٍ مِنْ رَبِّهِ وَيَتْلُوهُ شَاهِدٌ مِنْهُ وَمِنْ قَبْلِهِ كَتَبَ مُوسَىٰ إِمَامًا وَرَحْمَةً ﴿١٧﴾ [سورة

هود: 17]

“A janë (të barabartë me jobesimtarët), ata, që mbështeten në provë të qartë nga Zoti i tyre, që ndiqet nga një dëshmitar prej Tij (Kurani), para të cilit ishte Libri i Musait (dëshmitar) udhërrëfyes dhe mëshirë?...” [Hud: 17]

Në këto dy ajete, *imameti* nënkupton njërin prej dy kuptimeve:

- 1) *Imametin fetar* ose pejgamberinë dhe shpalljen, që janë modelet më të përsosura të udhëheqjes.
- 2) *Imametin e shëmbëlltyrave të mira* në bazat e fesë dhe tiparet e përsosura të moralit ¹

¹ Shih: Tefsiri i Sa'dit (versioni online: <https://furqan.co/saadi/2/124>) Tefsiri i Alusit (versioni online: <https://furqan.co/alaloosi/2/124>).

b- Eimmeh (أئمة), qëndron në më shumë se një vend në Kur'an dhe ka dy kuptime: kuptimin pozitiv dhe negativ të udhëheqje:

Kuptim **pozitiv** si në ajetin që vijon:

وَنُرِيدُ أَنْ نَمُنَّ عَلَى الَّذِينَ اسْتُضِعُوا فِي الْأَرْضِ وَنَجْعَلَهُمْ أَئِمَّةً وَنَجْعَلَهُمُ

الْوَارِثِينَ ﴿سورة القصص: 5﴾

“Por vullneti Ynë ishte që t’u jepnim mirësi atyre që qenë të shtypur në tokë, t’i bënim prijës e trashëgimtarë.” [Kasas: 5]

Ajeti bën fjalë për prijësit në të mira ose mbretërit. Duke qenë se më parë ishin nën sundimin e egër të Faraonit dhe të popullit të tij, Allahu xh.sh. ia kalon pushtetin shtresës së shtypur, për ti bërë prijës dhe sundues në Egjipt dhe në Sham, dhe për t’ia bërë të qartë Faraonit dhe parisë së tij se paralajmërimi i mëhershëm (se do ta humbisnin pushtetin në rast padrejtësie) tanimë kishte ndodhur¹.

¹ Shih Tefsirin e Ijxhit: *Xhamiu el-bejan* (versioni online: <https://furqan.co/iejee/28/5>) dhe Tefsirin e Mekki bin Talibit *El-hidajetu fi bulugi en-nihaje* (versioni online: <https://furqan.co/makki/28/5>).

Ndërsa në kuptim **negativ** është përmendur në ajetin vijues:

﴿ وَإِنْ نَكَثُوا أَيْمَانَهُمْ مِنْ بَعْدِ عَهْدِهِمْ وَطَعَنُوا فِي دِينِكُمْ فَقَاتِلُوا أَيْمَةَ
الْكَفْرِ إِنَّهُمْ لَا أَيْمَانَ لَهُمْ لَعَلَّهُمْ يَنْتَهُونَ ﴾ [سورة التوبة: 12]

“Por, nëse ata e prishin betimin pas lidhjes së marrëveshjes dhe sulmojnë fenë tuaj, atëherë luftoni kundër krerëve të mosbesimit - sepse ata nuk kanë besë që të mund të frenohen (nga të këqijat).”

[Teube: 12]

Ajeti bën thirrje për mposhtje të të gjithë jobesimtarëve duke theksuar parinë dhe liderët si shkaktarët kryesorë të shtytjes së popullit drejt punëve të kota ¹.

¹ Shih:Tefsiri i Rrazit *Mefatih el-gajb* (versioni online: <https://furqan.co/alrazi/9/12>).

2. *El-hukmu* (الحُكْم): është përmendur në disa ajete kur'anore, kuptimet e të cilës sillen rreth dy gjërave:

a- Pejgamberisë, gjykimit të drejtë, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, diturisë së fituar nga angazhimi shkencor.

Me këto kuptime ka ardhur në ajetin vijues:

﴿فَفَهَّمْنَهَا سُلَيْمَانَ وَكُلًّا ءَاتَيْنَا حُكْمًا وَعِلْمًا﴾ [سورة الأنبياء: 79]

“Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejtë çështjen dhe që të dyoe u dhamë mençuri e dituri...” [Enbija: 79]

Çdonjërit prej tyre Ne i dhamë urtësi dhe dije të shumtë jo vetëm Sulejmanit a.s.

b- njohja dhe kuptimi i normave fetare dhe respekti maksimal i tyre, duke u përqëndruar tek e mira si vlerë universale dhe duke penguar njëherit të keqen, në fjalë a vepër, çdo gjë që shkakton probleme dhe prishje rendi,

﴿...فَأَحْكُم بَيْنَ النَّاسِ بِالْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ الْهَوَىٰ فَيُضِلَّكَ عَن سَبِيلِ اللَّهِ﴾ [سورة ص: 26]

“... prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut!...” [Sad: 26]

3. *El-halifetu* (الخليفة): është përmendur në disa ajete Kur'anore me kuptime të cilat sillen rreth dy gjërave:

a- **Lideri suprem**, titull ky që kanë marrë sundimtarët myslimanë në të kaluarën. Në kuptimin literal shkronja *t* (الخليفة) në fund të emrit në arabishte, përdoret për ti dhënë peshë dhe domethënje kuptimit, gjegjësisht për të treguar se Halifeja është sundimtari mbi të cilin nuk ka sundimtar.

Istihlafi (الاستخلاف) në tokë nënkupton marrjen përsipër të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me shoqërinë dhe interesat e tyre fetare e materiale si dhe unifikimin e pjesëtarëve të saj rreth boshtit të besimit të pastër në Zotin dhe drejtësinë.

Thotë Allahu xh.sh.

﴿يَا دَاوُدُ إِنَّا جَعَلْنَاكَ خَلِيفَةً فِي الْأَرْضِ فَاحْكُم بَيْنَ النَّاسِ بِالْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ الْهَوَىٰ

فَيُضِلَّكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ﴾ [سورة ص: 26]

“O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut!...” [Sad: 26]

Halife, shumësi: Halaif (الخليفة ج: الخلائف) është ai që pason apo zëvendëson tjetrin dhe vjen në vend të tij: brez që pason brezin, popull që pason popullin. Besimtarët janë trashëgimtarë të tokës së popujve të Mëparshëm, të cilët u shkatërruan për shkak të dhunës dhe padrejtësive. Allahu xh.sh., i bëri trashëgimtarë që të shohë se si po punojnë, si po veprojnë. Ja çfarë na mëson Allahu xh.sh.:

﴿ثُمَّ جَعَلْنَاكُمْ خَلَائِفَ فِي الْأَرْضِ مِنْ بَعْدِهِمْ لِنَنْظُرَ كَيْفَ تَعْمَلُونَ ﴿١٤﴾﴾ [سورة يونس: 14]

“Pastaj ju bëmë juve pas tyre zëvendës në Tokë, për të parë sesi do të veprojnë.” [Junus: 14

4. Et-Temkin (التمكين): (gjuhësisht: *konsolidim, përforcim, instalim i pushtetit*) nënkupton fitoren dhe triumfin, përvetësimin dhe pasjen e një fuqie, pushteti dhe autoriteti, përkrahjen e masave, simpatizantëve dhe ithtarëv

Në Kur'an është përdorur në dy variante:

1- *temkinin në diçka, dhe,*

2- *temkini i diçkasë.*

E para kryesisht përfshin temkinin (*pushtetin*) në tokë ndërsa e dyta përfshin temkinin e (*fesë, fuqisë, pushtetit dhe pasurisë*). Shembujt në vazhdim do t'i shpjegojnë më hollësisht këto kuptime:

a- **Temkini¹ i Jusufit a.s.**

Nëse shfletojmë kaptinën Jusuf në Kur'anin Fisnik, do të gjejmë se ajetet që trajtojnë temkinin e Jusufit a.s. përfshijnë të dy kuptimet e temkinit², atë, **1-moral dhe 2- material**.

1- Ajeti në vijim trajton temkinin moral te Jusufit a.s. në zemrën e ministrit të Egjiptit, i cili e deshi dhe e trajtoi atë si ta kishte fëmijë të vet.

¹ Shih: <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar/التمكين>

² Shih artikullin e Dr. Feride Zemrud "Mefhum et-temkin fi el-Kur'ani el-Kerim", <http://www.mithaqarrabita.ma/> مفهوم التمكين في القرآن الكريم

﴿ وَقَالَ الَّذِي اشْتَرَاهُ مِنْ مِصْرَ لِامْرَأَتِهِ أَكْرِمِي مَثْوَاهُ عَسَىٰ أَنْ يَنْفَعَنَا أَوْ نَتَّخِذَهُ وَلَدًا وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ وَلِنُعَلِّمَهُهُ مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ وَاللَّهُ غَالِبٌ عَلَىٰ أَمْرِهِ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٢١﴾ ﴾ [سورة يوسف: 21]

“Një njeri nga Egjipti që e bleu, i tha gruas së vet: “Bëja të këndshëm qëndrimin këtu. Ndoshta do të na shërbejë ose do ta birësojmë!” Dhe kështu, Ne e vendosëm Jusufin në atë tokë të bukur dhe i mësuam shpjegimin e ëndërrave. Allahu ka kontroll dhe fuqi të plotë mbi çështjet e Tij por shumica e njerëzve nuk e dinë.”

[Jusuf: 2]

- 2- Lloji tjetër i temkinit të Jusufit a.s., **është material**, i marrjes së pushtetit pas konfirmimit të pafajësisë së tij. Jusufi a.s. fitoi besimin dhe simpatinë e mbretit, prandaj ai e mbajti afër vetes duke i dhënë mundësi dhe temkin (**fuqi dhe pushtet**). Allahu na rrëfen për këtë në ajetin 54 nga kaptina Jusuf:

﴿ وَقَالَ الْمَلِكُ ائْتُونِي بِهِ أَسْتَخْلِصُهُ لِنَفْسِي فَلَمَّا كَمَّمَهُ قَالَ إِنَّكَ الْيَوْمَ لَدَيْنَا مَكِينٌ أَمِينٌ ﴾

[سورة يوسف: 54] ﴿٥٤﴾

“Mbreti tha: “Ma sillni atë, do ta marr pranë vetes.” Pasi bisedoi me të, i tha: “Që sot, ti ke pozitë të lartë-te ne- dhe je i besuar”. [Jusuf: 54]

b- Temkini (udhhëqja, pushteti, mbretëria e Dhul Karnejnit), dhe i disa popujve të mëparshëm

Kur lexon kaptinën Kehf në Kur'an, gjenë se Allahu xh.sh. e ka dalluar Dhulkarnejnin me pushtet të madh. Ai pati çdo gjë që mund të kishin mbretërit, madje dhe më shumë: pushtet absolut, pushtet të ndërtuar mbi dituri dhe të ruajtur me ushtri të armatosur deri në dhëmbë, me pushtet që shtrihet pothuajse në çdo cep të botës. Allahu xh.sh., thotë:

﴿ إِنَّا مَكَّنَّا لَهُ فِي الْأَرْضِ وَءَاتَيْنَاهُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ سَبَبًا ﴿٨٥﴾ فَاتَّبَعَ سَبَبًا ﴿٨٦﴾ ﴾ [سورة الكهف: 84-85]

“Ne i dhamë atij mundësi në Tokë dhe i dhamë mjete e rrugë për të arritur çdo gjë, 85. kështu që ai u nis në një rrugë.” [Kehf: 84-85]

﴿ أَلَمْ يَرَوْا كَمْ أَهْلَكْنَا مِنْ قَبْلِهِمْ مِنْ قَرْنٍ مَكَّنَّاهُمْ فِي الْأَرْضِ مَا لَمْ يُمَكِّنْ لَكُمْ وَأَرْسَلْنَا السَّمَاءَ عَلَيْهِمْ مِدْرَارًا وَجَعَلْنَا الْأَنْهَارَ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهِمْ فَأَهْلَكْنَاهُمْ بِذُنُوبِهِمْ وَأَنْشَأْنَا مِنْ بَعْدِهِمْ قَرْنًا ءَاخِرِينَ ﴾

﴿ ﴿٦﴾ ﴾ [سورة الأنعام: 6]

“A nuk e shohin ata se sa brezni i kemi zhdukur para tyre?! Ata ishin njerëz që u kishim dhënë më shumë pushtet në tokë sesa ju kemi dhënë ju (mekasve)? Ne u sollëm atyre shira të bollshëm dhe bëmë që të rrjedhin lumenj në viset e tyre; por, për shkak të gjynaheve të tyre i shfarosëm dhe më pas, krijuam breza të tjerë.” [En’amë: 6]

Trajtesa e bërë këtu ishte vetëm në kuadër të nocioneve Kur'anore si sinonime të nocionit *leadership*, ndryshe, ne do t'i kthehemi prapë Dhulkarnejnit për të mësuar për komponentët e *leadership*it dhe tiparet e liderit të suksesshëm.

Grafiku në vazhdim sqaron domethëniet e përbashkëta të nocioneve Kur'anore të *leadership*it dhe kuptimet e tyre gjuhësore e terminologjike:



2. LIDERSHIPI EDUKATIV DHE FUSHAT E TIJ NË KUR'ANIN FISNIK

Vendi ku duam të ndalemi është një kapitull Kur'anor sipas të cilit *çdo gjë e dobishme për njerëzit, qoftë shpirtërore - fetare a materiale, është e nurshme¹ në vetvete dhe ka rëndësi të veçantë, dhe si e tillë nuk duhet shpërfillur as duhet shpërdorur!*

Ky princip është konfirmuar në disa vende në Kur'an ndërsa tek dijetarët, veçmas *usulistët*², njihet si *El-kul-lijjat el-hams* apo *ed-darurijjat el-hams* që në shqip mund të përkthehen si *pesë objektivat kryesore të fesë ose pesë gjërat e domosdoshme*.

Këta pesë objektiva kryesore janë:

- 1) *ruajtja e fesë,*
- 2) *ruajtja e jetës,*
- 3) *ruajtja e pasardhësve,*
- 4) *ruajtja e mendjes, dhe*
- 5) *ruajtja e pasuris¹*

¹ E *nurshme*: e dashur, e dëshiruar, simpatike, plotë dritë, e këndshme, atraktive. **Përkthyesi.**

² Imam Shatibiu, sa për shembull, në librin *El-muvaafekat*, ka thënë: “Objektivat e Sheriatit janë shpirti i veprave.” Shih veprën në fjalë, 2/344.

Logjikisht, për t'i ruajtur këto pesë qëllime, duhet ekzistuar një organ, një autoritet, ndryshe njerëzit nuk do të kujdeseshin për to dhe as që do të donin të dinin sa të shenjta janë! Ky organ ose autoritet është *Imami, Halifeja, mbreti, presidenti* ose i autorizuari për to! Mungesa e tyre do ti sillte shoqërisë shkelje të të drejtave, shtypje, shpërfillje, shkurt do të mbretëronte e keqja dhe kaosi total!

Kjo flet për rëndësinë që ka udhëheqja e drejtë dhe e urtë por dhe për qafimi i saj nga populli.

Për ta funksionalizuar këtë udhëheqje në praktikë, Allahu xh.sh., krijoi Ademin a.s. dhe ia ngarkoi detyrën e Halifes në tokë, në mënyrë që të mbrojë dhe sigurojë këto të drejta si dhe t'ua përcjell brezave të ardhshëm. Për ta rrënjëzuar udhëheqjen e drejtë në shpirtrat dhe zemrat e gjeneratave, Allahu xh.sh. vazhdimisht i dërgoi njerëzimit peygamberë, nga Nuhu a.s. e deri tek Muhammedi a.s., pastaj sahabet (shokët e Muhamedit) a.s., shokët e tij, gjeneratat pas tyre, Sulltana e liderë të drejtë dhe reformatorë.

Çështja e edukimit¹, udhëzimit dhe arsimimit është më e rëndë nga ç'pandehim! Është amanet hyjnor që na është ngarkuar në raport me familjet tona dhe me shoqërinë, qofshim nëpunës a

¹ Librin më të mirë që kam mundur ta gjejë në fushën e edukimit të fëmijëve është ai i hoxhës dhe profesorit të njohur, Dr. Abdullah Nasih Alvan, profesor i studimeve islame në Universitetin Mbreti Abdul Aziz në Xhidde. Libri titullohet *Terbijjetu el-evlad fi el-Islam (Edukimi i fëmijëve sipas Islamit)*. Libri është i botuar. (Ky libër është i përkthyer edhe në shqip. **Përkthyesi**

edukatorë, përgjegjës në institucione arsimore, publike apo ushtarake. Këtë koncept e gjejmë qartë e bukur në Kur'an. Allahu xh.sh., thotë:

﴿يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا فَوْا أَنفُسِكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ عَلَيْهَا مَلَائِكَةٌ
غِلَاطٌ شِدَادٌ لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ ﴿٦﴾ [سورة التحريم: 6]

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por ato i zbatojnë menjëherë.” [Tahrim: 6]

﴿وَكَانَ يَأْمُرُ أَهْلَهُ بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ وَكَانَ عِنْدَ رَبِّهِ مَرْضِيًّا ﴿٥٥﴾ [مریم: 55]

“Ai e urdhëronte popullin e vet që të falte namazin, të jepte zeqatin dhe si i tillë ishte i mirëpritur te Zoti i vet..” [Merjem: 55]

﴿وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ يَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ
وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَيُطِيعُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ أُولَئِكَ سَيَرْحَمُهُمُ اللَّهُ إِنَّ
اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٧١﴾ [سورة التوبة: 71]

“Besimtarët dhe besimtares janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zeqatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” [Teube:71]

Këtë pikpamje e gjejmë dhe në hadithet e Muhammedit a.s. Në hadithin e Abdullah bin Omerit r.a. të shënuar në Sahihun e

Buhariut, qëndron se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Secili prej jush është bari (përgjegjës), andaj secili do të japë përgjegjësi për kopenë e vet. Burri është përgjegjës për familjen e tij, ndaj do të japë përgjegjësi për të. Gruaja është përgjegjëse për shtëpinë e burrit të vet, ndaj do të pyetet për të. Shërbëtori është përgjegjës për pasurinë e zotërisë së vet, ndaj do të pyetet për të.”* Mendoj se ka thënë edhe: *“Burri është përgjegjës për pasurinë e babait të vet, ndaj do të pyetet për të. Pra, secili është bari, ndaj secili do të pyetet për kopenë e vet.”*¹

Në versionin e shënuar në Sahihun e Ibn Hibbanit qëndron: *“Para Allahut xh.sh. do të japin llogari dhe ata që janë ngarkuar si përgjegjës për punët me përgjegjësi dhe do të shihet nëse e kanë kryer punën me përgjegjësi a jo. Njëherit do të japin llogari dhe për anëtarët e familjes.”*²

Për ta jetësuar këtë koncept në praktikë, për të përmbushur rolin tonë ekzistencial dhe human me përkushtim ndaj Zotit tonë, na duhet dituria, përvoja dhe durimi. Kjo është ajo që ka diktuar nevojën e njohjes me sekretet e udhëheqjes dhe lidershit Kur’anor në edukim dhe udhëzim. Kur’ani na jep shembuj dhe mësim të rëndësishme në këtë aspekt dhe sa për ilustrim, do të përmendim shembullin e Ibrahimit a.s. me të atin në thirrje dhe këshillim për ta pranuar udhëzimin fetar. Pastaj shembullin e Nuhut a.s. me të birin, shembullin e Llukmanit a.s. me të birin po kështu.

Po të mos kishim frikë monotoninë nga zgjerimi i tepërt, do flisnin për të gjithë, mirpo këtë të fundit, pra shembullin e Llukmanit a.s. në edukimin e të birit me ashk e dashuri do ta shtjellojmë këtu për rëndësinë që ka. Këshillat e tij janë me shumë vlerë dhe duhet patjetër të përvetësohen. Tematikisht, ato mund të klasifikohen në katër fusha:

¹ Shih hadithin nr. 893.

² Shih hadithin nr. 4492.

2.1. Fusha e kredos e manifestuar në njëshmërinë e Allahut xh.sh. – monoteizmin

Kur'ani na ka ofruar një metodologji të rrallë dhe të çmuar për trajtimin e problemeve intelektuale, fetare, morale e shoqërore. Është mësim hyjnor ku fillimisht meson të merresh me identifikimin e problemit më pas me terapinë adekuate. Ikja nga këto parime për të përvetësuar mënyra të tjera nënkupton apriori dështim. Besimi nuk zë vend vetëm në zemër por edhe në mendje, dhe mes tyre nuk ka ndarje. Zemra dhe mendja ndikohen nga çështjet emocionale dhe filozofike (konceptuale) ato e përbëjnë fatin e njeriut. Perceptimi i vërtetë përkitazi me Allahun xh.sh., *rububijetin, uluhijetin, emrat¹ dhe tiparet e Tij*, për bazë ka zemrën, në varësi të së cilës janë sjelljet dhe veprimet e njeriut. Më qartë, nëse zemra ndryshon për të mirë, ndryshojnë për të mirë edhe sjelljet e besimtarit. Për këtë shkak, Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Vini re, në trup është një copë mishi (organ), i cili nëse është i shëndoshë, i shëndoshë është tërë trupi, e nëse është i prishur (sëmurë), i prishur është tërë trupi. Vini re, ajo është zemra.”²*

Këtu mbase qëndron sekreti pse i urti Lukman, këshillat dhe udhëzimet e para që ia dha të birit i përqëndroi te besimi në Zot, (*monoteizëm*), ndërkohë që e urdhëroi të braktiste shirkun (*idhujtarinë, politezimin*), sepse me monoteizëm adhurohet

¹ Shih kuptimin e nocioneve në fund të librit

² Transmeton Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit:52, Muslimi në Sahihun e tij, nr.i hadithit:1599, Imam Albani në Sahih el Xhami'e, nr. i hadithit:3193

vetëm Zoti i pastër dhe i dëlirë, ashtu siç Ai kërkon nga krijesat!
Duke na folur për këtë, Allahu xh.sh., thotë:

﴿وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴿١٣﴾﴾

“(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: “O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe”. [Llukman: 13]

Llukmani e këshilloi të birin të largohej nga idhujtaria sepse shpirti që mëton lartësim, do pastrimin, ngritje dhe përsosmëri, ndaj duhet patjetër të heq dorë nga veset e këqia, degjenerimi dhe devijimi. Transformimi në bindje dhe në besim nënkupton reformë në vepra dhe në moral. Figurativisht, nëse besimi dhe bindjet janë trangu, veprat dhe morali janë degët, kështu që përkujdesja për trangu reflekton edhe tek degët. Edukatorët e mëdhenj të ymetit na kanë mësuar se zhveshja nga të metat duhet të zavendësohet me virtyte të çmuara. Sa e vlefshme është kjo porosi e Llukmanit na meson dhe shpjegimi i bukur që i bën hoxha dhe dijetari dhe mufessiri, Sa’ di –u, Allahu e mëshiroftë!
“ Llukmani i dha një këshillë të birit në të cilën ka urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja dhe të cilat shoqërohen me nxitje dhe frikësim. (Më qartë) e urdhëroi për besim të sinqertë dhe të pastër në Allahun dhe e ndaloi nga idhujtaria duke ia shpjeguar edhe arsyen e kësaj këshille:

“...Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe”.
[Llukman: 13]

Shkaku pse është padrejtësi e madhe qëndron në atë se nuk ka vepër më të shëmtuar dhe më mizore se të barazosh atë që është krijuar nga dheu me Atë që zotëron krijesat, ta barazosh atë që nuk posedon asgjë me Atë që posedon çdo gjë, ta barazosh atë që ka të meta dhe që është i varfër nga çdo aspekt me Atë që është i përsosur dhe i pasur absolut, ta barazosh atë që nuk mund të gëzojë mirëqenie e salltanet vetvetiu me Atë që çdo mirësi e begati që posedojnë njerëzit materiale e fetare, fizike e shpirtërore, e kanë prej Tij dhe se askush pos Tij nuk mund tua largojë të keqen.

Së këndejmi, a ka padrejtësi më e madhe se kjo (që ti jep Allahu tërë këto të mira e ti ta mohosh)? A ka më të padrejtë se ai që Allahu e krijoi për ta adhuruar dhe për ta besuar sinqerisht ndërsa ai shkon dhe i beson atyre që nuk posedojnë asgjë, duke i bërë vetes kështu padrejtësi të madhe?”¹

Analiza që ka bërë Hoxha Sa’di është më e mira që mund të bëhet sepse, nga aspekti fetar, nuk përfillen normat dytësore para se të mbillen në zemër bazat e besimit fetar. Në fakt, këtu qëndrojnë dhe principet bazike fetare, në thirrjen e të tjerëve në besim dhe në zhvillimin e mëtejme të raporteve tona fetare. Ai që ka bërë shirk (*ka rënë në idhujtari*), ai ka bërë mëkatin më të pafalshëm, ka injoruar faktet dhe argumentet e panumërta që e rrethojnë, ka shpërdorur dhe përbuzur mirësitë dhe begatitë e shumta që ka, ka mohuar dhuratën nga Zoti – një gjë që nuk do të duhej ta bënte kurrë!

¹ Shih: Tefsiri i Sa’dit, versioni elektronik: <https://furqan.co/saadi/31/13>

Duke iu referuar ajetit në fjalë, një shpjegim brilant për raportet edukative baba-djalë (prind-fëmijë) dhe për rëndësinë e teuhidit dhe besimit në Allahun ka dhënë edhe komentatori i shquar i Kur'anit prof. Sejid Kutubi: “Pastaj trajtohet çështja e Teuhidit në formë të një këshille të Llukmanit dhënë të birit:

﴿وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴿١٣﴾﴾

“(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe”. [Llukman: 13]

Është këshillë, jo akuzë, sepse babai i do fëmijës së vet vetëm më të mirën. Babai është vetëm këshillues, jo mashtrues i fëmijës së vet. Ja, ky është Llukmani i urtë, i cili po e ndalon të birin nga idhujtaria duke ia shpjeguar të birit që kjo ndalesë që shpie në idhujtari është padrejtësi e madhe ndaj vetvetes dhe këtë ia konfirmon dy herë: herën e parë duke e paraprirë ndales dhe duke e ndarë justifikim dhe herën e dytë duke përdorur pjesëzat përforcuese (*inne* *ل* dhe *lamin* *ل*) në ndalesë...

Kjo është e vërteta që Muhammedi a.s. ia prezanton popullit të vet por që polemizojnë rreth saj, që po dyshojnë në qëllimet e tij, që po kanë frikë se mbrapa kësaj fshihet marrja e pushtetit nga duart e tyre dhe shfaqja e epërsisë ndaj tyre. Nëse ata mendojnë ashtu, atëherë çfarë mund të thuhet për këshillën e Llukmanit që ia jep të birit¹. Ajo është e pastër nga çfarëdo dyshimi dhe larg çfarëdo supozimi. Kjo është një e vërtetë e moçme që rrjedh në gjuhën e atyre që Allahu i ka begatuar me urtësi dhe me të cilën synohet vetëm e mira dhe asgjë pos saj...dhe ky ndikimi emocional është pikërisht ai që synohet...

Në Kur'an dhe në porositë e Pejgamberit Muhammed a.s. porosia e fëmijëve për prindërit përsëritet më shpesh në raport me porosinë e prindërve për fëmijët. Kjo e fundit ka ardhur kryesisht me kuptim të dashurisë dhe në rrethana të caktuara sepse është natyra e pastër njerëzore

ajo që njeriut ia ngarkon përgjegjësinë e edukimit të fëmijës dhe mbikëqyrjes së tij. Natyrshmëria (instinkti) e shtyn njeriu të përkujdeset për gjeneratën e re që jeta të vazhdojë ashtu siç Allahu dëshiron. Prindërit do të japin për fëmijën e tyre çdo gjë që kanë, fizike e materiale, pa u ndier keq dhe pa u ankuar, madje ndonjëherë dhe krejtësisht pavëmendshëm. Madje e bëjnë me aq dashuri e gezim sikurse marrin e jo japin (babai dhe nëna). Natyrshmëria mjafton si shtytje për kujdesin ndaj fëmijëve, edhe nëse nuk ka fare këshilla të kësaj natyre. Ndërsa fëmija, ai ka nevojë të përhershme për këshilla nga më të vjetrit - gjenerata sakrifikuese që i ngriti dhe që dalëngadalë po largohet nga kjo jetë... Fëmija nuk ka mundësi të shpaguante prindërit edhe po tua kushtonte atyre tërë jetën! Nënës, kuptohet nga vet natyra, i bie barra më e madhe në gjithë këtë process të rritjes dhe formimit..."¹

Interpretimi i prof. Sejid Kutubit jo vetëm që, për nga ana stilistike, është i rrallë dhe i mrekullueshëm, por është edhe logjik dhe real përsa i përket raportit prindër-fëmijë dhe qëllimeve që fshihen prapa këshillave ndaj fëmijëve, sepse prindi nuk do tjetër pos hajrit dhe të mirën për fëmijët. Nëse ndërmjet njerëzve mund të ketë zili dhe hased, ndërmjet prindërve dhe fëmijëve kjo nuk ndodhë kurrë!

Prindi vetëm të mirën ia do fëmijës dhe asgjë tjetër. Imazh i dashurisë së tij ndaj fëmijës përfshinë dhe ndalimin nga të këqijat, ato që shkaktojnë hidhërimin e Allahut xh.sh. siç është p.sh. shirku - të dy llojet, shirku i madh (*idhujtaria*), që të nxjerr tërësisht nga feja dhe shirku i vogël (*hipokrizia në fe, mendjemadhësia, vetëmahnitja*), që shkatërron veprat.

¹ Shih: Fi dhilal el-Kur'an, versioni elektronik: <https://islamweb.net/ar/library>, Shih po kështu dhe tefsiret El-bahru el-muhit të Ebu Hajjanit dhe Ettahrir ve ettenvir të Ibn Ashurit, respektivisht versionet elektronike të tyre në: <http://mosshaf.com/ar/>

Analiza shpirtërore, shoqërore dhe fetare që prof.Sejid Kutubi i bën rrezikut nga idhujtaria dhe rëndësisë së edukates fetare për të rinjtë, ofron argument shtesë dhe për detyrimet e fëmijës karshi prindit. Këtë e thekson edhe Kur’ani ndërsa porositë fëmijët për mirësjellje, respekt dhe bindje ndaj prindërve.

Pas kësaj mund të konkludojmë se metodologjia Kur’anore për transformimin e plotë të njeriut mbështetet tek ana e brendshme dhe ana e jashtme e njeriut. Që njeriu të ndryshojë për të mirë, duhet t’i kushtojë rëndësi dy aspekteve, ndryshe, efekti nuk do të arrihet, përpjekja do të jetë e kotë! Kështu na mëson Kur’ani:

﴿وَذُرُوا ظَاهِرَ الْأَيْمَنِ وَبَاطِنَهُ إِنَّ الَّذِينَ يَكْسِبُونَ الْأَيْمَنَ سَيُجْرَوْنَ بِمَا كَانُوا يَقْتَرُونَ ﴿١٢٠﴾﴾

[سورة الأنعام: ١٢٠]

“Largohuni nga gjynahet e hapura dhe të fshehta, sepse padyshim mëkatarët do të ndëshkohen për veprat e bëra.” [Kur’ani: En’amë: 120]

﴿قُلْ إِنَّمَا حَرَّمَ رَبِّي الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَّنَ وَالْإِثْمَ وَالْبَغْيَ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَأَنْ تُشْرِكُوا بِاللَّهِ

مَا لَمْ يُزَلِّ بِهِ سُلْطَانًا وَأَنْ تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٣٣﴾﴾ [سورة الأعراف: 33]

“Thuaj: Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin të hapura apo të fshehta, gjynahet, dhunimin pa të drejtë, t’i shoqërohet diçka Allahut (në adhurim diçka për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini.” [Kur’ani: A’rafë: 33]

﴿قُلْ تَعَالَوْا أَتْلُ مَا حَرَّمَ رَبِّي عَلَيْكُمْ أَلَّا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِمَّنْ إِمْلَقَ مَحْنُ نَزْرُقُكُمْ وَإِيْسَاهُمْ وَلَا تَقْرَبُوا الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا

وَمَا بَطَّنْ وَلَا تَقْتُلُوا النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ ذَٰلِكُمْ وَصَّوْكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ

تَعْقُلُونَ ﴿١٥١﴾ [سورة الأنعام: 151]

“Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); të silleni mirë me prindërit; të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; të mos u afroheni veprave të turpshme, qofshin të hapura apo të fshehta dhe të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (ligji). Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni.” [Kur’ani: En’amë: 151]

Paragrafët e kësaj njësie në formë grafiku mund t’i përmbledhim si më poshtë:



2.2. Fusha e meditimit në gjithëpërfshirjen e dijes së Allahut xh.sh. dhe mundësitë e pakufizuara të Tij dhe vetëvëzhgimi ynë si rezultat i këtij meditimi

Metodologjia edukative Kur'anore në këtë rrëfim të mrekullueshëm përplotë urtësi vazhdon më tutje me detajet dhe mënyrat e aplikuara në trajtimin e problemeve me bazë fetare dhe intelektuale. Për sukses të lidërshiptit edukativ, nevojitet transformimi rrënjësor i brendshëm dhe i jashtëm. Në kulmin e të të metave që paralizojnë besimin është harrimi i Zotit, neglizhenca dhe shkujdesi ynë përballë mbikëqyrjes së përhershme të Allahut xh.sh. si në vetmi ashtu dhe në publik, gjëra këto që konsiderohen mëkate ndaj Allahut xh.sh. dhe si të tilla konsiderohen shkelje dhe shpërfillje e të drejtave njerëzore.

Llukmani deshi ta mbjellë tek i biri frikën ndaj Allahut xh.sh. dhe ndjesinë e të qenit përherë nën vëzhgimin e Tij duke e bërë të bindet se Allahut nuk i fshihet asgjë në qiej dhe në tokë dhe se Ai ka dije të hollësishme për çdo gjë. Këtë çështje Kur'ani e shpjegon në shumë ajete ndërsa ne po kujtojmë këshillën e Llukmanit a.s.:

﴿يَبْنَئُ إِنهَآ إِن تَكُ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِّنْ خَرْدَلٍ فَتَكُنْ فِي صَحْرَةٍ أَوْ فِي السَّمَوَاتِ أَوْ فِي الْأَرْضِ يَأْتِ

بِهَآ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ لَطِيفٌ خَبِيرٌ ﴿١٦﴾ [سورة لقمان:16]

“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.”[Llukman: 16]

Komentatori i Kur'anit Prof.Sejid Kutubi përkitazi me kuptimet e këtij ajeti shton: *“Paragrafi vijues në këshillën e Llukmanit flet për çështjen e botës tjetër dhe llogarinë e hollësishme dhe shpërblimin e drejtë në të. Por kjo e vërtetë nuk prezantohet lakuriq. Ndërsa shpalos detaje nga dituria e madhe dhe gjithëpërfshirëse e Allahut, kjo e vërtetë prezantohet në një hapësirë universi të pafundme, në një imazh emocional dhe drithërues:*

﴿يَبُوءُ إِنَّهَا إِن تَكُ مِمَّا قَالَجَبَّةٍ مِّنْ خَرَدٍ فَتَكُنْ فِي صَحْرَةٍ أَوْ فِي السَّمَوَاتِ أَوْ فِي الْأَرْضِ يَأْتِ بِهَا اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ لَطِيفٌ حَيِيرٌ ﴿١٦﴾﴾ [سورة لقمان: 16]

“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njuh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.” [Llukman: 16]

Asnjë përshkrim i thjesht rreth hollësive të dijes së pasosur të Allahut dhe fuqisë së Tij, rreth detajeve të llogarisë dhe drejtësisë gjatë peshojës nuk mund të ndikojë dhe të prek ndjenjat e njeriut siç bën ky përshkrim i thellë figurativ, i cili i detyrohet natyrës sfiduese e Hyjnore Kur'anore.

Një kokërr sinapi, e vogël dhe pothuajse e pa diktuar në peshore dhe po, pa asnjë vlerë, “që ndodhet në shkëmb” ku nuk mund të shihet a të nxirret, apo “në qiej” në atë strukturë gjigante në të cilën edhe një yll i madh duket thjesht si një pikë e vogël apo grimcë lundruese, “apo në tokë” e humbur në dheun dhe rërën e saj, “Allahu do ta nxjerrë në shesh” sepse diturisë së Tij nuk i fshihet fuqisë së Tij nuk mund t'i përvidhet...Shpjegim që i përshtat kësaj skene të mahnitshme..”¹

Ky shpjegim i mahnitshëm Kur'anor me këshillat e Llukmanit për të birin qartëson rolin dhe rëndësinë e lidërshiptit në procesin edukativ, sipas Kur'anit Fisnik. Këto përshkrime të mrekullueshme nxisin mendjen e njeriut për reflektim rreth

¹ Shih: *Fi dhilal el-Kur'an*, versioni elektronik në: <https://islamweb.net/ar/>

krijimtarisë së Allahut xh.sh. duke u bindur me provat e ekzistencës së Tij, duke menduar thellë në tiparet e Tij, krijimtarinë e Tij, madhështinë e Tij. Vetëm simbioza e krijesave të Universit, bukuria dhe harmonia mund të na përafrojë tek vërtetsia e vulosur në ajetet Kuranore.

Ajo që do të donim të theksonim në interes për liderët dhe edukatorët është këshilla të lexojnë njëherësh mus'hafin e shkruar (*Kur'anin Fisnik*) dhe mus'hafin e shikuar (*universin, gjithësinë*) për të zbuluar kështu madhështinë e Krijuesit. Hoxha, lideri, edukatori duhet ta ketë parasysh këtë të vërtetë të padiskutueshme në mënyrë që fëmijëve, nxënësve, studentëve, nëpunësve, ushtarëve, tua forcojnë besimin në Krijuesin dhe t'i bëjnë ata të ndjejnë praninë e Allahut dhe vëzhgimin e Tij në çdo veprim që bëjnë (sekret a të hapur)!

Imazhet e panumërta të planeteve në gjithësi, yjet dhe trupat qiellorë që koekzistojnë në këtë sistem aq preciz qiellor, mund t'i gjejmë me po këtë saktësi edhe në Kur'an, pra ka një përputhje unike ndërmjet këtyre dy mus'hafëve. Për më tepër, në Kur'an gjejmë përshkrimin se mundësia që Allahu xh.sh. t'i krijojë nga fillimi është e padiskutueshme, madje, sipas kriterëve tona, është edhe më e lehtë për Të meqë ka modelin paraprak, dhe Allahu që ka mundësi për këtë gjë, ka mundësi edhe ta ringjallë njeriun dhe ta llogarisë që i miri të shpërblehet për të mirën dhe i keqi për të keqen.

Allahu xh.sh., thotë:

﴿ وَهُوَ الَّذِي يَبْدَأُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ وَهُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ وَلَهُ الْمَثَلُ الْأَعْلَىٰ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ ۝﴾

﴿ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۝﴾ [سورة الروم: 27]

“Ai e zë fill krijimin dhe Ai e përsërit atë e për Atë kjo është edhe më e lehtë. Atij i përket shembulli më i lartë në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” [Kur'ani: Rrum: 27]

﴿وَقَفُّهُمْ إِنَّهُمْ مَسْتَوْلُونَ﴾ [سورة الصافات: 24]


“Ndalini ata, se do të pyeten.” [Kur’ani: Saffat: 24]

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَانظُرُوا إِلَيْهِ خَيْرًا إِنَّا نَعْمَلُونَ

تَعْمَلُونَ﴾ [سورة الحشر: 18]

“O besimtarë, kini frikë Allahun dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për nesër! Kini frikë Allahun sepse Ai di çdo gjë që ju bëni!” [Kur’ani: Hashr: 18]

Grafiku në vijim na e sjell në formë të përmbledhur këtë njësi:



2.3. Fusha shoqërore edukative e manifestuar në urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja

Rrugëtimin tonë me Llukmanin a.s. dhe të birin e vazhdojmë me urdhërimin tjetër për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, siç qëndron në Kur'an:

﴿يُبَيِّنُ آتِمَ الصَّلَاةِ وَأُمَرَ بِالْمَعْرُوفِ وَأَنَّهُ عَنِ الْمُنْكَرِ وَأَصْبِرْ عَلَىٰ مَا أَصَابَكَ ۗ إِنَّ ذَٰلِكَ مِنْ عَزْمِ

الْأُمُورِ ﴿سورة لقمان: 17﴾

“O djali-biri- im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!” [Llukman:17]

Për shkak të rëndësisë që ka në ruajtjen e shoqërive nga shkatërrimi moral, Kur'ani dhe Sunneti i kanë kushtuar rëndësi maksimale urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja duke na mësuar se shpërfillja apo largimi nga feja në fakt paraqet shpallje lufte ndaj vlerave shoqërore, sepse jeta nuk mund të paramendohet pa kritere morale e fetare. Pikërisht për këtë arsye, për të shpëtuar nga shkatërrimi i sigurt, feja ka urdhëruar funksionalizimin dhe respektimin e këtij institucioni.

Urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja e plotësojnë dhe hadithet profetike. Në to vërehet nxitja dhe domosdoja për urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Me këtë rast përmendim hadithin e Usame bin Zejdit r.a. të shënuar në Sahihun e Buhariut, ku në mes tjerash qëndron:

“...E çfarë ke dëgjuar Pejgamberin a.s. të ketë thënë? - e pyetën. Tha: E kam dëgjuar duke thënë: *“Ditën e Kiametit do të sillet një njeri dhe do të hidhet në Zjarr. Atij do t’i nxirren zorrët dhe do të sillet rrotull siç sillet gomari rreth gurit të mullirit (ose si kali që fshinë në lëmë). Banorët e Zjarrit do të mblidhen rrotull tij e do t’i thonë: O filan. Ç’është kështu me ty? A nuk ishte ti që na urdhëroje për të mirë dhe na ndaloje nga e keqja?! Ai do t’u përgjigjet: Po, ju urdhëroja për të mirë por vetë nuk e zbatoja, ua ndaloja të keqen por vetë e bëja.”*¹

Në koleksionin e Imam Tirmidhiut qëndron hadithi ku Pejgamberi a.s ka thënë: *“Pasha Allahun në dorën e të Cilit është shpirti im, o do të urdhëroni për të mirë e të ndaloni nga e keqja, o nuk do të vonojë që Allahu tju çojë një dënim, për largimin e të cilit pastaj do ta lusni Allahun por nuk do t’ju përgjigjet.”*

Kështu e shpjegojnë këtë hadith dijetarët:

[Pasha Allahun në dorën e të Cilit është shpirti im...]: Pejgamberi a.s. po betohet në Allahun xh.sh. në Poseduesin e shpitrave tanë, gjë që si betim e ka përdorur shpesh.

[...Ose do të urdhëroni për të mirë e të ndaloni nga e keqja...]: ose do të jeni kureshtar për këtë dhe do t’i kushtoni rëndësi.

E mira këtu përfshin çdo fjalë a vepër të mirë që çon në adhurim të Zotit dhe në ndihmë të njerëzve. Është emër i përgjithshëm që përfshin të gjitha llojet e të mirave. Ndërsa *e keqja* nënkupton çdo fjalë a vepër që shpie në mëkat. Edhe kjo përfshin të gjitha llojet e të këqijave.

¹ Buhariu, nr. 3267

[...**O nuk do të vonojë dhe Allahu do t'ju çojë një dënim...**]: nëse ndaloni së urdhëruari për të mirë dhe së ndaluar nga e keqja, atëherë ju jeni afër dënimit që Allahu e ka përgatitur për ju.

[...**Për largimin e të cilit do ta lusni Allahun por nuk do t'iu përgjigjet.**]: kjo për të treguar se sa i rrezikshëm do të jetë ky dënim i shpërfilljes së urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja. Do ta lusni që tua largojë dënimin por Ai nuk do t'ju përgjigjet!

Ndër mësimet e hadithit veçojmë:

- 1) Tërheqja e vërejtjes dhe kërcënimi në rast të braktisjes së urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.

Dijetari dhe komentatori i shquar i Kur'anit Tahir bin Ashur, duke iu referuar ajetit të mësipërm: *"O djali-biri- im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!"* [Llukman:17], jep shpjegime të vlefshme lidhur me kuptimin gjithëpërfshirës të këtij urdhërimi: *"...Urdhërimi për të mirë përfshin kryerjen e çdo veprë të mirë në mënyrë të përgjithshme që shkoqitja më pas të kërkojë këshilla shtesë. Edhe e keqja përfshin braktisjen e çdo të keqe. Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja parashohin që protagonistin e tyre të jetë i pari ai që bën mirë dhe largohet nga të këqijat sepse, ai që urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja, sigurisht se është në dijeni për të mirat dhe të këqijat që gjenden në vepra, për dëmet dhe dobitë e tyre, kështu që padyshim ai do të jetë i pari që i ruhet (shmanget) të këqijave para se të urdhërojë e ndalojë të tjerët. Kjo fjalë përbëhet nga këshilla dhe devotshmëria ngaqë Llukmani në këshillën për të birin përmbodhi udhëzimin për ta përmbushur të mirën dhe për ta përhapur ndër njerëz njëherësh për tu shmangur nga e keqja duke i distancuar edhe njerëzit nga ajo.*

Pas kësaj vijon këshilla për durim për atë që mund të përballet me kundërshtarët. Ai që urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja

domosdoshmërisht do të ketë dhe kundërshtarë të cilët do të mundohen ta luftojnë ndaj dhe duhet durim dhe shkathtësi për tu përballur me rreziqet eventuale!”

Këtë të vërtetë e gjejmë të konfirmuar edhe në një vend tjetër në Kur'an, në kaptinën Asr:

﴿ وَالْعَصْرِ ﴿١﴾ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ ﴿٢﴾ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصُوا بِالْحَقِّ وَتَوَّصُوا بِالصَّبْرِ ﴿٣﴾ ﴾ [سورة العصر: 1-3]

“1.Për kohën! –pasha kohën - 2. Me të vërtetë, njeriu është në humbje, 3. përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën, i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” [Asr: 1-3]

Ndërsa sa u përket rëndësisë së kësaj vepre, kushteve që duhet t'i plotësojë ai që urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja dhe metodave që duhet të ndjek, këtë na mëson ajeti në vijim:

﴿ وَتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١٠٤﴾ ﴾ [سورة آل عمران: 104]

“Le të dalë prej jush një grup që thërret për mirësi, urdhëron për vepra të mira dhe ndalon veprave e shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.” [Al Imran: 104]

Ajeti është i qartë. Allahu xh.sh., dëshiron prej nesh që **“një grup”** i shkolluar, intelektual, i kualifikuar, me licencë, mbështetur e udhëhequr nga institucionet përkatëse ta merr përsipër këtë obligim. Pra jo çdokush mund ta kryejë këtë detyrë dhe jo çdokush e ka të drejtën e ngjitjes në minber për të folur e këshilluar, për të urdhëruar për të mirë e për të ndaluar nga e keqja. Pa plotësuar këto kushte dhe pa pasur leje nga autoritetet më të larta shtetërore e fetare, nuk mund të kryejnë këtë detyrë

jetike për njeriun- të urdhërojnë për të mirë dhe të ndalojnë nga e keqja.

Si imazh të shpërfilljes së këtij institucioni do të doja të përmend të sharat, ofendimet, fyerjet dhe kritikak e ashpra që i shohim në rrjete sociale ndaj burrështetasve dhe liderëve, vokabular absolutisht i papranuar si në aspektin fetar ashtu dhe në atë ligjor e moral!

Dijetarët kanë nënvizuar se norma për urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja është farz kifaje ose detyrim parcial me kuptim që nëse një pjesë e shoqërisë e kryen këtë detyrë në formën dhe mënyrën më të mirë dhe sipas kushteve të parapara për çka edhe kanë rezultatet konkrete në shoqëri, pra nuk shkaktojnë skandale me liderë shtetërorë, atëherë obligimi i pjesës tjetër të qytetarëve bie.¹

Se duhet të angazhohet një grup dhe jo tërë shoqëria na mëson dhe ajeti në vazhdim:

﴿ وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنْفِرُوا كَافَّةً ۚ فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ ﴿١٢٢﴾ ﴾ [سورة التوبة: 122]

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehen te ata, në mënyrë që ata ta kuptojnë (e të ruhen).” [Teube: 122]

Urdhëri hyjnor në këtë ajet nuk u drejtohet të gjithë njerëzve sepse, siç shpjeguar më parë, çështja e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja, nuk është çështje vullnetare, e lirë, që të mund ta ushtrojë kush të dojë, qoftë në emër të fesë, në emër të institucioneve shtetërore, apo edhe thjesht në emër të një adhurimi për Allahun! Arsyeja pse nuk lejohet një gjë e tillë për

¹ <https://dorar.net/hadith/sharh/35647>

të gjithë qëndron tek kushtet specifike që duhet ti plotësojë ai që kryen këtë mision, pra që të ketë dije për atë që urdhëron dhe ndalon, të jetë në dijeni për gjendjen shpirtërore, shoqërore e ekonomike të atyre që i urdhëron për të mirë dhe i ndalon nga e keqja në mënyrë që të mos shkaktojë ndonjë problem për shkak të mungesës së profesionalizmit, respektivisht dijes se kur duhet ndaluar të keqen me dorë, kur me gojë e kur me zemër.

Ndërsa sa i përket urdhërimit të familjes, fëmijëve dhe të afërmve, kjo është çështje individuale dhe secili prej nesh është i obliguar veç e veç ta ushtrojë atë pa pasur nevojë për leje paraprake nga autoritetet. Kjo edhe për faktin se të ngarkuarit me detyrën e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja nuk paramendohen që punën e tyre ta ushtrojnë si spiunë dhe agjent të fshehtë, assesi jo, ata janë të njohur, dhe ata nuk kalojnë muret për të parë se çfarë bën njeriu brenda mureve të shtëpisë. Njohja e këtyre rregullave konsiderohet prej *çështjeve të domosdoshme që duhet ditur nga feja*.

Në të kaluarën, dijetarë çështjet që kanë të bëjnë me urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja i kanë përmbledhur brenda një termi shkencor e administrativ të quajtur *Hisbe* duke shpjeguar se e mirë është ajo që njihet e mira e saj dhe që miratohet nga feja, dhe se e keqe është ajo që ndalohet dhe nuk ligjësohet nga feja. Në hadithin e Ebu Seid el-Hudrijit r.a., qëndron se Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Kush prej jush e sheh një të keqe, le ta ndalojë me dorë, nëse nuk mundet, le ta ndalojë me gjuhë, e nëse as kështu nuk mundet, atëherë le ta ndalojë me zemër dhe kjo është grada më e dobët e besimit.”*¹

¹ Hadith i saktë, i konfirmuar nga Albani në *Sahihu Ebi Davud*, nr. 4340; *Sahihu Ibni Maxheh*, nr. 3258; Shuajb Arnauti në *Musned*, nr. 11073., *Sahih ibni Hibban*, nr.308, <https://dorar.net/hadith/>

Ata që dëshirojnë njohuri më të zgjeruara rreth kësaj çështje, le t'i kthehen librit tonë *Haritatu eddaveti ila Rabbi el-enam fi tefsiri el-ustadhi Sejjid Kutub li-sureti el-en'amë* (Harta e Thirrjes në fenë e Zotit sipas komentimit të kaptinës En'amë nga Profesori Sejjid Kutubi).

Këtë qasje e ka edhe Imam Taberiu dhe këto kuptime i ka konfirmuar edhe ai në komentimin bërë ajetit 104 nga kaptina Al Imran:

“Le të dalë prej jush” besimtarëve **“një ymet”** xhemat, grup, **“që të thërrasë”** njerëzit **“për në mirësi”** në Islam dhe mësimet e tij të ligjësuara nga Allahu, **“të urdhërojë për vepra të mira”** të urdhërojë njerëzit për ta pasuar Muhammedin a.s. dhe fenë e tij të sjellë nga Allahu xh.sh., **“e të ndalojë prej veprave të shëmtuara!”** ndalojnë nga kufri ose mohimi i Allahut dhe përgënjeshtrimi i Muhammedit a.s., dhe fesë së tij, të luftojnë me duart dhe gjymtyrët e tyre për ta ndaluar të keqen në mënyrë që njerëzit t'iu nënshtrohen me bindje dhe respekt. **“Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** Tek Allahu të cilët do të qëndrojnë në Xhennetet e Allahut dhe mirësitë e Tij ¹.

Ymeti i Muhammedit a.s. ka arritur epërsinë, nderin dhe autoritetin atëherë kur ka urdhëruar për të mirë dhe ka ndaluar nga e keqja. Allahu xh.sh. na mëson:

﴿ كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ
بِاللَّهِ وَلَوْ ءَامَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ وَأَكْثَرُهُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿١١٠﴾

[سورة آل عمران: 110]

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ta; ka prej tyre

¹Shih: Tefsiri i Taberiu, <https://furqan.co/tabari/3/104>

besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.” [Al Imran: 110]

E kur ymeti braktisi urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, atëherë ra në një pozitë që askush nuk e xhelozon ¹.

Ndërsa jemi tek kjo temë - urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, dua të theksoj dhe një çështje tjetër me poaq rëndësi. Fjala është për dilemën nëse epërsia-*superioriteti* - e një ymeti vlerësohet nga shkakun që ai ymet urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja?²

Dijetarët myslimanë kanë debatuar rreth kësaj çështje dhe në shpjegim të pjesës së ajetit **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin”** kanë dhënë mendime të ndryshme.

Kanë diskutuar se folja ndihmëse *“kane كان”* a është e mangët (ar. *nakisa*) apo e plotë (ar. *tammeh*)?³. Po kështu kanë diskutuar nëse kjo epërsi është në Leuhi Mahfudh apo se mirësia dhe epërsia e këtij ymeti janë përmendur në librat e mëparshëm? Kanë diskutuar edhe për atë nëse kjo epërsi vlen deri në amshim!?

Me respektin më të madh për kolosët e tefsirit dhe mendimet e tyre me vlerë, megjithatë, kemi përshtypjen (nga studimi dhe analizat) që në ajet fshihet diçka tjetër! Konsiderojmë që ky privilegj lidhet drejtpërdrejtë me funksionalizimin e *urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja*. Pra, urdhërimi për të mirë dhe

¹ Shih: Tefsiri El-besit i Vahdiut, <https://furqan.co/albaseet/3/110>

² Shih: Tefsiri i Alusit në: <https://furqan.co/alaloosi/3/110>. Shih po kështu dhe Tefsirin e Rraziut, sipas referencës së përshkruar më parë.

³ Në gjuhën arabe, kur folja ndihmëse (*kane*) është e plotë tregon për kohë dhe veprim dhe për këtë mjaftohet me emrin në rasën emërore. Ndërsa kur është e mangët, ajo tregon thjesht për kohë dhe kuptimi i saj nuk plotësohet nëse kryefjala në emërore nuk lidhet patjetër me një kallëzues në kallëzore.
Përkthyesi.

ndalimi nga e keqja është shkak (ar. *il-leh*) ndërsa epërsia dhe privilegji janë normë (ar. *hukm*), dhe për ta fituar këtë privilegj dhe epërsi(ar.*el hajrije ve el efdalije*) duhet që shkakun të jetë aktiv dhe prezent në mënyrë masive, dhe kjo për momentin mjerisht nuk është, normal me përjashtime minimale, dhe siç thotë rregulli fetar në lëndën e Usuli fikh-ut, ekzistimi ose mosekzistimi i normës-hukmit-privilegjit, epërsisë në këtë kontekst varet direkt nga shkakun i ndërlidhur me privilegjin, dhe ajo është :urdhëresa për të mirë dhe ndalesa nga e keqja - sepse ne gjykuam dhe dhamë vendim të prerë se ymeti islam-respektivisht muslimanët janë më të privilegjuar dhe më të mirë se të tjerët-, e përderisa kjo nuk është; atëherë edhe ne (*ymeti islam, muslimanët*) nuk janë më të mirë dhe më të privilegjuar prej të tjerëve, sepse kanë një defekt të madh në jetën e tyre individuale, shoqërore dhe ndërkombëtare.

Bazuar në këtë, kuptimi i ajetit del si në vazhdim:

O myslimanë –drejtuar çdo myslimani deri në amshim-, ju jeni ymeti më i mirë, më i fortë, dhe më krenar në tokë përderisa urdhëroni për të mirë dhe ndaloni nga e keqja dhe përderisa e aplikoni Islamin në jetën tuaj në çdo imtësi dhe detaj të saj si dhe nuk devijoni nga qendra dhe as nga referenca juaj - Kur’ani dhe Sunenti, për çfarëdo çështje që të keni nevojë fetare, morale, civile, shoqërore, politike, ekonomike...Me këtë kusht ju arrini vendin tuaj të merituar dhe respektin e plotë dhe vazhdoni me të njëherit, ndryshe, nëse nuk përçoni urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja, atëherë ju nuk meritoni pozitë as privilegj! Allahu e di më së miri!

Mendimin tonë e përkrah edhe shpjegimi që Imami Ibën Kethir ka dhënë në tefsirin e tij, ku thotë: Kuptimi i ajetit është se besimtarë myslimanë janë ymeti më i mirë për ymetet dhe njerëzit më të dobishëm për njerëzit. Për këtë shkak edhe ka thënë (Allahu xh.sh.): “...(sepse) **ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira,**

i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...” E vërteta është se ky ajet përfshin tërë ymetin, secilën gjeneratë veç e veç, e padyshim gjenerata më e mirë ishte ajo e Muhammedit a.s. për të vazhduar më pas me dy gjeneratat vijuese ¹.

Me keqardhjen më të madhe më duhet ta them duke e konfirmuar se kjo epërsi e ymetit, ky nder, kjo krenari e madhështi në këtë shekull, fillimi i shekullit XXI, nuk ekziston. Ymeti ka humbur këtë pozitë për shkak se nuk mbahet pas fesë dhe për shkak të prapambetjes së madhe në shkencë, teknologji e industri. Institucioni i urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja është pothuajse i shuar dhe nuk mund të gjesh veçse raste individuale ose në rrethe të ngushta, fakte jo inkurajuese!

Nga ajetet në kaptinën Llukman dhe në kaptinat tjera mund të përfundojmë se urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja kanë rëndësi të madhe dhe jetike për ymetin dhe se çfarëdo shpërfillje e këtij institucioni është shkak për t’iu ekspozuar ndëshkimit të Allahut dhe shkatërrimit të civilizimit, vlerave e virtyteve humane. Allahu në Kur’an na tregon se shkakun pse ishin mallkuar hebrenjtë ishte pikërisht shpërfillja e këtij institucioni:

﴿لُعِنَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ بَنِي إِسْرَائِيلَ عَلَى لِسَانِ دَاوُدَ وَعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ ذَلِكَ بِمَا عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ ﴿٧٨﴾ كَانُوا لَا يَتَنَاهَوْنَ عَنْ مُنْكَرٍ فَعَلُوهُ لَبِئْسَ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ﴿٧٩﴾﴾ [سورة المائدة: 78-79]

“Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi. 79. dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!” [Maide: 78-79]


¹ Shih: Tefsiri i Ibën Kethirit në: <https://furqan.co/ibn-katheer/3/110>.

Mbi dënimet e Allahut për ata që e shpërfillin urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, hoxha dhe profesori im i nderuar, Dr. Halid Sebt, duke shpjeguar këtë hadith (fjala është për hadithin e Tirmidhiut) deklaroi: “...dënimi nuk është përcaktuar, kështu që ai mund të jetë humbje në pasuri, në shëndet, pra sëmundje dhe epidemi për të cilat mjekët nuk mund të gjejnë ilaç, vdekje të shumta, pushtimi nga ndonjë armik i pamëshirshëm i cili i poshtëron dhe përbuzë. Apo dhe në forma tjera siç shohim: herë tërmete e herë vërshime, të cilat marrin gjithçka me vete, për t’i shndërruar njerëzit në histori (pra për t’i mbytur). Dënimi mund të manifestohet edhe në humbjen e pasurisë, tregtisë, aksioneve dhe nuk është kjo e tëra. Kur njerëzit të ndëshkohen, do ta përgjërojnë Allahun për falje por Ai nuk do t’u përgjigjet. Allahun e lusim për falje dhe shpëtim! Atëherë belaja lëshon rrënjë dhe mbizotëron! Tanimë meseleja nuk ka të bëjë vetëm me ata që kanë bërë keq por me të gjithë ne. Ne duhet t’i shpëtojmë ata, ta shpëtojmë shoqërinë, ta shpëtojmë dhe veten tonë nga ky dënim gjithëpërfshirës. Pra, çështja nuk është ashtu siç e kuptojnë disa ose siç e perceptojnë të tjerët si liri individuale dhe se ai që i urdhëron të tjerët për të mirë ose i ndalon nga e keqja ai i ka shkelur këto të drejta dhe iu ka ndërhyrë në jetën e tyre. Jo, për shkak se veprimet e tyre të këqija janë shkak që ndjellin dënimin e Allahut për të gjithë.”¹

Ndëshkimet hyjnore që shohim sot në kohën tonë në të gjitha nivelet individuale, familjare, shoqërore, shtetërore, ndëshkime shpirtërore (psikologjike), fizike, natyrore..., janë dëshmi se dënimet e Allahut për braktisjen e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja mund të marrin formë të ndryshme.

¹ Shih: <https://khaledsabt.com/explanations/1376/>.

Hadithet në këtë kapitull janë shumë por ne do të mjaftojmë me këtë që përshkruam. Për ta kuptuar edhe më mirë, paragrafët e kësaj njësie do t'i përmbledhim në formë të grafikut në vazhdim:



2.4. Fusha personale e moralit dhe sjelljes

Edhe në këtë njësi do të vazhdojmë të flasim për lidërsipin edukativ sipas mësimëve të përfituara nga rrëfimi i Llukmanit a.s. në Kur'an. Në tre njësitë paraprake kemi trajtuar lidërsipin edukativ në:

- 1) Aspektin e besimit i manifestuar në Teuhid, besimin e pastër në Zotin një,
- 2) Aspektin e meditimit në dijen dhe fuqinë e pakufishme të Allahut e cila parasheh frikën prej Tij dhe vëzhgimin e Tij në çdo gjë që bëjmë, e fshehtë apo publike, dhe
- 3) Aspektin shoqëror i manifestuar në urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja për ta ruajtur shoqërinë nga rrënimi moral dhe përmbysja e vlerave.

Në këtë njësi do të shpalojmë qasjen Kur'anore nga rrëfimi i Llukmanit a.s. përkitazi me edukimin personal dhe reflektimin e tij në raport me vetveten dhe të tjerët.

Kur besimi i pastër lëshon rrënjë në zemër, atëherë efektet e tij pozitive duhet të vërehen deri në gjymtyrë, sepse nuk mund të paramendohet që një mysliman i sinqertë të kundërshtojë vetveten duke shfaqur të kundërtën e asaj që fsheh në zemër dhe as të jetë i devotshëm dhe të bëjë vepra të këqija! Kjo është e pamundur! Konsiderojmë se e meta më e madhe në historinë e myslimanëve e cila madje edhe ka çuar në rënien e qytetërimit islam dhe ka përfshirë të gjitha nivelet e shoqërisë, duke filluar nga liderët e deri tek njerëzit e thjeshtë, është kundërthënia morale dhe etike ndërmjet asaj që thonë e besojnë dhe asaj që veprojnë. Kjo demagogji, jo vetëm që ndalohet rreptësisht në fe por konsiderohet si një nga mëkatet e mëdha!

Allahu xh.sh. thotë:

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لِمَ تَقُولُونَ مَا لَا تَفْعَلُونَ ﴿٢﴾ كَبُرَ مَقْتًا عِنْدَ اللَّهِ أَنْ تَقُولُوا مَا لَا تَفْعَلُونَ ﴿٣﴾ ﴾ [سورة الصف: 2-3]

“O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? 3. Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!” [Saf: 2-3]

Në vazhden e këshillave dhënë të birit, Llukmani a.s. kaloi tek çështja e edukatës dhe moralit që duhet të ketë në raport me njerëzit, duke e ndaluar nga nënçmimi i njerëzve dhe nga mburrja ndaj tyre. Mesazhi i fshehur brenda rreshtave të këtyre këshillave parasheh që, përderisa ndalohet nga këto tipare, të shfaq të kundërtat e tyre, respektivisht barazinë me të tjerët dhe ndalimin e shfaqjes së epërsisë! Epërsia vlen vetëm në devotshmëri dhe në vepra, në moral, sjellje e dije, pavarësisht nga njeriu, rraca, ngjyra, gjinia, pozita a familja.

Kështu na mëson Kur’ani:

﴿ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتَقْوَىٰ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾ ﴾ [سورة الحجرات: 13]

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” [Huxhurat: 13]

Kjo është peshorja e vërtetë e njohjes së njerëzve dhe trajtimit të tyre. Islami ka bërë një lidhje të fuqishme ndërmjet besimit dhe moralit duke e konsideruar këtë të fundit si pjesë të pandarë të personalitetit të besimtarit ngase nuk mund të paramendohet që një besimtar të pretendojë besim të fortë në njëren anë dhe në anën tjetër të bëjë vepra që janë në kundërshtim të plotë me moralin islam. Pejgamberi Muhammed a.s. ka qenë i dalluar në

fushën e moralit e madje edhe është marrë shembull dhe model për moralin. Për këtë shkak në Kur'an nuk mund të gjesh ndarje ndërmjet besimit dhe veprës së mirë dhe këtë me qëllim që ana e brendshme dhe ana e jashtme e besimtarit të jenë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën.

Së këndejmi, ajo që ne shohim sot tek disa myslimanë të cilët bëjnë vepra që ndeshen direkt me besimin dhe moralin islam nuk është gjë tjetër pos një treguesi të fortë të injorancës së tyre në raport me fenë, sistemet, ligjet dhe normat e shtetit. Është po kështu edhe pasojë e neglizhencës së institucioneve fetare përkatëse për të prezantuar bukuritë e fesë dhe etikën e trajtimit të këtij defekti moral dhe edukativ tek ata njerëz. Me këtë rast nuk do të doja të lë pa përmendur dhe rolin denigrues të disa qarqeve mediatike dhe institucioneve të caktuara që mundohen të shpërftyrojnë Islamin duke e prezantuar ashtu siç nuk është! Duke qenë se mendjemadhësia dhe kryelartësia janë sëmundje të lashta dhe si të tilla janë ndër më të shëmtuarat dhe irrituarat, atëherë këshilla e Llukmanit përmban edhe këtë porosi për tu larguar prej tyre. Kjo edhe për faktin se ato janë djallëzore sepse i pari që shfaq mendjemadhësi dhe kundërshtoi ta respektonte urdhrin e Allahut për t'i bërë sexhde Ademit a.s. ishte djalli. Këtë na e shpjegon Allahu në disa vende në Kur'an, si:

﴿وَلَقَدْ خَلَقْنَاكُمْ ثُمَّ صَوَّرْنَاكُمْ ثُمَّ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ لَمْ يَكُنْ مِنَ السَّاجِدِينَ ﴿١١﴾ قَالَ مَا مَنَعَكَ آلَا تَسْجُدَ إِذْ أَمَرْتُكَ قَالَ أَنَا خَيْرٌ مِّنْهُ خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ

من طين ﴿١٢﴾ [سورة الأعراف: 11-12]

“Ne ju krijuam e pastaj ju dhamë formën; e u thamë engjëjve: “Përlujuni në sexhde Ademit!” – Të gjithë iu përlulën, përveç Iblisit. Ai nuk ishte nga ata që u përlulën. Allahu tha: “Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?” Ai u përgjigj: “Unë jam më i mirë

se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta". [A'rafë: 11-12].

Rasti i Llukmanit a.s. me të birin e tij në këtë kontekst është paralajmërim për ne që të qëndrojmë largë prej dy tipareve shumë të shëmtuara, e ato janë:

2.4.1.Ndalimi nga mendjemadhësia dhe kryelartësia

Në arabisht shprehja e përdorur për këtë sëmundje shpirtërore e morale është *tesau'ur* ose *es-sa'aru* (التَّصَعُّرُ أَوْ الصَّعْرُ), e cila kuptimisht nënkupton një sëmundje e cila shfaqet në qafë tek devetë ose njerëzit dhe që pamundëson lëvizjen lirshëm të kokës. Kjo bën që fytyra e njeriut ose devesë të mbetet e mbajtur anash ose pjerrtas. Nga kjo perspektiv është huazuar si shprehje figurative për ta shprehur mendjemadhësinë dhe kryelartësinë¹.

Është lloj prej llojeve të mendjemadhësisë, e cila pavarësisht kësaj mbetet ndër tiparet më të urryera të moralit. Bile është koka e të gjitha paturpësive dhe të këqijave. E duke qenë e tillë, ajo ka zënë vend në këshillën e Llukmanit a.s., për të birin si tipar e sjellje që duhet ikur prej saj. Allahu xh.sh., thotë:

﴿وَلَا تُصَعِّرْ خَدَّكَ لِلنَّاسِ وَلَا تَمْتَشِ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ ﴿١٨﴾﴾

[سورة لقمان: 18]

"Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!"
[Llukman: 18]

¹ Shih: <https://almaany.com/ar/dict/ar-ar/الصعر/>.

Kuptimi i ajetit: *mos e kthe fytyrën në shenjë mendjemadhësie ndaj njerëzve, por kur të flasësh me ta kthehu me tërë fizikun tënd kah ai, me fytyrë të buzëqeshur e dashamirëse, pa shfaqur arrogancë a mendjemadhësi. Me fjalë tjera, ji modest dhe sillu butë me ta! Mbi këtë bazë duhet ndërtuar raportet tona me të tjerët.*

Siç është e ditur në fushën e *i'xhazit* shkencor dhe retorik në Kur'anin Famëmadh, secila shprehje që përdoret në Kur'an fsheh në vete kuptime, dimensione dhe fshehtësi edukative, morale e gjuhësore, që po të përdorej një shprehje tjetër nuk do të arrinte t'i mbulonte e madje as që do të mund ta shprehte qëllimin për çka flitet e trajtohet në kontekstin përkatës. I madhëruar qoftë Allahu që na begatoi me shpalljen e këtij Libri të qartë, të saktë, të përsosur, pa kundërthënie as kontradita.

Sa shpjegim të bukur i ka bërë Imam Kurtubiu këtij ajeti: Në këtë ajet janë tre mesele:

E para: sa'ri nënkupton animin. Hereviu ka thënë: *la tusaa'ir* (لا تُصَوِّرْ): mos ua kthe shpinën në shenjë mendjemadhësie. Kur ta godet devenë një sëmundje që i mbetet qafa e përdredhur thuhet: *Esabe el-beire saarun ve sajedun*. Thuhet për mendjemadhin: *fihî sa'arun ve sajed*. Kuptimi i shprehjes kur'anore *la tusaa'ir* (لا تُصَوِّرْ) është: mos ia impono faqes tënde sa'rin (përdredhjen). Në hadith qëndron: "Do të vijë koha kur ndër njerëz nuk do të ketë tjerë vetëm se es'ar dhe ebter (mendjemëdhenj dhe farësosur)." Kështu: es'ar nënkupton njeriun që në shenjë mendjemadhësie e kthen fytyrën në anën tjetër duke synuar me këtë përbuzjen e njerëzve. Kjo shprehje është atribut për njerëzit më të paturpshëm, ata që nuk kanë fe. Në hadith qëndron: "Secili sa'ar (mendjemadh) është i mallkuar."

E dyta: Kuptimi i ajetit: mos e kthe anash fytyrën tënde në shenjë mendjemadhësie dhe përbuzje ndaj njerëzve. Ky është

interpretimi që Ibën Abbasi r.a. dhe disa të tjerë kanë bërë. Sipas një interpretimi tjetër, kuptimi është: mos e përdredh nofullën tënde ndërsa përmendet në praninë tjetër ndonjë njeri sikur me këtë ti po e nënçmon. Së këndejmi, kuptimi i ajetit është: *kthehu kah njerëzit me modesti, afërsi dhe dashamirësi madje edhe kur të flet më i vogli ndër ta, dëgjoje me vëmendje derisa ta mbarojë*. Kështu ka vepruar Pejgamberi a.s. Me këtë kuptim është edhe hadithi i Enesit r.a., në të cilin qëndron se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mos e urreni njëri-tjetrin, mos e kini zili njëri-tjetrin dhe mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit (duke e braktisur njëri-tjetrin), por jini vëllazër, o robërit e Allahut! Nuk është aspak e lejueshme për një mysliman që të mbajë mëri me vëllain e vet mysliman për më shumë se tri ditë.” Shprehja “Mos e braktisni njëri-tjetrin...” në arabisht është: (la tedaberu) e cila nënkupton kthimin e shpinës dhe lëçitjen. I është thënë *i’radit* (largimit, heqjes dorë, braktisjes, shmangies, qëndrimit mënjane; refuzoj, mos pranimit) *tedabur*, sepse atë që e urren zakonisht ia kthen shpinën. Kështu vepron edhe ai që të urren. Për dallim nga ai që e do dhe të do që njëri-tjetrin e shikoni përballë dhe qëndroni ashtu për ta bërë të kënaqur e lumtur. Në porosinë e Llukmanit a.s., gjegjësisht në fjalën *saar* fshihet dhe kuptimi i *tedâburit*¹.

Në Kur’anin Fisnik dhe në hadithet e Pejgamberit Muhammed a.s., kemi porosi të shumta për t’i ikur këtij tipari të urryer dhe për tu fisnikëruar me tiparet e modestisë dhe përluljes. Me këtë rast do të donim të përmendim sa për ilustrim tekstet në vijim:

﴿وَأَخْفِضْ جَنَاحَكَ لِمَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ﴾ [سورة الشعراء: 215]

“Dhe bëhu i butë me besimtarët që të pasojnë ty!” [Shuara: 215]

¹ Shih: Tefsiri i Imam Kurtubiut <https://furqan.co/qurtubi/31/18>.

﴿ لَا تَمُدَّنَّ عَيْنَيْكَ إِلَىٰ مَا مَتَّعْنَا بِهِ أَزْوَاجًا مِّنْهُمْ وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ وَأخْفِضْ جَنَاحَكَ لِلْمُؤْمِنِينَ ﴾

[سورة الحجر: 88] ﴿﴾

“Mos i drejto sytë e tu nga kënaqësitë që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre dhe mos u hidhëro për ta! Me besimtarët sillu butë!” [Hixhr: 88]

﴿ مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ ﴾ [سورة الفتح: 29]

“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre...” Fet’h: 29]

Natyrisht ka edhe shumë ajete tjera të cilat përmbajnë porosi të këtilla. Ndërsa sa i përket haditheve me këtë përmbajtje, nga ato ka shumë. Ato nxisin besimtarin në modesti dhe butësi. Në hadithin e Abdullah bin Mes’udit r.a. qëndron se Pejgamberi a.s. ka thënë: “A t’iu rrëfej për atë që i ndalohet zjarrit apo zjarri i ndalohet atij (nuk ndëshkohet në botën tjetër): I ndalohet çdo të thjeshti, të buti dhe të lehti.”¹

Në hadithin e Talha bin Ubejdullahut të cilin e ka cituar Imam Hejthemiu qëndron: “...Kush bëhet racional në shpenzime, Allahu do ta pasurojë; e kush bëhet shpërdorues dhe ekstravagant, Allahu do ta varfërojë. Kush bëhet modest për hir të Allahut, Allahu do ta ngrisë, e kush shfaqet mendjemadh, Allahu do ta shemb përdhe (do ta ndëshkojë).”²

¹ Hadithin e shënojnë Tirmidhiu në *Sunen*, nr. 2488: Imam Ahmedi në *Musned*, 1/415, Ibn Hibani në *Sahih*, 2/216.

² Hadithin e shënon Imam Hejthemiu në *Mexhmeu ez-zevaid*, 1/255

Në një hadith të saktë qëndron: *“Allahu më ka shpallur që të jemi modestë dhe të mos shfaqim krenari ndaj njëri-tjetrit dhe as mos t’i bëjmë padrejtësi njëri-tjetrit.”*¹

Si përmbyllje të kësaj nënjësie themi se ndër parimet më të rëndësishme të lidërshiptit dhe pikat e tij edukative që duhet pasur në konsideratë është dëlirsia shpirtërore dhe pastrimi nga tiparet e urryera, në radhë të parë nga mendjemadhësia dhe kryelartësia në njërën anë, dhe fisnikërimi me tipare të çmuara, me virtyte të larta ku bën pjesë modestia dhe butësia. Sepse, nuk ka dobi nga fëmija arrogant e mendjemadh ndaj prindërve, vëllezërve e motrave; nuk ka dobi nga studenti arrogant ndaj kolegëve e profesorëve, as nga nëpunësi që shfaq egërsi ndaj eprorit; nuk ka dobi as nga ushtari kryelartë ndaj komandantit dhe as nga komandanti që shfaq kryelartësi ndaj ushtarit! Nuk ka dobi nga askush që dallohet me vese të urryera!

Në kohën tonë, si imazh dhe kuptim shtesë i mendjemadhësisë është edhe përdorimi i celularit ndërsa dikush të flet dhe ka nevojë serioze për ndihmën tënde. E si të jetë ndryshe ky ves i ligë kur një aparat të thjeshtë e vë mbi lartësinë e një njeriu, një krijese të Allahut xh.sh.

Nuk krahasohet Krijuesi me Krijesat!

Atëherë pse ky fodullëk te njeriu?

Në hadithin Kudsij qëndron: *“Krenaria është pelerina ime (shprehje figurative retorike që nënkuptojnë madhërinë e Allahut xh.sh.), ndërsa madhështia petku (shprehje retorike për*

¹ Hadithin e shënon Imam Muslimi në Sahih, nr. 2865. Shihe komentin në: <https://dorar.net/hadith/sharh/16720>.

lartëmadhërinë e Allahut), *kush m'i konteston ato ose më rivalizon në to, do ta hedh në zjarr (do ta ndëshkojë).*¹

2.4.2. Ecja me kryelartësi dhe ngritja e zërit

Prej tipareve shoqëruese të mendjemadhit është edhe *merehi*, për kuptimet e të cilit janë dhënë disa shpjegime: *gëzimi i tepërt dhe entuziazmi më i madh se pozita e vërtetë që ka njeriu; ecja ngadalë me fodullëk dhe vetëpëlqim, ecja duke u shalakatur, mohimi i të vërtetës dhe mendjemadhësia, refuzimi i të vërtetës dhe nënvlerësimi i saj, çuarja e kohës dëm pa realizuar asnjë punë të dobishme për veten, familjen, rrethin, shoqërinë, fenë... Është kjo që ne e shohim sot në shoqëritë tona, jo vetëm tek të rinjtë e të rejat por edhe tek grupomoshat tjera, të cilët bëjnë një jetën të shthurur, të zhytur në mëkate, të ikur nga përgjegjësitë fetare, familjare, shoqërore, akademike, shtetërore që kanë. Të tillë i sheh tek ndjekin lukset; vetura luksoze, telefona të mençur të versioneve më të reja, përhapës të thashethemeve dhe të pavërtetave në rrjete sociale facebook, twitter, instagram, etj. Mjerë ata për dënimin që do ta kenë ndërsa kanë harruar! Djalli ua ka hijeshuar këto vepra të këqia duke i bindur se ata nuk janë duke bërë gjë tjetër pos mire! Këto dezinformata që po i përhapin gjithandej do të shndërrohen në tmerr e dënim për ta! Ky është sindromi i kësaj*

¹ Hadithin e shënojnë Ebu Davudi në Sunen, nr. 4090; Imam Ahmedi në Musned, nr. 9359; Ibn Maxheh në Sunen, nr. 4174. Në këtë hadith janë përmendur krenaria dhe madhështia në shembull të rrobave, të cilat mbase mund të keqkuptohen nga lexuesi i rëndomtë. Dijetarët kanë përmendur se pelerina dhe petku janë përmendur vetëm si shembull për të treguar se si njeriu nuk pranon ortakëri në pelerinë dhe petk, po kështu Allahu xh.sh., nuk pranon ortakëri në krenari dhe madhështi. Ky ishte mendimi i Hattabiut, autorit të komentarit të Sunenit të Ebu Davudit. **Përkthyesi.**

kohe që ka prekur shumicën absolute të rinisë sonë, përveç një pjesë të vogël, për çka ne e lusim Allahun të jemi prej tyre!!!

Këto ishin disa prej tipareve të *merehinëve* në kohën tonë. Gjithsesi se ishte e rrugës që Llukmani a.s. ta këshillonte të birin nga ky moral i ulët që mbretëronte edhe në atë kohë, dhe megjithëse me kuptime e imazhe të ndryshme nga *merehi* i kohës sonë, efektet negative të tij janë të njëjta në çdo kohë, andaj dhe është i ndaluar në çdo kohë! Por, duke krahasuar kohët dhe duke marrë parasysh zhvillimet e reja, del që pasojat e kësaj dukurie janë shumë të rënda sot se që ishin dikur!

Se *merehi* ka këtë kuptim mësojmë edhe nga shpjegimi i Imam Kurtubiut, i cili thotë se *merehi* nënkupton *kibrin* – mendjemadhësinë. *Merehi* është entuziazëm dhe ecje me gëzim pa ndonjë punë ose nevojë. Njerëzit që kanë këtë moral zakonisht janë dhe mburravec dhe mendjemëdhenj sepse *merehi* në fakt nënkupton ecjen duke u shalakatur...¹

Kur’ani na ka rrëfyer për këshillën që Llukmani a.s. ia ka dhënë të birit:

﴿... وَلَا تَمَشْ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ﴾ [سورة لقمان: 18]

“... dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!” [Llukman: 18]

Ecja është proces i domosdoshëm në jetë por jo ecje me kryeneqësi por me modesti e thjeshtësi. Ecje të drejtë, të qetë, ashtu siç i ka hije njeriut me edukatë. Ajo që u tha më parë për moralin e urryer të mendjemadhësisë, thuhet edhe për këtë.

¹ Shih: *Tefsiri i Kurtubiut*, <https://furqan.co/qurtubi/31/18>.

“...dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!” [Llukman: 18]

Edhe në një vende tjera Kur'ani e ka cilësuar si moral të keq dhe të urryer. Allahu xh.sh., thotë:

﴿وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا وَإِذَا خَاطَبَهُمُ الْجَاهِلُونَ قَالُوا سَلَامًا﴾

[سورة الفرقان: 63]

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”

[Furkan: 63]

﴿ذَٰلِكُمْ بِمَا كُنتُمْ تَفْرَحُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَإِذَا كُنتُمْ تَمَرَحُونَ﴾ [سورة غافر: 75]

(75)

“Ky dënim është për shkak se gëzoheshit në tokë, pa kurrfarë të drejte dhe ngaqë keni qenë të ndërkryer.” [Gafir: 75]

﴿مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ﴾ [سورة الفتح: 29]

“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm ndërmjet vete...”

[Fet'h: 29]

Edhe në hadithe gjejmë vërejtje të ashpër dhe kërcënim për ata që dallohen për këtë moral të urryer të cilin Allahu nuk e do përveç në raste të caktuara si në sheshe lufte me armiqtë. Në hadithin e Abdullah Halid, i biri i Semmakut qëndron se Ebu Duxhane ditën e betejës së Uhudit e kishte vënë një shall të kuq dhe me kryelartësi parakalonte ndërmjet dy radhëve të ushtarëve.

Pejgamberi a.s. e shikoi dhe tha: *Është ecje që e urren Allahu përveçse në këtë vend.*¹

Në hadithin e Xhabir bin Utejkut të shënuar në Sunenin e Ebu Davudit dhe të saktësuar nga Imam Albani qëndron se

¹ Hadithin e shënon Imam Hejthemiu në *Mexhmeu ezzevaïd*, nr. 112.

Pejgamberi a.s., ka thënë: “...ka kryelartësi të cilën e do Allahu dhe kryelartësi të cilën e urren. Sa i përket asaj që e do, ajo është kur njeriu (ushtari) mburret dhe ec kryelartë në luftë dhe kur jep sadaka. Ndërsa atë që e urren Allahu është kryelartësia me padrejtësi dhe mburrje.”

Kuptimi i hadithit është si në vijim: Kryelartësia që Allahu e do është ajo kur në momente lufte ushtari ose komandanti përdorë këtë si taktikë, strategji për të mposhtur armikun. Kryelartësia në lëmoshë ka kuptimin e gëzimit për atë që i jep të varfërit duke mos konsideruar kurrë se ka dhënë shumë. Përkundrazi, tërë atë që e jep, e jep duke e llogaritur si të paktë. Ndërsa sa i përket llojit të urryer të kryelartësisë është kur ajo manifestohet në padrejtësi, gjegjësisht njeriu e lartëson veten dhe i thur lavde për shkak të padrejtësisë që i ka bërë tjetrit duke ia marrë pasurinë e të ngjashme. E kështu është edhe kur shprehet në momente mburrje, pra kur njeriu përmend tipare personale para të tjerëve, pasurinë, pozitën, vetëm e vetëm që të mburret para tyre...¹

Padyshim, natyra njerëzore e urren një qëndrim të tillë. Këtë dukuri e gjejmë të theksuar dhe tek sportistët dhe atletët të cilët e përdorin për qëllime të caktuara (mburren para njëri-tjetrit para se të fillojë ndeshja ose gara që ta frikësojnë njëri-tjetrin dhe ta thyejnë emocionalisht para mundjes fizike). Konteksti i lidhshëm edukativ në kaptinën Llukman na zbulon një dukuri tjetër të urryer, atë të ngritjes së zërit për shkak të shqetësimit të dëgjuesit pa pasur nevojë. Natyrisht, edhe këtu ka raste përjashtimi, pra kur lejohet ngritja e zërit, por në përgjithësi ajo është e urryer. Ata që kanë njohuri themelore fetare e dinë se ngritja e zërit, fishkëllima, duartrokita janë tradita të periudhës para islame dhe shoqërisë së atëkohshme (*xhahilijeti*) e cila

¹ Shih: <https://dorar.net/hadith/sharh/29358>.

kryente ritualet fetare dhe lutjet në Qabe në këtë formë. Allahu xh.sh., na rrëfen për këtë:

﴿ وَمَا كَانَ صَلَاتُهُمْ عِنْدَ الْبَيْتِ إِلَّا مُكَاءً وَتَصَدِيَةً فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ
تَكْفُرُونَ ﴿٣٥﴾ [سورة الأنفال: 35]

“Lutja e tyre në Shtëpinë e Shenjtë ishte vetëm me fërshëllima dhe rrahje duarsh. Prandaj (atyre do t’u thuhet:) Provojeni ndëshkimin, pasi kurrë nuk besuat!” [Enfalë: 35]

Fatkeqësisht forma të këtyre traditave të ndaluara i gjejmë edhe sot prezente në mesin tonë në salla ligjëratash, në ambiente shkollash, në qendra tregtare, në institucione shtetërore. Jo rrallë i shohim tek bërtasin e fishkëllejné duke mos çarë kokën se me këtë i shqetësojnë të tjerët dhe ua prishin rehatinë. Që të mos jemi viktimë e kësaj dukurie, këtë këshillë Kur’anore në kaptinë Llukman, duhet ta rikujtojmë mbrëmje e agim.

Por jo të gjithë janë të këtillë. Komunikimi i mirëfilltë dhe me edukatë në disa vende myslimane është ngritur në nivel kombëtar, si p.sh. në Malajzi, Indonezi, Brunei Darussalam, ku edhe kam patur fatin të jetoj e të punoj dhe të shijoj këtë kulturë të lartë komunikimi. Kujtoj se njëherë i pata pyetur për sekretin e zërit të vogël në bashkëbisedim, më patën thënë: Ngritja e zërit është tipar i majmunëve në xhunglat tona. Ndërsa neve që jemi njerëz dhe myslimanë nuk na përket ta ngrisim zërin si ata!

Ju lumtë atyre për këtë kulturë dhe moral të lartë!

Arsyeja pse Kur’ani e shëmbëllen zërin e lartë me zërin e gomarit qëndron në shëmtinë e zërit të lartë dhe irritimin e njerëzve prej tij. Në ajet aludohet se zëri i gomarit ka qenë i urryer njësoj si sot! Ashtu do të jetë përgjithmonë. Të vërtetën e ka thënë Allahu xh.sh., kur thotë:


﴿ وَأَقْصِدْ فِي مَشْيِكَ وَأَعْضُضْ مِنْ صَوْتِكَ إِنَّ أَنْكَرَ الْأَصْوَاتِ لَصَوْتُ الْحَمِيرِ ﴿٥١﴾

*“Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më I
vrazhdë është zëri i gomarit”!* [Llukman: 19]

Ekspozeja Kur'anore përkitazi me rëndësinë e lidërshpimit edukativ nga kaptina Llukman, respektivisht rrëfimi i Llukmanit a.s, me popullin, fëmijët, studentët, mjafton sa për të marrë mësim dhe për tu udhëzuar e vepruar sipas këtyre ajeteve. Aty gjetëm shumë elemente që skicojnë qartë dhe bukur rrugën që duhet ndjekur në edukimin e fëmijëve, studentëve, ushtarëve, duke i fisnikëruar si metalet, në mënyrë që të xhvishen nga çdë e metë, tipar i urryer tek Allahu xh.sh.

Grafiku në vazhdim do të përmbledh shkurtimisht paragrafët e kësaj nënnteme:

Aspekti moral etik dhe udhëheqës në rrëfimin e Llukmanit a.s.



Kapitulli III:
SHEMBUJ TË LIDERSHIPIT TË SUKSESSHËM
DHE TË DËSHTUAR NGA PRIZMI KUR'ANOR

1. RËNDËSIA E LIDERSHIPIT TË DREJTË NË ZBATIMIN E RREGULLAVE TË FESË DHE TË SHTETIT

- 1.1. Shtigjet e ripërtëritjes së kërkuar
- 1.2. Komponentët e shariatit islam dhe kushtet e implementimit të tij si autoritet në tokë
- 1.3. Harta e rrugës që çon në fitimin drejt këtij pushteti dhe epërsie në tokë

2. SHEMBUJ TË LIDERSHIPIT TË SUKSESSHËM NGA PRIZMI KUR'ANOR

- 2.1. Lidërshipi i përgjithshëm muhamedan
- 2.2. Lidërshipi muhamedan në fushën ushtarake
- 2.3. Lidërshipi jusufian në fushën financiare
- 2.4. Lidërshipi musajian në fushën e këshillimit, konsulencës dhe motivimit
- 2.5. Lidërshipi mbretëror në Kur'an: shembujt e Sulejmanit a.s, Belkizës dhe të mbretit Talut
- 2.6. Lidërshipi dhulkarnejnian

3. LIDERSHIPE TË DËSHTUARA NGA PRIZMI KUR'ANOR

- 3.1. Pesë shembuj të lidërshipt të dështuar
- 3.2. Distancimi i liderëve të dështuar nga pasuesit e tyre

1. RËNDËSIA E LIDERSHIPIT TË DREJTË NË ZBATIMIN E RREGULLAVE TË FESË DHE TË SHTETIT

1.1. Shtigjet e ripërtëritjes së kërkuar

Të vërtetat Kur'anore, profetike dhe historike janë dëshmia më e mirë se nga kjo gjendje e përgjithshme e ndjerë ku gjendemi sot, mund të dalim vetëm nëse ripërtërijmë lidhjet tona të shkëputura me Zotin, në pikpamje individuale e kolektive (globale), në të gjitha rrafshet: fetar, moral, etik, politik, ekonomik, etj, duke zbatuar në tërësi si normat fetare ashtu dhe ato shtetërore. Në rrafshin fetar, kjo ripërtëritje (ky zgjim a rilindje) arrihet nëse i rikthejmë në jetë vlerat e braktisura islame, duke luftuar njëherit bestytnitë dhe faktorët tjerë që cenojnë parimet themelore njerëzore.

Dijetarët islamë përgjatë historisë kanë qenë shumë të përpiktë në zbatimin e *texhdidit* (ripërtrirjes, reformimit¹), sepse kanë njohur rëndësinë dhe kuptimin e plotë të tij. Dikur e kanë quajtur *Ringjallja e shkencave fetare* (Ihjau ulumi eddin), *Ripërtëritja e trashëgimisë fetare* (Texhdid etturath eddinij), *Ripërtëritja e metodologjisë usuliste* (Texhdid el-menhexh el-usulij), *Ripërtëritja e fesë* (Texhdid eddin) dhe me shprehje të tjera të ngjashme. Rëndësinë e texhdidit e konfirmon edhe hadithi i saktë profetik që thotë: “Në krye (fillim ose fund) të çdo shekulli

¹ Do ta përdorim në original këtë dhe termet tjera për t'i përvetësuar si shprehje por dhe për faktin se (siç kemi shpjeguar në kapitullin e parë) në fund të librit do të kemi indeksin me termet dhe konceptet fetare.

Allahu xh.sh. i dërgon këtë ymeti dijetarë që ripërtrijnë fenë e Tij (Allahut xh.sh.).¹

Komenti i këtij hadithi sipas dijetarve është ky:

Allahu xh.sh. mëshiron ymetin islam duke u përkujdesur që ai – ymet - përhërë të ketë dijetarë e pushtetarë që përhapin fenë që nga koha e Muhammedit a.s. dhe e Sahabëve r.a. gjer më sot,

[Allahu xh.sh. i dërgon]: (krijon, cakton, pregadit), dijetarë, pushtetarë..

[edhe për këtë ymet...]: ymetin islam në tërësi, por edhe për tërë njerëzimin²,

[Në krye të çdo shekulli]: fillimin ose fundin e tij, kur feja dobësohet nga injoranca ose kur risitë (kundërshtitë e synetit) nisin të zënë vendin e synetit,

[këta dijetarë, pushtetarë të pregaditur, caktuar nga Allahu e ripërtërijnë fenë e Tij] – rikthejnë atë që është anashkaluar ose braktisur fare nga njerëzit, përhapin synetin dhe vlerat islame.

[i cili apo, të cilët..³], dijetarët apo pushtetarët, nënkuptojmë – një apo më shumë njerëz të ditur (poliedrikë) indikativë, ose pushtetar në mbarë shoqërinë.

Pos dijetarëve fetarë, ymetin e mbrojnë dhe liderët shtetërorë (**pushtetarët të drejtë**), sepse dijetarët fetarë mbrojnë bazat

¹ Hadithin e shënon Ebu Davudi në *Sunen*, nr. 4291, ndërsa Albani e ka saktësuar në *Essilsiletu essahihah*, f. 599, nr. 80111.

² Në terminologjinë fetare, ymeti përdoret në dy forma: *ymeti i da'ves*, ku bën pjesë populli që i përket tërë njerëzimit dhe *ymeti i ixhabes* – që përfshinë vetëm myslimanët. **Përkthyesi.**

³ Në origjinal është përemri lidhor 'men'-i cili, të cilët- Në shqip e përkthjem *dijetarë* në trajtën e pashquar për tu përshtatur kuptimisht me domethënien e hadithit. **Përkthyesi.**

fetare kurse pushtetarët e drejtë, shtetin e së drejtës, njëherit dhe vlerat e besimit.

Hadithi pasqyron mënyrën se si Allahu i Lartmadhëruar e ruan fenë nga shtrembërimi dhe nga shuarja.

Përderisa *texhdidi* (nevoja për rifreskim) është konstante, e përhershme¹, detyrë e dijetarëve mbetet të sqarojnë mënyrat e implementimit të *texhdidit* në fe.

Shih grafikun mëposhtë:

¹ Shih rreth kësaj teme kapitullin e pestë nga: Elmuthenna Abdul Fettah Mahmud, *Fikhu ettag'jir ve binau el-ummeti el-vesat*, (Katar: Ministria e Fesë, 2016), f. 217-235. Libri ka fituar çmimin Shejh Ali Abdullah Al Thani për vitin 2016 si 'Libri më i Mirë'.



1.2. Komponentët e sheriatit islam dhe kushtet e implementimit të tij si autoritet në tokë

Dëshmia e ymetit për njerëzit¹ dhe epërsia e tij ndaj të tjerëve nuk ndodhë pa u praktikuar plotësisht feja, në fjalë e vepra, në formë e përmbajtje, gjithë kjo konform grafikut sipër.

E pamundur të ndodhë rimëkëmbja e ymetit vetëvetiu! Ajo ndodhë vetëm me *temkin*², që nënkupton zbatimin e plotë të fesë në kuptimin akaidologjik, moral, familjar, shoqëror, ekonomik e politik. Kur zbatimi i fesë të ketë rënë në binarë të vet dhe të përputhet plotësisht me vizionin në fjalë, atëherë realizohet dhe premtimi i Allahut xh.sh. për ndihmë besimtarëve, rimëkëmbjen e tyre në tokë, saktësisht për kalimin e pushtetit në duar të sigurta. Të parët tanë respektuan këtë parim ndaj dhe kuptuan, zbatuan dhe e përhapën Islamit si vlerë, kudo nga Lindja në Perëndim.

Grafiku më poshtë sqaron rëndësinë e përfshirjes së Islamit në të gjitha sistemet shtetërore:



¹ Është koncept fetar të cilin e gjeni në indeks në fund të librit. **Përkthyesi.**

² Për temkinin kemi dhënë shpjegime në kapitullin paraprak por këtu *temkini* trajtohet në kontekst të ymetit, pra është koncept fetar.

Pra, rimëkëmbja kushtëzohet nga përmbushja e plotë (jo e pjesërisht!) e detyrimeve si në nivelin individual (privat) ashtu dhe në atë shoqëror (publik). Vetëm duke zbatuar parametrat hyjnorë dhe detyrimet e lidërshiptit, ne përmbushim kushtet themelore të *temkinit!* Pra pasi rimëkëmbemi dhe marrim pushtetin në tokë, ne aftësohemi të udhëheqim njerëzimin drejt begative që na i siguron Allahu xh.sh.

Gjendja e mjerueshme e ymetit sot, në përgjithsi, dekadencia e të gjitha llojeve (shkencore, materiale e shpirtërore) është pasojë e dhënies së njeriut pas epsheve të kësaj bote, që ka si rezultat largimin e tij nga parimet dhe etika islame, thjeshtë njeriu harron vdekjen! Si rrjedhojë, armiqtë shfrytëzojnë këtë situatë dhe trasojnë terren të përshtatshëm për të kundërshtuar vlerat e islamit duke krijuar mundësi për kolonizim, okupim, luftë, rrethana ideale për përçarje në baza fetare, etnike e politike. Shto pastaj kësaj dhe kundërthëniet që ne muslimanët kemi mes vete (në teori e praktikë), tendencat për tu dhënë pas formës duke anashkaluar përmbajtjen (esencën), afinitetin për kamuflime e zbukurime (madje dhe gjatë leximit të Kur'anit!), shpërfilljen e mësimëve Kuranore...

Së këndejmi, *shpërblimi vjen sipas veprës*¹ ose siç thotë populli: Jemi ashtu siç e kemi gjendjen! Dmth: jemi keq sepse veprat i kemi të këqija. Allahu xh.sh. thotë:

﴿الَّذِينَ إِنْ مَكَّنَّاهُمْ فِي الْأَرْضِ أَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ وَأَمَرُوا بِالْمَعْرُوفِ وَنَهَوْا عَنِ الْمُنْكَرِ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِالْأُمُورِ ﴿٤١﴾﴾ [سورة الحج: 41]

“Allahu i ndihmon ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zeqatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe

¹ Është koncept fetar të cilin e gjeni në indeks në fund të librit. **Përkthyesi.**

pengojnë punët e mbrapshta. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.” [Haxh: 4]

Si mund ta rimëkëmben (rikthehen) myslimanët kur kanë neglizhuar namazin, dhënien e zekatit, urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja? Si mund të rikthejnë udhëheqjen me këto kundërthënie (kontradikta) mes fjalëve dhe veprave?

Ymeti do ta rikthejë lavdinë e dikurshme dhe krenarinë e humbur vetëm atëherë kur vetëdijësohet dhe kthehet nga dija e shkenca, ashtu siç ka qenë dikur, i përkushtuar maksimalisht në zhvillimin teknologjik dhe industrial, kur dallohej me virtyte e vepra. Allahu xh.sh. nuk ia mban anën askujt; kush punon - fiton, kush mëson - kalon, kush di not – del në sipërfaqe, kush angazhohet për zhvillim – avancon, dhe ajo që duhet të theksohet këtu si parim është fakti që në këto çështje të dynjasë, përkatësia fetare nuk luan rol determinues, pra, vetëm për faktin që je musliman ti nuk mund të ngritesh në kuptimin ekonomik, teknologjik, industrial etj, pa dhënë kontributin tënd maksimal në të gjitha këto fusha!

Grafiku në vazhdim shpjegon kuptimin e këtij ajeti:



Të njejtin kuptim e kanë dhe disa ajete të tjerë, psh. Ajeti 105 i Kaptinës Enbija:

﴿وَلَقَدْ كَتَبْنَا فِي الزَّبُورِ مِنْ بَعْدِ الذِّكْرِ أَنَّ الْأَرْضَ يَرِثُهَا عِبَادِيَ الصَّالِحُونَ﴾

[سورة الأنبياء: 105]

“Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën¹ do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.”

Sot, myslimanët, për fat të keq, për shkak të problemeve të shumta (të brendshme dhe të jashtme), kryesisht për shkak të veseve të këqia si: *spiunazhi, hipokrizia, tradhtia, përgojimi, dobësia shpirtërore*, pastaj nga faktorët e ndryshëm ideologjik sektar e përçarës, ku shpesh ndikon edhe *ateizmi, globalizmi, rendi i ri botëror, sekularizmi, orientalizmi, ungjillëzimi dhe krishterizimi, dëshmitarët e jehovait*, etj), muslimanët nuk kanë arritur nivelin e duhur të qeverisjes në botë! Nuk është as për tu çuditur sepse për të trashëguar dhe udhëhequr me botën një lider, duhet ti përmbushë dy kushtet kryesore: *salahi* (reformimin e brendshëm) dhe *islahi* (reformimin e jashtëm, shoqëror, institucional, etj.) Grafiku në vijim e shpjegon më qartë qëllimin e ajetit kur’anor “ ... që tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.”




¹ Mufesirët kanë dhënë disa mendime rreth këtij ajeti kur’anor, dhe ne anojmë kah mendimi i cili thotë se në këtë kontekst qëllimi nga ajeti kur’anor “**tokën**” që do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë” ka për qëllim tokën e kësaj dynjaje në këtë botë, jo “**tokën**” e Xhennetit.

Allahu xh.sh besimtarëve u premtan fitore, pushtet në tokë, zbatim të fesë, siguri dhe mirëqenie, nëse ata paraprakisht bëjnë vepra të mira duke adhurar gjithmonë dhe sinqerisht Allahun xh.sh. Këtë kuptim e gjejmë në ajetin vijues:

﴿وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُم مِّن بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا وَمَن كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ﴾ [سورة النور:

[55

“Allahu u ka premtuar atyre që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira se do t’i bëjë məkëmbës në Tokë, ashtu siç i ka bërë dhe ata para tyre, do t’ua forcojë besimin, me të cilën Ai është i kënaqur dhe frikën do t’ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e mos të Më shoqërojnë me askë (në adhurim)! Kurse ata që edhe pas kësaj (besimit) mohojnë, ata janë nga të mbrapshtët.” [Nur: 55]. Shih grafikun:



Imam Zemahsheri duke interpretuar këtë ajet thotë: *“Ajeti i drejtohet Pejgamberit a.s. dhe besimtarëve që janë me të. (Pjesëza) minkum (منكم) është vetëm për shpjegim (jo për kufizim shifror), ashtu siç është në fund të kaptinës fet’ h – (منهم) Allahu xh.sh. premton se do ta mbrojë Islamin nga kufri, do t’ua lë atyre në trashëgim tokën, duke i bërë sundues të saj, ashtu siç veproi me izraelitët kur ua la trashëgim Egjiptin dhe Shamin pas shkatërrimit nga tiranët (zullumqarët). Njëherit, fenë e tyre, të cilën Ai e pëlqen, Islamin pra, do ta bëjë ngadhnyese. Temkini i fesë nënkupton forcimin dhe lëshimin rrënjë të saj, duke i siguruar paraprakisht që do t’ua heq frikën. Kjo për arsye se Muhammedi a.s. me shokë, sa ishin në Mekkë për dhjetë vjetë kishin frikë nga armiqtë dhe kur migruan në Medinë (ku asnjë ditë nuk mund të rrinin të pambrojtur) nga frika thoshin: A vjen dita kur do t’i lëmë armët? Pejgamberi a.s. i qetësoi duke ua dhënë myzhdënë se nuk do të kalonte kohë e gjatë kur ata do të rrinin pa patur nevojë të mbanin armë. Allahu xh.sh. ua përmbushi premtimin dhe i bëri ngadhnyes në gadishull, fillimisht për t’i çliruar e më pas për ti bërë përhapës të Islamit nga Lindja gjer në Perëndim, duke trashëguar nga perandoritë pasuritë dhe duke qeverisur gradualisht tërë botën. Më pastaj erdhën gjeneratat tjera që për fat të keq devijuan nga rruga e drejtë, mëkatuan dhe mohuan mirësitë e Allahut! Denigrim që përshkruhet saktësisht në hadith: “Pas meje hilafeti do të jetë tridhjetë vjetë. Pastaj Allahu ia jep pushtetin kujt të dojë dhe bëhe tmbretëri. (Pastaj¹ do të ketë plaçkitje, grabitje në rrugë, gjakderdhje, marrje të pasurisë pa të drejtë...)”²*


Sahabët r.a pra shokët e Muhammedit a.s, ishin gjenerata e parë e njerëzve që pasuan pejgamberin a.s. Ata qenë njerëz të thjeshtë si ne: hanin, pinin, shisnin e blinin, siç bëjmë ne. Njerëz fizik dhe

¹ Për këtë pjesë të këtij hadithi në kllapa, Imam Ibni Haxher el Askalani në: *El Kafij El Shafi fi Tahrixhi Ehadijth el Keshaf*, ka thënë: *nuk e kam hasur, gjetur askund..fq: 203. Ne nuk shohim ndonjë problem serioz për mosgjetjen e kësaj pjese të hadithit tekstualisht, sepse në realitet ato veprat e këqija të lartëpërmendura janë bërë në të kaluarën gjatë historisë islame dhe akoma vazhdojnë edhe sot, shek.20 dhe 21, prandaj nuk ka kontradikta aspak.*

² Zemahsheri, *El-keshshaf*, 24/55. Për hir të korrektesisë, pjesa e dytë e hadithit në kllapa që ka argumentuar me të Zemahsheri nuk gjendet në libra tjerë. Zejleiu konsideron se me këtë formulim është *garib*. **Përkthyesi.**

emocional: në kuptimin e fuqisë, pafuqisë, emocioneve, gëzimit, hidhërimit, pikëllimit, brengave, mërziës... Pafuqinë përballë shtypësve (tiranëve) idhujtarë, ata e tejkalojnë me besim, me durim dhe me shpresë. Duke llogaritur në ndihmën e Allahut xh.sh. ata iu ankuan Muhammedit a.s. për frikën konstante që kishin dhe e pyetën nëse ajo do të përfundonte ndonjëherë (nëse do të vinte dita kur do të flinin të qetë e të sigurt pa armë, pa frikë nga sulmi i befasishëm i armikut). Pejgamberi a.s. i qetësoi duke ua dhënë myzhdënë se së shpejti gjërat do të shkonin në favor të tyre dhe se ata do të qeverisnin botën, do ta çlironin gadishullin arabik e më pas do të përhapnin fenë islame në çdo cep të botës. Kjo do të ishte dhurata e Zotit për devocionin e tyre të plotë ndaj Zotit dhe për respektin maksimal që kishin ndaj njëri tjetrit.

Çështja e frikës në kohë sprovash e vështirësish është e natyrshme për njerëzit, kushdo qofshin. Kur'ani na tregon se këtë ndjesi e kanë patur madje edhe Pejgamberët e Allahut xh.sh. Grafiku në vijim tregon rëndësinë e lidërshpimit të drejtë dhe të suksesshëm.



1.3. Harta e rrugës që çon në marrjen e pushtetit dhe të epërsisë në tokë

Mësuam për *temkinin*, lidershipin, mëkëmbjen dhe trashëgiminë e saj në esencë. Në këtë kontekst duam të sqarojmë hollësisht detajet lidhur me mëkëmbjen në tokë dhe përmbajtjen doktrinare e metodologjike të jetësimit të *temkinit* në praktikë.

Në trajtimin e *temkinit*, dijetarët, gjithmonë kanë patur dallime konceptuale e metodologjike të qasjes, në strategji, prioritete, etapa, me të vetmen arsye - që premtimi i Allahut për sundimin e besimtarëve mbi tokë të realizohet në tërësi, duke arritur dhe kënaqësinë e Tij në ahiret.

Profesor Sejjid Kutubi, shpjegon në mënyrë brilante ajetin e *temkinit* në kaptinën Nur, kaptinë që meriton të shkruhet me germa të arta, sepse përmbanë rëndësi të jashtëzakonshme (*akademike, fetare, familjare, shoqërore, politike*), që meriton të shpjegohet mirë për besimtarët! Gjithë kjo, me shpresë që myslimanët të rimarrin timonin dhe të qeverisin botën dinjitetshëm, ashtu siç bënë me shekuj paraardhësit e tyre ¹!


Sejjid Kutubi e rikonfirmon shumëfish këtë premtim të Allahut xh.sh. duke shtuar se shtyrja e tij -e premtimit- nuk mund të ketë ndonjë arsye tjetër pos papërgjegjesisë së myslimanëve, sepse

¹ Në këto momente të korigjimit të librit tim, të përkthyer, para botimit, me datën 15 Gusht 2021, pas negociatave amerikane dhe afgane këtu në Doha-Katar, dhe pas 20 vitesh rezistence dhe lufte të ashpër kundër aleancës europiane, amerikane, (Nato's), në Afganistan, ushtria e hekurt talibane e riktheu shtetin e tyre të okupuar e të shkatërruar me krenari dhe trimëri. Ma sha Allah për këtë fitore, Allahu ua dhashtë suksesin, bereqetin, sigurinë, qeverinë kontruktiv politike, ekonomike, shoqërore dhe fetare islame. Amin.

premtimi i Allahut gjithmonë përmbushet! Allahu nuk e shkel premtimin e Vet! Ja shpjegimi i Sejjid Kutubit:

...Premtimi i Allahut për pjesëtarët e ymetit të Muhammedit a.s. të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira është se Allahu do t'i bëjë mëkëmbës në tokë, do tua bëjë triumfuese fenë që Ai e ka përzgjedhur për ta dhe frikën do t'ua zavendësojë me siguri. Ky është premtimi i vërtetë i Allahut dhe ai ndodhë, sepse Allahu nuk shkel premtimin e Vet!

Grafiku në vazhdim e shpjegon këtë:




Profesori Kutubi pos shpjegimit se premtimi i Allahut është i garantuar dhe i vërtetë, thekson se për këtë mëkëmbje duhen sakrifica! Mëkëmbja e vërtetë, shpjegon Kutubi, parasheh reformim të thellë dhe të gjithanshëm, formal e esencial, të jashtëm dhe të brendshëm, individual e shoqëror. Pra, ndryshim në çdo cep, çdo pore të saj. Ja çfar thotë konkretisht, Kutubi:

Cila është e vërteta e këtij besimi? Dhe cila është e vërteta e kësaj mëkëmbje? E vërteta e besimit sipas të cilit realizohet premtimi

i Allahut është e vërtetë gjigande që përfshinë tërë angazhimin njerëzor. Sapo të zë vend në zemër, besimi fillon punën menjëherë, për tu shfaqur në formë të veprës, aktivitetit, ndërtimit në emër të Allahut xh. Besimtari nuk kërkon kënaqësi tjetër pos kënaqësinë e Allahut xh.sh. Besimi është bindje ndaj Zotit dhe nënshtrim absolut ndaj Tij në çdo gjë, të madhe a të vogël. Besimi nuk i lë vend epshit¹ (pasionit), as në shpirt as në zemër! Besimi nuk lejon njeriun të udhëhiqet nga ndjenjat (emocionet) por nga parimet fetare, porositë e Muhammedit a.s, të kumtuara nga Allahu xh.sh. Ky besim përfshin njeriun në tërësi: mendimet, sjelljet, emocionet, prirjet, dëshirat, preferencat, madje dhe lëvizjet trupore, etikën, konfidencën me Zotin, familjen dhe njerëzit në përgjithësi. Në raport me të gjitha këto, njeriu i përulet vetëm Allahut xh.sh.

Grafiku në vazhdim ilustron trajtat e besimit të vërtetë në jetën e besimtarit:

¹ Me *epsh* nuk është për qëllim dëshira e madhe për të plotësuar kënaqësitë trupore. Epshi është koncept, kuptimin e të cilit mund ta gjeni në fund të librit. Përkthyesi.



Profesori dhe komentatori i Kur'anit Sejjid Kutubi më pas i rreket një çështjeje të rëndësishme, të cilën ne, myslimanët e sotëm e kemi neglizhuar goxha shumë! Bëhet fjalë për parapregaditjen për bartje të përgjegjësive, për ligjin universal, ligjin e jetës, ligjin e Kur'anit, ligjin e Pejgamberit a.s. dhe të shokëve të tij, ligjin e liderëve të suksesshëm - i vlefshëm edhe sot e gjersa të ketë jetë në këtë botë. Ja si shprehet Sejjid Kutubi: *“Ai besim është program i kompletuar i jetës, ku përfshihet çdo gjë që ka urdhëruar Allahu xh.sh. Në kuadër të asaj që ka urdhëruar Allahu xh.sh. është dhe krijimi i kushteve dhe përgatitja materiale, përvetësimi i mjeteve dhe përgatitja për bartjen e amanetit të madh në tokë, të amanetit të mëkëmbjes dhe të udhëheqjes.”*

Grafiku më poshtë figurativisht përmbledh këtë që thamë:




Sejjid Kutubi – Allahu e pastë mëshiru, sqaron dhe një detaj që asnjë lider botëror nuk e ka bërë përgjatë historisë.

Shumë liderë despotë, zullumqarë, çështjen e lidërshiptit, pushtetit, sundimit dhe të mëkëmbjes e kanë kuptuar si shans

për epërsi dhe keqtrajtim mbi njerëzit ndaj kanë sunduar egër, në lluks, shfrenim, për përfitime personale e materiale, duke shpërdorur pasurinë publike, duke shpërfillur kërkesat dhe nevojat e popullit! Lidhur me këtë, Sejjid Kutubi shprehet: *"...Cila është e vërteta e mëkëmbjes në tokë? Ajo nuk nënkupton thjesht pushtetin, sundimin me dorë të çeliktë, dominimin dhe autoritetin e të fortit mbi të dobëtin. Këta elementë lejohen në funksion të reformimit dhe mirëqenies së gjithmbarshme, për realizimin e programit me parametra të Zotit, në mënyrë që njerëzimi të orientohet sipas tyre, për të arritur nivelin e përsosmërisë së paraparë si krijesa të Allahut xh.sh. Mëkëmbja në tokë paraqet aftësi konstruktive dhe jo destruktive! Është mënyrë për të arritur drejtësinë dhe lumturinë në këtë botë!"*

Dy grafikët më poshtë ilustrojnë qëllimin e prof. Sejjid Kutubit:


Grafiku 1:



Këta janë besimtarët të cilëve Allahu xh.sh. ua ka premtuar fitoren dhe temkinin, siç shprehet Sejjid Kutubi:

“Allahu xh.sh u ka premtuar se do t’i bëjë udhëheqës në tokë siç i bëri më parë besimtarët e singertë, në mënyrë që ta jetësojnë programin që Allahu deshi, ta vendosin drejtësinë që Allahu deshi, ta çojnë njerëzimin hap pas hapi në rrugën e përsosmërisë së përcaktuar nga Allahu (për njerëzimin).”

Grafiku 2:



Sipas Sejjid Kutubit, liderët që kanë veset e lartpërmendura, nuk meritojnë mëkëmbjen dhe temkinin, sepse janë çrregullues dhe shkatërrues. Ja si shprehet prof. Sejjid Kutubi, *rahmet pastë!*:

“Ndërsa sa i përket atyre që marrin pushtet e shkaktojnë çrregullime në tokë, bëjnë padrejtësi e zullum dhe ulin njeriun në gradë të kafshës, ata nuk janë mëkëmbës në tokë. Ata, siduket janë sprovuar me këtë pozitë, ose të tjerët janë sprovuar me ta për ndonjë urtësi që veç Allahu e di.”

Sa largpamës ke qenë, o profesor i nderuar, Sejjid Kutub! Edhe pse je ndarë prej nesh prej më shumë se gjysmë shekulli (1966), me përshkrimet tua sikur pandeh se ç'po ndodhë dhe sot në botë! Sikur *'ke parë gajbin nga një perde e tejdukshme'* (siç thoshin dijetarët e parë nga gjenerata e frymëzuar Kur'anore)! Përshkrimi yt përputhet me gjendjen tonë deri në hollësi: *"...Kjo është mëkëmbja që Allahu ua ka premtuar atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. U ka premtuar se do t'i bëjë udhëheqës në tokë siç i bëri më parë besimtarët e singertë, në mënyrë që ta jetësojnë programin që Allahu e deshi, me drejtësinë që Allahu e ofroi, të çojnë njerëzimin hap pas hapi në rrugën e përsosmërisë që Allahu xh.sh. caktoi për njerëzimin. Kurse ata që marrin pushtet për të shkatërruar e çrregulluar botën, duke ushtruar padrejtësi e shtypje dhe për të përulur njeriun deri në nivel të kafshës, ata njerëz nuk mund të jenë kurrë mëkëmbës në tokë! Ata, në fakt, këtë pozitë e kanë patur sprovë, për vete ose për të tjerët, Allahu e di më mirë!"*

Sa i përket *temkinit*, Profesori Kutub pohon se temkini fillimisht ndodhë në zemër. Pra, para se të bëhemi autoritet në tokë, duhet të bëhemi autoritet në zemër, të fitojmë dashurinë dhe besnikërinë e njerëzve. I madhëruar qoftë Allahu! Realiteti ynë i sotëm, kaq i hidhur, ky distancim nga feja (në nivelin individual, kolektiv e global!), ky kërcënim e kjo luftë e hapur globale kundër Islamit dhe besimtarëve myslimanë, kjo *islamofobi* e theksuar, kjo luftë psikologjike e ushtarake ku bëjnë pjesë dhe mediat perëndimore, ato sioniste, duke mos përjashtuar as ato arabe... ka një emërues – injorancën e hapur ndaj Islamit dhe programit të tij hyjnor dinamik! Si rrjedhojë kemi dhe lëkundjet e brendshme tek komuniteti mysliman, labilitetin shpirtëror që ndikon drejtpërdrejtë dhe në reperkusionet e jashtme. Madhështia e Krijuesit dhe mesazhi i Tij hyjnor kuptohet vetëm duke lexuar, studjuar dhe duke

përmirësuar imazhin e shtrembëruar ndaj islamit¹. Ja analiza e bukur e Prof. Kutubit: “*Temkini (forcimi) i fesë ndodhë nëpërmjet temkinit në zemra, temkinit në çështjet e jetës dhe të menaxhimit të saj. Pra, Allahu u ka premtuar se do t’i bëjë prijës në tokë dhe do t’ua forcojë fenë që ua ka përzgjedhur, pra do ta bëjë dominante. E feja e tyre urdhëron për qasje islame, drejtësi, mbizotërim mbi epshet, mirëmbajtje të tokës (ekosistemit, biodiversitetit), përfitim nga çdo e mirë që Allahu ka caktuar për njerëzimin, natyrisht duke ia përkushtuar tërë veprimtarinë Allahut xh.sh.*”

Grafiku në vazhdim e shpjegon figurativisht këtë³:



¹ Për më shumë rreth kësaj, ju propozojmë librat në vazhdim të Sejjid Kutubit: *Mukavvimat ettesavvuri el-islamij*, *Hasais ettesavvouri el-islamij*, *Mealim fi ettarik*, *El-mustakbel li-hadha eddin*, *El-islam vesselamu el-alemij*, etj.

² Shih: Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur'an*, 4/2484.

³ Shih edhe: Ebu Hajjan, *Tefsiru el-bahri el-muhit*, 24/55.

Sqaruar strategjitë e mëkëmbjes dhe temkinit, format e aplikimit në praktikë dhe hapat që duhet ndjekur në funksionalizimin e këtij programi hyjnor në tokë, duke qenë të bindur që ky sqarim është i mjaftueshëm, dhe Allahu di më mire.

2. SHEMBUJ TË LIDERSHIPIT TË SUKSESSHËM NGA PRIZMI KUR'ANOR

Shembuj Kur'anorë për modele të suksesshëm të lidershipit ka shumë. Një nga ata është dhe modeli gjithëpërfshirës i pejgamberit tonë, Muhammedit a.s, model që përfshinë të gjitha fushat.

Shembulli tjetër është ai i Sulejmanit a.s. me Belkisën, mbretëreshën e popullit *sebe'*, gruan që pranoi Islamin. Para konvertimit, me të pranuar letrën e Sulejmanit a.s ajo konsultohet me gjeneralët ushtarakë mbi përgjigjen që do t'ia kthente Sulejmanit a.s. Veprim i saj i zgjuar që reflekton vizion dhe largpamësi! Këta elementë, bashkë me konsultën ose *shura-në*¹ (siç e njohim në fe), janë elementë të lidershipit të suksesshëm. Në rastin e Belkisës kjo u dëshmuar në praktikë, me vet faktin që ajo bashkë me popullin e saj shpëtuan nga dënimi i Zotit (në dynja e ahiret)! Shpëtoi dhe nga sulmi i mundshëm i Sulejmanit a.s. në rast se do ta refuzonte kërkesën ose do t'i përgjigjej me forcë, siç mund të ndodhte sipas mendësisë së gjeneralëve të asaj kohe.

¹ Detaje rreth *Shura-së* në Siren profetike dhe mënyrat e aplikimit të saj në kohën tonë mund t'i gjeni në artikullin me titull "*Eshshura fi essijaseti ennebevijeh*" të dr. Fehd bin Salih el-Axhlanit në portalin e Ligës së Dijetarëve të Ehlu Sunneti: <http://www.rabtasunna.com>. Portali është shfletuar më datë: 03.02.2019.

Shembull tjetër Kur'anor kemi Jusufin a.s. dhe përvojën e tij të shkëlqyer në ekonomi e financa, shembulli i Dhulkarnejnit në fushën ushtarake si dhe shembujt tjerë që për shkaqe objektive nuk do të mund ti përfshijmë!

2.1. Lidershipi i përgjithshëm i Muhamedit a.s.

Prej shembujve të lidershipit kulmor, në fushën ushtarake, shoqërore gjithsesi dhe fetare është shembulli i peygamberit tonë, Muhammedit a.s.

Allahu xh.sh. e ka dalluar peygamberin tonë me tipare dhe virtyte çfarë nuk ka patur askush nga njerëzit tjerë! Për të qenë model për njerëzimin, Ai e ka zbukuruar me petkun e moralit të përkryer, ashtu siç përshekruhet në Kur'an:

﴿وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ ﴿٤﴾﴾ [سورة القلم: 4]

“Sepse ti je, me të vërtetë, me moral; të lartë..” [Kalem: 4]

Njëherit e ka dalluar dhe me mëshirë, dhembshuri dhe dashamirësi për mbarë njerëzimin, veçmas për myslimanët. Këtu qëndron dhe sekreti i aftësisë së tij për t'i afruar dhe pushtuar zemrat e njerëzve. Thjeshtësia dhe modestia e Peygamberit a.s. shkonte deri aty sa ai konsultonte shokët dhe merrte mendimet e tyre madje dhe në çështjet esenciale, në luftë e ushtri. Për këto elemente të fuqishme lidershipi flasin ajetet në vazhdim:

﴿فِيمَا رَحِمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ
وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ ﴿١٥٩﴾﴾ [سورة

آل عمران: 159]

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed!). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falju gabimin, kërkoi falje Allahut për ta dhe këshillohu me ta për çështje të ndryshme. Për vendime, mbështetu tek Allahu! Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” [Al Imran: 159]

﴿لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ

بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿١٧٨﴾ [سورة التوبة: 128]

“Ju erdhi i dërguar nga mesi juaj. Atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja. I brengosur për besimtarët, i butë dhe i mëshirëshëm..” Teube: 128]

Një nga segmentet më të rëndësishëm në realizimin e çfarëdo projekti (të çfarëdo institucioni politik, ushtarak, civil, edukativ) dhe të çfarëdo niveli (pra edhe në nivel të ymetit në tërësi), është emërimi i një lideri shembullor; me virtyte të larta; me edukatë, besimtar i kulluar dhe i lidhur fortë pas Allahut xh.sh. Mungesa e një lideri të tillë mund të jetë pasojë e gjithë mjerimit që përmendëm më sipër, si në rrafshin praktik të besimit fetar ashtu dhe në rrafshin qeverisës shtetëror (të politizimit apo ideologjizimit të fesë)!

*Ehlul hil-lit dhe akdit*¹ i mbetet për detyrë që në bashkëpunim me dijetarët, ekspertët dhe këshilltarët, të gjejnë një lider të tillë; ta përgatisin së pari e më pas ta aftësojnë për të marrë përgjegjësi administrative, fetare, shoqërore, ushtarake e shtetërore.

Kushdo që ka lexuar *Siren* ose biografinë profetike, biografite e katër udhëheqësve të drejtë², biografite e liderëve dhe

¹ Shih kuptimin e këtij nocioni në fund të librit.

² Shih kuptimin e këtij nocioni në fund të librit.

komandantëve të njohur politikë e ushtarakë përgjatë historisë, do ta gjejë këtë të vërtetë të kristalizuar¹.

Në Betejën e Mu'tes, Pejgamberi a.s. i kishte përgatitur komandantët me radhë, duke caktuar fillimisht si komandant të parë Zejd bin Harithen r.a, në vend të të cilit në rast se do të vritej do të vinte Xhafer bin Ebi Talibi r.a e të cilin do ta pasonte Abdullah bin Revaha poqëse edhe Xhaferi do të vritej. Pas kësaj, komandant do të bëhej ai rreth të cilit pajtohen unanimisht të gjithë besimtarët.

Lidershipi i Muhamedit a.s. nuk përjashton mundësinë e përfitimit nga përvojat e popujve tjerë, në aspektin ushtarak e shkencor dhe të sigurisë së popullit e gjakut të besimtarëve, kuptohet duke marrë gjithçka me kujdes të shtuar dhe mbi bazë të përvojës së dëshmuar si të suksesshme. Kështu pati vepruar Pejgamberi a.s. në Betejën e Hendekut, kur mori mendimin e Sahabiut të nderuar, Selman Farisiut r.a.² për të hapur hendeqe rreth Medinës, në mënyrë që tu pamundësohej ushtrive kundërshtarë (idhujtarëve, çifutëve dhe fiseve arabe) të depërtojnë në Medinë. Kjo ishte mënyrë e njohur në luftërat e persianëve por jo dhe në ato të arabëve, prandaj Pejgamberi a.s. e implementoi dhe kjo u tregua si metodë e suksesshme.

Përsa i përket Sires, do të përmendim dhe disa shembuj tjerë, të cilët i ka përmbledhur Fehd bin Salih Axhlani në një punim në të cilin Siren e ka trajtuar nga këndvështrimi i *Shuras*:

¹ Shih sa për ilustrim librin *100 min udhamai ummeti el-Islam gajjeru mexhra et-tarih* të Xhihad Turbanit, b. 10, Dar et-takva, Medine Munevvere 2015. Shihe dhe: Alija Izetbegoviç, *Avaik en-nehdati el-islamijje – mexhmu mekalat*, përktheu në arabisht: Omer Husejnspahiç, botuar në Doha më 1996.

² Shih: Ibn Hisham, *Essiretu ennebevijjetu*, pjesa ku flitet për Betejën e Hendekut, 3/165.

Pejgamberi a.s. i ka konsultuar shokët edhe lidhur me betejat tjera¹. Ka patur raste kur Pejgamberi a.s. ka diskutuar vetëm me një pjesë (elitare) të shokëve të tij, siç ndodhi p.sh. në Betejën e Bedrit, kur u konsultua me Ebu Bekrin r.a. dhe Omerin r.a. lidhur me robërit e luftës.

Në Sahihun e Muslimit transmetohet që pasi ishin zënë robërit e luftës, Pejgamberi a.s. kishte pyetur Ebu Bekrin dhe Omerin: Çfarë mendoni për këta robër (si të veprojnë me ta)? Ebu Bekri i ka thënë: O Lajmëtar i Allahut, janë kushërinj dhe farefis, prandaj mendimi im është të marrësh kompensim material për ta (t'i lirosh kundrejt një pagese) që të jetë burim force për ne ndaj jobesimtarëve. Ka mundësi që Allahu t'i udhëzojë në Islam! Po ti, o biri i Hattabit, çfarë mendon? - iu drejtua Omerit Pejgamberi a.s. Jo o i Dërguari i Allahut, jo, për Allahun unë nuk e mendoj atë që e tha Ebu Bekri. Unë mendoj që me lejen tënde t'ua prejme kokat; Aliut t'i japësh mundësi t'ia presë kokën Akilit, kurse mua filanit (një të afërmi të Omerit) ... sepse ata janë koka dhe zemra të idhujtarëve!

Pejgamberi a.s. i kishte veçuar për këshilla dhe dy Sa'dët, Sa'd bin Muadh dhe Sa'd bin Ubad, tamam në ditën kur ndodhi Beteja e Hendekut, kur kishte menduar t'ia jepte 1/3 e frutave prijësve të fisit *Gatafan* për ta zhbllokuar Medinën. Pejgamberi a.s. e ftoi Sa'd bin Muadh dhe ia përmendi këtë. Sa'di iu drejtua: O i Dërguari i Allahut, në të kaluarën edhe ne si ata mohuam Allahun, adhuronin idhujt, as e njihnim as e adhuronim Allahun, prapsepapë, ata nuk guxonin të hanin nga frutat e Medinës pos kur ishin mysafirë ose kur ishin blerës. Kurse tani, që Allahu na nderoi me Islam, na udhëzoi në të dhe na bëri krenarë me ty dhe me Të, t'ua japim ne atyre pasuritë

¹ Shih: Ibn Hisham, *Essiretu ennebevijetu*, pjesa ku flitet për Betejën e Bedrit, 2/258.

tona? Jo, pasha Allahun, nuk do t'iu japim asgjë pos shpatës, derisa Allahu të gjykojë mes nesh dhe atyre!

Atëherë le të jetë kështu, merru ti me ta, i tha Pejgamberi a.s!

Sa'di e mori letrën e marrëveshjes dhe e fshiu të tërën.

Rasti tjetër flet për marrëveshjen e Hudejbijes, kur Pejgamberi a.s. urdhëroi shokët të therrnin kurban dhe ti qethnin flokët. Asnjëri nga ata nuk respektoi vendimin! Pejgamberi a.s. hyn tek Ummu Seleme-bashkëshortja e tij - dhe ia përmend këtë. Ummu Seleme i thotë: O lajmëtar i Allahut, dil para tyre dhe pa fjalë there kurbanin tënd dhe thirre berberin të të qethë.

Pejgamberi a.s. kështu veproi; pa i folur askujt theri devenë si kurban dhe i tha berberit ta qethte. Me ta parë, shokët u çuan dhe i therën kurbanet e tyre.


Shura apo konsulta në rastin e pejgamberit a.s. nuk ishte thjesht vetëm një çështje politike! Pejgamberi a.s. diskutonte me shokët edhe për çështje të tjera, si për shembull për rastin e Ajshes r.a, pyet Aliun dhe Usame bin Zejdin nëse duhej ta divorconte për shkak të moralit!? Usame r.a. i përgjigjet se beson në ndershmërinë e gruas së tij (Ajshes) ndërsa Aliu r.a. ishte i mendimit se bota nuk kishte mbetur në një grua dhe se kishte gra të tjera (pra e këshilloi për divorc).¹

Një studiues i nderuar duke folur për lidërshtipin nën dritën e ajeteve Kur'anore veçon disa tipare dhe karakteristika të lidërshtipit të Muhamedit a.s., të cilat do t'i përshkruajmë në formë të përmbledhur sipas tipareve: *Morali i lartë, përkushtimi*

¹Shkëputje nga artikulli "*Esh-shura fi essijaseti ennebevijje*" të dr. Axhlanit, të cituar më lartë. Shih po kështu edhe konsultimin e Pejgamberit a.s. me Ensarët: Ibn Hishami, *Essiretu ennebevijje*, 2/258; konsultimin me Ummu Seleme në Marrëveshjen e Hudejbijes dhe konsultimet në Betejën e Bedrit 3/263; 2/249 në referencën në fjalë.

*për mirëqenien e ushtrisë, butësia dhe mirësjellja, aftësia për të organizuar, sistemuar dhe deleguar detyrat, konsultimi, vendosmëria, përfitimi nga përvojat ushtarake të popujve tjerë*¹.

Aspektet udhëheqëse të lidershipit të Pejgamberit a.s.:



¹ Shih: El-Astal, Muhammed Ahmed, *El-kijadetu fi dav'i el-ajat el-kur'anijeh*, f. 175-178.

2.2. Lidershipi muhamedan në fushën ushtarake

Po të lexosh me vëmendje ajetet Kur'anore vërenë se ai që motivon një ushtar për luftë (duke mos ia luhatur moralin luftarak apo dhe dezertimin!) ai njeri është komandanti i dalluar! Prijës me formim shembullor! Prania e komandantit në fushëbetejë ngre lart motivin dhe moralin ushtarak dhe nxitë për heroizëm të lartë përballë armikut. Gjithë kjo bëhet me qëllim që të arrihet grada më e lartë e shehidit (dëshmorit). Të gjitha këto elemente të liderit shembullor i gjejmë tek Muhammedi a.s. Aftësinë e pejgamberit a.s. për planifikim dhe organizim të ushtrisë në kohën e luftës dhe para përballjes me armikun, na e përshkuan Kur'ani famëlartë:

﴿وَإِذْ عَدَوْتَ مِنْ أَهْلِكَ تُبَوِّئُ الْمُؤْمِنِينَ مَقَاعِدَ لِلْقِتَالِ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ﴾ [سورة آل عمران: 121].

“Atë mëngjes, kur ti (o Muhamed) dole nga shtëpia jote për t’u caktuar besimtarëve vendet e luftës - Allahu dëgjon dhe di çdo gjë.” [Al Imran: 121]

Hoxha AbduRrahman Sa'di duke komentuar këtë ajet thotë: *“Dalja këtu ka kuptimin thjesht të daljes, pa caktuar kohën, pra nuk është për qëllim dalja (vetëm) në mëngjes¹...Pra, ka dalë dhe ua ka përcaktuar secilit vendin dhe pozicionin ku do të qëndrojë. Ky qëndrim i Muhammedit a.s. në fakt paraqet figurën më të lartë të ushtarakut dhe të strategut (ai personalisht udhëheq ushtrinë dhe ua përcakton luftëtarëve pozicionet në fushëbetejë). Natyrisht, kjo si rezultat i dijes dhe vizionit të përkryer të tij, i saktësisë, maturisë, vullnetit të madh për të kryer këto detyra me rrezik të lartë dhe duke kryer këtë detyrë*

¹Siç ka përzgjedhur përkthyesi i kuptimeve të Kur'anit Hasan ef. Nahi ta përkthejë fjalën 'gadevte' dhe siç mendojnë disa interpretues të Kur'anit. **Përkthyesi.**

*personalisht, me guxim të plotë e devocion të padiskutueshëm, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!*¹”

Imam Alusi duke komentuar këtë ajet, thotë: Ky ajet në mënyrë eksplicite i drejtohet Muhammedit a.s....” *për t’u caktuar besimtarëve...*” për t’i vendosur e përgatitur “...vendet e luftës...” pozicionet dhe qëndrimet...²

Ndërsa flasim për lidhshkrimin e Muhammedit .a.s. dhe veçoritë e tij në fushëbetëje, nevojën e ndjekjes apo përvetësimit të shëmbëlltyrës së tij, kuptohet duke marrë parasysh gjithnjë rrethanat e kohës dhe të vendit, shohim të rrugës të veçojmë guximin, vendosmërinë dhe qëndrimin stoik të Pejgamberit a.s. gjatë përballjes me idhujtarët në Betejën e Uhudit³ apo dhe në Betejën e Bedrit, ku epërsia ushtarake e idhujtarëve ishte dukshëm më e madhe nga ajo e besimtarëve, me ç’rast disa shokë i kishin propozuar: “Po deshe mund të tërhiqemi”, ndërsa ai është përgjigjur: “Nuk i takon një profeti që të zmbrajset pasi të ketë vënë parzmoren⁴ ndërsa Allahu gjykon (vendosë) për të.”⁵

Ky citat dëshmon guximin, qëndrimin, vendosmërinë dhe strategjinë e Pejgamberit a.s. në fushën e lidhshkrimit ushtarak si një shembull unik dhe i pakrahasueshëm.

Prezenca e një komandanti (profeti hyjnor) në mesin e ushtarëve (njerëzve tokësorë), modestia dhe vëllazëria e tij me ushtarët, si në gëzim ashtu dhe në pikëllim, rreziqet që merr përsipër dhe gjithë barra e moralit ushtarak, janë vetëm disa nga cilësitë e

¹Tefsiri i Sa’idit, 3/121.

²Tefsiri i Alusit, 3/121.

³ Beteja e Uhudit ndodhi në vitin e 3 hixhri në muajin Shevval, shih *Siren* e Ibn Hishamit, 3/23.

⁴ Veshje prej metali, e gjatë deri në brez, që mbronte luftëtarët në kohët e vjetra gjatë ndeshjeve me armë të ftohta...shih: <https://fjale.al/parzmore>

⁵ Beteja e Bedrit ndodhi në vitin e 2 hixhri në muajin Ramazan, shih *Siren* e Ibn Hishamit, 2/249.

larta që kanë inkurajuar besimtarët për sakrificë, në kauzën fetare.

Historia klasike dhe moderne na jep shembuj të shumtë të admirueshëm të lidërshipt ushtarak, si: Salahuddin Ejjubi me kryqëzatat, Sulltan Mehmet Fatihu me bizantinët, Sulltan Sulejman Kanuni në perandorinë osmane me mbretërit e krishterë ortodoksë në Evropë, Ballkan dhe Azi, Omer Muhtari kundër pushtuesve italianë, Alija Izetbegoviçi kundër kriminelëve serbë e kroatë në Bosnjë dhe Hercegovinë, liderët çeçenë dhe afganistanezë kundër pushtuesve tiranë rusë, disa figura qendrore të rezistencës palestineze ndaj pushtetit sionist dhe nga historia më e re e Kosovës, figurat e dalluara të rezistencës shqiptare si Adem Jashari, Hamëz Jashari, etj, të cilët i dhanë fund pushtimit serb në Kosovë, pastaj trimat shqiptarë që u sakrifkuan për kauzën shqiptare në Maqedoni të Veriut, etj. Këta modelë janë liderë për së mbari; që luftuan të keqen dhe nxitën të mirën me mjete të ndershme.

Por historia njeh dhe një kategori tjetër, që luftojnë me mjete të ndyra (me tradhti, ç'nderim, vrasje makabre të njerëzve të pafajshëm, siç ishin zullumqarët e njohur psh. Hitleri, Stalini, Sharoni, Olmert, Netanjahu, Millosheviçi, Enveri, etj, me teoritë (makiaveliste¹) materialiste të të cilëve përdhosnin e përbaltnin çdo vlerë humane e fetare për qëllime të tyre personale dhe politike!

Padrejtësia dikton nevojën për një lider model në Islam, udhëheqës me virtyte të larta; edukatë, dituri, moral, besimtar që çdo vendim e merr në bazë të Kur'anit e Sunnetit (tradiës së pejgamberit Muhamed a.s.).

¹ Shih: Hamud Abdullah El-Ehnumi, *El-kijadetu el-ammetu min hilal el-Kur'an el-kerim ve err-Rresul el-adhim*, f. 1.

Çdo lider që për shembëlltyrë ka qëndrimet dhe vizionin largpamës të Muhammedit a.s. respektivisht lidërshtipin e tij të dëshmuar si shembullor, ai njeh dhe ajetet që flasin pikërisht mbi këtë çështje.

Kur'ani është përplotë me ajete që flasin për thelbin e këtij lidërshtipi. Shpalosë detaje mbi vendimet e Muhammedit a.s kur merrte pjesë aktive në beteja, i shoqëronte shokët e vet, ishte në vijën e parë të frontit, i inkurajonte me ndihmën e Allahut sa herë që u shfaqej frika në fushëbeteja. Pejgamberi a.s. ua kishte kujtuar atyre ndihmën e Allahut xh.sh, përkrahjen me një numër të madh të engjëjve që do tju vijinë në ndihmë në betejat e Bedrit, Uhudit dhe të Hendekut, gjë që e kishte forcuar edhe më shumë moralin e tyre luftarak dhe vullnetin për fitore. Allahu xh.sh. thotë:

﴿ إِذْ تَقُولُ لِلْمُؤْمِنِينَ أَلَنْ يَكْفِيَكُمْ أَنْ يُمَدِّدَ رَبُّكُمْ بِثَلَاثَةِ آلْفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُزِيلِينَ ﴿١٢٥﴾ بَلَىٰ إِنْ تَصَبَّرُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ مَا اتَّقَوْا وَأُتُوا كُمْ مِنْ قَوْرِهِمْ هَٰذَا يُمَدِّدْ رَبُّكُمْ بِخَمْسَةِ آلْفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُسَوِّمِينَ ﴿١٢٦﴾ ﴾


[سورة آل عمران: 124- 125]

“Atëherë ti (Muhammed) u thoshe besimtarëve: “A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë engjëj të dërguar?” 125. Po! Por, nëse ata ju sulmojnë, bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë do t’ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar.” [Al Imran: 124-125]

Ndërsa flasim për këto ajete, dua të theksoj mësimin që përfitojmë nga këto ajete, duke iu shmangur debatit të mufesirëve lidhur me detajet (vendi dhe shkaku i shpalljes së tyre, a ka qenë shkak i shpalljes së tyre Beteja e Bedrit apo e Uhudit etj.etj.), por ne na intereson aspekti i implementimit të rolit komandues të Pejgamberit a.s. në ushtri, përkrahja morale që ua jep ushtarëve në luftë (se Allahu do të dërgonte engjëj për t’i ndihmuar në fushëbetejë), duke i përkujtuar ata se përgjigja

nga Allahu xh. vjen gjithmonë pasi ata të shprehin tiparet e besimit (durimin, devotshmërinë dhe përgjërimin ndaj Allahut xh.).

Kështu edhe ndodhi. Premtimi i Pejgamberit a.s. u përmbush. Allahu xh.sh. ndihmoi besimtarët e devotshëm që treguan vendosmëri dhe durim. Sigurisht, kjo falë prezencës së liderit të tyre të madh, Muhammedit a.s. ndryshe, për shkak të praktikave të armiqve në luftë, respektivisht përhapjes së thashethemeve, propagandës së hipokritëve, përpjekjes për ta mposhtur ushtrinë kundërshtarë, ndoshta besimtarët do të thyheshin e do të dobësoheshin, gjë kjo e natyrshme që mund t'iu ndodhte sahabëve, të cilët, në fund të fundit, ishin njerëz si gjithë të tjerët. Kështu, për ta ruajtur unitetin dhe moralin luftarak, prania fizike e komandantit në fushëbetejë ishte e domosdoshme. Këtë detaj të lidërshiptit motivues ushtarak nuk duhet harruar kurrë! Dhe Allahu e di më së miri!



**Vështrim për të trajtuar qëndrimet
e mufessirëve rreth kësaj meseleje**

Në këtë pikë, derisa po merremi me etimologjinë Kur'anore lidhur me lidërshiptin motivues ushtarak, duhet të theksoj se mendimet e dijetarëve dallojnë goxha shumë përsa i përket synimeve në këtë ajet! *“Atëherë ti (Muhammed) u thoshe besimtarëve: “A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë engjëj të dërguar?” 125. Po! Por, nëse ata ju sulmojnë, bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë do t’ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar.”* [Al Imran: 124-125]

Problemi qëndron në kohën kur ka ndodhur zbritja e engjëjve për t'i ndihmuar besimtarët, ka qenë në kohën e Betejës së Bedrit apo të Uhudit, dhe mbi dilemën nëse kjo ndihmë me engjij ka ndodhur apo nuk ka ndodhur!?

Në mesin e shumë mendimeve të mufessirëve klasikë e modernë, kemi gjetur dhe një grup me këtë mendim:

Ajeti paraprak në kaptinën Al Imran ka folur për Betejën e Uhudit e po kështu edhe pyetja e Pejgamberit a.s. drejtuar Sahabeve r.a.¹ (dhe e përshkuar në këto ajete):

﴿إِذْ تَقُولُ لِلْمُؤْمِنِينَ أَلَنْ يَكْفِيَكُمْ أَنْ يُمَدِّدَ رَبُّكُمْ بِثَلَاثَةِ آلَافٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُنَزَّلِينَ ﴿١٢٤﴾
بَلَىٰ إِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا وَيَأْتُوكُم مِّن فَوْرِهِمْ هَذَا يُمَدِّدْكُمْ رَبُّكُمْ بِخَمْسَةِ آلَافٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ

مُسَوِّمِينَ ﴿١٢٥﴾، [سورة آل عمران: 124-125]

“Atëherë ti (Muhamed) u thoshe besimtarëve: “A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë engjëj të dërguar?”. Po! Por, nëse ata ju sulmojnë, bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë do t’ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar.” [Al Imran: 124-125]

Sipas këtij mendimi, përforcimi me engjëjt nuk ka ndodhur dhe këtë për shkak të mungesës së kushteve tek besimtarët: durimit, devotshmërisë, ardhjes së shpejt të armikut. Kështu, përderisa nuk kanë ekzistuar kushtet, nuk ka ndodhur as e kushtëzuara: ardhja e engjëjve në ndihmë. Sahabet r.a. nuk kishin duruar ndaj presë së armikut dhe i kishin lëshuar pozicionet e caktuara nga

¹Shih tefsirin *En-nuket ve el-ujun* të Mavedit dhe tefsirin *Irshadu el-akli esselim ila meza ja el-Kitabi el-kerim* të Ebu Suudit, për të mësuar më shumë rreth detajeve për përgatitjen për Betejën e Uhudit, 3/121.

Mendimi i përzgjedhur për meselen në fjalë

Pejgamberi a.s, kështu që nuk i ishin përmbajtur urdhrat të Pejgamberit a.s.¹

Hoxha Ibën Uthejmini duke komentuar këtë ajet ka thënë: “Ky ajet ka të bëjë me Uhudin, jo Bedrin, sepse ajeti për Bedrin nuk lidhet me gjëra të kushtëzuara:

﴿إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَابَ لَكُمْ أَنِّي مُمِدُّكُم بِآلِفٍ مِّنَ الْمَلَائِكَةِ مُرَدِّينَ ۝﴾

سورة الأنفال: 9]

“Ju kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj: “Unë do t’ju ndihmoj me një mijë engjëj që do të vijinë njëri pas tjetrit” [Enfalë: 9]

Ky ajet (pra nga kaptina Al Imran) ka ardhur i kushtëzuar dhe përderisa kushtet nuk u plotësuan, e kushtëzuara nuk u realizua. Me fjalë tjera, myslimanët në Betejën e Uhudit nuk i përmbushën kriteret e përcaktuara nga Allahu xh.sh. që ishin: devotshmëria, durimi dhe prezenca e idhujtarëve në fushëbetejë. Kjo e fundit nënkupton se, po të kishin durim dhe besim (frikë ndaj Allahut) si dhe armiq në fushëbetejë, atëherë engjëjt do të zbritnin, ndryshe jo. Nuk ndodhi zbritja e engjëjve sepse myslimanët u fjalosën, dështuan dhe mëkatuan, kështu që nuk ishin meritore për atë që Allahu ua kishte kushtëzuar...²

Mendimi i Hoxha Uthejminut pajtohet shumë me mendimin e dijetarëve në të kaluarën si: Ibën Kethiri, Fahrudin Rrazi, Begaviu, Maverdi, Sa’di, etj³, se ndihma me engjuj nuk ka ndodhur.

Nga konteksti i ajeteve dhe analizave tona shohim se:

¹ Me fjalë të tjera, mos përmbajtja urdhrat të Pejgamberit a.s. nënkupton mungesën e devotshmërisë, që tekstualisht autori e ka përmendur si kusht të paplotësuar. Përkthyesi.

² Shih: Tefsiri i Ibën Uthejminut, 3/128.

³ Për dobi shkencore më të shumta, referojuni tefsireve të Sa’dit, Maverdit, Begaviut, Rraziut.

- 1) Ndihma hyjnore ka ndodhur dhe engjëjt kanë zbritur. Mendimi i Rrazit dhe të tjerëve se, “përderisa kanë munguar kushtet, nuk është realizuar e kushtëzuara”, me çka konstaton se engjëjt nuk kanë zbritur dhe ndihma hyjnore nuk ka ardhur, është paksa i çuditshëm kur dihet nga argumentet tjera (hadithet) se engjëjt kanë zbritur dhe se kokat e idhujtarëve fluturonin-këputeshin- në Betejën e Bedrit e po kështu edhe në atë të Uhudit. Këtë lajm e kanë përmendur edhe disa mufessirë tjerë¹.
- 2) Kurdoherë që plotësohen kushtet e kërkuara, ndihma e Zotit vjen. Pra, kurdo që *durimi, devotshmëria, vendosmëria, parapërgatitja ushtarake dhe logjistike për përballjen me armikun* ekzistojnë, ndihma e Allahut vjen. Kështu na mëson Allahu xh.sh. në Kur’an:

﴿وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهَبُونَ بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ وَعَدُوَّكُمْ
وَالْآخَرِينَ مِنْ دُونِهِمْ لَا تَعْلَمُونَهُمُ اللَّهُ يَعْلَمُهُمْ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يُوَفَّ
إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ لَا تَظْلَمُونَ﴾ [سورة الأنفال: 60]

“Përgatisni kundër tyre kuaj dhe fuqi ushtarake sa të mundeni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerët që ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.” [Enfalë: 60]

Kudo dhe kurdo që të plotësohen kriteret e lartpërmendura, ndihma e Allahut xh.sh. vjen dhe kjo nuk ka pse të ndodhë vetëm nëpërmjet engjëjve! Pra, ka dhe forma tjera se si Allahu xh.sh. i ndihmon besimtarët, siç janë rastet tek: përçarja e armiqve mes vete, luftërat e tyre te brendshme, etj, gjëra për të cilat na mëson Kur’ani:

¹Shih: Ibn Ashur, *Ettahriru ve ettenviru*, 3/124.

﴿قُلْ هُوَ الْقَادِرُ عَلَىٰ أَنْ يَبْعَثَ عَلَيْكُمْ عَذَابًا مِّنْ فَوْقِكُمْ أَوْ مِّنْ تَحْتِ أَرْجُلِكُمْ أَوْ يَلْبَسَكُمْ بِشِيْعًا

وَيُذِيقَ بَعْضَكُمْ بَأْسَ بَعْضٍ ۚ أَنْظُرْ كَيْفَ نُصَرِّفُ الْآيَاتِ لَعَلَّهُمْ يَفْقَهُونَ ﴿٦٥﴾ [الأنعام: 65]

“Thuaj: “Ai ka fuqi t’ju ndëshkojë prej së larti ose nga poshtë këmbëve tuaja, ose t’ju përçajë në grupe e të vuani nga duart e njëritjetrit. Shih si ua shpjegojmë shpalljet, që ata të mund të kuptojnë!” [En’amë: 65]

﴿وَكَلَّا أَخَذْنَا بِذُنُوبِهِ ۗ فَمِنْهُمْ مَّنْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِ حَاصِبًا وَمِنْهُمْ مَّنْ أَخَذَتْهُ الصَّيْحَةُ

وَمِنْهُمْ مَّنْ حَسَفْنَا بِهِ الْآرْضَ وَمِنْهُمْ مَّنْ أَعْرَقْنَا وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُظْلِمَهُمْ وَلَكِن كَانُوا

أَنفُسُهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٤٠﴾ [سورة العنكبوت: 40]

“Ne të gjithë i dënuam për gjynahun e vet: disa me furtunë, disa të tjerë i tronditi një zë i tmerrshëm, disa i lëshoi toka dhe të tjerët i përmyti uji. Allahu nuk u bëri atyre padrejtësi por ata vetes i bënë padrejtësi.” [Ankebut: 40]

Ushtrinë e Allahut askush nuk mund ta dijë se si është dhe cilat janë mundësitë e saj, këshillë kjo e madhe për ata që mendojnë. Ky është tefsiri ose komenti i duhur i ajetit:

﴿بَلَىٰ إِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا وَيَأْتُوكُم مِّن فَوْرِهِمْ هَذَا يُعْمِدْ كُرْبُكُمْ بِخَمْسَةِ آلَافٍ مِّنَ الْمَلَائِكَةِ

مُسَوِّمِينَ ﴿١٢٥﴾ [آل عمران: 125]

“Po! Por, nëse ata ju sulmojnë, bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë do t’ju dërgojë ndihmë pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar.” [Al-Imran: 125]

Kjo edhe për faktin se, siç thotë rregulli fetar: ‘leksioni nxirret nga përgjithësimi i tekstit, jo nga konteksti (arsyeja specifike) e tij ¹.’

¹Më gjerësisht dhe të ilustruar edhe me shembull konkretisht mund ta gjeni në fund të librit. **Përkthyesi.**

Në përmbyllje dua të citoj Imamin Tahir bin Ashur dhe shpjegimin e tij brilant, i cili pasuron mendjen dhe shëron shpirtin. Ka të bëjë pikërisht me këtë që thamë - përforcimin me engjëj në Betejën e Bedrit. Ai thotë: “Në kaptinën Enfalë, ajetin e nëntë, Allahu xh.sh. përmend përforcimin me njëmijë engjëj: “...**Unë do t’ju ndihmoj me një mijë engjëj...**”, ndërsa këtu Allahu xh.sh. iu premtonte fillimisht me tremijë e më pas me pesëmijë engjëj. Përputhja e ajeteve mund të bëhet nga aspekti se Allahu xh.sh. fillimisht u premtoi ndihmë me njëmijë engjëj, duke e lënë të hapur mundësinë edhe për engjëj të tjerë. Siç duket, numri i shumtë i armiqve i kishte frikësuar myslimanët, ndaj Pejgamberi a.s. u thoshte: “**Atëherë ti (Muhamed) u thoshe besimtarëve: “A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë engjëj të dërguar?”**.” [Al Imran: 124] Me këtë donte t’i forconte edhe më shumë. Pastaj ua premtoi edhe dymijë engjëj me kusht që të kishin durim dhe devotshmëri.

Kështu u interpretua nga xhumhuri-pjesa dërmuese e komentatorëve të kur’anit - dhe ky është konteksti i përgjithshëm i ajeteve në fjalë.

Është konfirmuar se engjëjt kanë zbritur në Betejën e Bedrit për t’i ndihmuar besimtarët. Bile disa sahabë dhe i kanë parë engjëjt derisa të tjerët kanë parë vetëm veprimet e tyre (kokat e prera të idhujtarëve)¹.


Engjëjt janë përshkruar si “**të dërguar**” për faktin se kanë zbritur në tokë, në fushëbetejë për tu kujdesur për besimtarët...²

Ky është mendimi që ka përzgjedhur Imami Tahir bin Ashuri, **të cilin ne e konsiderojmë si më të saktin dhe më të qëlluarin për çështjen në fjalë**. Allahu e di më së miri!

Në fund të kësaj njësie, në formë grafiku, mund të përmbledhim tiparet më të rëndësishme dhe të domosdoshme të liderit të guximshëm dhe motivues për ushtrinë.

¹Shih: Ibn Hisham, *Essiretu ennebevijjetu*, 2/274.

²Ibën Ashur, *Ettahriru ve ettenvair*, 11/70..



2.3. Lidershipi i Jusufit a.s. në fushën financiare

Prej shembujve të rrallë dhe të suksesshëm në menaxhimin e parasë publike dhe në ekonomi në përgjithësi është shembulli i Jusufit a.s në Kur'an nga i cili dua të shkëpus disa segmente impresionuese:

- 1) Singëriteti dhe korrektësia në jetën private dhe publike me shokët dhe shërbëtorin e mbretit në burg, aq sa fitoi titullin e nderit 'i drejti.' Këtë na e mëson Kur'ani. Allahu xh.sh. thotë:

﴿يُوسُفُ أَيُّهَا الصِّدِّيقُ أَفْتِنَا فِي سَبْعِ بَقَرَاتٍ سِمَانٍ يَأْكُلُهُنَّ سَبْعُ عِجَافٍ
وَسَبْعِ سُنبُلَاتٍ حُضِرٍ وَأَخْرَ يَا بَسَّتِ لَعَلِّي أَرْجِعُ إِلَى النَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَعْلَمُونَ

﴿سورة يوسف: ٤٦﴾

“(Shërbëtori) I tha: “O Jusuf, o njeri i drejtë! Na shpjego (ëndrrën) për shtatë lopë të majme, të cilat hahen prej shtatë lopëve të dobëta dhe për shtatë kallinj të gjelbër e shtatë tjerë të tharë, që të kthehem te njerëzit e ta dinë edhe ata”. [Jusuf: 46]

- 2) Përkujdesja për namin dhe reputacionin. Këtë mund ta mësojmë nga kërkesa e Jusufit a.s. shtruar mbretit që emri i tij të largohet nga akuzat që ishin përhapur për të dhe shkaku i të cilave qe burgosur. Kjo që njerëzit ta dinin se ai nuk ishte i padrejtë dhe që nuk kishte bërë marrëzira çfarë i mvisheshin. Këtë na e shpjegon ajeti në vijim:

﴿وَقَالَ الْمَلِكُ أَتُونِي بِهِ فَلَمَّا جَاءَهُ الرَّسُولُ قَالَ أَرْجِعْ إِلَىٰ رَبِّكَ فَسَأَلَهُ مَا بَأَلِ

السَّوَةِ الَّتِي قَطَعْنَ أَيْدِيَهُنَّ إِنَّ رَبِّي بِكَيْدِهِنَّ عَلِيمٌ ﴿٥٠﴾ [سورة يوسف: ٥٠]

“Mbreti tha: “Sillmani atë!” Kur (Jusufit) i erdhi i dërguari, ai i tha: “Kthehu te mbreti yt dhe pyete: Ç’patën ato gra që prenë

duart e veta?" Me të vërtetë, Zoti im i di dredhitë e tyre"![Jusuf: 50]

Imam Zemahsheri duke interpretuar këtë ajet, shpalos një mësim me rëndësi sa i përket ruajtjes së personalitetit, me ç'rast thotë: Mbrojtja e vetes nga akuzat e pabaza është obligim, siç është obligim për myslimanin dhe shmangia nga situatat kritike ku mund të përfshihesh pa dashje ¹.

- 3) Menaxhimi i mirë i punëve shtetërore², respektivisht planifikimi i suksesshëm i përballjes me krizën agrare, të grurit, thatësinë dhe krizat tjera të mundshme ekonomike tek banorët e Egjiptit. Elementet e suksesshme të këtij planifikimi dhe kësaj strategjie të matur burojnë nga kërkesat që Jusufi a.s. ua shtroi banorëve të Egjiptit:
- Mbjellja e vazhdueshme e grurit për shtatë vjetë,
 - Deponimi i grurit dhe ruajtja e tij në kallinj nga frika e prishjes (në rast lagështire apo prekja nga krimbat),
 - Shfrytëzimi i dyfishtë i grurit, respektivisht i kokrrave të grurit për ushqim (për njerëzit) dhe e kashtës (për kafshë),
 - Shfrytëzimi racional i grurit dhe ruajtja e tij për mbjellje në vitin pasues,
 - Mbajtja gjallë e moralit njerëzor duke u dhënë shpresë bujqërve për përfundimin e shpejtë të viteve të thatësisë dhe të ardhjes së shpejtë të kohës së begatisë.

Kjo strategji e rëndësishme nuk është vetëm materiale por dhe morale. Pra, krahas hapave të ndërmarrë për ruajtjen e grurit, Jusufi a.s. inkurajon dhe motivon shpirtërisht popullin në tejkalimin e krizës. Këta elementë të

¹ Shih: Zemahsheri, *El-keshshaf*, 1/521-522.

² Shih edhe: Ebu Hajjan, *Tefsiru el-bahri el-muhit*, 24/55.

leadershipit të suksesshëm ekonomik dhe agrar tek Jusufi a.s. i mësojmë nga ajetet në vazhdim:

﴿ قَالَ تَزْرَعُونَ سَبْعَ سِنِينَ دَأَبًا فَمَا حَصَدتُّمْ فَذَرُوهُ فِي سُنْبُلِهِ إِلَّا قَلِيلًا مِمَّا تَأْكُلُونَ ﴿٤٧﴾ ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ سَبْعٌ شِدَادٌ يَأْكُلْنَ مَا قَدَّمْتُمْ لَهُنَّ إِلَّا قَلِيلًا مِمَّا تُحْصِنُونَ ﴿٤٨﴾ ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ عَامٌ فِيهِ يُغَاثُ النَّاسُ وَفِيهِ يَعَصِرُونَ ﴿٤٩﴾﴾ [يوسف: 47-49]

“(Jusufi) tha: “Do të mbillni shtatë vjet rresht. Prodhimin që do të korrni lëreni në kallinj, përveç një pakice që do t’ju shërbejë për të ngrënë, 48. sepse pastaj do të vijjnë shtatë vite të thata, të cilat do t’i harxhojnë ato që i keni ruajtur, përveç një pakice që mund të kurseni. 49. Pastaj, pas këtyre do të vijë një vit plot shi për njerëzit, vit në të cilin ata do të shtrydhin (rrush, etj).” [Jusuf: 47-49]

- 4) Për tu siguruar se plani do të zbatohet në përpikmëri, atë nuk ia besoi askujt. Kështu që vet e mori përsipër zbatimin e tij.

Mesazhi që nxjerrim është fakti se në fenë Islame, nëse dikush e sheh veten të aftë për të marrë një detyrë a një rol të rëndësishëm në shoqëri, nuk ka asgjë të keqe, le ta kërkojë! Posti dhe përgjegjësia nuk konsiderohen ndalesa fetare, përkundrazi, janë pasqyrë e një administrate të suksesshme që krijohet nga një lider i aftë! Për të kuptuar më mirë këtë gjë, t’i referohemi ajetit në vazhdim ku Allahu xh.sh. thotë:

﴿ قَالَ أَجْعَلْنِي عَلَىٰ خَزَائِنِ الْأَرْضِ ۗ إِنِّي حَفِيظٌ عَلَيْمُ ۗ ﴿٥٥﴾﴾ [سورة يوسف: 55]

“(Jusufi) i tha: “Më cakto përgjegjës të depove të vendit, sepse unë jam ruajtës dhe njohës (i mirë i këtyre punëve).” [Jusuf: 55]

Imam Kasimiu duke e shpjeguar këtë ajet thotë:

Jusufi a.s. i tha mbretit ta caktonte mbikëqyrës të depove të tokës, pra të të gjitha të lashtave, për shkak të viteve të thata që po prisnin për të cilat ishte paralajmëruar, në mënyrë që të vepronte drejtë dhe mençur (t'i shpëtonte). Pastaj ia bëri me dije se (e kërkonte këtë gjë meqë) ishte kompetent, tha: unë jam ruajtës dhe njohës; e ruaj atë që doni ta ruani (depononi) dhe di hollësisht se si ta trajtoj (shfrytëzoj, ndaj, destinoj). Zemahsheriu ka thënë: Jusufi a.s. përmendi dy tipare të cilat mbretërit i kërkojnë nga nëpunësit e tyre: besnikërinë dhe aftësinë. Jusufi a.s. e bëri këtë kërkesë që nëpërmjet kësaj pozite të arrijë tek zbatimi i ligjeve të Allahut xh.sh, ta jetësojë të vërtetën, të vendosë rendin dhe drejtësinë, të arrijë temkinin për hir të të cilit peygamberët dërgohen tek popujt. Këtë e bëri edhe për arsye se ishte i bindur që askush nuk mund ta kryente atë detyrë më mirë se ai. Kështu, e kërkoi postin për hir të kënaqësisë së Allahut, jo për qëllime të tjera (famë, prestigj a përfitim material). Nëse pyet: si lejohet që të marrë një detyrë nga një jobesimtar, t'i raportojë dhe të jetë nën urdhrat e tij (ndërsa ai ishte peygamber), të them: Muxhahidi transmeton se mbreti e kishte pranuar Islamin. Katade thotë se ky shembull shërben si argument se njeriu (i ndershëm) lejohet të marrë një detyrë nga sundimtari i padrejtë. Të parët tanë, selefi, angazhoheshin në detyrën e gjyqësorit nga prijës dhe sundimtarë tiranë e despotë. E, nëse një peygamber ose dijetar, e di (bindet) se nuk ka rrugë tjetër për të gjykuar sipas ligjit të Zotit dhe për ta larguar padrejtësinë pos përmes temkinit të mbretit jobesimtar e moralprishur, atëherë kjo lejohet. Ky ajet shërben si argument për:

- lejimin e kërkimit të postit të gjykatësit ose posteve tjera përderisa njeriu beson se është i duhuri;
- për lejimin e marrjes së një detyre nga një prijës jobesimtar apo tiran;
- për lavdërimin e vetvetes për interesa të përgjithshme.
- për faktin se ai që merr përsipër një detyrë, duhet të jetë kompetent dhe elokuent...¹

5) Përgjegjësia individuale në realizimin e planeve, dëgjimi i kërkesave dhe halleve të njerëzve për tu bindur se realizimi i tyre do të ndodhë pa ndonjë vonesë a pengesë, si dhe konfidenca me nevojtarët për kërkesat e tyre, si tek rasti i vëllezërve të Jusufit a.s. (kur shkuan te Jusufi a.s. për të kërkuar furnizim , ushqim) shënohet si vijon nga Allahu xh.sh:

﴿وَجَاءَ إِخْوَةُ يُوسُفَ فَدَخَلُوا عَلَيْهِ فَعَرَفَهُمْ وَهُمْ لَهُ مُنْكَرَاتٌ﴾ [سورة

يوسف: 58]

“Dhe erdhën vëllezërit e Jusufit e hynë tek ai. Ai i njohu, por ata nuk e njohën.” [Jusuf: 58]

Çështje dhe norma që kanë të bëjnë me lidërsipin jusufian

Imam Kurtubiu që konsiderohet si kryeekspert në komentimin e Kur’anit, e sidomos ajeteve legjislativë rreth dispozitivave islame(çka është hallall dhe çka është haram), ka një shpjegim të hatashëm lidhur me këtë çështje. Këtë enigmë, nëse guxojmë ta quajmë kështu kërkesën e Jusufit a.s. për marrjen e postit administrativ (gjithnjë duke e krahasuar me tekstet apo hadithet që e ndalojnë një gjë të tillë), ai arrinë ta zgjidhë në mënyrë perfekte! Pas krahasimeve ndërmjet ajetit të lartpërmendur

¹ Shih: *Tefsiru el-Kaisimi*, 6/191.

(Jusuf: 58) dhe haditheve të Pejgamberit Muhammed a.s. ai vjen në konkludim se ndërmjet tyre nuk ka kundërthënie dhe se lejohet kërkimi i një pozite, nëse personi në fjalë plotëson kushtet, kriteret e kërkua. Ja çfarë thotë Imam Kurtubiu:

Në këtë ajet trajtohen katër mesele: E para...E dyta: Disa dijetarë kanë thënë: Në këtë ajet ka dëshmi për lejimin e angazhimit të njeriut të ndershëm nga njeriu i pandershëm dhe nga prijësi jobesimtar, me kusht që ta dijë se ajo që i delegohet nuk paraqet kundërshtim për të (dhe bindjet e tij), kështu që ai mundohet ta reformojë dhe rregullojë atë sa të ketë mundësi. Ndryshe, nëse angazhimi i tij është sipas përzgjedhjes së prijësit keqbërës, epsheve dhe tekave (shthurjes) të tij, atëherë nuk lejohet...E treta: Në ajet ka dëshmi për lejimin e kërkimit të një detyre nëse njeriu e sheh veten kompetent dhe të aftë. Nëse thuhet: Po në Sahihun e Muslimit në hadithin e përcjellë nga AbdurRahman bin Semure qëndron se Pejgamberi a.s. i ka thënë atij: “O Abdur-rahman, mos e kërko imaretin (pushtet, autoritet) sepse nëse të jepet sipas kërkesës sate, të ngarkohet (mbetesh pa ndihmën e Allahut xh.sh.), ndërsa nëse të ngarkohet (nga autoritetet pa e kërkuar atë) atëherë do të ndihmohesh (nga Allahu) për të (kryerjen e saj me përgjegjësi).” Përgjigja ime për këtë është kjo:

- Jusufi a.s. e kërkoi këtë pozitë me bindjen se askush më mirë se ai nuk mund të ndante drejtësi, të bënte dallimet e duhura dhe të ndihmonte fukaratë. Pra e shihte si farz ajn - detyrim të prerë. Kjo qëndron kështu edhe sot e kësaj dite. Nëse dikush e di se mund të ndajë drejtësinë dhe të gjykojë më mirë se të tjerët, apo të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, gjëra këto që askush pos tij nuk mund t'i kryejë, atëherë ai e ka detyrim të prerë që ta kërkojë dhe ta ushtrojë atë detyrë, post, me ç'rast (duke ndjekur praktikën e Jusufit a.s.) ai prezanton dhe aftësitë e veta. Në rast se ekziston dikush tjetër pos tij që mund të kryejë të njëjtën detyrë (dhe ai e di këtë), më mirë është të mos e kërkojë fare, gjithnjë sipas porosisë së Pejgamberit Muhammed a.s. për Abdur-rahmanin: “Mos e kërko imaretin!...” Këtë duhet bërë edhe për

ta edukuar nefsën sepse kërkimi dhe ambicia për një post (vështirësitë dhe problemet e të cilit dihen, sikur që dihet se nuk mund t'i shpëtohet lehtë, pa u njollosur nga padrejtësia etj.), është dëshmi se e bën për interesa dhe përfitime personale (pra nuk është kauzë por përfitim dhe interes).


- Jusufi a.s. nuk ka thënë se kishte prejardhje fisniku dhe as që ishte i pashëm dhe kishte fizik tërheqës, por tha: unë jam ruajtës dhe i ditur. Pra, e kërkoi detyrën, postin, për shkak të besnikërisë dhe të dijes-kualifikime dhe tipare speciale për lidërsip-, jo për shkak të prejardhjes dhe pamjes.
- Shpëljën e këtyre tipareve e bëri para atyre që nuk e njohnin, pra për ta prezantuar veten dhe për këtë arsye kjo nuk klasifikohet si kuptim që përfshihet në ajetin:

﴿ فَلَا تُزَكُّوا أَنْفُسَكُمْ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنِ اتَّقَى ﴾ [سورة النجم: 32]

“...Prandaj, mos u lavdëroni me pafajësinë tuaj! Ai i njeh më së miri ata që ruhen nga gjynahet.” [Nexhm: 32], dhe së fundit, Allahu e di më së miri!¹

¹ Shih: Tefsiru el-Kurtubij, 9/186.

Këtu do të mbarojmë me shembullin e lidhshimit të suksesshëm ekonomik dhe financiar të Jusufit a.s, përmbledhjen e të cilit do ta sjellim në formë grafiku:



2.4. Lidershipi *musajian* në fushën e këshillimit, konsulencës dhe motivimit

Në rrëfimin e Musait me të vëllanë, Harunin a.s, ne kemi shembullin më të mirë në fushën e lidershipit këshillues se si zgjidhet lideri apo ndihmësi (zëvendësi) i tij dhe si jepen këshillat dhe udhëzimet.

Kur'ani rrëfimin e këtyre dy vëllezërve pejgamberë e ka trajtuar detajisht në tre kaptina *A'rafë*, *Hûd* dhe *Tâha*.

Rrëfimi është ky;

Musai a.s. i kishte kërkuar Allahut xh.sh. një ndihmës nga familja, përkatësisht vëllanë Harunin a.s. për ta ndihmuar në punët e fesë dhe në punët tjera. Këtë na e rrëfen Kur'ani nëpërmjet lutjes së Musait a.s:

﴿وَجْعَلْ لِّي زَوِيْرًا مِّنْ اٰهْلِى ﴿٣٢﴾ هٰرُوْنَ اَخِيْ ﴿٣٣﴾ اَشْدَّدْ بِهٖ اَزْرِيْ ﴿٣٤﴾ وَاَشْرِكْهُ فِىْ اَمْرِىْ ﴿٣٥﴾﴾ [سورة

طه: 29-32]

“Më jep një ndihmës nga familja ime, Harunin, vëllanë tim! Ma rrit fuqinë nëpërmjet tij, dhe ma bëj bashkëpunor (ortak) në punë” [Taha: 29-32]

Allahu xh.sh. iu përgjigj lutjes së tij, ia përmbushi dëshirën dhe Harunin a.s. e bëri ndihmës të tij, pra pejgamber.

Mufessirët kanë përmendur se kur Allahu xh.sh. ua plotësoi mirësinë duke i shpëtuar nga armiku dhe duke i bërë mëkëmbës në tokë, deshi t'u dhurojë (japë) dhe një mirësi tjetër - atë të shpalljes së një libri, me ligje e norma të besimit të tyre fetar. Kështu ia caktoi Musait a.s. tridhjetë netë, të cilat i plotësoi me dhjetë të tjera për tu bërë gjithsej dyzet, në mënyrë që Musai a.s. të përgatitej për premtimin e Allahut xh.sh. që shpallja e Librit

të ishte diçka e veçantë për popullin (e Musait a.s.) dhe të ngjallte ndjenjë dashurie e malli për të. Dhe Musai a.s. shkoi për të takuar Allahun xh.sh. Nga përkushtimi dhe respekti për popullin, porositi Harunin a.s. që të ishte pasues i tij dhe të vepronte njësoj si ai, pra të ndiqte rrugën e drejtë, atë të Zotit dhe jo rrugët e gabuara¹.

Kur'ani konfirmon këtë në kaptinën *A'rafë*:

﴿وَوَعَدْنَا مُوسَىٰ ثَلَاثِينَ لَيْلَةً وَأَتَمَّمْنَا بِعَشْرِ فِتْرَةٍ مِيقَاتُ رَبِّهِ أَرْبَعِينَ لَيْلَةً وَقَالَ مُوسَىٰ لِأَخِيهِ هَارُونَ أَخْلُفْنِي فِي قَوْمِي وَأَصْلِحْ وَلَا تَتَّبِعْ سَبِيلَ الْمُفْسِدِينَ ﴿١٤٢﴾﴾ [سورة الأعراف: 142]

“Ne i premtuam Musait se do t’i flisnim pas tridhjetë netësh, të cilat ia shtuam edhe për dhjetë të tjera, kështu që takimi me Zotin e tij u bë pas dyzet netësh. Musai i tha vëllait të vet, Harunit: “Më zëvendëso te populli im, mbaj rregull dhe mos ndiq rrugën e ngatërrestarëve!” [A’rafë: 142]

Ashtu ndodhi. Allahu xh.sh. e nderoi Musanë a.s. dhe i foli atij ashtu siç e udhëzoi madhëria e Allahut xh.sh. Këtë na e rrëfejnë dy ajetet në vazhdim:

﴿وَلَمَّا جَاءَ مُوسَىٰ لِمِيقَاتِنَا وَكَلَّمَهُ رَبُّهُ قَالَ رَبِّ أَرِنِي وَلَئِن لَّن تَرِنِي وَلَئِن أَنظُرَ إِلَى الْجَبَلِ فَإِنِ اسْتَقَرَّ مَكَانَهُ فَسَوْفَ تَرِنِي فَلَمَّا تَجَلَّىٰ رَبُّهُ لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ دَكًّا وَخَرَّ مُوسَىٰ صَبُعًا فَلَمَّا آفَاقَ قَالَ سُبْحَانَكَ تُبْتُ إِلَيْكَ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٤٣﴾﴾ [سورة الأعراف: 143]

“Pasi erdhi në kohë të caktuar te Zoti, Musai a.s. tha: “O Zoti im, shfaqu të Të shoh” Zoti tha: “Ti nuk mund të më shohësh! Por shiko në atë mal: nëse ai mbetet në vendin e vet, atëherë ti do të më shohësh Mua”. E kur Zoti i tij iu shfaq malit, e thërrmoi atë dhe e bëri pluhur- e bëri rrafsh me tokë - ndërsa Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, ai

¹ Shih: *Tefsiru es-Sa’dij*, 1/587.

tha: "I lavdëruar qofsh Ti o Zot! Kthehem tek Ti i penduar. Unë jam i pari i besimtarëve!" [A'rafë: 143]

﴿وَرُسُلًا قَدْ قَصَصْنَاهُمْ عَلَيْكَ مِنْ قَبْلُ وَرُسُلًا لَمْ نَقْصُصْهُمْ عَلَيْكَ وَكَلَّمَ اللَّهُ مُوسَى

تَكْوِيمًا ﴿١٦٤﴾ [سورة النساء: 164]

"Për disa të dërguar të kemi treguar më parë dhe për disa të tjerë nuk të kemi treguar. Sa për Musain, Allahu i ka folur atij drejtpërdrejtë." [Nisa: 164]

Detaje të këtij bashkëbisedimi të Allahut xh.sh. me Musanë a.s. janë shpalosur edhe në kaptinat *Kasas*, *Tâha* dhe *Nâziat*. Kjo është një e vërtetë Kur'anore me peshë të madhe historike.

Ana argumentuese në rrëfim qëndron në faktin se, megjithëse Haruni a.s. ishte peygamber, Musai a.s. e këshilloi dhe e urdhëroi si të vepronte, si të menaxhonte punët në mungesë të tij. Dhe këtë e bëri për këto arsye:

- Myslimani për myslimanin është këshillues besnik, ndërsa këshilla është obligim ndërmjet myslimanëve.
- Musai a.s. kishte përvojë me izraelitët, i njihte ata në karakter prandaj dhe porositi Harunin a.s. që të mos binte në grackën e tyre, të shmangte rrugën e keqbërësve.

Nga ana tjetër, Haruni a.s. nuk e refuzoi këshillën, përkundrazi, e pranoi me dashamirësi sepse këshillat e mira i refuzojnë vetëm shpirtrat e liq, mendjemëdhenjtë dhe fodullët me komplekse.

Musai a.s. në këshillën e vet, me pak fjalë arriti efektin maksimal në atë që konsiderohet bosht i pushtetit dhe ajkë e këshillës, sepse u përqëndrua tek dy gjëra me rëndësi:

- 1) Mbajtja e rregullit dhe disiplinës, dhe
- 2) Shmangia nga rruga e ngatërrestarëve dhe keqbërësve.

Shkuarja e Musait a.s. për ta takuar Allahun xh.sh. dhe kalimi i kompetencave tek i vëllai, Haruni a.s. konsiderohet autorizim i

plotë për të ushtruar detyrën e liderit me të gjitha të drejtat dhe kompetencat në mungesë. Natyrshëm, ka qenë e drejtë e Harunit a.s. që të ushtronte çdo të drejtë dhe të ndërmernte çdo hap në ruajtjen e rendit dhe të harmonisë.

Herezia e izraelitëve që shprehej me adhurim të viçit ishte rezultat i mungesës së një lideri kryesor orientues apo dhe i një zëvendësi.

Haruni a.s. ose siç po shprehemi me terma të fushës që po trajtojmë - lideri kryesor, për të mbajtur rendin dhe për të mos ndjekur rrugën e ngatërrestarëve, nuk ndërmerr asgjë, saktësisht nuk përdor forcë. Në vend të forcës ai pret kthimin e liderit, sepse sipas tij ky ishte veprimi më i mirë në atë situatë. Indiferenca e tij nuk nënkupton pajtim me izraelitët! Zoti mos e dhëntë! Haruni a.s. ishte përpjekur maksimalisht që t'i ndalonte, duke i paralajmëruar se ajo që po bënin ishte mëkat i madh, por siç dihet historikisht për hebrejtë (ata janë popull temperament dhe nxitës konfliktesh), ata nuk e dëgjuan. Bile, shpërfillja ishte aq e madhe sa deshën dhe ta vrisnin! Kur'ani na shpalosë këtë skenë të dhimbshme mes Musait dhe Harunit a.s. dhe veprimin makabër të hebrejëve:

﴿وَلَمَّا رَجَعَ مُوسَىٰ إِلَىٰ قَوْمِهِ غَضْبَانَ أَسِفًا قَالَ بِئْسَمَا خَلَفْتُمُونِي مِنْ بَعْدِي ۖ أَتَعْلَمُونَ أَمْرَ رَبِّكُمْ ۖ وَأَلْقَى الْأَلْوَاحَ وَأَخَذَ بِرَأْسِ أَخِيهِ يَجُرُّهُ إِلَيْهِ ۚ قَالَ ابْنَ أُمَّ إِنَّ الْقَوْمَ اسْتَضَعَفُونِي وَكَادُوا يَقْتُلُونِي ۖ فَلَا تُشْمِتْ بِيَ الْأَعْدَاءَ وَلَا تَجْعَلْنِي مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿١٥٠﴾ [سورة الأعراف: 150]

“Kur Musai u kthye te populli i tij plotë zemërim e pikëllim, tha: “Shumë e keqe është ajo që bëtë pas ikjes sime! A mos deshët të shpejtonit ndëshkimin e Zotit tuaj?” Pastaj i hodhi pllakat dhe duke e kapur të vëllanë për koke, e tërhoqi drejt vetes. Haruni i tha: “O djali i nënës sime! Këta njerëz më quajtën të dobët dhe gati më mbytën! Mos

më turpëro më shumë para tyre, para armiqve, dhe mos më trajto si keqbërës!''. [A'rafë: 150]

Musai a.s. ia përmendi të drejtat në mënyrë të tërthortë, që nënkuptonte mes tjerash se ai kishte dhe të drejtën që të ushtronte forcë po të ish nevoja, për të parandaluar çdo gjë të keqe. Duke konsideruar se ai nuk e kishte kryer detyrën siç duhej dhe i pakënaqur nga mënyra e reagimit të Harunit a.s, Musai a.s. kishte vendosur ta qortonte të vëllanë për veprimet e padrejta të izraelitëve dhe për kaosin e plotë të shkaktuar, që ishte tërësisht në kundërshtim me porosinë paraprake - për të bërë *islah* (mbajtur rregullin) në tokë.

Mufessirët e kanë trajtuar këtë ngjarje (të këtyre dy Pejgamberëve të nderuar), në mënyra të ndryshme. Ne do të përzgjedhim atë të komentatorit të njohur Reshid Rida, në *Tefsiru el- Menar*, ku në mes tjerash thekson: *“Kuptimi i ajetit është: O vëlla, mos u ngut për t’me qortuar ashpër sepse unë nuk jam kursyer nga asnjë lloj munde për ta këshilluar popullin dhe për t’i ndaluar nga e keqja. Ata më nënçmuan, më shpërfillën dhe nuk iu bindën këshillave dhe urdhërave të mia. Madje tentuan edhe të më vrisnin! Prandaj mos më poshtëro në praninë e tyre dhe mos më trajto njësoj me të padrejtët. Pra, mos i bëj armiq të qeshin me ne dhe mos më rreshto përkrah atyre (të padrejtëve) që adhurojnë vëcin sepse unë nuk kam asgjë të përbashkët me ta!..., Kaq sa i përket vendosmërisë dhe qëndrimeve. Ky është qëndrimi unanim i dijetarëve të fesë sonë dhe të ithtarëve të Librit¹.*

Ajo që do të shtonim këtu është se, në rast se lideri kryesor, zyrtarisht lë ndonjë zëvendës, atëherë ai duhet ose t’ia delegojë kompetencat e plota ose pjesërisht, varësisht nga rrethanat dhe interesi, ndërsa zëvendësi duhet të ndihet i lirë në zgjidhjen e problemeve ekzistuese. Njëherit vendimet duhet ti marrë

¹ Shih: *Tefsiru el-Menar*, 9/178.

konform unitetit, besës dhe mbështetjes nga lideri kryesor. Ndryshe, çfarë dobie do të kishte emërimi i tij si zëvendës? Nëse zëvendësi më pas gabon, lideri kryesor nuk duhet ta qortojë!

Disa mufessirë kanë parë një dozë paksa të tepruar të qortimit të Harunit a.s. nga Musai a.s. sepse Haruni a.s. nuk ishte distancuar nga detyra dhe nuk e kishte shpërfillur besën e dhënë. Ai kishte bërë çmos që të ndalonte të keqen, madje duke e rrezikuar dhe jetën. Veprimet e tij qenë konform rastit dhe rrethanave. Atij nuk i kishte shkuar ndërmend që të ngjitej në kodër dhe ta informonte Musanë a.s. se një pjesë e izraelitëve kishin qenë idhujtarë (adhurues të viçit). Ky veprim i Harunit a.s. që dëshmon pafajsinë e tij – e zëvendësit të liderit - e shtyri Musanë a.s. që të pendohej dhe të pranonte se sjellja e tij qe paksa e ashpër me të vëllanë dhe se ishte nxituar para Allahut xh.sh. kur kishte hedhur pllakat, ndaj dhe u lut për falje dhe mëshirë për veten dhe për Harunin a.s.:

﴿ قَالَ رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِإِخِي وَأَدْخِلْنَا فِي رَحْمَتِكَ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ﴾ [سورة الأعراف:

[151

“Musai u lut: “O Zot! Më fal mua dhe vëllanë tim dhe na prano në mëshirën Tënde! Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve”. [A’rafë: 151]

Reshid Rida, duke interpretuar këtë ajet, thotë: “[Më fal] për fjalët dhe veprimet e mia të ashpra në raport me Harunin! [Fale atë] për lëshimin që ka bërë në mos vërejtjen dhënë popullit nga frika e keqtrajtimit dhe vrasjes që mund t’ia bënin. [Na fut edhe neve në mëshirën Tënde] ku përfshihet çdo gjë, na mbulo me të. Kjo formë e shprehjes “na fut në mëshirën Tënde!” është më domethënëse se shprehja “na mëshiro!” Sepse [Ti je Mëshirues më i madh] thurje e laudit për Zotin dhe shprehje shtesë e besimit në Zotin dhe në faljen e Tij. Lutja në këtë rast qetëson më shumë Harunin a.s. sesa kërkimfalja, sikur që shuan më shumë dhe shpresën e dashakëqijve dhe të armiqve që mezi prisnin të shihnin të keqen që do të ndodhte mes dy vëllezërve.

Zemahsheriu ka thënë: Musai a.s. është lutur që në një anë të kënaqë vëllanë dhe në anën tjetër të shfaq para armiqve respektin ndaj vëllait. Kërkoj falje për vete për sjelljen jo të mirë me të vëllanë dhe kërkoj falje për të vëllanë për mangësitë në kryerjen e detyrës si zëvendës. Kërkuan që të mbesin përherë nën mëshirën e Allahut, në dynja dhe në ahiret!...¹”

Këto që i ndodhën Musait a.s.; ashpërsia, zemërimi, gabimi në gjykim (në çështje jofetare) mund t'i ndodhin çdokujt, është njerëzore. Pra, shkalla e lartë e dijes (inteligjenca) nuk është garancë e pagabueshmërisë! Në këto çështje (që kanë të bëjnë me gjykime e vlerësime personale) mund të gabojnë edhe pejgamberët por në rastin e tyre ndërhyjnë *vahji-shpallja qiellore* për t'i korriguar ata (nëse gabojnë në çështje fetare).

Pra gabojmë sepse si njerëz, nuk jemi të përsosur. Por ajo që duhet ta bëjmë si njerëz, kushdo qofshim: *mbret, president, emir, komandant, drejtor, baba, bashkëshort...* është t'i kthehemi rrugës së vërtetë dhe të mos të vazhdojmë në rrugën e gabuar! dhe *Allahu e di më së miri!*

Këtë mund ta përmbledhim figurativisht në grafikun:

¹ Shih: *Tefsiru el-Menar*, 9/178.

Emërimi i Harunit a.s., në detyrën e zëvendësit të Musait a.s.

Izraelitët u larguan nga besimi dhe adhuruan viçin

Musai a.s., kërkoi nga Haruni a.s. ruajtjen e rendit dhe rregullit

Kërkoi po kështu të mos ndiqte rrugën e ngatërrestarëve

Haruni a.s. kuptoi se delegimi i kompetencave ishte bërë në tërësi

Haruni a.s. nuk shpërfilli detyrën dhe as që u kursye nga munda për t'i rregulluar punët

Musai a.s. qortoi të vëllanë duke menduar se ai kishte shpërfillur porositë e tij për mbajtje të rendit dhe për mos ndjekje të hapave të keqbërësve

Rezultati:
lidershipi musajian është dalluar për ashpërsi

Kur'ani na ofron dhe një model tjetër të lidërshiptit - musajian sa i përket nxitjes dhe motivimit të ushtarëve për të qëndruar të pathyeshëm përballë armikut, deri në fitore.

Musai a.s. që ishte peygamber por njëherit dhe komandant i ushtrisë popullore, bashkëndjente me dhimbjet e njerëzve, me hallet dhe brengat e tyre, u jepte zemër dhe kurajë dhe i përgëzonte për fitore të premtuar nga Allahu xh.sh. Ushtrisë së vet i thoshte të hynte në *tokën e shenjtë* - Kudsi (sot Palestina e okupuar). Kur'ani na përcjellë këtë mesazh nga ky rrëfim:

﴿يَقُولُوا ادْخُلُوا الْأَرْضَ الْمُقَدَّسَةَ الَّتِي كَتَبَ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَرْتَدُّوا عَلَىٰ أَدْبَارِكُمْ

فَسَتَقْبَلُوا خَيْرِينَ ﴿٢١﴾ [سورة المائدة: ٢١]

“O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë që Allahu e ka caktuar për ju dhe mos u zbrapsni sepse atëherë do të ktheheni të humbur!” [Maide: 21]

Ajeti shpalos rëndësinë që kanë rekomandimet dhe motivacioni. Musai a.s. ua bëri të qartë fitoren e shpejtë sepse Allahu xh.sh. ua kishte premtuar *tokën e shenjtë*, dhe kjo do të ndodhte, padyshim.

Imam Alusi duke interpretuar këtë ajet, thotë:

[**O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë...**]: thirrja (o populli im) është përsëritur (edhe këtu, si në ajetin paraprak) duke ia shtuar edhe atributin personal (populli im) për nder dhe respekt, për të shtuar kështu vlerësimin për ta dhe për t'i inkurajuar.

[**...në Tokën e shenjtë...**]: toka e shenjtë, siç interpretohet nga Ibn Abbasi r.a, Suddiu dhe Ibn Zejdi, është Kudsi. Ndërsa Zuxhaxhi mendon se është Damasku, Palestina dhe Jordania (e sotme). Është quajtur tokë e shenjtë për arsye se është e pastër nga shirku. Ajo tokë ka qenë vendbanimi i shumë Pejgamberëve. Apo është e shenjtë dhe sepse është e pastër nga sëmundjet. Pushtimi i saj nga tiranët nuk ia

zbeh shenjtërinë. Ka edhe mendime të tjera përse është quajtur e shenjtë. Disa konsideronin që këtë vend asnjëherë nuk e godet thatësia dhe uria apo sepse është vendi ku ndodhë shenjtërimi (pastrimi nga mëkatet).

[...Allahu e ka caktuar për ju...]: jua ka caktuar apo ndarë, apo e ka shkruar në Leuhi Mahfudh se ajo tokë do të jetë vendbanimi juaj¹.

Edhe në këtë ajet shprehet nevoja për një lidership udhëzues dhe motivues për ushtrinë, për ndarjen e problemeve dhe brengave të përbashkëta, pjesëmarrjes aktive të komandantit në luftë dhe stimulimit deri në fitore. Kësaj i nënshtrohen të gjithë ata që Allahu xh.sh. i ngarkon me ndonjë përgjegjësi shoqërore.

Në kuptimin kohor, nëse këtë dispozitë e transferojmë në ditët e sotme, kjo vlenë për presidentët e shteteve, komandantët ushtarakë, prindërit karshi fëmijëve, familjet në përgjithsi, drejtorët përballë punëtorëve, profesorët kundruall studentëve, dekanët me stafin akademik e kështu me radhë. Në fund, *Allahu e di më së miri!*

Në përmbyllje të modelit musajian të lidershipit **këshillues dhe motivues**, nga rrëfimi i Musait a.s. me të vëllanë Harunin a.s. dhe popullin e tyre, do të donim të nënvizonim disa mësimë bazë, si vlerë e shtuar.

¹ Shih: *Tefsiru el-Imam el-Alusi*, 6/106.

Mësime të përfituara nga lidershipi i Musait a.s.

- *Lideri (komanadanti) duhet të njohë moralin dhe karakterin e atyre që i udhëheqë, në mënyrë që ti ketë parasysh pritjet (pra të jetë vigjilent, syçelë, që të mos tradhëtohet).*
- *Këshilla nuk i jepet vetëm injorantit. Çdokush tjetër madje edhe Haruni a.s. që ishte pejgamber, pranon këshilla (për të parandaluar rrugën nga nuk shkohet, atë të keqbërësve).*
- *Komandanti duhet të jetë i butë dhe i mëshirshëm me ushtrinë, veçmas me bashkëatdhetarët. Ai duhet të punojë me përkushtim të plotë në interesin dhe mirëqenien e tyre. Haruni a.s. vetëm nga mëshira që pati për popullin dhe nga frika e përçarjes së mundshme, zgjodhi të mos përdorte forcën për ta shuar ngatërresën (fitnen) e adhuruesve të vëçit.*
- *Marrja e vendimeve të prera dhe të rëndësisë së veçantë duhet të bëhet nga lideri kryesor, jo nga zëvendësi i tij.*
- *Pozita e nënës është e veçantë në zemrat e besimtarëve. Haruni a.s. u mundua të qetësonte Musanë a.s. duke ia kujtuar se ishin bijtë e një nëne.*

2.5. Lidershipi mbretëror në Kur'an: shembujt e Sulejmanit a.s, Belkizës dhe mbretit Talut

Lidershipi mbretëror i Sulejmanit a.s, peygamber dhe mbret njëkohësisht, bashkë me Belkisën, përmendet në kaptinën *Neml* në ajete të cilat lexohen deri në Ditën e Kiametit, ndërsa lidershipi mbretëror i Talutit me izraelitët në kaptinën *Bekare*.

Për një imazh sa më të qartë të këtyre lidershipeve, do të shpalosim fillimisht kuptimet e përgjithshme të këtyre ajeteve Kur'anore, për të kaluar tek shpjegimet e dijetarëve dhe mësimet që përfitojmë prej tyre (në të gjitha fushat; politike, ekonomike, ushtarake, të sigurisë, etj).

Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَلَقَدْ آتَيْنَا دَاوُدَ وَسُلَيْمَانَ عِلْمًا وَقَالَا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي فَضَّلَنَا عَلَى كَثِيرٍ مِّنْ عِبَادِهِ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٧٠﴾ وَوَرِثَ سُلَيْمَانُ دَاوُدَ وَقَالَ يَا أَيُّهَا النَّاسُ عُلِّمْنَا مَنْطِقَ الطَّيْرِ وَأُوتِينَا مِنْ كُلِّ شَيْءٍ إِنَّ هَذَا لَهُوَ الْفَضْلُ الْمُبِينُ ﴿١٧١﴾ وَحِشْرَ لِسُلَيْمَانَ جُنُودَهُ مِنَ الْجِنِّ وَالْإِنْسِ وَالطَّيْرِ فَهُمْ يُوزَعُونَ ﴿١٧٢﴾ حَتَّىٰ إِذَا أَتَوْا عَلَىٰ وَادِ النَّمْلِ قَالَتْ نَمَلَةٌ يَا أَيُّهَا النَّمْلُ ادْخُلُوا مَسَاجِدَكُمْ لَا يُخَاطَبُكُمْ سُلَيْمَانُ وَجُنُودُهُ وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ﴿١٧٣﴾ فَتَبَسَّمَ ضَاحِكًا مِّن قَوْلِهَا وَقَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَىٰ وَالِدِي وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَدْخِلْنِي بِرَحْمَتِكَ فِي عِبَادِكَ الصَّالِحِينَ ﴿١٧٤﴾ وَتَفَقَّدَ الطَّيْرَ فَقَالَ مَا لِيَ لَا أَرَى الْهُدْهَدَ أَمْ كَانَ مِنَ الْغَائِبِينَ ﴿١٧٥﴾ لَأُعَذِّبَنَّهُ عَذَابًا شَدِيدًا أَوْ لَأَذْبَحَنَّهُ أَوْ لَيَأْتِيَنِّي بِسُلْطَنِ مُّبِينٍ ﴿١٧٦﴾ فَمَكَتْ عَيْرٌ بِعِيدٍ فَقَالَ أَحَطْتُ بِمَا لَمْ نَحِطُ بِهِ وَحِجَّتِكَ مِن سَبِيلٍ بِنْتًا يَفِيرُ ﴿١٧٧﴾ إِنِّي وَجَدْتُ أَمْرًا تَمَلِكُهُمْ وَأُوتِيَتْ مِن كُلِّ شَيْءٍ وَلَهَا عَرْشٌ عَظِيمٌ ﴿١٧٨﴾ وَجَدْتَهَا وَقَوْمَهَا بِسُجُودٍ لِلشَّمْسِ مِن دُونِ اللَّهِ وَرَبَّنَّ لَهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَلُهُمْ فَصَدَّهُمْ عَنِ السَّبِيلِ فَهُمْ لَا يَهْتَدُونَ ﴿١٧٩﴾ أَلَا يَسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي يُخْرِجُ

الْحَبَاءَ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَعْلَمُ مَا تُخْفُونَ وَمَا تُعْلِنُونَ ﴿١٥﴾ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ رَبُّ
الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴿١٦﴾ * قَالَ سَنَنْظُرُ أَصَدَقْتَ أَمْ كُنْتَ مِنَ الْكَاذِبِينَ ﴿١٧﴾ أَذْهَبَ بِكِتَابِي
هَذَا فَأَلْقَاهُ إِلَيْهِمْ ثُمَّ نَوَّلَ عَنْهُمْ فَأَنْظُرْ مَاذَا يَجْعُونَ ﴿١٨﴾ قَالَتْ يَتَأْتِيَهَا الْمَلَأُؤُا إِنِّي أَلْقِي إِلَيْكَ كِتَابًا
كَرِيمًا ﴿١٩﴾ إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿٢٠﴾ أَلَا تَعْلَمُونَ عَلَيَّ وَأُنُوفِي مُسْلِمِينَ ﴿٢١﴾
قَالَتْ يَتَأْتِيَهَا الْمَلَأُؤُا أَقْتُونِي فِي أَمْرِي مَا كُنْتُ قَاطِعَةً أَمْرًا حَتَّى تَشْهَدُونِ ﴿٢٢﴾ قَالُوا نَحْنُ أَوْلُوا قُوَّةٍ
وَأَوْلُوا بِأَسِ شَدِيدٍ وَالْأَمْرُ إِلَيْكِ فَانظُرِي مَاذَا تَأْمُرِينَ ﴿٢٣﴾ قَالَتْ إِنَّ الْمُلُوكَ إِذَا دَخَلُوا قَرْيَةً
أَفْسَدُوهَا وَجَعَلُوا أَعِزَّةَ أَهْلِهَا أَذِلَّةً وَكَذَلِكَ يَفْعَلُونَ ﴿٢٤﴾ وَإِنِّي مُرْسِلَةٌ إِلَيْهِمْ بِهَدِيَّةٍ فَنَاظِرَةٌ
بِعَرَبِ الْجَبَلِ الْمُرْسَلُونَ ﴿٢٥﴾ فَلَمَّا جَاءَ سُلَيْمَانَ قَالَ أَتُمِدُّونَ بِمَالٍ فِيمَا أَتَيْنَاهُ اللَّهُ خَبِيرٌ وَمَا آتَاكُمْ
بَلْ أَنْتُمْ بِهَدْيِكُمْ تَفْرَحُونَ ﴿٢٦﴾ أُرْجِعْ إِلَيْهِمْ فَلَنَأْتِيَنَّهُمْ بِجُنُودٍ لَّا قِيلَ لَهُمْ بِهَا وَلَنُخْرِجَنَّهُمْ مِنْهَا
أَذِلَّةً وَهُمْ صَاغِرُونَ ﴿٢٧﴾ قَالَ يَتَأْتِيَهَا الْمَلَأُؤُا أَيُّكُمْ يَأْتِينِي بِعَرْشِهَا قَبْلَ أَنْ يَأْتُونِي مُسْلِمِينَ ﴿٢٨﴾ قَالَ عِفْرِيَّتُ
مِنَ الْجِنِّ أَنَا آتِيكِ بِهِ قَبْلَ أَنْ تَقُومَ مِنْ مَقَامِكَ وَإِنِّي عَلَيْهِ لَقَوِيٌّ أَمِينٌ ﴿٢٩﴾ قَالَ الَّذِي عِنْدَهُ عِلْمٌ
مِّنَ الْكِتَابِ أَنَا آتِيكِ بِهِ قَبْلَ أَنْ يَرْتَدَّ إِلَيْكَ طَرْفُكَ فَلَمَّا رآه مُسْتَقِرًّا عِنْدَهُ قَالَ هَذَا مِنْ فَضْلِ
رَبِّي لَيْسَ لِي بِهِ شُكْرٌ أَمْ أَكْفُرُ وَمَنْ شَكَرَ فَإِنَّمَا يَشْكُرُ لِنَفْسِهِ وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ رَبِّي غَنِيٌّ كَرِيمٌ ﴿٣٠﴾ قَالَ
نَكِّرُوا لَهَا عَرْشَهَا نَنْظُرْ أَتَهْتَدِي أَمْ تَكُونُ مِنَ الَّذِينَ لَا يَهْتَدُونَ ﴿٣١﴾ فَلَمَّا جَاءَتْ قِيلَ أَهَكَذَا
عَرْشُكَ قَالَتْ كَأَنَّهُ هُوَ وَأُوَيْدَتَا الْعِلْمَ مِنْ قِبَلِهَا وَكُنَّا مُسْلِمِينَ ﴿٣٢﴾ وَصَدَّهَا مَا كَانَتْ تَعْبُدُ مِنْ دُونِ اللَّهِ
إِنَّهَا كَانَتْ مِنْ قَوْمٍ كَافِرِينَ ﴿٣٣﴾ قِيلَ لَهَا ادْخُلِي الصَّرْحَ فَلَمَّا رَأَتْهُ حَسِبَتْهُ لُجَّةً وَكَشَفَتْ عَن سَاقِيهَا
قَالَ إِنَّهُ صَرْحٌ مُّمَرَّدٌ مِّن قَوَارِيرٍ قَالَتْ رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي وَأَسَأَمْتُ مَعَ سُلَيْمَانَ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

﴿٤٤﴾ [سورة النمل: ١٥ - ٤٤]

“Ne i dhamë Daudit dhe Sulejmanit dituri dhe ata thanë: “Qoftë
lavdëruar Allahu që na ka ngritur mbi shumicën e robërve të Tij
besimtarë! 16. Sulejmani e trashëgoi Daudin (në misionin e tij profetik)
dhe tha: “O populli im! Neve na është mësuar gjuha e shpendëve dhe
na është dhënë gjithçka. Kjo është vërtet dhunti e madhe” 17. Para

Sulejmanit u tubua ushtria e Tij e përbërë prej xhindeve, njerëzve dhe shpendëve, të gjithë të radhitur në çeta të gatshme. 18. Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: “O milingona, hyni në banesat tuaja, që t’mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!” 19. Ai vuri buzën në gaz, duke qeshur me fjalët e saj dhe tha: “O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!” 20. Ai bëri kontrollin e shpendëve e tha: “Pse nuk e shoh pupëzën këtu, a nuk është e pranishme ajo? 21. Nëse nuk do të më sjellë arsyetim bindës, do ta dënoj me dënim të rëndë ose do ta therr!” 22. Nuk vonoi shumë dhe ajo erdhi e tha: “Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur dhe të kam sjellë lajme të vërteta prej (qytetit të) Sebës. 23. Kam parë një grua që sundonte popullin (e atij qyteti). Ajo zotëronte çdo gjë dhe kishte një fron madhështor. 24. Kam parë se ajo dhe populli i saj adhuronin Diellin e jo Allahun. Djalli ua paraqiste të bukura sjelljet e tyre, duke i larguar nga rruga e drejtë, prandaj nuk ishin të udhëzuar. 25. Ata nuk i përuleshin në sexhde Allahut, i Cili nxjerr gjithçka që është e fshehur në qiej dhe në Tokë dhe di çfarë fshihni ju dhe çfarë tregoni haptazi. 26. Allahu është Një, s’ka zot tjetër pos Tij, Zotit të Arshit të madh!” 27. Sulejmani tha: “Do të shohim nëse thua të vërtetën apo gënjeshtren. 28. Shko me këtë letër timen e çojua atyre. Pastaj largohu pak nga ata dhe shiko cila do të jetë përgjigjja e tyre!” 29. Mbretëresha (e Shebës) tha: “O paria ime! Mua më ka ardhur një letër fisnike. 30. Ajo është nga Sulejmani dhe është: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! 31. Mos u madhështoni para meje dhe ejani të përulur si besimtarë!” 32. Ajo tha: “O paria ime, më këshilloni ç’duhet të bëj në këtë çështje! Unë nuk vendos asgjë pa ju!” 33. Ata thanë: “Ne jemi shumë të fortë dhe luftëtarë të guximshëm, por urdhëri të takon ty, ndaj mendo mirë se ç’do të urdhërosh!” 34. Ajo tha: “Njëmend, kur mbretërit pushtojnë ndonjë vendbanim, e rrënojnë atë dhe e poshtërojnë parinë e tij. Kështu veprojnë ata. 35. Tani do t’u dërgoj atyre një dhuratë dhe do të shoh me

çka do të kthehen të deleguarit.” 36. Kur erdhën (të deleguarit), Sulejmani tha: “A mos doni të më ndihmoni me pasuri?! Ajo që më ka dhënë Allahu, është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve. Por ju gëzoheni me dhuratën tuaj. 37. Kthehuni tek ata! Ne do të sjellim ushtri, të cilën nuk do të mund ta përballojnë ata dhe me siguri, do t’i dëbojmë ata prej Shebës, të poshtëruar dhe të përulur”. 38. Pastaj ai tha: “O parësi, kush prej jush do të më sjellë fronin e saj, para se ata të vijnë të dorëzuar?” 39. Njëri nga xhindet, Ifriti, tha: “Unë do të ta sjell ty para se të ngrihesh nga vendi; unë për këtë jam i fortë dhe i sigurtë”. 40. Po ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: “Unë do të ta sjell ty sa çel e mshel sytë”. Kur (Sulejmani) e pa të vendosur para tij, tha: “Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për t’më provuar në jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues. 41. Ndryshojeni edhe fronin e saj! Do të shohim se a do ta vërejë ajo këtë gjë.” 42. Kur erdhi ajo, i thanë: “I tillë është froni yt?” Ajo u përgjigj: “Duket si ai”. Sulejmani tha: “Para saj na është dhënë dituria dhe para saj i jemi nënshtruar Allahut”. 43. Atë (Belkisën) e kishte penguar (nga Islami) ajo që adhuronte në vend të Allahut, sepse ajo ishte nga populli mohues. 44. Asaj i thanë të hynte në pallat. Kur e pa atë, ajo kujtoi se ishte ujë i thellë dhe përvoli fustanin te këmbët. Sulejmani i tha: “Ky pallat është i shtruar me xhama”. Ajo tha: “O Zoti im, me të vërtetë unë e paskam dëmtuar veten dhe tani, bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve!” [Kur’ani: Neml: 15-44]

2.5.1. Komentimi i përgjithshëm i ajeteve, sepse gjykimi i drejtë për diçka rrjedh nga perceptimi i drejtë për të

*Në dynja tefsire ka shumë,
por, betohem, si Dhilali¹ janë pak,
Nëse je duke kërkuar hije e freski,
Merre Dhilalin dhe mos iu ndajë atij!²*

Siç e dinë studiuesit fetarë, secili mufessir ka metodologjinë personale që ndjekë gjatë komentimit të Kur'anit. Duke marrë në konsideratë hapsirën e gjatë kohore³ të punës sonë që i dhamë tefsirit të prof. Sejjid Kutubit *Fi dhilali el-Kur'an*, veçojmë si referencë këtë mesele për disa arsye:

- ✓ Vlerësimet objektive për personalitetin e dëshmuar të Kutubit prej një mufessiri, elokuenti, intelektualit të madh, thirrësi të mufessirëve داعية المفسرين dhe, mufessiri të thirrësve مفسر الدعاء
- ✓ Fakti se Kutubi paraqet qendrën referuese sa i përket metodologjisë dinamike, aktuale dhe gjithëpërfshirëse në komentimin e ajeteve Kur'anore për të vepruar sipas tyre dhe për të ftuar në to. Tefsiri i Kutubit trajton aspektin

¹*Dhilali*: Tefsiri i Sejjid Kutubit (*Fi Dhilal el- Kur'an*)

² Autori ka një simpati të madhe ndaj Sejjid Kutubit dhe veprave të tij, të cilat i ka trajtuar edhe në punime shkencore. Për ta dëshmuar dashurinë por edhe vlerën e tefsirit të Sejjid Kutubit, ka thurur këto vargje, të ngjashme me ato që Zemahsheri kishte thurur për tefsirin e vet, Keshshafin:

*Në dynja tefsire ka shumë,
Por asnjë sikur Keshafi im nuk është,
Nëse kërkon udhëzimin, lexoje atë rregullisht*

sepse injoranca është si sëmundja ndërsa ilaçi është Keshafi im. Përkthyesi.

³ Në M.A., seminare ndërkombëtare, punime shkencore etj, që nga viti 1997-2021

doktrinar, davetik (misionar), moral, etik, ekonomik, politik, intelektual, kulturor dhe mbi të gjitha, ndjek metodologjinë mesatare duke ikur nga ekstremet çfarëdo lloj qofshin.

- ✓ Tefsiri i tij ka një ndikim të madh tek njerëzit gjë kjo influencë është dëshmuar nga ata që e kanë lexuar dhe e kanë kuptuar drejtë. Duke lexuar atë ke ndjesinë që je, jo para një libri por para një ngjarje të vërtetë, detajet e së cilës shpalosen para teje një nga një, si në një film a skenë, ku pushtohesh tërësisht nga e vërteta fizike dhe ajo shpirtërore ndërsa percepton edhe veten tënde si një pjesë të gjithë asaj! Allahu e di më së miri!

Që tiparet e lidërshiptit të jenë të qarta dhe të dukshëm nga rrëfimi i Sulejmanit a.s, Belkisës dhe Talutit, së pari na duhet t'i hedhim një vështrim të përgjithshëm këtyre shembujve të lidërshiptit, për tu ndalur më pas tek mësimet që përçojnë. Fillimisht, me mirëkuptimin tuaj shkëpusim citate të shumta nga Tefsiri i Kutubit, të cilët (për shkaqe praktike) me raste i parafrazojmë apo dhe i shkurtojmë, ndërkaq në fusnota do të citojmë dhe dijetarë të tjerë, klasikë e bashkëkohorë.

2.5.1.1. Dije, *temkîn*, epërsi dhe dhuratë hyjnore

Tregimi i Sulejmanit a.s. këtu është detajuar më shumë se në kaptinat tjera. Parathënia shkon në kontekst të mirësive që Zoti ia dha Sulejmanit a.s, të cilat ai i deklaroi para të gjithëve, saktësisht njoftoi se atij Allahu xh. ia ka mësuar gjuhët e shpezëve, ia ka dhuruar mirësitë tjera të panumërta dhe në fund vjen falënderimi për vlerësimin dhe përzgjedhjen e bërë nga Allahu xh.sh për të. Pastaj vjen eskorta apo parada e tij e përbërë nga xhinët, njerëzit dhe shpezët, vërejtja e milingonës ndaj milingonave tjera (që të kenë kujdes nga kjo paradë), kuptimi i

fjalëve të milingonës nga Sulejmani a.s, falënderimi i tij për Zotin për këtë mirësi, kuptimi i Sulejmanit a.s. se mirësia është sprovë dhe së fundi lutja bërë Allahut xh.sh. që ta bëjë falënderues dhe të suksesshëm në këtë sprovë.

Në tregim shpaloset dhe letra e Sulejmanit a.s. dërguar mbretëreshës së Sebeit, Belkisës, e cila, bashkë me popullin e saj, pa vonuar bëhen myslimanë, e bindur nga forca e madhe e Sulejmanit a.s, respektivisht nga dhuntia që Allahu xh.sh. ia kishte dhënë për ti nënshtruar xhinët, njerëzit dhe shpezët.

Sa i përket rrëfimit të Sulejmanit a.s. në këtë kaptinë, ai shpalos detaje nga mësimi i gjuhës së shpezëve dhe nga udhëheqja me erërat sipas urdhrit të Allahut xh.sh.

Rrëfimi fillon me këtë aludim: **“Ne i dhamë Daudit dhe Sulejmanit dituri...”** për tu shfaqur kështu vlera e diturisë, madhështia e mirësisë me të cilën Allahu i ka nderuar njerëzit, dhe dallimi apo epërsia e të diturve (që ua dhuroi Allahu xh.) mbi besimtarët tjerë. Në ajet dija është e përgjithshme dhe nuk përcaktohet se për cilën dije është fjala. Ajeti na jep të kuptojmë se dija është dhunti prej Allahut dhe se çdo i mençur e ka për detyrë (morale) që ta dijë burimin e dijes, ta falënderojë dhuruesin e dijes –Allahun xh.sh. dhe ta shpenzojë atë dije në gjëra që çmon Dhuruesi i saj. Dija nuk duhet ta largojë njeriun nga Allahu xh.sh. dhe as ta bëjë ta harrojë Atë. Dituria e cila e largon njeriun prej Zotit është dituri e refuzuar, e devijuar nga burimi dhe e çorientuar nga qëllimi, shterpe dhe dëshpëruese për individin dhe shoqërinë. Dituria e tillë prodhon dëshpërim, frikë, stres, shkatërrim, sepse është e shkëputur nga burimi, e devijuar nga drejtimi, e çorientuar në rrugë, pra dije që largon nga Allahut xh.sh.

Njerëzimi sot ka avancuar shumë në dije dhe në shkencë dhe ka arritur ta zbërthejë edhe atomin dhe ta vë në shfrytëzim, por cila

është dobia që ka përfituar njeriu prej saj kur ajo nuk ia kujton Allahun, nuk e afron pranë Tij, kur ata nuk janë falënderues për të! Çfarë tjetër solli shkenca pa besim pos viktimave të panumërta, ta zëmë në Hiroshimë e Nagasaki, pos frikës dhe tmerrit që e mban të mbërthyer Lindjen dhe Perëndimin dhe që e kërcënon përherë me shkatërrim e zhdukje...¹

Davudit a.s. krahas mbretërisë i ishte dhënë pejgamberia dhe dija, por mbretëria nuk përmendet ndërsa flitet për mirësinë e Allahut ndaj tij dhe të birit, Sulejmanit a.s. Përmendet vetëm dija sepse mbretëria pa dituri nuk ka vlerë... **“Sulejmani e trashëgoi Daudin...”** Trashëgimia këtu ka të bëjë me dijen sepse është vlëra më e madhe dhe më e lartë që meriton të veçohet me përmendje. Këtë e konfirmon edhe shpallja që Sulejmani a.s. e bëri para njerëzve: **“O populli im! Neve na është mësuar gjuha e shpendëve² dhe na është dhënë gjithçka...”** Shpalosja e këtyre mirësive para njerëzve në fakt është bërë për ta shpalosur

¹ Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2599-2643.

² Komentatori i Kur'anit Ibn Ashuri duke folur për gjuhën e shpezëve dhe sekretet e fjalëve të Sulejmanit a.s.: *“na janë mësuar, na janë dhënë”* ka thënë: *“Zërat e shpezëve i ka quajtur gjuhë duke i ngjasuar kështu me gjuhën e njerëzve nga aspekti i kuptimit të asaj që zogjtë komunikojnë ndërmjet vete. Përemri në shumës: “Na janë mësuar (neve), na janë dhënë (neve)”* ka të bëjë vetëm me Sulejmanin a.s. por është në formë shumësi për modesti. Apo ka të bëjë me atë se ai është i duhuri për ta shfaqur madhësinë e pushtetit duke dashur kështu ta shfaq veten më madhështor para popullit dhe ata t'ia kenë frikën. Por kjo mund të jetë dhe për shkak të natyrës së pushtetit, e cila përcakton një gjë të tillë në raste të caktuara, siç ta zëmë ndodhi me Muaviun r.a. dhe Omerin r.a. Ky i fundit e kishte takuar Muaviun r.a. në Sham dhe i kishte thënë: A qenke bërë si cezarët, o Muavi! Omerit r.a. nuk i kishte pëlqyer salltaneti dhe shpenzimet për rrobat dhe armët e shtrenjta dhe luksoze të ushtrisë. Muaviu r.a. i kishte thënë: Ne jemi në front përballë armikut dhe armikun asgjë pos kësaj nuk e frikëson. Omeri r.a. i kishte thënë: Mashtrim i të shkathëtit (bërë armikut) apo ixhtihad i të diturit. As nuk të urdhëroj, as nuk të ndaloj. **Kështu Omeri r.a. çështjen se si qeveriste me popullin dhe çfarë politikash ndiqte ia la në dorë atij...**” 20/237.

mirësinë dhe meritat e Allahut dhe jo për mburrje të një individi para të tjerëve! Shpendët, kafshët, insektet kanë gjuhën me të cilën kuptohen mes vete, gjë që është vërtetuar edhe shkencërisht! Sot disa mufessirë të ndikuar nga shkenca dhe teknologjia, mundohen që aftësinë apo dhuntinë e Sulejmanit a.s. për të komunikuar me gjuhën e shpezëve dhe të insekteve ta interpretojnë me metoda bashkëkohore shkencore, duke e abstrahuar nga interpretimi fetar si një mrekulli e dhënë nga Allahu xh! Ndaj unë do të ndalem pikërisht tek mrekullia!

Interpretimet e tilla e nxjerrin mrekullinë nga natyra e saj (duke e trajtuar vetëm si dukuri shkencore të veçuar nga trajta e saj shpirtërore). Gjithë kjo është pasojë e shkurtpamësisë shpirtërore dhe diturisë së kufizuar njerëzore!

Për Allahun xh.sh. nuk paraqet kurrfarë vështirësie t'i mësojë një robi gjuhën e shpendëve, të kafshëve dhe të insekteve. Është dhunti prej Tij, qe Sulejmani a.s. e trashëgoi pa përpjekje dhe pa angazhim paraprak. Pos që është mirësi, kjo në fakt paraqet një mrekulli. Pjesa tjetër e saj ka të bëjë me nënshtrimin e xhinëve dhe të shpezëve dhe rekrutimin e tyre si pjesë e ushtrisë së tij, ashtu siç ishin ushtarët nga radhët njerëzore. Lloji i shpezëve të nënshtruara ishin më inteligjentë nga shpezët tjera. Dëshmi për këtë kemi hud'hudin ose pupëzën e cila kishte arritur të kuptojë nga gjendja e mbretëreshës dhe popullit të saj atë që e kupton njeriu më i mençur, më i zgjuar dhe më i devotshëm. Dhe kjo kishte ndodhur në formë të mbinatyrshme, si mrekulli...¹

¹ Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2599-2643. Parafrazim.

2.5.1.2. Nënshtrimi i xhinëve, njerëzve dhe shpezëve dhe falënderimi për Dhuruesin

Nga kjo hyrje e shkurtë do të kalojmë tek detajet e rrëfimit të Sulejmanit a.s. pas trashëgimit të Davudit a.s. dhe shpalljes së mirësive të cilat Allahu xh.sh. ia kishte dhënë; *dija, temkini dhe epërsia*.

“Para Sulejmanit u tubua ushtria e Tij e përbërë prej xhinëve, njerëzve dhe shpendëve, të gjithë të radhitur në çeta të gatshme.”¹ Kjo është parada e Sulejmanit a.s. e rreshtuar para tij, e përbërë nga xhinët, njerëzit dhe shpezët.

E dimë se Allahu xh.sh. ia kishte nënshtruar një grup të xhinëve të cilët punonin për Sulejmanin a.s, ndërtesa, statuja dhe enë të mëdha ushqimi. Zhyteshin poashtu edhe në det dhe i përmbaheshin fjalës dhe urdhrat të tij.

Nuk kanë qenë tërë njerëzit nën sundimin e Sulejmanit a.s. për faktin se pushteti i tij nuk tejkalonte hapësirat që sot njihen si

¹ Përkitazi me këtë meselë, Ibn Ashuri ka thënë: Pjesa e ajetit: “...**ushtria e Tij e përbërë prej xhinëve, njerëzve dhe shpendëve...**” flet për tre llojet e ushtarëve të tij: llojin e xhinëve, i cili ishte për drejtimin e forcave të fshehta dhe për ndikim në çështje shpirtërore; llojin e njerëzve, të cilët ishin ushtria e tij për të ekzekutuar urdhrat, për ta luftuar armikun dhe për ta mbrojtur vendin dhe llojin e shpezëve, si pjesë plotësuese dhe që shërbenin për bartjen e lajmeve dhe pranimin e tyre si dhe për dërgimin e letrave dhe shkresave tek komandantët dhe vartësit...Fjala vez’ë (الْوَزْعُ) – shqip: *të gjithë të radhitur në çeta të gatshme*) nënkupton heqjen dorë nga ajo që nuk synohet, kështu që përfshin urdhrat dhe ndalesat. Me fjalë tjera, nënkupton se ushtria vepron sipas urdhërësive dhe ndalesave. Allahu ia kishte nënshtruar tërë popullin...Ajeti na mëson se mbretërit e kanë obligim ta bashkojnë ushtrinë dhe ta trajnojnë që të përkujdesen për gjendjen dhe nevojat e tyre si dhe të ndiejnë atë që iu mungon dhe ta përkujtojnë atë që mbase mund ta kenë harruar gjatë kohës kur ndizet lufta dhe ashpërsohet beteja...20/239.

Palestinë, Siri, Irak deri tek bregu i Eufratit. Po kështu as tërë xhinët dhe të gjitha shpezët nuk kanë qenë nën komandën e tij. Ka qenë vetëm një grup i tyre.

Vazhdojmë tutje... Kur Sulejmani a.s. kontrolloi shpezët, pa se pupëza mungonte. Po të ishin të gjitha shpezët nën sundimin e tij dhe pjesë e ushtrisë së tij, nuk do të mund ta diktonte mungesën e një pupëze në mesin e miliona pupëzave dhe miliarda shpezëve dhe as do të pyeste: Ku mbeti pupëza, përse nuk po e shoh!? Pra ka qenë pupëz e veçantë dhe e dalluar. Mund të ketë qenë ajo (e vetmja) që i është nënshtruar Sulejmanit a.s. nga bota e pupëzave. Kjo mbase edhe për faktin se ka qenë e veçantë¹, e zgjuar dhe se niveli i inteligjencës së saj

¹Tahir bin Ashuri ka thënë: “Dijen e të folurit të shpezëve Sulejmani a.s. e ka mësuar nëpërmjet vahjit (shpalljes). Allahu xh.sh. ia ka mundësuar që nëpërmjet cicërimave të tyre të arrijë ta deshifrojë kuptimin e asaj që shpezët thonë apo duan. Dobia e kësaj dije qëndron në shërbimin që i ofrohet Sulejmanit a.s. prej saj, respektivisht në botën të cilën shpezët mund ta kuptojnë para të tjerëve për shkak të karakteristikave që Allahu xh.sh. ua ka dhënë. Shpezët kanë një lloj të veçantë komunikimi ndërmjet vete dhe lajmërimi për gjërat që janë (i shohin), gjë kjo që mund ta ndihmojë liderin në qeverisje të vendit. Sulejmani a.s. e shfrytëzoi pupëzën për të marrë dhe kthyer lajme. Disa zëra të shpezëve, siç dihet nga vëzhgimi i tyre, janë thirrje e mashkullit për femrën, disa të tjerë alarmojnë rrezikun kur dikush t’i kapë ose sulmojë. Format e tyre nuk mund t’i dijë askush pos Krijuesit të tyre. Janë të ngjashëm me kuptimet që dalin nga vendartikulimi i shkronjave, gjegjësisht nga forma se si shqiptohet një shkronjë e caktuar, e cila ka edhe kuptim të caktuar, të cilin nuk mund ta dallojë ai që ka njohuri sipërfaqësore për atë gjuhë. P.sh. në arabisht: *daleltu*(دَلَّلتُ) dhe *dhaliltu*(ظَلَّلتُ) janë të përafërta në shqiptim të ndryshme në kuptim të cilat nuk mund t’i dallojë dikush që nuk e njeh arabishten mirë. Allahu xh.sh. ia mësoi Sulejmanit a.s. këto forma nëpërmjet vahjit duke e mësuar edhe për kuptimet që ato i kanë në rrethana të caktuara, gjëra këto që njerëzit e tjerë nuk i dinin fare... ” 20/237.

matet me koeficientin e njerëzve më të zgjuar dhe më të devotshëm...

“...të gjithë të radhitur në çeta të gatshme...”, kjo ishte pamja e ushtrisë, e mobilizuar dhe radhitur në çeta, në mënyrë që të mos shkapërderdhej dhe të shkaktohej kaos mes tyre. Është term ushtarak për mobilizimin dhe organizimin.

“Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha:”: kjo milingonë ishte në cilësi të mbikëqyrësit dhe organizatorit të milingonave që kërkonin ushqimin në luginë. Komunikonte me milingonat tjera me gjuhën përkatëse. Milingona u tha: Hyni në banesat tuaja që Sulejmani dhe ushtria e tij të mos ju shkelin pa ju vënë re. Sulejmani a.s. e kuptoi çfarë tha milingona dhe mbeti shumë i kënaqur e i gëzuar që Allahu ia mundësoi ta kuptonte këtë. U gëzua sepse ishte çudi se si një milingonë mund ta kishte këtë nivel, të të kuptuarit¹ dhe si milingonat tjera e kuptojnë dhe i përmbahen fjalës së saj. Sulejmani a.s. e kuptoi këtë dhe **“Ai vuri buzën në gaz, duke qeshur me fjalët e saj...”**...Pamja e kësaj

¹Tahir bin Ashuri ka thënë: “...Ai u çudit nga ajo se si milingona e dinte emrin e tij dhe se ajo ka thënë: ruani mos nga pakujdesia po iu mbysin. Ky është një vlerësim për Sulejmanin a.s. dhe për ushtrinë e tij se ata janë të mëshirshëm dhe se nuk mbysin kot asgjë që ka shpirt. Është sinjalizim për mëshirën dhe drejtësinë gjithëpërfshirëse të Sulejmanit a.s. me çdo krijesë të padëmshme. Është një e vërtetë e përshkuar nga milingona që Sulejmani a.s. ta dijë vlerën e drejtësisë dhe të mos e nënvlerësojë aplikimin e saj në çdo fushë të mundshme. Nga ky rast merret mësim se nëse pushtetari ndan drejtësi, atëherë ajo reflekton në gjithçka dhe tek të gjitha krijesat, gjë kjo thuaje e ditur edhe për krijesat që nuk kanë intelekt. Kështu çdo punë e popullit realizohet sipas drejtësisë dhe mbi bazën e saj. E Allahu sjell shembuj për njerëzit, kështu, profetit të Vet, Sulejmanit a.s. ia solli këtë shembull për vahjin (shpalljen) dhe mundësinë e kuptimit të gjuhës së shpezëve nëpërmjet tij, sekretet ky ndërmjet tij dhe Zotit, shenjë dhe thirrje se duhej falënderuar Allahun xh.sh. andaj edhe tha (u lut Sulejmani a.s.): **“O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua...”**. ” 20/241.

skene për Sulejmanin a.s. ishte fascinuese dhe menjëherë zemrën e tij e ktheu kah Zoti të cilit i detyrohet për këtë mirësi dhe mrekulli. U kthye kah Zoti duke u lutur: **“O Zoti im, më frymëzo të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi...”**...”**Zoti im,...**” me këtë thirrje të afërt, të drejtpërdrejt dhe të pashkëputur...”**më frymëzo**” më bëj tërësisht: me gjymtyrë, ndjenja, gjuhë, zemër, mendime, fjalë, shprehje, vepra, këshilla, me bëj të tërin, më bashko tërë kapacitetin fund e krye, që të jenë të gjitha në shërbim të falënderimit për mirësinë Tënde ndaj meje dhe prindërve të mi. (Të lus edhe që:) **“...të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur....”** Edhe vepra e mirë është mirësi nga Allahu për të cilën e bekon besimtarin falënderues.

Sulejmani a.s. i cili ka qenë falënderues duke kërkuar ndihmën e Zotit për ta forcuar në rrugën e falënderimit, po kërkon ndihmën e Tij edhe për ta bekuar për vepra të mira. Ai ndiente se vepra e mirë është bekim dhe mirësi tjetër e Allahut ndaj tij. **“...Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!”** Sulejmani a.s. e dinte që pranimi në mesin e robërve të devotshëm është mëshirë e Allahut xh.sh. për robin dhe bekim për punën e tij të hajrit.

Sulejmani a.s. lutej dhe përgjerohej megjithëse ishte peygamber i dalluar, lutej për mirësitë e shumta dhe për nënshtrimin e xhinëve, njerëzve dhe të shpezëve. Ai nuk e kishte frikë ndëshkimit, madje edhe atëherë kur ishte zgjedhur peygamber. Ai kishte frikë se mos puna dhe falënderimi i tij nuk do të ishin të nivelit dhe të dispozitave që kërkon Allahu xh.sh...¹

¹Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2599-2643. Parafrazim.

2.5.1.3. Skenat artistike dhe profesionale të rrëfimit

Tani do të merremi me pjesën e rrëfimit ku protagonistë janë hud'huđi (pupëza) dhe mbretëresha e Sebeit, Belkisa.

Kjo pjesë është e ndarë në gjashtë skena ndërmjet të cilave ka zbrazëti artistike, të cilat mund ti kuptojmë ndërsa prezantojmë skenat në vazhdim;

Prezantimi artistik në këtë rrëfim plotësohet ose merr formë të përkryer nga dy aspekte: aspekti artistiko-estetik dhe aspekti fetaro-sentimental. Tregimi përfshin në role protagoniste xhinët, njerëzit dhe shpezët. Në të shpaloset edhe roli i diturisë. Ky prolog është një lloj aludimi edhe për bartësit e roleve kryesore në tregim, ku shpalosen dhe tiparet e personalitetit dhe karakteristikat e veçanta të protagonistëve: personaliteti i Sulejmanit a.s, personaliteti i mbretëreshës Belkisa, personaliteti i pupëzës, veçoritë e suitës mbretërore. Në tregim shfaqen dhe momentet psikologjike të protagonistëve në skena dhe rrethana të ndryshme...¹



Skena I:

Fillon skena e parë...

Fillon pas prezantimi ushtarak, pas arritjes në luginë dhe pas fjalëve të milingonës për dëgjimin dhe kuptimin e të cilave Sulejmani a.s. e falënderoi Allahun xh.sh: **“Ai bëri kontrollin e shpendëve e tha: “Pse nuk e shoh pupëzën këtu, a nuk është e pranishme ajo? 21. Nëse nuk do të më sjellë arsytim bindës, do ta dënoj me dënim të rëndë**

¹Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2599-2643. Parafrazim.

ose do ta therr!" Ja, ky është mbreti profet, Sulejmani, duke marshuar me ushtrinë e tij të madhe dhe madhështore. Ja, ai, Sulejmani, po i kontrollon shpezët dhe nuk po e gjen pupëzën...¹

Nga ky veprim i Sulejmanit a.s. përfitojmë tipare të personalitetit të tij: *vigjilencën, precizitetin dhe vendosmërinë*. Pavarësisht numrit të madh të ushtarëve, të përberë nga tre lloje krijesash: njerëz, xhinë, shpezë, atij nuk i është shmangur nga syri asnjëri prej tyre. Ai i kontrollon nga i pari tek i fundit me radhë. Ai po pyet për pupëzën në një formë krenarie, tingëlluese dhe përmbledhëse: **"Pse nuk e shoh pupëzën këtu, a nuk është e pranishme ajo?"** Bëhet e qartë se pupëza mungon dhe të gjithë e kuptojnë nga konstatimi i mbretit se pupëza mungon pa lejen e tij. Ky është momenti kur ai frenon kaosin në mesin e ushtrisë. Pas pyetjes nga mbreti kjo pyetje më nuk ishte sekret kështu që, nëse nuk do të ndërmernte ndonjë hap serioz, kjo do të shërbente si pretekst i keq tek ushtarët. Për këtë shkak Sulejmani a.s. e

¹Tahir bin Ashuri ka thënë: Në kuadër të ushtrisë ishin edhe shpezët sepse shumë prej tyre janë të dobishëm për ushtrinë, si pëllumbi transportues, pupëza për njohjen e ujit, skifterët dhe sokolat për gjuetinë e mbretit dhe ushtrisë së tij apo edhe për të sjellë ushqimin për ushtrinë nëse janë në zona të vështira dhe kanë mbetur pa ushqim. Shpezët kanë ushtri e cila merret me punët e tyre. Përkujdesja për ushtrinë është moto e mbretit dhe princave dhe është objektivë prej objektivave të radhitjes dhe organizimit të tyre.

Pushtetarët myslimanë e kanë për detyrë që personalisht të kujdesen për popullin dhe punëtorët, ashtu siç veproi Omeri r.a. kur në vitin e shtatëmbëdhjetë sipas Hixhrit shkoi në Sham. Apo, ata mund t'ia ngarkojnë këtë detyrë një njeriu të veçantë, siç veproi Omeri r.a. me Muhammed bin Mesleme Ensariun, të cilin e la mbikëqyrës të punëtorëve. Pupëza është zog shtegtar me trup sa të pëllumbit, të mbuluar me pupla të ndritshme e ngjyra-ngjyra, me sqep të gjatë e të hollë dhe me një xhufkë në kokë. E vëren ujin nga një distancë e largët dhe e ndien edhe kur është në thellësi të tokës. Nëse cicëron mbi një vend, dihet se aty ka ujë. Këtu qëndron arsyeja pse Sulejmani a.s. e ka angazhuar në ushtri...20/245.

kërcënon ushtarin që ka munguar pa lejen e tij: **“...do ta dënojmë me dënim të rëndë ose do ta therr!”**

Por, Sulejmani a.s. nuk ishte mbret tiran. Ai ishte peygamber dhe përderisa nuk kishte dëgjuar asgjë nga pupëza, nuk duhej të paragjykonte!...Këtu shfaqet tipari i profetit të drejtë: **“Nëse nuk do të më sjellë arsyetim bindës...”**Pra, nëse nuk më sjell provë të fortë që dëshmon pretendimin e saj dhe në bazë të së cilës përjashtohet nga dënimi për veprën në fjalë...¹



Skena II:

...Këtu bie perdja dhe mbaron skena e parë. Ai ka qenë apo edhe vazhdon të qëndrojë në këmbë kur ja vjen pupëza me një lajm të madh, me një befasi të madhe, jo vetëm për Sulejmanin a.s. por edhe për ne, spektatorët e vëmendshëm. “Nuk vonoi shumë dhe ajo erdhi e tha: **“Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur dhe të kam sjellë lajme të vërteta prej (qytetit të) Sebe’es.”** Pupëza dinte për vendosmërinë dhe ashpërsinë e Sulejmanit a.s. ndaj e fillon bisedën me lajmin befasues për të zhvendosur çështjen e mungesës dhe për të fituar vëmendjen e mbretit: **“Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur dhe të kam sjellë lajme të vërteta prej (qytetit të) Sebe’es.”** Cili mbret nuk do të dëgjonte ndërsa dikush nga populli i vet a nga vartësit do t’i thoshte: **“Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur...”** E kur fitoi vëmendjen e mbretit, filloi të shpaloste detajet e lajmit të madh që kishte sjellë, lajmit për popullin Sebe’ – mbretëria e Sebeit shtrihej në jug të gadishullit në Jemen dhe shtoi se ata udhëhiqeshin nga një grua², **“Kam parë një grua që sundonte**

¹ Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur’an*, 5/2599-2643. Parafrazim.

² Ibn Ashuri ka thënë: Kuptimi i pjesës së ajetit: **“...i është dhënë gjithçka...”** është: ka arritur çdo gjë të mirë nga çështjet e pushtetit. Përgjithësimi këtu

popullin (e atij qyteti). Ajo zotëronte çdo gjë dhe kishte një fron madhështor.” Pjesa: “Ajo zotëronte çdo gjë” flet për pushtetin e madh të saj, për pasurinë dhe për shkallën e civilizimit, forcën dhe të mirat materiale, ndërsa pjesa “kishte një fron madhështor” – froni është kolltuku madhështor dhe gjigant i mbretëreshës, i cili flet për pasurinë e madhe, për luksin dhe për zhvillimin industrial që kishin¹. Pupëza shpjegoi më tutje: “**Kam parë se ajo dhe populli i saj adhuronin Diellin e jo Allahun....**” Këtu pupëza shpjegon shkakun e devijimit të atij populli, djallin, i cili ua kishte zbukuruar veprat e këqija dhe i kishte devijuar, kështu që ata nuk mund të udhëzoheshin në adhurimin e Zotit, të Diturit të Gjithëdijsëm...²

Deri në këtë çast, pupëza po qëndron në bankën e të të akuzuarit³, për të cilin mbreti ende nuk ka marrë një vendim. Në

është i rëndomtë nga dy aspekte e që shpjegohet nga konteksti, ashtu siç është shpjeguar fjala e Sulejmanit a.s.: “**..na është dhënë gjithçka**”, pra gjithçka që ka të bëjë me tiparet e mbretërve, pasuritë e tyre, ushtritë e tyre, pasuritë e mbretërve të tyre, bukuritë dhe çdo gjë tjetër të mirë....20/249.

¹ Tahir bin Ashuri ka thënë: “*Kjo fjalë që i është thënë Sulejmanit a.s. ka përmbledhur bazat e gjeografisë politike: cilësinë e vendit, feve, karakterin (organizativ të) e shtetit dhe pasuritë e tij...*” 20/249.

² Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur’an*, 5/2599-2643. Parafrazim.

³ Ibën el-Arabij në librin *Ahkam el-Kur’an*, ka thënë: Meseleja e parë: pjesa e ajetit: “**do të shohim a po e thua të vërtetën**” Sulejmani a.s. nuk e ndëshkoi pupëzën sepse i kërkoi falje dhe askush më shumë se Allahu nuk e do arsyetimin. Për këtë shkak edhe i ka dërguar peygamberët dhe profetët. Kështu e ka detyrë të veprojë edhe pushtetari dhe të mos i ndëshkojë njerëzit që arsyetohen. Por, e drejtë e tij është ta testojë arsyetimin, veçmas nëse lidhet për ndonjë normë fetare, ashtu siç veproi Sulejmani a.s. të cilit kur i tha pupëza: “**Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur dhe të kam sjellë lajme të vërteta prej (qytetit të) Shebës. 23. Kam parë një grua që sundonte popullin (e atij qyteti). Ajo zotëronte çdo gjë dhe kishte një fron madhështor.**” Kjo nuk i bëri përshtypje dhe as që e nxiti dëshira për ta zgjeruar pushtetin të merrej me të. Por, kur i tha: “**Kam parë se ajo dhe populli i saj adhuronin Diellin e jo Allahun. Djalli ua paraqiste të bukura**

fund të lajmit, përmend Allahun, Mbretin e mbretërve, të Fuqishmin, Zotin e të gjithëve, Pronarin e fronit të madh me të cilin nuk krahasohen fronet e njerëzve. Pupëza e bën këtë që ta minimizoj pushtetin e tij në raport me pushtetin e Allahut xh.sh: **“Allahu është Një, s’ka zot të vërtetë pos Tij, Zotit të Arshit të madh!”**

Në kontekst të komentit që i bëhet veprës së gabuar të mbretëreshës dhe popullit të saj, pupëza bën thirrje me delikatesë e dhembshuri.

Ne jemi përballë një pupëze interesante, të zgjuar dhe besimtare. Pupëza sjell lajmin në formë të magjishme, shfaq vigjilencën për pozicionin në të cilin është dhe përdor aludimin, insinuatën dhe shenjat. Pupëza kishte kuptuar se kjo mbretëreshë dhe populli i saj i përkulen (bien në sexhde) diellit, jo Allahut! Kjo nuk është ajo çfarë bëjnë pupëzat e rëndomta, por kjo është një pupëz e veçantë, pupëz mrekulli.

Sulejmani a.s. nuk ngutet të vërtetojë as të përgënjeshtrojë lajmin, sikur që përshkrimi i fuqisë dhe pushtetit të mbretëreshës nuk e frikëson fare. Si peygamber i drejtë dhe mbret i vendosur, ai më parë dëshiron të verifikojë saktësinë e lajmit: **“Do të shohim se a thua të vërtetën a jo. 28. Shko me këtë letër timen e çojua atyre. Pastaj largohu pak nga ata dhe shiko cila do të jetë përgjigja e tyre!”**

Në këtë skenë nuk prezantohet përmbajtja e letrës. Ajo (përmbajtja) vazhdon të jetë e mbyllur, sikur letra, derisa të hapet dhe lexohet atje (tek mbretëresha)...¹

sjelljet e tyre, duke i larguar nga rruga e drejtë, prandaj nuk ishin të udhëzuar.” Atëherë u zemërua nga ajo që dëgjoji dhe kërkoi të shkante atje për ku po rrëfente dhe të sillte informacione shtesë, në mënyrë që ta ndryshonte dhe ta kthente tek Allahu xh.sh....3/484.

¹ Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur’an*, 5/2599-2643. Parafrazim.



Skena III:

Befasia artistike shfaqet tamam në kohën e duhur. Ngrihet perdja dhe shfaqet mbretesha, të cilës i ka ardhur letra, të cilën po e diskuton me parinë e saj¹, respektivisht po merr mendimin e tyre si të veprojë: **“O paria ime! Mua më ka ardhur një letër fisnike. 30. Ajo është nga Sulejmani dhe është: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! 31. Mos u madhështoni para meje dhe ejani të përulur si besimtarë!”**”

Mbretëresha po u rrëfen për letrën duke mos ditur për dërguesin (sjellë) dhe mënyrën se si ka ardhur. Ajo po e përshkruan letrën si ‘*fisnike*’, përshtypje kjo e fituar nga vula apo forma e letrës, apo mbase dhe nga përmbajtja, të cilën ia lexoi parisë: **“Ajo është nga Sulejmani dhe është: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! 31. Mos u madhështoni para meje dhe ejani të përulur si besimtarë!”**”

Mbretëresha ishte idhujtare por për Sulejmanin a.s. dinte gjithë rajoni. Gjuha e përdorur në shkresë, siç na rrëfen Kur’ani, ishte

¹ Dr. Amir Buselame ka thënë: “Thelbësore në kornizën e përgjithshme është se matura dhe reflektimi kanë principe me të cilat vepohet ndër të cilat, ndoshta më e rëndësishmja është ikja nga mendimi, ideja dhe vendimi individual në shura (mendim të kolektivit) dhe trajtim sa më të thellë të një çështje që të kuptohet më mirë. Kjo i ngjason një zone të errët ku nuk dihet se çfarë ka për shkak të errësirës. Kështu, për ta ditur se çfarë ka, hapi i parë janë reflektorët të cilët i vendos në të gjitha anët që ta matësh distancën saktësisht dhe vetëm më pas ta marrësh vendimin. Ndryshe, nëse çfarëdo vendimi merret pa nderur reflektorët më parë, ai është vendim irracional dhe emocional që në shumicën absolute të rasteve çon në dështim. Shembuj të tillë historikisht ka pasur shumë, madje ka edhe sot.” Shih artikullin “Esh-shura essadikah” në portalin e revistës kuvajtiane *muxhteme*, <http://mugtama.com/articles/item/16305-الصادقة الشورى>, shfletimi është bërë më datë: 01.10.2019.

gjuhë e lartë, dominuese, me vendosmëri e qëndrim të prerë¹, gjë që mund ta ketë frymëzuar mbretëreshën për atë përshkrim.

Përmbajtja e shkresës ishte jashtëzakonisht modeste dhe e fuqishme². Ishte hapur me *bismilah* (**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**) Në të kërkohej vetëm një gjë: Të mos shfaqni mendjemadhësi ndaj dërguesit të letrës dhe të mos e kundërshtoni si dhe t'i nënshtroheni Zotit në emër të të Cilit po u fliste. Mbretëresha ia lexoi parisë së popullit përmbajtjen e letrës dhe menjëherë vazhdoi me diskutimet se çfarë të bënte, sepse pa marrë mendimin e tyre ajo nuk do të

¹Tahir bin Ashuri ka thënë: "Letra e Sulejmanit a.s. ishte e shkurtër, sepse kështu është më e përshtatshme t'i drejtohesh atij që nuk e kupton gjuhën tënde. Kështu, mjaftohet me thelbin e saj për shkak të mundësisë së përkthimit dhe të kuptimit. Sulejmani a.s. shkroi këtë që duhej, pra kërcënimin ndaj mbretëreshës që të mos guxonte të shfaqte kryelartësi dhe të mos nënshtrohej, ashtu siç patën vepruar mbretërit e vendeve përreth Egjiptit, Surit (qytet detar në Liban) dhe Irakut. Me shprehjen "**dhe ejani të përulur si besimtarë**" synohet ana metaforike, ashtu siç thuhet: pasoje rrugën time (pra ndiqe traditën time). Muslimanë (siç është përmendur në ajetin e mësipërm: (*Ejani, besimtarë!* **Shën. Përkth**). *Muslimijn*..rrjedh nga (folja) *esleme* kur ta ketë përvetësuar Islamin. Në thirrjen e Sulejmanit a.s. shohim se si janë gërshtetuar elementet mbretërore dhe profetike, respektivisht thirrja për ta pranuar pushtetin e tij, nga ana mbretërore dhe fenë e tij, nga ana profetike. Pejgamberët janë urdhëruar për t'i udhëzuar njerëzit në fe dhe kështu është thirrja e Sulejmanit a.s. këtu. Pejgamberi Muhammed a.s. ka thënë: "*Që Allahu ta udhëzojë një njeri nëpërmjet teje është më mirë se të kesh pasurinë më me vlerë.*" Kjo është tradita e feve sepse synimi kryesor dhe objektiva primare është udhëzimi i njerëzve, jo hakmarrja dhe dashuria për triumf e pushtet..." 20/258.

²Tahir bin Ashuri ka thënë: Pjesa e ajetit: "**Mos u madhështoni para meje...**" është formë kërcënimi, për këtë shkak mbretëresha iu drejtua parisë: "**O paria ime, më këshilloni se ç'duhet të bëj në këtë çështje!**" 20/258.

ndërmerрте asgjë¹: **“O paria ime, më këshilloni se ç’duhet të bëj në këtë çështje! Unë nuk do të vendos asgjë pa ju!”...²**

Ky çast shfaq tiparin e shkathtësisë së mbretëreshës. Që nga momenti i parë kur morri letrën, dërguesin e të cilës nuk e njihte, ajo kuptoi që letra kishte një përmbajtje fuqie e krenarie, të cilën ajo e quan ‘fisnike’. Qartë, ajo nuk dëshiron rezistencë as armiqësi, por këtë nuk e shprehë drejtpërdrejtë. Përshkrimin që i kishte bërë letrës, ishte një lloj parapërgatitje.

Më pas mbretëresha kërkon mendimin e të tjerëve. Siç e do rendi ushtarak, komandantët shfaqin gatishmëri për luftë, por, para çdo gjëje, çështjen ia lënë në dorë sundueses: **“Ne jemi shumë të fortë dhe luftëtarë të guximshëm, por urdhëri të takon ty, ndaj mendo mirë se ç’do të urdhërosh!”** Këtu vihet në spikamë personaliteti i femrës prapa personalitetit të mbretëreshës: ajo nuk do luftë, as shkatërrim. Para forcës, ajo përdorë mjete tjera më të zgjuara, dinakërinë dhe joshjen (nëpërmjet dhuratave): **“Ajo thotë: “Njëmend, kur mbretërit pushtojnë ndonjë vendbanim, e rrënojnë atë dhe e poshtërojnë parinë e tij.**

¹ AbduRahman Sa’di duke komentuar këtë ajet ka thënë: “Shenja të vendosmërisë dhe mendjemprehtësisë së mbretëreshës ishte thirrja që i bëri parisë dhe burrështetasve të popullit dhe mbretërisë së vet duke iu thënë: **“O paria ime, më këshilloni se ç’duhet të bëj në këtë çështje!”** Pra më lajmëroni se si t’i përgjigjem? A t’i nënshtrohemi apo si të veprojmë? Kjo ngase: **“Unë nuk do të vendos asgjë pa ju!”** Pra nuk do të marr vendim krye në vete pa iu konsultuar juve dhe pa marrë mendimet tuaja.” *Tejsir el-Kerim el-Rahman fi Tefsiri kelami el-Mennan*, f. 708.

² Imam Alusi në tefsirin e vet Ruh el-meani, duke shpjeguar pjesën e ajetit: **“Unë nuk do të vendos asgjë pa ju!”** ka thënë: Unë nuk do të marr ndonjë vendim të prerë që ka të bëjë me pushtetin pa prezencën dhe mendimet tuaja. Me këtë ajet janë shërbyer ata që thonë se preferohet konsultimi dhe marrja e mendimeve të tjerëve në çështje të rëndësishme dhe me peshë...19/197.

Kështu vepronë ata. 35. Tani do t'u dërgoj atyre një dhuratë që të shoh me çka do të kthehen të deleguarit."

Mbretëresha e dinte se kur mbretërit merrnin një qytet, e shkatërronin atë, e çnderonin dhe shpërbënin forcat mbrojtëse të tij me në krye parinë, të cilët i poshtëronin të parët si element rezistues¹. Kjo ishte tradita e mbretërve dhe forma si vepronin.

Dhurata zbut zemrën, shfaq mirësinë, shpreh dashurinë, shpesh mposhtë dhe luftërat. Këtë e dëshmon përvoja. Kështu, nëse Sulejmani a.s. e pranon dhuratën, ai është mbret materialist dhe me të tillë punët kryhen kështu. Ndërsa nëse refuzon, atëherë ai refuzon nga besimi, prej të cilit nuk ka pasuri që mund ta largojë dhe as mall nga malli i kësaj bote...²

¹Tahir bin Ashuri ka thënë: "Mbretëresha e dha mendimin e saj duke favorizuar paqen ndaj luftës dhe duke shfaqur kujdes nga hyrja nën pushtetin e tyre vullnetarisht. Ajo e dinte se epilogu i mundshëm i luftës ishte fitorja e Sulejmanit a.s. kështu që mbretëria e Sebeit do t'i kalonte atij. Po kështu dhe pranimi vullnetar i pushtetit të tij nënkupton që mbretëria kalon në duart e tij. Pra, në të dy rastet kemi të bëjmë me një mbret të ri në qytet. Ajo e dinte nga dëshmitë e historisë dhe nga përvoja me mbretërit dhe veprimet e tyre se ata kur ta marrin një vend, e ndryshojnë sistemin në dobi dhe interes të tyre që t'ia pamundësojnë popullit të mposhtur të përfitojë nga rrethana të caktuara kur pushtuesi do të jetë i dobët apo i zënë me punë tjera të çohen kundër tyre dhe ta kthejnë pushtetin. Kështu, gjëja e parë që bëjnë ata është largimi nga pushteti i mëhershëm, sepse rreziku prej tyre është permanent meqë ata janë më të dëmtuarit, ata kanë humbur pushtetin. Pastaj bëhet ndërrimi i ligjeve dhe sistemeve sipas të cilave ka punuar shteti. Ndërsa nëse hyjnë dhunshëm nën pushtetin e tyre, atëherë vendi do të shkatërrohet, njerëzit do të robërohen, të mirat do të plaçkiten. Të dy rastet (e pranimit vullnetar të pushtetit dhe hyrjes së dhunshme nën të) janë të përfshira në fjalën e mbretëreshës: "Njëmend, kur mbretërit pushtojnë ndonjë vendbanim, e rrënojnë atë dhe e poshtërojnë parinë e tij."..." 20/266.

² Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2599-2643. **Parafrazim.**



Skena IV:

Bien perdet, mbyllet skena e tretë, për tu ngritur prapë, kur ja shfaqen të deleguarit e mbretëreshës dhe dhurata e saj para Sulejmanit a.s.

Idenë e tyre për ta blerë me para dhe për ta bërë të hiqte dorë nga thirrja në Islam Sulejmani a.s. e sheh të shëmtuar dhe aty për aty shpall me forcë dhe ngulm kërcënimin dhe paralajmërimin e tij të fundit: **“Kur erdhën (të deleguarit), Sulejmani tha: “A mos doni të më ndihmoni me pasuri?! Ajo që më ka dhënë Allahu, është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve. Por ju gëzoheni me dhuratën tuaj. 37. Kthehuni tek ata! Ne do të sjellim ushtri të cilën ata nuk do të mund ta përballojnë dhe me siguri do t’i dëbojmë ata prej Shebës të poshtëruar dhe të përrulur”.**”

Përgjigja e Sulejmanit a.s. është tallje me pasurinë dhe refuzim të pranimit të saj në një fushë ku nuk pranohet, në fushën e besimit dhe të thirrjes: **“A mos doni të më ndihmoni me pasuri?”** A po më ofroni këtë gjë të pavlerë ndërsa: **“Ajo që më ka dhënë Allahu, është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve.”** Allahu më ka dhënë pasuri më të mirë se kjo që më keni ofruar, madje më ka dhënë gjëra që absolutisht janë më të mira se pasuria: dijen dhe profetësinë. Po kështu mi ka nënshtruar xhinët dhe shpezët kështu që nuk ka mall nga pasuria e kësaj bote që më kënaq më shumë: **“Por ju gëzoheni me dhuratën tuaj.”** Ju jeni ata që ngazëlلهeni me këto vlera të ulëta të cilat janë në interes vetëm për tokësorët (jofetarët) të cilët nuk janë të lidhur me Allahun xh.sh. dhe nuk pranojnë (marrin) dhuratat e Tij. Por çështja nuk mbaron me kaq. Refuzimi pasohet me kërcënim: **“Kthehuni tek ata!”** me këto dhurata dhe prisni për fundin e frikshëm që do të keni: **“Ne do të sjellim ushtri, të cilën nuk do të mund ta përballojnë ata...”**, ushtri që nuk i është nënshtruar njerëzimit kurrë në asnjë vend dhe ndaj të cilës

mbretëresha nuk ka fuqi ta sfidojë: **“...me siguri, do t’i dëbojmë ata prej Shebës të poshtëruar dhe të përulur”.**”

Këtu bie perdja e kësaj skene të dhunshme dhe të deleguarit nisen. Konteksti i tregimit më nuk iu qaset atyre. Sikur puna me ta ka mbaruar dhe më nuk trajtohet.

Pastaj Sulejmani a.s. kupton se përgjigja e tij do të mjaftonte për tu sqaruar me mbretëreshën, e cila nuk do armiqësi, siç mund të vërehet nga përgjigja e saj me dhurata ndaj një letre kërcënuese! Ai është i bindur se mbretëresha do të përgjigjet pozitivisht...¹



Skena V:

Konteksti nuk shpjegon se si janë kthyer të deleguarit, çfarë iu ka thënë mbretëresha dhe as çfarë kishte vendosur më pas. Në tregim është një zbrazëti dhe nga ajo që pason mësojmë se mbretëresha do të shkonte dhe se Sulejmani a.s. e dinte këtë gjë dhe se me ushtrinë e vet do ta sillte fronin e mbretëreshës, të cilin e kishte lënë pas në vendin e saj të ruajtur dhe të mbrojtur. Sulejmani a.s. tha: **“O parësi, kush prej jush do të më sjellë fronin e saj, para se ata të vijnë të dorëzuar? 39. Njëri nga xhindet - Ifriti, tha: “Unë do të ta sjell ty para se të ngrihesh prej vendit; unë për këtë jam i fuqishëm dhe i sigurt”. 40. Po ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: “Unë do të ta sjell ty sa çel e mshel sytë”.**”...

E dini se çfarë e shtyri Sulejmanin a.s ose çfarë kishte për qëllim ai kur mendoi ta sillte fronin e saj para se ajo vet të vinte myslimane bashkë me popullin e saj? Mendojmë se pikërisht ky segment shfaq forcën e mbinatyrshme – mrekullinë, me të cilën Allahu e ndihmonte, në mënyrë që të ndikonte tek mbretëresha dhe ta shtynte drejt pranimit të fesë. Një *ifrit* nga xhinët i tha se

¹ Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur’an*, 5/2599-2643. Parafrazim.

mund t'ia sillte atë para se ai të çohet nga takimi ku ishte. Siç transmetohet, Sulejmani a.s. nga sabahu e deri në drekë, merrej me punët e shtetit – gjykimet dhe vendimet. Siç duket, kjo periudhë iu duk e gjatë dhe e ngadalshme. Kështu: **“ai që ishte i pajisur me dijen e Librit”** i ofroi që t'ia kryente këtë punë në çast. As emri i tij dhe as Libri prej të cilit e kishte dijen nuk përmenden. Ajo që dihet për të është se ishte besimtar dhe i lidhur me Allahun xh.sh, i begatuar nga Allahu me një sekret që i jep fuqi të jashtëzakonshme para të cilës nuk mund të ketë pengesa. Është gjë e dukshme kjo tek disa besimtarë të devotshëm. Sekreti i tij nuk është zbuluar dhe as është interpretuar sepse është jashtë parametrave të njohurive njerëzore, pra është mrekulli.

Këtu mbarojmë tregimin (për të mos kaluar në legjenda dhe bestytni!)

Disa mufessirë janë marrë me pjesën e ajetit: **“ishte i pajisur me dijen e Librit”** për çka kanë dhënë disa shpjegime të cilat nuk janë bindëse. Kanë thënë me qëllim se libri është Teurati. Të tjerë kanë thënë se ky njeri e dinte emrin më të madh të Allahut xh.sh. Kanë dhënë edhe mendime tjera. Çështja është me e lehtë se tërë kjo nëse e shikojmë nga një këndvështrim tjetër, ai i realitetit flet sa shumë të panjohura ka kjo botë, sa shumë gjëra që nuk i dimë, sa forca ka që nuk i shfrytëzojmë, sa shumë mundësi e kapacitet ka qenia njerëzore por që ende nuk është e vetëdijshme për të! Kështu, kur do Allahu udhëzon. Mrekullia shkon përtej të njohurës për njerëzimin! Së këndejmi, me lejen e Allahut dhe me ndihmën e Tij ndodhin gjëra për të cilat ne nuk kemi shpjegim! Burrin që kishte dije nga Libri, dija sekrete e lidhë me forcat kosmologjike nëpërmjet të cilave arrinë të realizojë mrekullinë e tij. Kjo për arsye se dija që posedonte ia kishte lidhur zemrën me Allahun xh. në mënyrë që të pranonte çdo fuqi dhe aftësi të

jashtëzakonshme që ia jep Allahu (gjëra që të tjerët nuk i kanë as që mund t'i shfrytëzojnë)¹.

Disa mufessirë kanë përmendur se ky njeri në fakt ishte vet Sulejmani a.s. por ne nuk mendojmë kështu. Po të kishte qenë Sulejmani a.s. konteksti do ta përmendte me emër dhe nuk do ta fshihte sepse tregimi është rreth tij dhe nuk ka nevojë të fshihet emri i tij pikërisht në këtë çast madhështor...²

“Kur (Sulejmani) e pa të vendosur para tij, tha: “Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues.”

Zemra e Sulejmanit ndjeu këtë befasi madhështore dhe përjetoi një lloj frike, ndërsa Allahu xh.sh. ia përmbushte kërkesat në formë të mbinatyrshme. Ai ndjeu se mirësia në këtë formë, ishte sfida më e madhe që kërkon vigjilencë për ta kapërcyer. Ai kishte nevojë për ndihmën e Allahut që të forcohej në këtë sprovë. Ai kishte nevojë ta njihte mirësinë dhe ti shprehte konsideratë Dhuruesit. Allahu nuk ka nevojë për njeriun! Njeriu për Allahun po! Allahu nuk ka nevojë as për falënderimin e

¹Tahir bin Ashuri ka thënë: “Debati ndërmjet Ifrit-it dhe njeriut që kishte dije nga Libri në fakt flet për atë se ajo që arrihet me urtësi është me e madhe se ajo që arrihet me forcë dhe se urtësia, referuar pjesës së ajetit: **“Po ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha...”**, është diçka që fitohet, përvetësohet; se fuqia e elementeve/komponentëve është e natyrshme në të; se përvetësimi i dijes është mënyrë e shfrytëzimit të forcave të cilat nuk mund ta shfrytëzojnë njëra tjetrën. Në këtë rrëfim u përmend një shembull se si dija dominon forcën. Duke qenë se këta dy burra (Ifriti dhe njeriu që kishte dije nga Libri) i ishin nënshtruar Sulejmanit a.s. atëherë dija me të cilën ishin veçuar dhe dalluar i detyrohet meritave dhe nderit të Sulejmanit a.s. të cilit Allahu xh.sh. i kishte dhënë forcë. Pozita e profetësisë së Sulejmani a.s. është më e lartë nga fronti mbretëror i Belkisës...2/270.

² Sejjid Kutubi, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2642.

askujt. Kështu, kush falënderon Allahun, i ka bërë mirë vetes sepse kështu tërheq më shumë të mira nga Allahu xh.sh. dhe fiton ndihmën dhe përkrahjen e Tij pa rezervë, në çdo sprovë. Allahu dhuron nga bujaria. Ai nuk ka nevojë për falënderime. Ai është Bujar dhe jep nga bujaria e Vet dhe jo që pret falënderimin për t'i dhënë dikujt ndonjë të mirë¹.

Tani që Sulejmani a.s. mësoi se mbretëresha do të arrinte së shpejti, filloi të përgadiste surpriza. Tha: **“Ndryshojeni edhe fronin e saj! Do të shohim se a do ta vërë re ajo këtë gjë.”** Ia ndryshuan disa gjëra që e identifikonin fronin dhe ishin karakteristika të tij për të parë nëse intuita dhe zgjuarsia do ta bënë ta njihnte fronin e vet.

Ky mund të kishte qenë një test i Sulejmanit a.s. për shkallën e pranimit të mrekullisë hyjnore (përmes zgjuarsisë dhe veprimeve të mëtejshme) nga ana e mbretëreshës, përgjatë surprizës me ndryshimin e fronit të saj².

¹Tahir bin Ashuri ka thënë: “Kur Sulejmani a.s. e përmendi mirësinë duke ia atribuuar atë Allahut xh.sh, deshi tua bëjë me dije se ai është më i vlerësuar për shkak se është rob i Zotit të vet. Avantazhi që kishte, ishte thjesht mirësi e Allahut ndaj tij dhe pavarësisht që u soll froni, as kjo dhe as mundësia e vartësve të tij për të bërë gjëra të tilla, nuk e magjepsi Sulejmanin a.s. përkundrazi, ai u largua në një qoshe dhe e falënderoi Allahun xh.sh. për të mirat që i kishte dhe për nënshttrimin e kësaj ushtrie me këtë dije dhe kapacitet kaq të madh, që flasin për vlerësimin maksimal të tij nga Allahu xh.sh. Sulejmani a.s. na ofroi një urtësi të lartë etike dhe fetare, atë se kush falënderon, falënderon për vete dhe se kush mohon, mohon prapë për vete, sepse Allahu është i pasur (dhe nuk ka nevojë për falënderime) dhe është bujar. Çdokush që bën vepër të mirë, duhet ta sjell ndërmend se vepra që bën është vetëm për të mirën e tij, me të cilën synon shpërblimin dhe kënaqësinë e Allahut dhe shpreson në vazhdimin e mirësisë së Allahut ndaj tij në dynja. Ky njeri përfiton të mira në të dy botët ndërsa Allahu xh.sh. nuk përfiton asgjë nga vepra e tij...20/274.

² Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2599-2643. **Parafrazim.**



Skena VI:

Skena në vijim paraqet mbretëreshën Belkisa që arrinë tek Sulejmani a.s. **“Kur erdhi ajo, i thanë: “I tillë është froni yt?” Ajo u përgjigj: “Duket sikur të ishte ai”.**”... Ashtu tha sepse ajo mbeti e shokuar nga një transformim i tillë i fronit të saj. Ajo e kishte lënë fronin në vendin e saj, të mbyllur me dry e të ruajtur nga ushtarët. Si mund të kishte ardhur në Kuds, në kryeqytetin e Sulejmanit? Kush mund ta kishte sjellur? Pastaj, pse i maskuar ishte froni i saj? A thua si do të reagonte ajo, ta mohonte (për shkak të kamuflimeve) apo të pranonte se ishte froni i saj (për shkak të ngjashmërive)? Ajo dha një përgjigje tejet të zgjuar, tha: **“Duket si të ishte ai.”** Pra, as nuk e pohoi, as nuk e mohoi. Kjo flet për nivelin e saj të lartë, për zgjuarsinë dhe mendjemprehtësinë për të pranuar një fakt pa kërkuar shpjegim!

Sulejmani a.s. i kishte përgatitur mbretëreshës edhe befasi tjera: **“Asaj i thanë të hynte në pallat. Kur e pa atë, ajo kujtoi se ishte ujë i thellë dhe përvoli fustanin te këmbët. Sulejmani i tha: “Ky pallat është i shtruar me xhama”. Ajo tha: “O Zoti im, me të vërtetë unë e paskam dëmtuar veten dhe tani, bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve!”**” Befasia ishte pallati i kristaltë, kati përdhesë i të cilit ishte ndërtuar mbi ujë. Dukej sikur të ishte ujë i thellë. Kështu, kur iu tha asaj që të hynte në pallat, ajo mendoi se do të hynte në këtë ujë, andaj përvoli fustanin deri te këmbët. Kur befasia ndodhi, Sulejmani a.s. i tregoi për sekretin: **“Ky pallat është i shtruar me xhama.”** Mbretëresha mbeti e shtanguar plotësisht para këtyre befasive të mbinatyrshme që ia kishte pregaditur Sulejmani a.s.

Kështu, mbretëresha iu bind Allahut, u pendua, duke pranuar padrejtësinë që i kishte bërë vetes duke adhuruar zota të rremë. Ajo pranoi Islamin (nënshttrimin) në prezencë të Sulejmanit a.s. Pranoi besimin e Zotit të Sulejmanit. Zemra e saj u ndriçua dhe

u udhëzua. Ajo e kuptoi se t'i nënshtrohesh Allahut do të thotë të mos i nënshtrohesh askujt tjetër qoftë ai dhe pejgamber si Sulejmani, profeti më i dalluar për nga mrekullitë e mbinatyrshme.

Islami nënkupton nënshttrim vetëm ndaj Allahut, Zotit të botëve. Islami thërret besimtarët në rrugë të barazisë..."**bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve!**" Kur'ani e ka regjistruar këtë detaj dhe e ka shpalosur atë për ta zbuluar natyrën e vërtetë të besimit në Zot dhe të nënshttrimin ndaj Tij. Besimi është krenari që ngre lartë të përulurit duke i barazuar me fitimtarët. Madje triumfuesi dhe i mposhturi bëhen vëllezër për hir të Allahut dhe si të tillë, të lidhur me besimin ndaj Zotit, bëhen të barabartë sa që mes tyre zhduket çdo vi ndarëse!

Paria mekase e kundërshtonte thirrjen e Muhammedit a.s. për Islam, për shkak të mendjemadhësisë, e cila i pengonte t'i nënshtrohen Muhammedit, të birit të Abdullahut, i cili do t'i udhëhiqte dhe do të kishte epërsi mbi ta. Kurse kjo grua, po u sillte një shembull superior, po i mësonte se Islami barazon thirrësit me të thirrurit, komandantët me ushtarët, liderët me popullin. Ajo po i mësonte ata se duke pranuar islamin, bashkë me Pejgamberin a.s. ata i nënshtrohen Allahut, Zotit të botëve!¹


Kështu erdhëm në fund të tregimit Kur'anor për lidërshtimin, tregim i mbushur plot e përplotë me mësimet e këshilla për këta dy mbretër dhe liderë të mëdhenj, shëmbëlltyra e të cilëve lutemi të shërbejë si model për të gjithë udhëheqësit e kësaj bote deri në amshim. Allahu e di më së miri!

Në grafikun mëposhtë sjellim tiparet më të theksuar të lidërshtimit të Davudit dhe Sulejmanit a.s:

¹ Shih: Sejjid Kutub, *Fi dhilal el-Kur'an*, 5/2599-2643. Parafrazim. Shihe dhe: Ibn Ashur, *Ettahrir ve ettenvair*, 20/274.


Tiparet më të theksuara të lidershipit *sulejmanian* dhe *davudian*

- pjesa e parë -



Tiparet më të theksuara të lidershipit

sulejmanian dhe davudian - pjesa e dytë -



Prof. Mahmud Ahmed Astali ka përmbledhur tiparet kryesore të lidershipit të drejtë të mbretëreshës Belkisa në tetë pika:

Tiparet më të theksuara të lidershipit belkizian

Belkisa nuk ngutet në marrjen e një vendimi. Ajo konsulton ekspertët për problematikën e shfaqur rishtazi.

Belkisa, mbretëresha e popullit Sebe' në Jemen, idhujtare. Pranon një letër nga Sulejmani a.s. me të cilën i bën thirrje ta pranojë Islamin dhe e kërcënon në rast refuzimi.

Komandantët dhe ushtria ia deleguan tërësisht të drejtën Belkisës, që ajo të merrte vendimin dhe nuk folën asgjë. Disa këtë heshtje e quajnë tradhti ndaj amanetit të këshillimit.

Pavarësisht se ishte mbretëreshë dhe ajo merrte vendimet, megjithëkëtë, Belkisa konsultoi parinë dhe suitën e saj.

Belkisa e merr me seriozitet dhe jo shpërfillje letrën dhe dërguesin e saj (Estetika e letres, stilit dhe lloji i çmuar i saj).

Belkisa kishte njohuri sa i përket profileve psikologjike të njerëzve dhe trajtimit të tyre. Ajo deshi ta testonte Sulejmanin a.s., nëpërmjet dhuratës që ia dërgoi. Në ishte peygamber, nuk e pranon dhuratën, në ishte mbret, po.

Belkisa erdhi personalisht që të bindet për drejtësinë dhe madhësitinë e Sulejmanit a.s. Ajo ishte kureshtare për mirëqenien e popullit dhe vendit të vet.

Rezultati: Belkisa iu përgjigj të vërtetës dhe iu nënshtrua Allahut bashkë me Sulejmanin a.s. Pushteti i saj i madh dhe forca e ushtrisë së saj nuk e ndaluan ta refuzonte shirkun dhe të pranoi besimin e pastër monoteist. Ajo nuk e pranoi fenë për hir të Sulejmanit por për hir të Allahut.

Zgjuarsia e Belkisës, e cila nuk shfaqti direkt dëshirën e saj për paqe me Sulejmanin a.s., por në mënyrë indirekte tregoi se, kur mbretërit hynë në një vend, e shkatërrojnë atë dhe i poshtërojnë parinë e atij vendi.

2.5.2. Modeli i mbretit Talut me ushtrinë e vet

Vazhdojmë të shtjellojmë aspektin këshillues në lidhshqipin motivues ushtarak sipas ajeteve Kur'anore.

Kur'ani na përshkruan shembullin e komandantit trim, mbretit të izraelitëve, të përzgjedhur dhe të përcaktuar nga Allahu xh.sh, mbretin Talut dhe modelin e tij motivues dhe këshillëdhënës ushtarak, për t'i bërë ballë armikut, edhe nëse ky i fundit i tejkalon ata shumëfish me ushtarë e armatim.

Për tu bindur se sa i përmbahen urdhrave të tij dhe si do t'i qasen rrethanave të vështira në luftë, mbreti Talut i testoi ushtarët duke kërkuar prej tyre që të pinin ujë nga lumi aq sa të shuanin etjen dhe hiç më shumë! Këtë model motivues të lidhshqipit, Kur'ani na e sjell në ajetet në vazhdim:

﴿فَلَمَّا فَصَلَ طَالُوتُ بِالْجُنُودِ قَالَ إِنَّ اللَّهَ مُبْتَلِيكُمْ بِنَهَرٍ فَمَنْ شَرِبَ مِنْهُ فَلَيْسَ مِنِّي وَمَنْ لَمْ يَطْعَمْهُ فَإِنَّهُ مِنِّي إِلَّا مَنِ اغْتَرَفَ غُرْفَةً بِيَدِهِ فَشَرِبُوا مِنْهُ إِلَّا قَلِيلًا مِّنْهُمْ فَلَمَّا جَاوَزَهُ هُوَ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا مَعَهُ قَالُوا لَا طَاقَةَ لَنَا الْيَوْمَ بِجَالُوتَ وَجُنُودِهِ قَالَ الَّذِينَ يَظُنُّونَ أَنَّهُم مُّكَلَّفُوا اللَّهَ كَرَمًا مِّنْ فَعَةٍ قَلِيلًا عَلِمْتُمْ فَعَةً كَثِيرَةً يَأْذِنُ اللَّهُ وَاللَّهُ مَعَ الصَّابِرِينَ ﴿٢١٩﴾ [سورة البقرة: 249].

“Kur Taluti u nis për luftë bashkë me ushtrinë, u tha atyre: “Allahu do t’ju provojë me një lumë. Kush pi ujë në të, nuk është ushtari im, ndërsa kush nuk pi ujë në të ose kënaqet vetëm me një grusht ujë, është ushtari im” 42. Por të gjithë pinë, përveç një pakice. Pasi ai me ata (ushtarë) që ishin besimtarë kaluan lumin, shumë prej tyre thanë: “Ne sot nuk kemi fuqi të luftojmë me Xhalutin dhe ushtrinë e tij”. Por ata që ishin të bindur se do të takoheshin me Allahun, thanë: “Sa herë, me ndihmën

e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit". [Bekare: 249]

Kur izraelitët protestuan ndaj përzgjedhjes së Talutit nga Allahut xh.sh. me justifikimin se Taluti nuk ishte i pasur, nuk ishte fisnik, nuk rridhte nga një familje me emër, Allahu xh.sh. ua bëri me dije se përzgjedhja ishte bërë mbi bazë të vlerave dhe të virtyteve të tij, që mes tjerash ishin dija dhe fuqia fizike. Pra, kriteret e Allahut dhe jo parapëlqimet e njerëzve!

Fatkeqësisht, këto parime, (të fokusimit në pasuri dhe në prejardhje familjare) udhëheqin edhe sot izraelitët, dhe sipas tyre janë kriteret në përzgjedhjen e udhëheqësve të tyre dhe jo sipas kriterëve të etikës, besimit, profesionalizmit, humanizmit! Kjo, jo vetëm që bie ndesh me fenë tonë dhe principet e shëndosha të Islamit, por është dhe një defekt i madh shoqëror, koston e të cilit po e paguan shtrenjtë njerëzimi!

Kur'ani i ka regjistruar këto kriteret materialiste të hebrenjve si patologjike duke kërkuar nga ne që të distancohemi dhe t'u shmangemi në jetën e përditshme, sot e përgjithmonë, deri në Kiamet. Mjerisht, kjo sëmundje është 'ngjitëse' dhe nga kjo janë infektuar edhe disa myslimanë, që njeriun e vlerësojnë sipas pasurisë, famës, pushtetit dhe prejardhjes familjare!

Ky nuk është thjesht një fenomen por një alarm për cunami moral e etik, i cili mund ta fundosë shoqërinë tërësisht, nëse nuk e ndryshon qëndrimin! Është shkarje shoqërore, etike dhe intelektuale dhe duhet një angazhim i gjithëmbarshëm, kolektiv, që korrigjohet vetëm duke zbatuar parimin Kur'anor, që thekson: devotshmërinë, moralin e mirë, diturinë, zgjuarsinë, kreativitetin, fuqinë fizike, korrektësinë, sinqeritetin, përkushtimin, vetëmohimin, sakrificën, dashurinë për fe, atdhe, prijës, lider. Ndryshe, çdo shmangie dhe devijim nga këto vlera

e principe është shmangie dhe devijim nga rruga e drejtë e Islamit!

Për këtë na mëson Kur'ani, pikërisht nëpërmjet gjuhës së izraelitëve dhe mbretit të tyre, Talutit:

﴿وَقَالَ لَهُمْ نَبِيُّهُمْ إِنَّ اللَّهَ قَدْ بَعَثَ لَكُمْ طَالُوتَ مَلِكًا قَالُوا أَنَّى يَكُونُ لَهُ الْمُلْكُ عَلَيْنَا وَنَحْنُ أَحَقُّ بِالْمُلْكِ مِنْهُ وَلَمْ يُؤْتَ سَعَةً مِنَ الْمَالِ قَالَ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاهُ عَلَيْكُمْ وَزَادَهُ بَسْطَةً فِي الْعِلْمِ وَالْجِسْمِ وَاللَّهُ يُؤْتِي مَلَكَهُ مَن يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٤٧﴾ [سورة البقرة: 247]

“Profeti i tyre u tha: “Allahu ka dërguar Talutin si mbretin tuaj.” Ata thanë: “Si mund të bëhet ai mbreti ynë, kur ne kemi më tepër merita se ai për të sunduar?! Përveç kësaj, ai nuk ka ndonjë pasuri të madhe.” Ai u përgjigj: “Allahu e ka zgjedhur atë për mbretin tuaj dhe e ka pajisur me dituri të gjerë dhe me fuqi të madhe fizike. Allahu ia jep pushtetin kujt të dojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.” [Bekare: 247]

Hoxha, AbduRrahman Sa’ di, duke e komentuar këtë ajet, thotë: **“Profeti i tyre u tha...”** si përgjigje ndaj kërkesës së tyre **“...Allahu ka dërguar Talutin si mbretin tuaj...”** përcaktimi ishte bërë nga Allahu xh.sh. andaj ishte detyrë për ta që ta pranonin, t’i bindeshin dhe të mos e refuzonin, por ata kundërshtuan duke thënë: **“...Si mund të bëhet ai mbreti ynë, kur ne kemi më tepër merita se ai për të sunduar?! Përveç kësaj, ai nuk ka ndonjë pasuri të madhe....”** pra, si mund të jetë mbret kur pozita e tij familjare është më e ulët se pozita jonë kështu që ne jemi më meritore në mbretëri se ai. Përveç kësaj, ai është i varfër, nuk ka pasuri të mjaftueshme për të ngritur mbretëri! *Ky ishte një perceptim i gabuar i tyre mbi mbretërinë dhe pushtetin.* Mendonin se ato nuk paramendoheshin pa pasuri dhe prejardhje familjare duke harruar se tiparet e vërtetat që

parashohin dhënien përparësi në pushtet janë më të rëndësishme dhe më me prioritet se këto. Për këtë shkak, Pejgamberi i tyre iu tha: “...Allahu e ka zgjedhur atë...” kështu që ua bëri obligim t’i bindeni dhe ta dëgjoni “...dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe me fuqi trupore...” e ka dalluar prej jush dhe e ka vlerësuar ndaj jush me dije dhe fuqi fizike. *Pra, i ka dhënë fuqinë e mendjes – dijen, dhe fuqinë e trupit, me të cilat organizohen dhe udhëhiqen punët e mbretërisë. Mungesa e ndonjëres prej këtyre dy tipareve prish balancin dhe ç’ekuilibron pushtetin. Fuqia fizike pa atë intelektuale shkakton kaos! Në këtë rast do të ketë fuqi por jo dhe urtësi. Edhe dija pa fuqi është e çalë!* Kjo dije nuk i shërben asnjë lloj lidërshipi! ¹

Izraelitët (*hebrejtë, jehuditë*) ekstremistë, siç dihet botërisht dhe historikisht Kur’ani na flet se ata kanë qenë, dhe janë njerëz problematikë, provokues konfliktesh e ngatërresash, thurin komplete e shkaktojnë kriza ekonomike e politike dhe këtë gjë e bëjnë që nga lashtësia, normal me përjashtim të atyre që nuk janë sionistë dhe ekstrem, që janë të moderuar dhe paqedashës, si p.sh.hebrenjë *Haredi* të grupit *Neturei Karta*. Këtë karakter ekstrem të tyre të lashtë e përshkruan Kur’ani:

﴿كُلَّمَا أَوْقَدُوا نَارًا لِلْحَرْبِ أَطْفَأَهَا اللَّهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ﴾

[سورة المائدة: 64]

“...Kurdo që ata ndezin zjarrin e luftës, Allahu e shuan atë. Ata përpiqen të shkaktojnë ngatërresa në Tokë, por Allahu nuk i do ngatërrestarët.” [Maide: 64]

Pas shqyrtimit dhe analizës së ajeteve Kur’anore ku trajtohet lidërshipi motivues luftarak, konkludojmë se lideri i duhur është ai që nxitë në durim dhe besim, në pritje për ndihmë nga Allahu

¹ Tefsiri i Sa’dit, f. 109.

xh. që t'i përforcojë me arsenal shtesë (engjëj, apo me ushtri që askush pos Tij nuk e di), sepse Allahu ka ushtri të tillë:

﴿... وَمَا يَعْلَمُ جُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ ﴿٣١﴾...﴾. [سورة المدثر: 31]

“...Askush tjetër, përveç Tij, nuk i di ushtritë e Zotit tënd...”

[Muddeththir: 31]


Pas kësaj, besimtarëve u mbetet për detyrë të luten për ndihmë, për forcim në fushëbetejë, për vazhdimësi të kësaj ndihme dhe këtij përforcimi sepse ndonjëherë mund të ndodhë që ndihma e Allahut të vjen shkurtë, nuk qëndron gjatë, për shkaqe dhe faktorë të shumtë, dhe mu për këtë shkak besimtarët duhet të luten dhe të thonë: *O Allahu ynë, na ndihmo dhe na përforco në rrugën tënde, para armikut, në çdo rast e në çdo moment. Na përforco zemrën dhe këmbët pa afat të caktuar!* ashtu siç Allahu na mëson në Kur'an:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَصُورُوا اللَّهَ يَنْصُرْكُمْ وَيُثَبِّتْ أَقْدَامَكُمْ ﴿٧﴾﴾ [سورة محمد: 7]

“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë juve dhe do t’ju bëjë të qëndroni fortë në këmbët tuaja.” [Muhammed: 7]

Në fund, Allahu e di më së miri!

Ti shohim në grafikë karakteristikat e lidërshipt të Talutit.



2.6. Liderशिpi dhulkarnejnian

Në kaptinën *Kehf*, Kurani na ka rrëfyer në detaje për rastin e mbretit dhe liderit të drejt, Dhulkarnejnit. Para se të shpalosim detaje, do t'i prezantojmë ajetet që flasin për Dhulkarnejnin, pushtetin, drejtësinë, udhëtimet dhe strategjitë e tij udhëheqëse në dhënien e ndihmës për nevojtarët, të dëmtuarit dhe të dobëtit. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ ذِي الْقَرْيَيْنِ قُلْ سَأَتْلُوا عَلَيْكُمْ مِنْهُ ذِكْرًا ﴿٨٣﴾ إِنَّا مَكَّنَّا لَهُ فِي الْأَرْضِ وَءَاتَيْنَاهُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ سَبَبًا ﴿٨٤﴾ فَاتَّبَعَ سَبَبًا ﴿٨٥﴾ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَغْرِبَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا تَغْرُبُ فِي عَيْنٍ حَمِئَةٍ وَوَجَدَ عِنْدَهَا قَوْمًا قُلْنَا يَا ذَا الْقَرْيَيْنِ إِنَّمَا أَنْ تُعَذِّبَ وَإِنَّمَا أَنْ تَتَّخِذَ فِيهِمْ حُسْنًا ﴿٨٦﴾ قَالَ أَمَّا مَنْ ظَلَمَ فَسَوْفَ نُعَذِّبُهُ ثُمَّ يُرَدُّ إِلَىٰ رَبِّهِ فَيُعَذِّبُهُ عَذَابًا نُكْرًا ﴿٨٧﴾ وَأَمَّا مَنْ ءَامَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَهُ جَزَاءٌ الْحَسَنُ وَسَنَقُولُ لَهُ مِنْ أَمْرِنَا يُسْرًا ﴿٨٨﴾ ثُمَّ اتَّبَعَ سَبَبًا ﴿٨٩﴾ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَطْلِعَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا تَطَّلِعُ عَلَىٰ قَوْمٍ لَمْ يَجْعَلْ لَهُمْ مِنْ دُونِهَا سِتْرًا ﴿٩٠﴾ كَذَٰلِكَ وَقَدْ أَحَطْنَا بِمَا لَدَيْهِ خُبْرًا ﴿٩١﴾ ثُمَّ اتَّبَعَ سَبَبًا ﴿٩٢﴾ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ بَيْنَ السَّدَّيْنِ وَجَدَ مِنْ دُونِهِمَا قَوْمًا لَّا يَكَادُونَ يَفْقَهُونَ قَوْلًا ﴿٩٣﴾ قَالُوا يَا ذَا الْقَرْيَيْنِ إِنَّا يَا جُوجَ وَمَأْجُوجَ مُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ فَهَلْ نَجْعَلْ لَكَ خَرْجًا عَلَيْنَ أَنْ نَجْعَلَ بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمْ سَدًّا ﴿٩٤﴾ قَالَ مَا مَكَّنِّي فِيهِ رَبِّي خَيْرٌ فَأَعِينُونِي بِقُوَّةٍ أَجْعَلْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ رَدْمًا ﴿٩٥﴾ ءَأَتُونِي زُبُرَ الْحَدِيدِ حَتَّىٰ إِذَا سَاوَىٰ بَيْنَ الصَّدَفَيْنِ قَالَ انْفُخُوا حَتَّىٰ إِذَا جَعَلَهُ نَارًا قَالَ ءَأَتُونِي أُفْرِغَ عَلَيْهِ قِطْرًا ﴿٩٦﴾ فَمَا اسْطَعُوا أَنْ يَظْهَرُوهُ وَمَا اسْتَطَعُوا لَهُ نُقْبًا ﴿٩٧﴾ قَالَ هَٰذَا رَحْمَةٌ مِنِّي فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ رَبِّي جَعَلَهُ دَكَّاءَ وَكَانَ وَعْدُ رَبِّي حَقًّا ﴿٩٨﴾ وَتَرَكْنَا بَعْضَهُمْ يَوْمَئِذٍ يَمُوجُ فِي بَعْضٍ وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَجَمَعْنَاهُمْ جَمَاعًا

﴿سورة الكهف: ٨٣ - ٩٩﴾

“Ata (hebrenjtë) të pyesin ty (Muhamed) për Dhulkarnejnin, thuaj: “Unë do t’ju tregoj disa lajme për të.” 84. Ne i dhamë atij mundësi në Tokë dhe i dhamë mjete e rrugë për të arritur çdo gjë, 85. kështu që ai

u nis në një rrugë. 86. Kur arriti në vendin e perëndimit të Diellit, pa se ai po ulej në një burim të zi balte dhe në afërsi të tij gjeti një popull. Ne thamë: “O Dhulkarnejn, mund t’i ndëshkosh ata ose mund t’u bësh mirë atyre.” 87. Ai tha: “Sa i përket atij që bën të këqija, Ne do ta ndëshkojmë e pastaj do të kthehet te Zoti i vet, i Cili do ta ndëshkojë me një dënim të rëndë. 88. Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe atij do t’i premtojmë lehtësira.” 89. Pastaj ndoqi një rrugë tjetër. 90. Kur arriti në vendin e lindjes së Diellit, Ai e pa të lindte mbi një popull, të cilit Ne nuk i kishim dhënë gjë, për t’u mbrojtur nga dielli. 91. Kështu ndodhi dhe Ne dinim gjithçka për të. 92. Pastaj mori një rrugë tjetër. 93. Derisa, kur arriti në mes dy malesh, gjeti rrëzë tyre një popull, i cili pothuajse nuk kuptonte asnjë të folme. 94. Ata thanë: “O Dhulkarnejn, vërtet, Jexhuxhët dhe Mexhuxhët janë ngatërrestarë në Tokë. A të të japim një pagesë që të ngresh një pendë midis nesh dhe atyre?” 95. Ai tha: “Ajo që më ka mundësuar Zoti im është më e mirë (se pagesa juaj), por më ndihmoni mua me krahë! -fuqi punëtore- Do të ndërtoj një pendë midis jush e atyre. 96. Më sillni blloqe hekuri!” Dhe, kur ai i rrafshoi dy anët e thepisura të maleve, tha: “Fryjini zjarrit, derisa hekuri të skuqet si zjarri.” Pastaj tha: “Më sillni bakër të shkrirë që ta hedh sipër.” 97. Kështu, ata (Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët) nuk mundën më të kapërcejnë pendën as të hapnin vrimë në të. 98. Ai tha: “Kjo është mëshirë nga Zoti im! Kur të vijë premtimi i Zotit tim, Ai do ta rrafshojë atë (pendën). Premtimi i Zotit tim është (gjithnjë) i vërtetë. 99. Atë Ditë, Ne do të bëjmë, që të vërshojnë njëri mbi tjetrin si valët (e detit) dhe do t’i fryhet Surit e do t’i tubojmë, që të gjithë së bashku.” [Kur’ani: Kehf: 83-99]

Rrëfimi për Dhulkarnejnin nëpërmjet shpjegimeve të mufessirëve

2.6.1. Komentimi i përgjithshëm i ajeteve

Ithtarët e Librit ose idhujtarët e kishin pyetur Muhamemdin a.s. për rrëfimin e Dhulkarnejnit ndaj Allahu xh.sh. e urdhëroi t'iu thoshte:

“...Unë do t’ju tregoj disa lajme për të...” - pra do t’iu rrëfej për ngjarjen e tij dhe atë që mund të shërbejë si mësim e këshillë prej jetës së tij. **“...Ne i dhamë atij mundësi në Tokë...”** –Allahu e bëri mbret dhe i dha pushtet mbi shumë vende duke i bërë ato nën sundimin e tij. **“...i dhamë mjete e rrugë për të arritur çdo gjë...”** – Allahu xh.sh. i dha mjete për të arritur atë që kishte arritur, mjete për të pushtuar vendet dhe për të arritur me lehtësi deri në pjesët më të largëta të tokës. Këto mjete janë të përshkuar kështu, ndryshe detaje se si kanë qenë nuk i dimë meqë as Allahu xh.sh. dhe as i Dërguari i Tij, Muhammedi a.s. nuk na kanë rrëfyer për to. Kështu, nuk kemi pse të gjurmojmë se si kanë qenë dhe aq më pak t’i referohemi *israilijateve*¹ për të mësuar se si kanë qenë ato.

“...Kur arriti në vendin e perëndimit të Diellit, pa se ai po ulej në një burim të zi balte dhe në afërsi të tij gjeti një popull...” – Nga forma se si përshkruhen mundësitë dhe të arriturat e Dhulkarnejnit, mund të themi se mjetet e tij kanë qenë të jashtëzakonshme dhe se në bazë të tyre ai kishte një ushtri të

¹ Burime dhe informacione nga, apo; të Ehlul Kitabit-pasuesit e Librit (*Hebrenjtë dhe të Krishterët*), gje që nuk lejohet. Në këtë kontekst bejnë përjashtim informacionet të cilat nuk bien ndesh dhe nuk kontradiktohen me burimet e fesë sonë islame, Kur’anin dhe Synetin.

sofistikuar me të cilën mposhte armiqtë dhe arrinte në lindje e perëndim dhe në pjesë tjera të tokës me lehtësi¹. Ajeti: **“...Kur arriti në vendin e perëndimit të Diellit, pa se ai po ulej në një burim të zi balte dhe në afërsi të tij gjeti një popull...”** ka kuptimin: ai ndoqi një rrugë që e shpiu tek qëllimi që kishte dhe kur arriti në përfundim të tokës, kah ana perëndimore atje ku nuk ka më tokë por është vetëm oqeani Atlantik, pra duke kaluar nëpër vendet e perëndimit: Tunizi, Algjeri, Marok, gjeti diellin tek perëndonte tek një burim me baltë të zezë. Kjo është ajo që vërehej ndërsa pllaka e diellit perëndonte në bregdetin e oqeanit të përzier me rërë dhe baltë të zezë. Pikërisht atje, në pjesën më të largët të perëndimit tek ai burim me baltë të zezë gjeti një popull të madh mohues të Zotit. **“...Ne thamë: “O Dhulkarnejn, mund t’i ndëshkosh ata ose mund t’u bësh mirë atyre.”...”** – E frymëzuam duke i thënë: para vetes ke dy mundësi: o t’i ndëshkosh duke i mbytur për shkak të këmbëngulësisë së tyre në pabesim, ose t’iu bësh mirë dhe t’i durosh duke i thirrur në fe, duke ua dëftuar rrugën e drejtë dhe duke ua mësuar parimet fetare. **“...Sa i përket atij që bën të këqija, Ne do ta ndëshkojmë e pastaj ai do të kthehet te Zoti i vet, i Cili do ta ndëshkojë me një dënim të rëndë...”** – Dhulkarnejni u tha asistentëve të vet: Sa i përket atyre që i kanë bërë vetes padrejtësi duke mos hequr dorë nga pabesimi dhe nuk kanë pranuar fenë, do t’i ndëshkojmë në dynja duke i vrarë, ndërsa në ahiret do ta kenë dënimin tjetër në xhehenem. **“...Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe atij do t’i premtojmë lehtësira.”...”** – Ndërkaq sa u përket atyre që e kanë besuar Allahun, e kanë pranuar thirrjen dhe kanë bërë vepra të mira në përputhje me besimin, ata për shpërblim do ta kenë xhenetin. Me të tillët do të sillemi butë dhe lehtë, do t’i nxisim

¹ AbduRrahman Sa’di, *Tejsir el-Kerim err-Rrahman fi tefsiri kelami el-Mennan*, 1/486.

dhe motivojmë për fe me lehtësi, që ta duan fenë dhe që t'i përfillin detyrimet fetare, namaz, agjërim, zekat, etj. Të tillët nuk do t'i ngarkojmë me detyra të rënda por të lehta¹.

"...Pastaj ndoqi një rrugë tjetër. Kur arriti në vendin e lindjes së Diellit, Ai e pa të lindte mbi një popull, të cilit Ne nuk i kishim dhënë gjë, për t'u mbrojtur nga dielli..." – pastaj ndoqi një rrugë tjetër duke u drejtua prej perëndimit të diellit kah lindja e tij. Kur arriti tek vendi ku lindte dielli, hasi në një popull të zhveshur, nuk kishin asnjë rrobë mbi trup shkak i nxehtësisë së madhe të diellit. Nuk kishin as shtëpi, ndërtesa, plantacione. Bënin jetë nën qiell të hapur pa asnjë vendstrehim ndërsa për ushqim kryesisht e kishin peshkun.

"...Kështu ndodhi dhe Ne dinim gjithçka për të..." – Ne dinim paraprakisht çdo gjë për Dhulkarnejnin andaj edhe e bëmë mbret dhe Ne dimë gjithçka për të dhe jemi në vëzhgim të çdo gjëje që bën ai. Asgjë nuk na fshihet Neve...² **"...Pastaj mori një rrugë tjetër. Derisa, kur arriti në mes dy malesh, gjeti rrëzë tyre një popull, i cili pothuaj nuk kuptonte asnjë të folme..."** – Pastaj ai ndoqi rrugën e tretë duke u drejtuar nga lindja në veri. Kur arriti në një vend ndërmjet dy kodrave ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit, gjeti një popull të cilët, për shkak të gjuhës së tyre të rrallë dhe nivelit të ultë të inteligjencës, nuk kuptonin të folmen e të tjerëve. Ata ishin sllavë që banonin në pjesën lindore të Detit të Zi, në një vend ndërmjet dy kodrave, në afërsi të qytetit Derbent (sot në Rusi). Ata thanë:

"...O Dhulkarnejn, vërtet, Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët janë ngatërrestarë në Tokë. A të të japim një pagesë që të ndërtosh një pendë midis nesh dhe atyre?..." – Dhulkarnejni, me dhuntitë që i kishte dhënë Allahu xh.sh. arriti ta kuptonte të

¹Zuhajli, *Et-Tefsir el-munir fi el-akideti ve esh-sherhati ve el-menhexh*, 16/25.

²Po aty, 16/26.

folmen e tyre. Ata i kërkuan që të ndërtonte një pendë që të shkëpusnin kontaktin e tyre me dy fise shkatërrimtare, Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët. Ata madje kërkuan që ta kompensonin materialisht që ta ndërtonte një mur apo pendë që do t'i pengonte ato dy fise të arrinin tek ata¹. **"...Ai tha: "Ajo të cilën ma ka mundësuar Zoti im, është më e mirë (nga pagesa juaj), por më ndihmoni mua me krahë!(fuqi punëtore) Do të ndërtoj një pendë midis jush e atyre..."** – Dhulkarnejni iu tha: pushtetin, mundësitë dhe pasurinë që mi ka dhënë Allahu xh.sh. janë më me vlerë se kjo që po më ofroni, mu ashtu siç Sulejmani a.s. pati thënë kur Belkisa i ofroi pagesë:

﴿أَتُمِدُّونَ بِمَالٍ فَمَا آتَيْنَاهُ اللَّهُ خَيْرٌ مِّمَّا آتَاكُمْ﴾ [سورة النمل: 36]

"...A mos doni të më ndihmoni me pasuri?! Ajo që më ka dhënë Allahu është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve..." [Kur'ani: Nemi: 36]

Ajo që kërkoi prej jush, u tha Dhulkarnejni, është të më ndihmoni me fuqi puntore dhe me mjete ndërtimi, në mënyrë që të ngre mes jush dhe atyre një pengesë, një pendë, që do t'ua pamundësonte atyre qasjen me ju. Më saktë, iu kërkoi:

"...Më sillni blloqe hekuri!" Dhe, kur ai i rrafshoi dy anët e thepisura të maleve, tha: **"Fryjini zjarrit, derisa hekuri të skuqet si zjarri."** Pastaj tha: **"Më sillni bakër të shkrirë që ta hedh sipër..."** – kur ia sollën këto, ai filloi me ndërtimin e pendës ndërmjet dy kodrave. Kur ndërtimi arriti në nivel të kodrave, ai kërkoi bakrin e shkrirë të cilin ia hodhi hekurit të nxehtë për ta forcuar kështu dhe për të mbyllur zbrazëtitë e hekurit². **"...Kështu, ata (Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët) nuk mundën që ta kapërcenin pendën dhe as nuk mundën që të hapnin vrimë në të..."** – ata nuk patën mundësi të hipin mbi

¹Zuhajli, *Et-Tefsir el-munir fi el-akideti ve esh-sheriatu ve el-menhexh*, 16/26.

²Po Aty, 16/28.

pendë, pasi ajo ishte e lartë dhe e rrëshqitshme, siç nuk patën mundësi as ta shpojne poshtë e të bëjnë vrime, për shkak se ishte e padepërtueshme. Kështu, Allahu i shpëtoi ata dhe popujt përreth prej të këqijave të atyre dy fiseve.

Kur Dhulkarnejni e mbaroi këtë punë, tha:

“...Kjo është mëshirë nga Zoti im! Kur të vijë premtimi i Zotit tim, Ai do ta rrafshojë atë (pendën). Premtimi i Zotit tim është (gjithnjë) i vërtetë...” – Kjo pendë është mëshirë dhe shenjë treguese e mëshirës së Allahut xh.sh. me atë popull. Por kur të vjen koha e caktuar për daljen e atij populli, Allahu xh.sh. do ta rrafshojë me tokë atë pendë, sepse premtimi i Zotit për daljen e atyre fiseve dhe rrafshimin e kësaj pende është i vërtetë dhe patjetër do të ndodhë!

Në gjysmën e shekullit të shtatë Hixhrij, tatarët dhe mongolët sulmuan botën islame, e shkatërruan atë duke shkaktuar edhe rënien e Bagdadit në vitin 565 h. Rrethi është zgjeruar dhe është rritur (penda ka filluar të çahet), ashtu siç qëndron në ajetin vijues (99): **“...Atë Ditë, Ne do të bëjmë, që të vërshojnë njëri mbi tjetrin si valët (e detit) dhe do t’i fryhet Surit e do t’i tubojmë, të gjithë së bashku.”** Atë ditë kur do të dalim Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët, ne do t’i lëmë disa njerëz të trazohen, çrregullohen dhe të përzihen me njëri-tjetrin që për pasojë vrasjet do të shtohen, të lashtat do të shkatërrohen, pasuritë do të shpërdorohen. Kështu thotë dhe ajeti 96 i kaptinës Enbija:

[96: ﴿حَتَّىٰ إِذَا فُتِحَتْ يَأْجُوجُ وَمَأْجُوجُ وَهُمْ مِّن كُلِّ حَدَبٍ يَنْسِلُونَ﴾ [الأنبياء: 96]

“Dhe, kur të dalin Jexhuxhët dhe Mexhuxhët e të shpejtojnë prej çdo lartësie.”

E tërë kjo do të ndodhë para kataklizmës dhe para fryrjes në sur. Mufessirë të tjerë konsiderojnë se ata do të trazohen e përzihen

në Ditën e Kiametit siç ndodhë me valët e detit. Kurtubiu e përzgjedh për të saktë mendimin që thotë: Ne i kemi lënë Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët të përzihen me njëri-tjetrin në kohën e plotësimit të pendës¹.

Këtu mbaron komentimi i përgjithshëm i ajeteve që flasin për Dhulkarnejnin.

2.6.2. Shkaku i zbritjes së ajetit 83 nga kaptina Kehf:

Metodologjia Kur'anore e ligjësimit të normave dhe përmendjes së rrëfimeve të popujve të mëparshëm dhe ngjarjeve e ndodhive që i kanë paraprirë dërgimit të Muhammedit a.s., dhe zbritja e ajeteve kur'anore përkitazi me ato raste; lidhet zakonisht me pyetje që i janë parashtruar Muhammedit a.s. nga idhujtarët, kurejshët, çifutët, të krishterët e ndonjëherë edhe nga disa besimtarë. Prandaj njohja e shkakut të zbritjes së ajetit kur'anor na mundëson kuptimin më të drejtë të ajetit kur'anor.

Kur'ani na shpalosë pyetje të tilla që i janë bërë Muhammedit a.s. në plot katërmbëdhjetë vende dhe të cilat përfshijnë çështje të ndryshme: *kiametin, bonjakët, prenë e luftës, shpirtin, verën, bixhozin dhe për Dhulkarnejnin* (shqip: **dybrirëshin**).

Nga ajo që kam lexuar në librat që trajtojnë shkaqet e zbritjes së ajeteve dhe nga komentuesit e Kur'anit, klasikë e modernë, nuk kam gjetur ndonjë transmetim të saktë që flet për shkaqet e zbritjes së këtyre ajeteve - ky është mendimi që e mban *xhumhuri*

¹ Shih: Zuhajli, *Et-Tefsir el-munir*, 16/29; Tefisi i Sa'dit, 1/486.

i mufessirëve (pjesa dërmuese e komentuesve të Kur'anit). Ekzistojnë disa transmetime të gjata por të cilat nuk kanë rrugë të pranueshme të transmetimit, pra janë të dobëta dhe kryesisht janë *israilijate*. Ky është mendimi që ndajnë shumë mufessirë, në mesin e të cilëve dy imamët e tefsirit, Imam Taberiu dhe Imam Ibën Kethiri kur flasin për shkaqet e shpalljes së kaptinës Kehf në përgjithësi. Disa prej këtyre transmetimeve kanë përmendur rrëfimin e Dhulkarnejnit siç p.sh. gjejmë tek Imam Sujuti dhe Ibën Haxher Askalani. Ky i fundit, në librin *Muvafekatu el-hubri el-habere fi tahrixhi ehadithi el-muhtesar* (موافقة الخبر الخبير في تخریح أحاديث المختصر)¹ e ka përmendur transmetimin në vijim:

Ibën Abbasi r.a. përcjell se idhujtarët kurejshë i kishin dërguar Nadr bin Harithin dhe Ukbe bin Ebi Muajtini tek rabinët çifutë në Medinë dhe iu kishin thënë: Pyetni për të dhe ua rrëfoni atyre lajmin e tij dhe ua përshkruani fjalët e tij sepse ata janë ithtarët të librit të parë dhe kanë dije të Pejgamberëve që ne nuk kemi. Nadri dhe Ukbe shkuan në Medinë dhe i pyetën rabinët për Muhammedin a.s. dhe iu rrëfyan atyre për fjalët që propagonte Muhammedi a.s. Rabinët u thanë: Pyeteni për tre gjëra, nëse iu tregon për to, dijeni që është pejgamber i dërguar nga Allahu xh.sh. Ndryshe (nëse nuk ju jep përgjigje), dijeni se është mashtrues. Pyeteni për disa djelmosha nga e kaluara që u larguan, cila është puna e tyre, sepse rrëfimi i tyre është interesant. Pyeteni edhe për një njeri që ka shëtitur lindjen dhe perëndimin, cilat janë lajmet për të? Pyeteni edhe për shpirtin çfarë është ai? Pas kësaj, ata u kthyen në Mekke dhe iu drejtuan kurejshëve: O kurejshë, ne kemi gjërat që janë vijë ndarëse ndërmjet nesh dhe Muhammedit. Rabinët na urdhëruan ta pyesim Muhammedin për tre gjëra. Shkuan tek Pejgamberi a.s.

¹ Ahmed bin Ali bin Haxher el-Askalani. Ver. shkenc: Hamdi bin Abdul Mexhid es-Selefi dhe të tjerë. (Rijad: Mektebetu err-rrushd, ed. 3, 1419 h.), 2/70. Hadithi, siç qëndron në www.dorar.net, është *garib*.

dhe ia shtruan këto pyetje. Nesër do t'ua kthej përgjigjet – iu tha, por pa thënë *insha Allah*¹ (nëse do Allahu). Por përgjigja u shty për pesëmbëdhjetë ditë sepse Allahu xh.sh. nuk i shpalli asgjë dhe Xhibrili a.s. nuk i vinte. Pejgamberi a.s. u mërzit shumë. Banorët e Mekkes i bënë presion, na premtoi një natë, ja u bënë pesëmbëdhjetë e nuk ka përgjigje. As sot nuk po na jep përgjigje. Atëherë zbriti Xhibrili me kaptinën *Kehf*, në fillim të së cilës Allahu xh.sh. e qortoi Muhammedin a.s. pse ishte pikëlluar për shkak të fjalëve të tyre, për t'ia shpalosur më pas rrëfimin për djelmoshat e shpellës, për Dhulkarnejnin dhe për çështjen e shpirtit². Allahu e di më së miri!

Prof. Sejjid Kutubi përkitazi me këtë thotë: *“Për shkak të transmetimeve të shumta, preferojmë të fokusohemi vetëm në tekstin Kur’anor në të cilin nuk ka dyshim. Prej ajetit kuptojmë se ishte bërë një pyetje për Dhulkarnejnin por se kush e kishte bërë këtë nuk e dimë. Madje edhe po ta dinim nuk është se rrëfimit do t'i jepte ndonjë dimension shtesë. Kështu, t'i qasemi tregimit pa asnjë shtesë. Teksti Kur’anor nuk na ofron asnjë detaj lidhur me personalitetin e Dhulkarnejnit dhe as për kohën apo vendin ku ka jetuar. Ky është elementi konsekuent i rrëfimeve Kur’anore. Ajo që synohet në këto tregime nuk është shënimi historik por mësimi dhe urtësia që përfitohen prej tyre³.*

Jam i bindur që mendimi i prof.Sejjid Kutubit është i qartë dhe i mjaftueshëm për rastin dhe temën në fjalë.

¹ Shihe kuptimin e kësaj fraze si koncept në fund të librit. **Përkthyesi.**

² Sujuti, *Lubabu en-nukul fi esbabi en-nuzul*, f. 168.

³ Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur’an*, 1/2714.

2.6.3. Prezantim shkencor dhe metodologjik përkitazi me mënyrën e trajtimit të historisë njerëzore dhe rrëfimeve historike në Kur'anin Fisnik

Ne këtë pikë duam t'ju ofrojmë një përmbledhje rregullash shkencore dhe metodologjike përkitazi me trajtimin e historisë dhe rrëfimet historike në Kur'anin Fisnik. Rregulla të një rëndësie të veçantë, veçmas për studjuesit por dhe për besimtarët që synojnë gjithmonë të vërtetën. Konsideroj se nga të gjithë, prof.Sejjid Kutubi ka bërë trajtimin më të bukur dhe më kuptimplotë, duke treguar epërsi në këtë pikë ndaj mufessirëve klasikë dhe bashkëkohorë. Në tefsirin e tij *Fi dhilal el-Kur'an*, ai thotë: *“Historia e kodifikuar njeh një mbret me emrin Aleksandër Dhulkarnejni që, pa asnjë dyshim, nuk ka të bëjë asgjë me Dhulkarnejnin të cilin e përmend Kur'ani. Aleksandri grek ka qenë idhujtar ndërsa ky për të cilin na flet Kur'ani ka qenë besimtar që ka besuar në Allahun, në ringjalljen dhe në botën tjetër. Astrologu, Ebu Rejhan Bejruni, në librin El-athar el-bakije an el-kurun el-halije (الأثار الباقية عن القرون الخالية) thekson: Dhulkarnejni që përmendet në Kur'an, vështruar sipas emrit, ka qenë nga Himjeri. Kjo për arsye se mbretërit e Himjerit thirreshin kështu: Dhu, si: Dhu Nuvas, Dhu Jezen. Emrin e plotë e kishte Ebu Bekir bin Afrîksh. Me ushtrinë kishte kaluar përgjatë brigjeve të Detit të Bardhë. Kishte kaluar kah Tunizia, Maroku dhe vende tjera. Ai kishte ndërtuar një qytet afrikan ndërsa i tërë kontinenti ishte quajtur sipas tij.*

Kjo edhe mund të jetë e vërtetë por nuk kemi se si ta testojmë. Kjo për arsye se ne nuk mund të hulumtojmë në historinë e atij që Kur'ani na ka rrëfyer shumë pak për të ashtu siç na ka rrëfyer pak edhe për popujt e Nuhut a.s., Hudit a.s., Salihut a.s. etj. Historia e shënuar, krahasuar me historinë e njerëzimit, është relativisht e re. Kanë ndodhur shumë gjëra para se historia të ketë filluar të shënohet. Kështu që ai nuk është

që pyet për këto gjëra. Sikur Teurati (Dhiata e Vjetër) të mos shtrembërohej e të mos devijojë, do të mund të ishte referencë për disa nga këto ngjarje por ai është ngulfatur nga legjendat që dihet mirëfilli se janë të pavërteta, sikur që është ngarkuar me transmetime që pa fije dyshimi i janë shtuar versionit origjinal të shpallur nga Allahu xh.sh. Përfundimisht, Teurati nuk mund të merret për burim të besueshëm për ngjarjet historike që përmenden në të¹. Së këndejmi, përveç Kur'anit Fisnik i cili i ka shpëtuar ndryshimit dhe shtrembërimit, nuk kemi ndonjë burim tjetër të cilit mund t'i referohemi për rrëfimet historike. Ekzistojnë dy arsye pse Kur'ani nuk mund të gjykohet nga historia:

- 1) Historia (e shënuar) është relativisht e re që nënkupton se shumë ngjarje që kanë ndodhur nuk janë shënuar. Kur'ani i përmban disa nga këto ngjarje për të cilat historia nuk ka asnjë të dhënë.
- 2) Edhe nëse historia ka arritur t'i shënojë disa ngjarje, atëherë, marrë parasysh njeriun dhe mangësitë e tij, të cilat doemos reflektojnë dhe në punën dhe veprimtarinë e tij. Ne sot në kohën e zhvillimit të paparë të mjeteve të komunikimit jemi dëshmitarë se si një ngjarje trajtohet nga aspekte të ndryshme, jo rrallë kundërthënëse. Fatkeqësisht, nga ky piring bëhet historia, pavarësisht se çfarë thuhet më pas për vlerësim apo verifikim...²

Kështu, të thuhet se historia duhet të pyetet për rrëfimet e Kur'anit është diçka që para kredos islame e mohon edhe vet logjika, sepse rregullat metodologjike të vëna nga shkencëtarët e mohojnë një gjë të tillë. Pyetësit pyetën për Dhulkarnejnin, e pyetën Muhammedin a.s. ndërsa Allahu xh.sh. i shpalli këtë që përmendet këtu (në kaptinën Kehf). Për këtë biografi ne nuk kemi burim tjetër kështu që nuk kemi si t'i qasemi asgjëje për më shumë informacione. Në tefsire janë përmendur mendime të ndryshme por jo të mbështetura, të cilat duhen marrë me rezervë për shkak të israilijateve dhe miteve që përmbajnë!

¹ Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur'an*, 1/2710.

² Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur'an*, 1/2711.

Në kontekstin Kur'anor janë përshkruar tre udhëtime të Dhulkarnejnit: i pari në perëndim, i dyti në lindje dhe i treti ndërmjet dy pendave... Kështu, le t'i mbesim besnik këtij konteksti në përshkrimin e këtyre tre udhëtimeve¹."

2.6.4. Mendimi i përzgjedhur përkitazi me emrin e mbretit ose profetit të quajtur Dhulkarnejn? Kush është ai dhe gjeografikisht ku ndodhet penda e përmendur në Kur'an?

Mufessirët kanë dhënë mendime të ndryshme dhe kontradikte sa i përket personalitetit, përkatësisë, vendit dhe kohës kur ka jetuar Dhulkarnejni. Gjatë shfletimit të tefsireve klasike dhe bashkëkohore² kemi gjetur mendime dhe qasje nga më të ndryshmet.

Prej mufessirëve që kanë ofruar shpjegime për mua logjikisht të pranueshme dhe të cilat nuk ndeshen me tekstet Kur'anore, e që edhe personalisht i kam përvetësuar shpjegimet e tij si qëndrim, është Tahir bin Ashur, i cili në tefsirin e tij *Et-tahrir ve et-tenvir* ka thënë:

"..Mufessirët nuk janë të një mendimi sa i përket faktit se kush është Dhulkarnejni. Ky dallim në mendime është mbase shkak i informacioneve të marra nga rrëfimet dhe historia apo dhe për shkak të dallimeve të rrëfimitarëve³ të cilët kanë shfaqur interesim të shkujdesur e jo verifikues karshi kodifikimit të ngjarjeve dhe

¹ Po aty, 1/2711-2712, parafrazim.

² Shih: Tefsiri i Taberit, 26/94; Tefsiri i Rrazit, 21/164-165; Tefsiri i Kurtubiut, 13/364-365; Tefsiri i Ibën Kethirit, 5/189; Tefsiri i Kasimiut: *Mehasin et-Te'vil*, f. 4099; Tefsiri i Sa'dit, f. 458; Tefsiri i Zuhajlit: *Et-tefsir el-munir*, 6/16-21.

³ Është koncept, kuptimin e të cilit e gjeni në fund të librit. Përkthyesi.

ndodhive të çlirimtarëve. Kështu ata deshën ta trajtojnë këtë tregim nga ky prizëm¹.

Këtu kanë pikënisjen mendimet që provojnë të përcaktojnë se kush ishte *Dhulkarnejni*:

- Sipas mendimit të parë, ai ishte Aleksandri nga Maqedonia, i biri i Filipit. Në arsyetimin se pse ka marrë nofkën *Dhulkarnejn* (dybrirësh) kanë thënë se ai kishte ndarë gërshetuar flokët në formë të bririt. Apo se gjatë luftës mbante në kokë një helmetë me dy brirë. Disa kanë thënë se në kohën kur e sundonte Egjiptin në monedhat e tyre kishte vizatuar veten me dy brirë duke tentuar t'i përngjajë idhullit të egjiptianëve, *amonit*.
- Mendimi i dytë thotë se Dhulkarnejni ishte mbret nga Himjeri që quhej Tubbeë Ebu Kerb.
- Sipas mendimit të tretë, Dhulkarnejni ishte persian, pra mbret persian, që quhej Afridon bin Athfijan bin Xhemshid.

Këto janë mendimet më të qarta ndërsa mendimeve tjera nuk duhet referuar dhe aq më pak saktësuar transmetimet e tyre².

¹Shih: Tahir bin Ashur, *Ettahriru ve ettenviru*, 16/18.

²Shih: Tahir bin Ashur, *Ettahriru ve ettenviru*, 16/18-19.

Mendimi më i saktë sipas Ibën Ashurit

Nëse shqyrton rrëfimin detajisht, lehtë e ke për të përfunduar se Dhulkarnejni nuk ka qenë Aleksandri maqedonas për shkak se ky i fundit nuk ishte mbret i devotshëm por mbret idhujtar dhe si i tillë nuk ishte i denjë për t'iu shpallur nga Allahu xh.sh. Kjo nuk do të thotë se ai nuk kishte vlera tjera! Po kështu, në historinë e tij nuk përmendet se ai ka ndërtuar ndonjë pendë ndërmjet dy vendeve...¹

Unë mendoj, vazhdon Tahir bin Ashuri, se ai ishte mbret kinez dhe këtë për arsytet në vijim:

- 1) Që nga lashtësia kinezët njihen për menaxhim dhe zanate (industri).
- 2) Shumica e mbretërve kinezë ishin të drejtë dhe dinin të menaxhonin me mbretëri.
- 3) Ishte karakteristikë e tyre të rrisnin flokët dhe t'i ndanin në dy gërsheta. Nga ky aspekt shfaqet përshkrimi i tij si Dhulkarnejn ose dybrirësh.
- 4) Kina bashkë me viset e mongolëve disponojnë me rezervat më të mëdha në botë të bakrit dhe plumbit. Ky është një fakt i pranuar gjithandej bazuar në hadithin e Ummu Habibes r.a. nga Zejneb bint Xhahsh r.a. se Pejgamberi a.s. kishte dalë një natë dhe kishte thënë: *Mjerë për arabët për sherrin që po iu afrohet! Sot është hapur*

¹Po aty, 16/20.

një e çarë në digën e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve! – duke bërë më pas një rreth me gishtin e mesëm dhe gishtin tregues¹.

- 5) Krenaria e pushtetit të arabëve mori fund në duart e mongolëve kur pushtuan Bagdadin. Kështu mongolët u identifikuan si Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët ndërsa diga e përmendur në Kur'an si diga që ndan viset mongole nga Kina. Ai që ndërtoi digën ishte një mbret. Ajo që duhet të kemi parasysh është se emërtimi që Kur'ani i ka bërë këtij mbreti, Dhulkarnejn, në fakt është përsëkrim, jo vënie e nofkës a titullit, ashtu siç mbreti izraelit Shaveli u quajt Talut². Ky mbret është ai që ka ndërtuar digën ndërmjet Mongolisë dhe Kinës. Emri i tij ishte Qin Shihuang dhe ka jetuar 247 vjetë para lindjes së Isait a.s. Pra një shekull pas Aleksandrit të Maqedonisë. Atëbotë Kina për fe kishte konfucionizmin. Sigurisht ithtarët e tij kanë qenë të drejtë dhe të ndershëm. Siç e përshekruajnë librat e historisë, ky mbret destruktiv kishte shkatërruar atë që kishte ndërtuar, duke vrrarë dijetarët dhe djegur librat.

Jam më se i bindur që këto informacione lidhur me këtë mbret dhe lider të madh Dhulkarnejnin kanë qenë të dobishme për studiuesin, dhe në fund të kësaj teme, them vetëm Allahu e di të vërtetën!³

¹Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi në Sahihët e tyre.

²Shih: Tahir bin Ashur, *Ettahriru ve ettenviru*, 16/22.

³Po aty, 16/25.

2.6.5. Tiparet më dalluese të lidërshipt të suksesshëm në rrëfimin e Dhulkarnejnit

Sa i përket tipareve dhe karakteristikave të lidërshipt të fituara nga rrëfimi i Dhulkarnejnit, për çka edhe iu kthyem tefsireve klasike dhe bashkëkohore që kësaj mesele t'i bëjmë trajtim referencial, më duhet të them se nuk kam gjetur atë që kam pritur të gjej për këtë studim, me përjashtim tek disa mufessirë klasikë si Imam Kurtubiu dhe disa bashkëkohorë, si AbduRrahman Sa'di, Tahir bin Ashuri, Sejjid Kutubi. Kjo mbase për shkak të trajtimit jo me prioritet të temës së lidërshipt në kohën e shumë mufessirëve sepse në atë kohë ymeti ballafaqohej me sfida tjera, dhe pushtetarët nuk ishin siç janë sot.

Këto karakteristika të lidërshipt mund të radhiten si më poshtë:

1) Vetëbesimi dhe pajtimi me atë që Allahu të ka dhënë nga pasuria, shëndeti, pushteti dhe sundimi

Imam Kurtubiu duke komentuar pjesën e ajetit 95 nga kaptina Kehf: *"Ajo të cilën ma ka mundësuar Zoti im, është më e mirë (nga pagesa juaj)..."* ka thënë:

Në të fshihen dy mesazhe:

E para, pjesa e ajetit: "Ajo të cilën ma ka mundësuar Zoti im është më e mirë..." – Dhulkarnejni po iu thotë se fuqia dhe pushteti që ia ka dhënë Allahu xh.sh. janë më të mira se pagesa dhe kompensimi material

që po më ofroni. Ajo që kërkoj nga ju është fuqia punëtore, pra burrat tuaj që të punojnë fizikisht.


E dyta, ky ajet është provë dhe dëshmi se si mbreti e ka për farz ose detyrë që ta ruajë popullin dhe të kujdeset për ta, mirëqenien dhe sigurinë e tyre dhe këtë nga mjetet materiale të tyre. Të drejtat e tyre (materiale) të cilat i përmbledh arka e tyre janë nën menaxhimin e tij (mbretit), dhe nëse arka do të zbrazej për shkak të investimit në projekte në interes të tyre, prapë detyrim do të mbetej mbushja e saj nga pasuritë e tyre ndërsa mbreti do ta kishte për detyrë të kujdesej për këtë pasuri¹) me këto tre kushte: të mos e veçojë veten ndaj tyre me diçka nga kjo pasuri, të fillojë me shpërndarjen e saj tek ata që kanë më së shumti nevojë dhe ta shpërndajë atë sipas pozitave. Kur arka të zbrazet, atëherë ai kërkon që ata ta ofrojnë veten (fizikisht) para pasurive të tyre. E nëse kjo nuk mjafton, atëherë merr prej pasurisë së tyre me mirëkuptim dhe e shpenzon atë në mënyrë racionale e të kontrolluar. Kështu veproi Dhulkarnejni kur ata ia ofruan pagesën fillimisht që t'i mbronte nga armiqësia e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve. Ai iu tha se nuk kishte nevojë për paratë e tyre por për punën fizike të tyre. Më ndihmoni mua për veten tuaj sepse paratë janë në dorën time ndërsa meshkujt (fuqia fizike) në dorën tuaj. Dhulkarnejni pa se pasuria nuk luante rol primar në këtë rast dhe se ai po ta merrte pagesën apo shpërblimin kjo do ta pakësonte atë për të cilën ai kishte nevojë (fuqinë fizike) kështu që do t'i duhej të angazhonte punëtorë me pagesë nga radhët e tyre. Për këtë shkak, kërkimi i fuqisë punëtore këtu ishte primar. Lideri nuk ia merr pasurinë askujt pa nevojë. Në këtë rast, marrja e pasurisë bëhet haptazi, jo fshehurazi, shpenzohet me drejtësi dhe jo për përfitim (investim në kapital), bëhet me konsultim dhe jo me vendim arbitrar.

*Allahu i lartësuar është Ai që bekon të qëlluarën!*²

Grafiku në vazhdim në formë të përmbledhur prezanton tiparet e lidërshiptit sipas opinionit të Imam Kurtubiut.

¹Pjesa brenda kllapave nuk është shënim i përkthyesit por teksti komplet i Imam Kurtubiut të cilin përkthyesi e solli për tu kuptuar meseleja më qartë. Përkthyesi.

²Kurtubi, *El-xhamiu li-ahkami el-Kur'an*, 11/60.



2) Luftimi i korrupsionit, zhvillimi industrial, modestia dhe falënderimi për Allahun xh.sh, drejtësia sociale dhe ndihma për nevojtarët, mbrojtja e qytetarëve nga rreziqet dhe armiqësitë që iu kanosen pa kompensim material, shpalljen e kushtetutës dhe ligjit, ndëshkimi i keqbërësve, shpërblimi i mirëbërësve...

Prof. Sejjid Kutubi duke interpretuar Ajetet 95-99 nga kaptina *Kehf* ka thënë: “...Ai lider i mirë e refuzoi kompensimin material për punën që bëri në përputhje me programin e mirë që kishte shpallur për ta luftuar të keqen dhe çrregullimin në tokë. Ai erdhi në përfundim se mënyra më e mirë për ta parandaluar popullin çrregullues ishte të ndërtonte një digë ndërmjet dy kodrave. Kështu, për ta bërë këtë punë, kërkoi ndihmë materiale (copa hekuri dhe bakër të shkrirë) dhe fizike. **“...por më ndihmoni mua me krahë! Do të ndërtoj një pendë midis jush e atyre. 96. Më sillni blloqe hekuri!...”**, kështu ata i sollën copa hekuri, **“...Dhe, kur ai i rrafshoi dy anët e thepisura të maleve,...”** dhe u bë një pirg nga rrafshimi i tyre **“...tha: “Fryjini zjarrit, derisa hekuri të skuqet si zjarri.”...** pra kur hekuri u skuq shumë dhe u bë pothuajse zjarr, **“...tha: “Më sillni bakër të shkrirë që ta hedh në të.”**”, pra bakër të shkrirë për ta përzier me hekurin që ta forcojë edhe më shumë.

Kjo formë e përforcimit të hekurit është përdorur edhe në kohën bashkëkohore pasi që është konstatuar se shtimi i një sasive të bakrit hekurit i shton forcë dhe qëndrueshmëri. Kjo njohuri ishte nga Allahu xh.sh. dhe si e tillë është e regjistruar në Librin e Tij të përjetshëm, duke i paraprirë kështu shkencës moderne me njohuri dhe praktika të dëshmuara shumë shekuj më parë, që saktësisht vetëm Allahu e di kur ka ndodhur¹.

¹Shih: Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur'an*, 1/2714.

Me këtë veprim të Dhulkarnejnit korridori u mbyll dhe bashkë me të edhe rruga e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve. "Kështu, ata (Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët) nuk mundën që ta kapërcenin pendën dhe as nuk mundën që të hapnin vrimë në të."

Dhulkarnejni, që ishte begatuar me dije e fuqi nga Allahu, këtë punë gjigante nuk e shikoi si diçka që thjesht mund ta kryente, pra nuk ishte i mashtruar me këto dhunti që i ishin dhënë¹, por me modesti dhe falënderim për Allahun duke dashur që ajo të jetë shpagim i mirësive të Allahut ndaj tij. Ai nuk shfaqti pavarësi nga Allahu, përkundrazi, shfaqti pavarësi nga vetvetja duke iu mbështetur tërësisht Allahut dhe duke iu dorëzuar Atij. Ai shfaqti dijen që kishte se do të vjen koha kur këto kodra, para Kiametit, do të rrafshohen me tokë. "Ai tha: "Kjo është mëshirë nga Zoti im! Kur të vijë premtimi i Zotit tim, Ai do ta rrafshojë atë (pendën). Premtimi i Zotit tim është (gjithnjë) i vërtetë."

Këtu përfundon biografia e Dhulkarnejnit, këtij shembulli të përkryer të liderit të ndershëm, të cilit Allahu xh.sh. i dha forcë dhe pushtet në tokë dhe për të cilin kishin nevojë Lindja dhe Perëndimi. Ai nuk ishte i vetëmashtruar dhe aq më pak mendjemadh a arrogant. Pushteti dhe sukseset nuk ishin mjet për përfitime materiale personale dhe as për të shfrytëzuar njerëzit apo vendet për interesa personale. Vendet e pushtuara nuk i trajtonte me ligje skllavërie dhe as i shtypte banorët e tyre si tiran. Ai ndante drejtësi kudo që ishte, ndihmonte nevojtarët kudo që thërriste nevoja, ua siguronte lirinë pa kompensim material. Mundësitë që ia kishte dhënë Allahu xh.sh. i kishte vënë në dobi të njerëzimit, në favor të shfrytëzimit, ndryshimit dhe rregullimit, largimit të armiqësisë dhe jetësimi të sigurisë e paqes. Për asnjë çast nuk harronte të falënderonte Allahun dhe t'i detyrohej Atij për

¹Shih edhe: AbduRrahman Sa'di, *Tejsiru el-Kerimi el-Mennan*, 487, kur bën krahasimin ndërmjet modestisë dhe falënderimit të Sulejmanit a.s. për dhuntitë e dhëna dhe arrogancës dhe mendjemadhësisë së Karunit. Ky i fundit të gjitha ia atribuonte vetes së tij, jo Allahut xh.sh.

mirësitë dhe mëshirën, njëherit të përkujtonte forcën dhe fuqinë e Tij dhe se ai, Dhulkarnejni, një ditë (si gjithë të tjerët), do të kthehej tek Allahu xh.sh¹.


E rëndësishme këtu është se Dhulkarnjeni shpalli platformën e tij për mënyrën e qeverisjes me vendet e çliruara, të cilat iu nënshtruan dhe ishin nën pushtetin e tij. **“Ai tha: “Sa i përket atij që bën të këqija, Ne do ta ndëshkojmë e pastaj do të kthehet te Zoti i vet, i Cili do ta ndëshkojë me një dënim të rëndë. 88. Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe do t’i premtojmë atij lehtësira.”** Kështu, Dhulkarnejni shpalli se keqbërësit do të ndëshkohen në këtë botë, sikur që do të ndëshkohen dhe në botën tjetër me dënim çfarë njeriu nuk mund ta paramendojë. Ndërsa sa i përket besimtarëve të devotshëm, për ata do të kenë shpërblime, trajtim dinjitoz dhe privilegje.

Kjo është platforma e liderit të mirë, kjo është kushtetuta që duhet të ketë. Besimtari i mirë duhet të ndihet krenar, të jetë i favorizuar, të shpërblehet, ndërsa shkelësi i të drejtave, kriminel, duhet të merr ndëshkimin. Kur mirëbërësi të gjejë shpërblimin për mirëbërje dhe pozitë e respekt në shoqëri, dhe keqbërësi të merr ndëshkimin e merituar për krimin, kjo do të shërbejë si mësim dhe motivim për të vazhduar me ndershmëri dhe produktivitet (për të dhënë edhe më shumë nga vetja). Ndryshe, nëse përmbysen kriteret e pushtetit ku në vend të mirëbërësve shpërblehen e nderohen keqbërësit, kur të ndershmit anashkalohen dhe për më keq, luftohen, atëherë i gjithë pushteti shndërrohet në mjet dhune, kalon në duar e tiranit dhe çrregullohet i gjithë sistemi shoqëror derisa të kalojë në kaos total...²”

Përmbledhje e shkurtër dhe grafike e treguesve të lidërshipt sipas Sejjid Kutubit, rahmet pastë!

¹Shih: Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur’an*, 1/2714.

²Shih: Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur’an*, 1/2712-2713.



3) Ndershmëria dhe drejtësia, frymëzimi nga Allahu dhe mbështetja tek Ai, zgjerimi i sundimit, arritja në token e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve, ndërtimi i digave dhe urave për të evituar dhunën dhe për të mbrojtur të dëmtuarit nga dhuna e padrejtësia, përkushtimi për industrinë dhe zejen, përdorimi i fuqisë njerëzore për realizimin e objektivave...

Imami Tahir bin Ashuri ka thënë:

Ky rrëfim Kur'anor na ofron tipare të liderit dhe lidërsipit të cilat pashmangshëm na duhen (për ndërtimin e modeleve të reja):

- 1) *Ai (Dhulkarnejni) ishte mbret i ndershem dhe i drejtë.*
- 2) *Ishte i frymëzuar nga Allahu xh.sh.*
- 3) *Pushteti i tij ishte shtrirë në vise të shumta.*
- 4) *Ai kishte shkuar në vendin e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve që kishte qenë gjeografikisht i përfshirë në territorin ku sundonte ai. Ishte ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, pra as në Lindje as në Perëndim, siç parashihet nga ekzaminimi apo gjurmimi i mjeteve të tij.*
- 5) *Ai kishte ndërtuar një digë që ndante Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët nga një popull tjetër.*
- 6) *Ai me vete kishte një ekip ekspertësh për përpunim të hekurit dhe në ndërtim¹.*

¹Ibn Ashur, *Ettahriru ve ettenviru*, 16/25.

Përmbledhje e tipareve të lidërshipt nga këndvështrimi i Imamit Tahir bin Ashur:



Në fund konsideroj që koncepti dhe tiparet e lidërshipt sipas modelit të Dhulkarnejnit mjaftojnë për të qenë shembull dhe model i mirë për të gjithë ata që duan të jenë liderë të suksesshëm dhe të ndjekur nga të tjerët në çdo kohë. Këtu do të shtoja dhe disa detaje rreth Dhulkarnejnit.

Përpyqjet e dijetarëve për ta përcaktuar kohën dhe vendin ku/kur ka jetuar janë thjesht përpyqje shkencore që mund të pranohen dhe të refuzohen për faktin se Kur'ani nuk është deklaruar rreth tyre dhe as që janë synuar në kontekstin të cilin Kur'ani e përmend Dhulkarnejnin, ndonëse nuk përjashtohet mundësia që dikush nga mufessirët t'i zbulojnë ato, sepse

urtësitë e Kur'anit zbulohen përherë dhe janë të hapura për të gjithë. Për të qenë mrekullia edhe më e madhe, urtësitë e Kur'anit shpalosen në çdo kohë, deri në ditën e kiametit.

Po e theksoj se gjëja më e rëndësishme është që Kur'ani është deklaruar qartë rreth liderit; pregaditjen e tij fetare, intelektuale, emocionale dhe shumëdimensionale kundrejt luftës me të gjitha format e të keqes dhe prezantimit të të gjitha tipareve individuale e shoqërore që afirmojnë vlerat e mirëfillta islame. Kjo është ajo që kërkohet. Allahu e di më së miri!

3. SHEMBUJ TË LIDERSHIPIT TË DËSHTUAR NGA PRIZMI KUR'ANOR

3.1. Shembuj të lidershipit të dështuar

Kur'ani dallohet për një metodologji të rrallë dhe unike për sa i përket prezantimit, analizimit dhe më pas gjykimit të ngjarjeve. Karakterizohet me paanësi dhe objektivizëm në shpjegimin e aspekteve pozitive dhe negative të dukurive a fenomeneve të caktuar. Sa për ilustrim, do të përmendim rastin me alkoolin, për çka në Kur'an qëndron:

﴿يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ قُلْ فِيهِمَا إِثْمٌ كَبِيرٌ وَمَنْفَعٌ لِلنَّاسِ وَإِثْمُهُمَا أَكْبَرُ مِنْ نَفْعِهِمَا...﴾ ﴿٢١٩﴾ [سورة البقرة: 219]

“Të pyesin ty për verën dhe kumarin. Thuaju: “Ato sjellin dëme të mëdha (gjynahe), por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia” ...” [Kur'ani: Bekare: 219]

Ana argumentuese e ajetit qëndron në shpjegimin që Allahu xh.sh. flet për qëllimet pse njerëzit merreshin me alkoolin dhe bixhozin në të cilat, pavarësisht mëkatit të madh, disa njerëz kishin edhe përfitime materiale. Tregtarët përfitonin sepse e shisnin alkoolin duke mos çarë kokën për anën tjetër, respektivisht ndalesën fetare dhe dëmin nga ai dhe bixhozi.

Kjo metodologji Kur'anore e prezantimit objektiv të gjërave vihet re edhe në trajtimin e disa modeleve shtypëse dhe represive të lidershipit, pra modele të dështuara, të cilat janë përmendur nga pejgamberët përgjatë gjithë historisë njerëzore dhe të cilat, ndonëse në forma pak më ndryshe, vazhdojnë të

qeverisin edhe sot e kësaj dite. Shembull konkret i kësaj që po themi, është rasti i tiranit të madh, Faraonit dhe të dy ministrave destruktivë të tij, Karunit dhe Hamanit. Allahu xh.sh. na rrëfen për këtë e thotë:

(1) ﴿وَنَادَى فِرْعَوْنُ فِي قَوْمِهِ قَالَ يَا قَوْمِ أَلَيْسَ لِي مُلْكُ مِصْرَ وَهَذِهِ الْأَنْهَارُ تَجْرِي مِن تَحْتِي أَفَلَا بُصِرُونَ ﴿٥١﴾ أَمْ أَنَا خَيْرٌ مِّنْ هَذَا الَّذِي هُوَ مَهِينٌ وَلَا يَكَادُ يُبِينُ ﴿٥٢﴾ فَلَوْلَا أَلْقَى عَلَيْهِ آسُورَةٌ مِّنْ ذَهَبٍ أَوْ جَاءَ مَعَهُ الْمَلَائِكَةُ مُقْتَرِنِينَ ﴿٥٣﴾ فَاسْتَحَفَّ قَوْمَهُ فَأَطَاعُوهُ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا فَاسِقِينَ ﴿٥٤﴾﴾ [سورة الزخرف: 51-54]

1- “Dhe Faraoni i thërriste popullit të vet: “O populli im! Vallë, a nuk më përket mua sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje? A nuk shihni-madhmshtin, timë -? 52. Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë, i cili mezi shprehet? 53. Përse nuk i janë dhënë atij byzylykë ari? Përse nuk kanë ardhur bashkë me të engjëjt?” 54. Kështu, ai e mashtroi popullin e vet. Ata iu nënshtruan atij, sepse ishin vërtet një popull i pabindur.” [Zuhruf: 51-54]

Dëshmia nga ajeti qëndron në pretendimin e pushtetit absolut nga Faraoni, në kryelartësinë e tij ndaj popullit dhe në frikësimin e tyre, në ç’vlerësimin e nivelit intelektual të tyre dhe në dyshimet e vazhdueshme që kishte për ta. Populli i tij ishte mëkatar dhe pikërisht pushteti i padrejtë i Faraonit ishte kostoja që paguanin ata për mëkatet e tyre. Duke mos gjetur zgjidhje tjetër para vetes, gjithnjë sipas asaj që u diktonte Faraoni dhe për shkak të gjendjes së mjerë si pasojë e mëkateve, ata pasuan dhe iu bindën Faraonit.

Dijetari i njohur, Fahrudin Rrazi, i ka bërë një interpretim të shkëlqyer këtij ajeti me ç’rast ofron një analizë të bukur dhe kuptimplote:

Ajeti përmban disa mesele:

Meseleja e parë: Qëllimi i rikthimit të rrëfimit të Musait a.s. me Faraonin në këtë vend është bërë për ta konfirmuar ose miratuar atë që është thënë më parë. Kjo për arsye se idhujtarët kurejshë kontestuan pejgamberinë e Muhammedit a.s. me pretekstin se ishte i varfër dhe pa autoritet. Pas shpalosjes së mrekullive sfiduese të Musait a.s. në saktësinë e të cilave nuk ka dyshim, e përmendi këtë dyshim të Faraonit, të ngjashëm me atë që idhujtarët kurejshë thanë për Muhammedin a.s. Faraoni tha: unë jam i pasur dhe i pushtetshëm. A nuk shihni se si pushteti i Misrit (Egjiptit) më takon mua dhe se këta lumenj që rrjedhin në fakt po rrjedhin nën mua dhe sundimin tim. Ndërsa Musai është i varfër, i përbuzur dhe nuk mund të shprehet mirë. Kështu, gjithnjë sipas mendësisë së Faraonit, si mund të dërgohet një njeri i varfër nga Zoti për tek ai që ka pushtet të madh dhe pasuri. Kështu, konfirmohet se dyshimin që hodhën idhujtarët kurejshë për pejgamberinë e Muhammedit a.s. dhe të cilin Kur'ani e përmend: “ Pastaj thanë – kurejshët-paraia e Mekës -: “Përse të mos ketë zbritur ky Kur'an një njeriu të madh nga dy qytete?” [Zuhruf, ajeti 31], (e kishin për qëllim njeriun e madh njerin prej dy liderëve të tyre-el Velid bin el Mugire nga Meka, ose Urva bin Mas 'ud el Thakafi nga Taiqi – dmth: sipas tyre Muhamedi a.s.nuk e ka merituar zbritjen e Kur'anit, jo i madh sipas tyre)!!, është po ai që hodhi më parë me Faraonin ndaj Musait a.s. Qëllimi i këtij rrëfimi qëndron në konfirmimin e dy gjërave: **e para**, argumentimit të jobsimtarëve dhe injorantëve ndaj Pejgamberëve me këtë akuzë dhe dyshim të dobët e të paqëndrueshëm, të cilit nuk duhet t'i kushtohet vëmendje dhe as rëndësi, dhe, **e dyta**, Faraoni kur ishte në gjendje materiale më të mirë të mundshme në dynja, u përmbys dhe mori fund dhe ky është fundi për armiqtë e tu (o Muhammed!). Pra, poenta e ripërtëritjes së rrëfimit nuk ka të bëjë me vet rrëfimin por me miratimin e përgjigjes ndaj dyshimit të përmendur...¹

¹ Fahrudin Rrazi, *Mefatih el-gajb*, 1/186, meselen e dytë nuk e përmendëm.

Një tjetër ajet që trajton shembullin e dështuar të Faraonit është ajeti në vazhdim:

(2) ﴿ وَقَالَ فِرْعَوْنُ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ مَا عَلِمْتُ لَكُمْ مِنْ إِلَهِ غَيْرِي فَأَوْقَدْ لِي يَهْمُنْ عَلَى الظَّالِمِينَ فَأَجْعَلْ لِي صَرْحًا لَعَلِّي أَطَّلِعُ إِلَى إِلَهِ مُوسَى وَإِنِّي لأظنُّهُ مِنَ الْكَاذِبِينَ

﴿سورة القصص: 38﴾

2- “Dhe Faraoni tha: “O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot pos meje! O Haman, më ndez një zjarr të pjek qerpiçë dhe më ndërto një kullë të lartë të ngjitem te Zoti i Musait. Jam i bindur se ai (Musai) gënjen!” [Kasas: 38]

Dëshmia nga ky ajet, siç përmend dijetari Ibn Ashuri, qëndron në ligjërimin e Faraonit përmes të cilit ai do të bindë parinë në hyjninë e tij të rrejshme (pretendonte që ishte zot! sh.p.), kështu që iu tha se nuk dinte ndonjë zot tjetër pos tij, duke tentuar kështu zhvlerësimin e asaj që predikonte Musai a.s. siç është rrëfyer në kaptinën Shuara ajeti 24, dhe 26, detalisht: “Zoti juaj dhe Zoti i etërve tuaj është Allahu” dhe “Ai (Allahu) është Zoti i qiejve dhe i tokës dhe çdo gjëje që ekziston ndërmjet tyre nëse jeni të bindur.” Kështu Faraoni u tha atyre se nuk i besonte thirrjes së Musait a.s. dhe se ai nuk dinte zot tjetër për popullin e vet përveç vetes së tij¹.

(3) Kur’ani na ka rrëfyer edhe për rastin e parisë së popullit të Shuajbit a.s, despotë dhe tiranë që pamëshirshëm keqtrajtonin popullin e pafajshëm, të cilët pasonin liderët e udhëzuar dhe të drejtë nga radhët e Pejgamberëve. Allahu xh.sh. thotë:

3- ﴿ قَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا مِنْ قَوْمِهِ لَنُخْرِجَنَّكَ يَشْعَبُ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا مَعَكَ مِنْ قَوْمِنَا أَوْ لَنَعُودَنَّ فِي مِلَّتِنَا قَالَ أُولَئِكَ كَرِهِينَ ﴿٣٨﴾ قَدْ أَفْرَيْنَا عَلَى اللَّهِ كَذِبًا إِنَّ عُدْنَا فِي مِلَّتِكُمْ بَعْدَ إِذْ

¹ Ibn Ashur, *Ettahriru ve ettenviru*, 21/122.

نَجَنَّا اللَّهُ مِنْهَا وَمَا يَكُونُ لَنَا أَنْ نَعُودَ فِيهَا إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّنَا وَسِعَ رَبُّنَا كُلَّ شَيْءٍ عِلْمًا
 عَلَى اللَّهِ تَوَكَّلْنَا رَبَّنَا افْتَحْ بَيْنَنَا وَبَيْنَ قَوْمِنَا بِالْحَقِّ وَأَنْتَ خَيْرُ الْفَاتِحِينَ ﴿٨٩﴾ وَقَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ
 كَفَرُوا مِنْ قَوْمِهِ لِيْنَ اتَّبَعْتُمْ شُعَيْبًا إِنَّكُمْ إِذًا لَخٰسِرُونَ ﴿٩٠﴾ فَأَخَذْتَهُمُ الرِّجْفَ فَأَصْبَحُوا فِي دَارِهِمْ
 جٰثِمِينَ ﴿٩١﴾ الَّذِينَ كَذَبُوا شُعَيْبًا كَأَن لَّمْ يَعْنُوا فِيهَا الَّذِينَ كَذَبُوا شُعَيْبًا كَانُوا هُمُ الْخٰسِرِينَ
 ﴿٩٢﴾ فَتَوَلَّى عَنْهُمْ وَقَالَ يَا قَوْمِ لَقَدْ أَبْلَغْتُكُمْ رِسَالَاتِ رَبِّي وَنَصَحْتُ لَكُمْ فَكَيْفَ آسَأَى
 عَلَى قَوْمٍ كٰفِرِينَ ﴿٩٣﴾ (سورة الأعراف: 88-92)

3-“Paria arrogante e popullit të tij tha: “O Shuajb! Kthehuni në fenë tonë ose do t’ju dëbojmë nga qyteti ynë, ty me gjithë ndjekësit e tu”. Shuajbi tha: “Edhe pse e urrejmë atë?! 89. Nëse do të ktheheshim në fenë tuaj, pasi Allahu na shpëtoi nga ajo, atëherë do të shpifnim gënjeshtër kundër Allahut. Ne nuk mund të kthehemi në të, përveçse po të dojë Allahu, Zoti ynë. Ai përfshin çdo gjë me dijetarinë e Vet dhe tek Ai ne mbështetemi. O Zoti ynë, gjyko drejt midis nesh dhe popullit tonë! Ti je Gjykatësi më i mirë”! 90. Por paria e pafe i tha popullit të tij: “Nëse shkoni pas Shuajbit, atëherë, me siguri do të jeni të humbur.” 91. E kështu, ata i goditi një tërmet i rëndë dhe u gdhinë të shtrirë përmbys në shtëpitë e tyre. 92. Ata që e quajtën Shuajbin gënjeshtar, sikur nuk kishin banuar kurrë në atë vend; ata që e quajtën Shuajbin gënjeshtar, qenë të humbur” [A’rafë: 88-92]

Siç shpjegon dijetari Sheukani në tefsirin e tij Fet’h el-Kadir, aspekti i argumentimit me ajetet në fjalë fshihet në atë se “...paria nuk u mjaftua me braktisjen e besimit dhe shfaqjen e arrogancës dhe të kundërshtimit ndaj thirrjes që iu ishte drejtuar (nga Shuajbi a.s.), por shkoi edhe më tutje duke shfaqur dhunë, mendjemadhësi dhe duke kërcënuar pejgamberin e tyre dhe pasuesit e tij, duke i kërcënuar se do t’i nxirrnin me dhunë nga vendbanimet e tyre ose do ti kthenin në fenë e tyre të vjetër (në

idhujtari). Pra, kishin para vetes vetëm një nga dy zgjidhjet: internimin¹ ose kthimin në idhujtari.”²

(4) Këtë proces refuzimi e kundërshtimi të dhunshëm e gjejmë dhe në rrëfimin e Ibrahimit a.s. me popullin e vet tiran, që jo vetëm e kërcënuan por u përpoqën edhe ta djegin të gjallë për të shpëtuar kinse prej tij dhe për ta hequr qafe njëherë e përgjithmonë. Por, Allahu xh.sh. e shpëtoi duke ia prishur kurthet atij populli mizor. Kur’ani na shpalos detaje nga kjo tendencë makabër dhe ky veprim mizor e barbar i popullit të Ibrahimit a.s:

4 ﴿وَإِبْرَاهِيمَ إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاتَّقُوهُ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْمُرُونَ ﴿١٦﴾ إِنَّمَا تَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ أَوْثَانًا وَتَخْلُقُونَ إِفْكًا إِنَّ الَّذِينَ تَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ لَا يَمْلِكُونَ لَكُمْ رِزْقًا فَابْتَغُوا عِنْدَ اللَّهِ الرِّزْقَ وَاعْبُدُوهُ وَاسْكُرُوا لَهُ ۗ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿١٧﴾ وَإِن تَكذَّبُوا فَقَدْ كَذَّبَ أُمَمٌ مِّن قَبْلِكُمْ وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلْغُ الْمُبِينُ ﴿١٨﴾ أُولَئِكَ يَرَوْنَ كَيْفَ يُبَدِّئُ اللَّهُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ ۗ إِنَّ ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿١٩﴾ قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ بَدَأَ الْخَلْقَ ثُمَّ اللَّهُ يُنشِئُ النَّشْأَةَ الْآخِرَةَ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٠﴾ يُعَذِّبُ مَن يَشَاءُ وَيَرْحَمُ مَن يَشَاءُ وَإِلَيْهِ تُقْلَبُونَ ﴿٢١﴾ وَمَا أَنْتُمْ بِمُعْجِزِينَ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَمَا لَكُمْ مِّن دُونِ اللَّهِ مِن وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿٢٢﴾ وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ وَلِقَائِهِ أُولَٰئِكَ يَئِسُوا مِن رَّحْمَتِي وَأُولَٰئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٢٣﴾ فَمَا كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ ۗ إِلَّا أَن قَالُوا اقْتُلُوهُ أَوْ حَرِّقُوهُ فَأَنجَاهُ اللَّهُ مِنَ النَّارِ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٢٤﴾﴾ [سورة العنكبوت: 16-24]

¹ Si në kohën e regjimeve komuniste në Shqipëri e Jugosllavi e në Bashkimin Sovjetik.

² Imam Sheukani, *Fet'h el-Kadir*, 1/486. Kjo metodë e dhunës dhe e diktatorisë ka ekzistuar dhe akoma vazhdon së ekzistuari edhe sot (shek.21), “ ose me ne, ose kundër nesh”!!!

4 - "Kujtoje Ibrahimin, kur i tha popullit të vet:

"Adhuroni Allahun dhe frikësojuni Atij! Kjo është më e mirë për ju, nëse e dini. 17. Vërtet, ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, janë vetëm idhuj. Ju po shpifni gënjeshtër. Në të vërtetë, ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk kanë pushtet t'ju furnizojnë, andaj, vetëm tek Allahu kërkoni riskun dhe adhuroni e falënderoni vetëm Atë. Tek Ai do të ktheheni. 18. Nëse ju nuk më besoni, dijeni se edhe popujt e mëparshëm i kanë quajtur gënjeshtarë (të dërguarit) dhe se i Dërguari ka për detyrë vetëm që të shpallë qartazi." 19. Vallë, a nuk e vërejnë ata se si Allahu e zë fill krijimin, pastaj e ripërsërit atë? Natyrisht, kjo është e lehtë për Allahun. 20. Thuaj: "Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin. Pastaj do të jetë Allahu Ai që do të bëjë krijimin e dytë (ringjalljen). Me të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë. 21. Ai ndëshkon kë të dojë dhe mëshiron kë të dojë; tek Ai do të ktheheni. 22. Ndëshkimit të Tij nuk mund t'i shpëtoni as në Tokë e as në qiell dhe përveç Allahut nuk keni as mbrojtës, as ndihmës. 23. Ata që mohojnë shpalljet e Allahut dhe takimin e Tij, pikërisht ata e kanë humbur shpresën në mëshirën Time dhe për ta do të ketë dënim të dhembshëm." 24. Populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveçse tha: "Vriteni atë ose digjeni!" Por Allahu e shpëtoi atë nga zjarri. Vërtet, këtu ka shenja të qarta për njerëzit që besojnë." [Ankebut: 16-24]

Hoxha Muhammed el-Emin Shenkiti, duke shpjeguar këto ajete në tefsirin e tij të njohur *Advau el-bejan*, ka thënë:

Në këtë ajet fisnik, Allahu xh.sh. përmend se pasi i Dërguari i Tij, Ibrahim, paqja qoftë mbi të dhe mbi peygamberin tonë, e heshti popullin e vet mohues me argumente dhe dëshmi të qarta e të prera, këta të fundit nuk panë rrugë tjetër pos përdorimit të forcës, andaj thanë: digjeni dhe masakrojeni nëse doni të ndihmoni dhe përkrahni idhujt tuaj! Është

bërë traditë që ithtarët e të kotës të përdorin dhunën si mjet kundër të së vërtetës sa herë që argumentet dhe provat e tyre dështojnë¹.

5-Shembull tjetër mohues dhe tiran gjejmë dhe në rrëfimin e *As'hab el-uhdud*² të cilët dogjën për së gjalli besimtarët vetëm pse besuan Allahun, krijuesin e qiejve dhe të tokës. Allahu e ka përjetësuar në Kur'an rrëfimin e këtyre besimtarëve besnikë që ruajtën besimin e tyre pavarësisht çmimit që paguan:

5- ﴿ قُتِلَ أَحَبُّ الْأَحْدُودِ ۖ النَّارِ ذَاتِ الْوُجُودِ ۖ إِذْ هُمْ عَلَيْهَا فُعُودٌ ۖ وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ ۚ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ۖ وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَن يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ۖ الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۖ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ۖ إِنَّ الَّذِينَ فَتَنُوا الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ فَمَا كُفِرُوا فَلَهِمْ عَذَابٌ جَهَنَّمَ ۖ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ۖ ﴾ [سورة البروج: 4 – 10]

“Mallkuar qofshin njerëzit e Hendekut, 5. zjarrit (të ushqyer) me lëndë djegëse, 6. kur rrinin ulur rreth tij, 7. duke dëshmuar atë që po i bënin besimtarëve! 8. Ata i munduan besimtarët³, vetëm pse këta i besuan Allahut, të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd, 9. të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe që është Dëshmitar i çdo gjëje. 10. Pa dyshim, ata që i përndjekin besimtarët dhe besimtarët e nuk pendohen, i pret dënimi i Xhehenemit dhe dënimi me zjarr.” [Buruxhë: 4-10]

¹ Muhammed El-Emin esh-Shenkiti, *Advau el-bejan fi idahi el-Kur'an bi el-Kur'an*, 4/162.

² Kjo masakër-ky holokost, shkurtimisht sipar disa burimeve islame, **Sahihu i Muslimit, Musnedi i Ahmedit dhe Sunneni i Nesaiut**, ka ndodhur sipas Dahhakut para shpalljes së Muhamedit a.s. 40 vite, në Jemen me të krishterët e qytetit Nexhran në Jug të Arabisë Saudite, shkaku ishte se ata kaluan nga hebreizmi në krishterizëm, dhe për hakmarje mbreti i tyre *Dhu Nevvas el Jahudi Zur'ah ibn Tebban Esa'ad el Himjerij* me ushtrinë e tij i masakroi ata me djegje për së gjalli, i hodhi ata në hendeqe të thella përplot zjarrë, shih: *el Tefsir el Munir fi el Akideti ve el Sheriati ve el Menhexh*, 30 / 153

³ Rreth masakrave të bëra kundër atyre besimtarëve shih tefsirin e Imam el Kurtubiut dhe transmetimet e trishtueshme që janë bërë në atë kohë, 19/248

Ebu Suudi i ka bërë një shpjegim të bukur këtyre ajeteve dhe këtij rrëfimi që mendoj se ia vlen ta përmendim!

Në tefsirin e tij *Irshad el-akl esselim*, ka thënë: “Është thënë se për qëllim është: janë mbytur. Por, cilido që të jetë kuptimi, fjalia është haberije (njoftuese, lajmëruese)¹. Edhe më qartë, ajo duket të jetë duaije (fjali lutëse) që tregon për përgjigje. Sikur është thënë: “Betohem në këto gjëra se mohuesit e Mekës janë të mallkuar sikur vrasësit e Uhdudit!” Kjo për arsye se kaptina ka ardhur për t’i përforcuar besimtarët në besim dhe për t’i bërë të duruar, për t’iu dhënë kurajo për t’u rezistuar keqtrajtimit të mohuesve dhe për t’ua ofruar një shembull durimi e sakrifice të mëhershme për besimin, në mënyrë që t’i pasojnë ata (besimtarët e mëparshëm) për të përballuar më lehtë keqtrajtimin nga ana e popullit të tyre. Njëherit dhe për të ditur se keqtrajtuesit e tyre janë në pozitën e keqtrajtuesve të besimtarëve të mëhershëm dhe janë të mallkuar njëjtë siç ishin edhe ata dhe se meritojnë të quhen tiranë siç janë quajtur tiranët e mëparshëm...²

3.2. Distançimi i liderëve dështakë nga pasuesit e tyre

Provë e gabimit, padrejtësisë dhe rrjedhimisht dështimit të shembujve të lidershit të përmendur në pjesën paraprake është dhe distancimi i pasuesve nga të pasuarit (liderët), mallkimi i tyre, lutja që të kenë dënim të shumëfishuar në Ditën e Kiametit, ditën e drejtësisë kur do të vendoset mizani (peshoja) dhe do të ndahet drejtësia. Në Kur’anin Fisnik përshkruhen pamje tronditëse nga këto skena ku do të dominojë fyerja,

¹ Në gjuhën arabe, fjalia *haberije* nënkupton fjalinë e cila përmban një haber, lajm, i cili mund të jetë i saktë ose pasaktë. **Përkthyesi.**

² Ebu Suud, *Irshadu el-akli esselim*, 9/136.

mallkimi dhe urrejtja ndërmjet miqve të interesit material dhe famës e karrierës. Allahu xh.sh. thotë:

﴿يَوْمَ تُقَلَّبُ وُجُوهُهُمْ فِي النَّارِ يَقُولُونَ يَا لَيْتَنَا أَطَعْنَا اللَّهَ وَأَطَعْنَا الرَّسُولَ ﴿٦٧﴾ وَقَالُوا رَبَّنَا إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا فَأَضَلُّونَا السَّبِيلًا ﴿٦٨﴾ رَبَّنَا آتِهِمْ ضِعْفَيْنِ مِنَ الْعَذَابِ وَالْعَنَاهُمْ لَعْنًا كَبِيرًا ﴿٦٩﴾﴾ [سورة الأحزاب: 66 – 68]

“Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: “Ah, sikur t’i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit!” 67. Dhe do të thonë: “O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. 68. O Zoti ynë, atyre jepju dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!”. [Ahzabë: 66-68]

Ku mund të ketë rast më të rëndë e të vështirë se ky?

Ai që deri dje kur ishte gjallë e deshi, pasoi, shoqëroi, sot po çohet kundër tij dhe po e mallkon. Allahu na ruajtë nga shoqërimi i hipokritëve!

Dijetari, AbduRahman Sa’di, duke interpretuar këto ajete thotë: *“...kur e morën vesh se ata dhe prijësit e tyre do të jenë së bashku të ndëshkuar, deshën ta shfryjnë mllefin ndaj tyre andaj thanë: O Allah, dënoji dyfish dhe mallkoi me mallkim që i ndjek pas përjetësisht!” Allahu ju thotë se të gjithë do të keni dënim të dyfishtë për shkak të bashkëpjesëmarrjes në kufër dhe në mëkate, kështu që edhe dënimin do ta ndani bashkë edhe pse mund të keni dallim në ndëshkim nga njëri-tjetri, varësisht nga pesha e krimit të kryer...¹”*

Këtë gjendje të dhimbshme dhe dëshpëruese, pra mallkimin, sharjen dhe ofendimin ndërmjet pasuesve dhe të pasuarve, Kur’ani na e sjell edhe në një kaptinë tjetër:

¹ AbduRahman Sa’di, *Tejsir el-Kerimi err-Rrahman fi Tefsiri kelami el-Mennan*, 6/1403.

﴿ وَقَالَ إِنَّمَا اتَّخَذْتُم مِّن دُونِ اللَّهِ أَوْثَانًا مَّوَدَّةَ بَيْنِكُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ثُمَّ يَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكْفُرُ بَعْضُكُم بِبَعْضٍ وَيَلْعَنُ بَعْضُكُم بَعْضًا وَمَأْوَاكُمُ النَّارُ وَمَا لَكُم مِّن نَّاصِرِينَ ﴿٢٥﴾ ﴾ [سورة العنكبوت: 25]

“Dhe ai tha: “Ju, në vend të Allahut, keni zgjedhur idhujt, për shkak të dashurisë midis jush në këtë jetë. Por, në Ditën e Kiametit do ta mohoni njëri-tjetrin dhe do ta mallkoni njëri-tjetrin. Streha juaj do të jetë zjarri dhe nuk do të ketë për ju kurrfarë ndihmësi.” [Ankebut: 25]

Kjo është drejtësia hyjnore dhe ky është gjykimi objektiv që u bëhet njerëzve në ditën kur asgjë tjetër pos zemrës së pastër nuk bën dobi, sepse nuk janë të barabartë liderët kriminelë dhe despotë, që urdhërojnë dhe ndalojnë, marrin vendime dhe vënë firmën e tyre, me nëpunësit e tyre që urdhërohen e detyrohen dhe që pa vullnetin e tyre veprojnë! Kështu, për secilin duhet të ketë gjykim përkatës dhe shpërblim sipas veprës. Këtu mbaron puna me kriminelët dhe zullumin e tyre.

Dëshmi tjetër e dështimit të këtyre modeleve të lidërshiptit dhe falsitetit të këtyre lidhjeve ndërmjet lidërëve dhe pasuesve të tyre është përshkrimi rrëqethës që Kur’ani i bën momentit të ndarjes dhe distancimit mes pasuesve injorantë miopë e kokëtrashë¹ dhe lidërëve tiranë e të devijuar. Allahu xh.sh., thotë:

﴿ إِذ تَبَرَّأَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا مِنَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا وَرَأَوْا الْعَذَابَ وَتَقَطَّعَتْ بِهِمُ الْأَسْبَابُ ﴿١٦٦﴾ وَقَالَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا لَوْ أَنَّا كُنَّا نَدَّبُهُمْ كَمَا تَبَرَّأُوا مِنَّا كَذَلِكَ يَرِيهِمُ اللَّهُ أَعْمَالَهُمْ حَسَرَاتٍ عَلَيْهِمْ وَمَا هُمْ بِخَارِجِينَ مِنَ النَّارِ ﴿١٦٧﴾ ﴾ [سورة البقرة: 166 – 167]

¹ Shih emisionin televiziv ‘Sekretet e lidërshiptit profetik’ të prezantuar nga profesori Tarik Suvejdani, respektivisht emisionin *Ujejne bin Hisn* shembull i liderit të keq. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=XpqqN_2ZCOM

“Ah, sikur ta shihnin çastin kur të adhuroarit do t’i braktisin adhuresit e tyre, kur të gjithë do të shohin dënimin e midis tyre do të këputet çdo lidhje. 167. Atëherë adhuresit do të thonë: “Ah, sikur të ktheheshim edhe një herë (në jetën e Tokës) e t’i braktisnim ata ashtu siç na braktisën ne!” Kështu, Allahu do t’ua tregojë veprat e tyre si burim hidhërimi për ta dhe ata s’kanë për të dalë kurrë nga zjarri.”
[Bekare: 166-167]

Imam Kurtubiu duke interpretuar këtë ajet ka thënë:

Do të thotë zotërinjtë dhe prijësit distancohen nga pasuesit e tyre në kufër. Është thënë edhe ndryshe se kuptimi është i përgjithshëm, pra se përfshin çdo të pasuar (gjë që mua, si autor, më duket më afër të qëlluarës). “...kur ta shohin dënimin...” – është thënë: kur të binden për të kur ta shohin në dynja. Por është thënë edhe ndryshe, kur të merren në llogari në botën tjetër. Që të dyja mendimet janë të qëlluara pasi që ata do ta marrin vesh këtë gjë me rastin e vdekjes, gjegjësisht duke dhënë shpirt iu bëhet e qartë se ku do të jenë në botën tjetër ndërsa në botën tjetër do ta përjetojnë dënimin e hidhur. Pra, zotërinjtë dhe paria distancohen nga ata që i kanë pasuar në kufër¹.

Këtë gjë e konfirmon edhe fakti se shumica e pasuesve do të heqin dorë nga të pasuarit në Ditën e Llogarisë dhe se gjërat do të jenë krejtësisht ndryshe nga ato në këtë dynja. Harmonia dhe raportet e mira që dukeshin në dynja do të zhduken! Në vend të tyre do të ketë polemika, zënka, fjalosje, armiqësi për arsye se raportet e tyre në dynja në fakt kanë qenë të ndërtruara mbi gënjeshtër e tradhëti. Këtë na e vërteton edhe ajeti në vazhdim:

﴿الْأَخِلَاءُ يَوْمَئِذٍ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ إِلَّا الْمُتَّقِينَ﴾ ﴿سورة الزخرف: ٦٧﴾

“Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtët, që e kanë patur frikë Allahun.”[Zuhruf: 67]

¹ Imam Kurtubiu, *El-xhamiu li-ahkami el-Kur’an*, 2/194.

Ibn Xheuziu duke interpretuar këtë ajet thotë:

Shokët e dunjasë atë ditë, pra Ditën e Kiametit, do të jenë armiq të njëri tjetrit sepse, nëse shoqëria është për kufër dhe mëkat, shndërrohet me automatizëm në armiqësi në Ditën e Kiametit. Mukatili ka thënë: Ky ajet është shpallur për Umejje bin Halefin dhe Ukbe bin Ebi Muajtjin...¹

(6) Shembuj tjerë të lidërshiptit të dështuar dhe influencues për të keq tek populli kemi edhe idhujtarët arabë nga radhët e kurejshitëve, të cilët, në periudhën kur qe dërguar Muhammedi a.s. kishin shprehur pezm, revoltë dhe refuzim ndaj tij dhe besimit të tij. Ata janë dalluar për fanatizmin, kërcënimet dhe kërkesat irracionale, kanë dyshuar në vërtetësinë e profetësisë së Muhammedit a.s si pejgamber i vërtetë! Allahu xh.sh. na rrëfen për këtë e thotë:

﴿وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَا تَسْمَعُوا لِهَذَا الْقُرْآنِ وَالْغَوْا فِيهِ لَعَلَّكُمْ تَعْلَمُونَ﴾ [فصلت: 26]

“Jobsimtarët thonë: “Mos e dëgjoni këtë Kuran! Flisni e qeshni me zë të lartë, që të ndërprisni leximin e tij!” [Fussilet: 26]

Imam Zemahsheri duke interpretuar këtë ajet thotë:

Shprehja ‘elgav’ është lexuar në dy versione: me zanoren (e –velga’u) dhe zanoren (u –velgu)...Lagvi nënkupton fjalët e pavlera dhe të padobishme. Kuptimi është: mos e dëgjoni kur të lexohet dhe ngriteni zërin e thoni broçkulla çfarë t’iu vjen në gojë që lexuesit t’ia pështillni dhe të dominoni ndaj leximit të tij. Kurejshët ia përcillnin njëri tjetrit këtë si porosi e testament...²

Një interpretim të shkëlqyer të këtij ajeti e kam parë edhe tek Imam Sheukani, i cili ka thënë:

Ata i kanë thënë njëri-tjetrit: mos e dëgjoni Kur’anin dhe mos ia varni veshin. Është thënë se për qëllim me mos dëgjim është mos bindja dhe

¹ Ibn el-Xheuzi, *Zad el-mesir*, 7/327.

² Zemahsheri, *El-keshshaf*, 5/381.

nënshtrimi, sepse, gjuhësisht, dëgjimi nënkupton bindjen dhe nënshtrimin. Fjala elgaw! ka kuptimin: kundërshtojeni duke thënë fjalë të kota ose ngriteni zërin që t'i pështillet lexuesit. Muxhahidi ka shpjeguar se lagvi nënkupton fishkëllimat, britmat, duartrokitjet, shprehje të përziera që ajeteve t'i humbet kuptimi. Dahhaku ka thënë: folni sa të keni mundësi që t'i pështillet ajo që thotë. Ebu el-Alijeh thotë: nënvlerësojeni dhe shpallen me të meta (të pavlerë)¹.

Sa mëkat për këta liderë injorantë, që nuk ndjekin Kur'anin i cili i është dhënë njerëzimit deri në kiamet! Ata nuk lanë gur pa lëvizur dhe nuk lanë fjalë të rëndë pa thënë, me qëllimin e vetëm – të ndalin fenë e Zotit dhe ta dëmtojnë mesazhin e Muhammedit a.s. por nuk ia dolën! E tëra që ndodhi ishte se fjalët dhe veprat e tyre u regjistruan si prova dhe dëshmi kundër tyre, në ditën kur do të merren në llogari.

Këta prijës dështakë nuk hoqën dorë nga përpjekjet për ta mohuar peygamberinë e Muhammedit a.s. dhe Kur'anin Fisnik. Përpjekjet e tyre janë të regjistruara edhe në vende tjera në Kur'an, ku përshkruhen në hollësi por për shkak të natyrës së librit, ne do ta përmbyllim me kaq!

¹ Sheukani, *Fet'h el-Kadir*, 1/1315.

Kapitulli IV: TIPARET E PERSONALITETIT DHE STILET E LIDERSHIPIT

1. TIPARET E PERSONALITETIT

Hyrje: *Shembuj të personaliteteve të dështuara në administratë dhe lidership të cilët i kam njohur nga afër, kam bashkëjetuar dhe kam shkruar për ta*

- 1.1. Përkufizimi i personalitetit individual
- 1.2. Komponentët dhe parametrat e personalitetit individual
- 1.3. Teoritë e personalitetit individual
- 1.4. Faktorët që ndikojnë tek personaliteti individual
- 1.5. Karakteret dhe llojet e personalitetit individual
- 1.6. Matja e personalitetit

2. LLOJET E LIDERSHIPIT

- 2.1. Lidershipi autokratik apo diktatorial: pikat e forta dhe të dobëta
 - 2.1.1. Sjelljet e liderit autokrat
 - 2.1.2. Meritat e liderit autokrat
 - 2.1.3. Mangësitë e liderit autokrat
- 2.2. Lidershipi demokratik dhe shtyllat e tij
 - 2.2.1. Zhvillimi i raporteve njerëzore
 - 2.2.2. Marrja e përbashkët e vendimeve
 - 2.2.3. Delegimi i pushtetit
 - 2.2.4. Defektet e lidershipit demokratik
- 2.3. Lidershipi laissez-faire
 - 2.3.1. Veçoritë e këtij stili lidershipit
 - 2.3.2. Vërejtjet ndaj këtij lloji lidershipi
 - 2.3.3. Krahasim ndërmjet tre stileve të lidershipit

1. TIPARET E PERSONALITETIT

Hyrje: Përvoja të personaliteteve të dështuara në administratë dhe lidhshëm të cilët i kam njohur nga afër, kam bashkëjetuar dhe kam shkruar për ta

Kjo trajtesë ka një rëndësi të veçantë, për lidhjet e drejtpërdrejta që ka lideri i propozuar apo i përzgjedhur për pozitë udhëheqëse. Procesit të zgjedhjes së liderit i paraprijnë testimet¹, takimet dhe intervistat, të cilave duhet t'u nënshtrohet lideri i ardhshëm. Mbikqyrjen e merr përsipër një komision i veçantë, detyrë e të cilit është të hulumtojë rreth këtij lideri; tja shqyrtojnë hollësisht tiparet, sjelljet, qëndrimet, mendimet, raportet e tij me Zotin, me njerëzit, veçmas me familjen, në mënyrë që të njihet sa më mirë me personalitetin e tij. Nëse raportet e tij me Zotin janë në nivel të dëshiruar, atëherë ato reflektojnë pozitivisht edhe në raportet me familje e shoqëri, përndryshe jo. Ky trekëndësh raportesh (*me Zotin, familjen dhe shoqërinë*) është i mbyllur dhe nuk funksionon ndryshe pos si tërësi dhe është konstelacion i pashmangshëm!

Arsyeja kaq e hollësishme e tipareve të tij, qëndron në faktin se ky lider do të luajë një rol dhe detyrë shumë të rëndësishme si

¹ Ju lutem referohuni testeve dhe pyetsorëve të pregaditura në këtë kapitull, janë me rëndësi të madhe, dhe mos gaboni kurrë me caktue ndonjë lider në ndonje post fetar, akademik, politik, civil apo ushtarak, pa iu nënshtuar këtyre testeve, në mënyrë që ta zbulojmë personalitetin i tij real, dhe Allahu e di më mirë.

drejtues në vendin që menaxhon, qoftë organizatë ushtarake, civile, fetare, politike apo akademike. Influenca e tij tek vartësit dhe pasuesit në realizimin e synimeve dhe objektivave të organizatës është e madhe. Kjo arrihet falë tipareve, shkathtësive dhe aftësive që ka ky lider i ardhshëm. Për këtë shkak dhe në mënyrë që të mos marrim vendime të nxituara e joreale (*të krijuara mbi iluzione, opinione të dyshimta, interesa personale, ryshfet, nepotizëm etj, pasojat e të cilave do t'i bartnim ne më vonë*), sepse përzgjedhja e liderit duhet t'i nënshtrohet këtij procesi dhe filtrimi. Këtë mungesë parametrash e hasim sot në shumë institucione tona akademike, administrative, politike, shoqërore, ekonomike e fetare, si pasojë e emërimeve të kandidatëve të padenjë, të pakualifikuar dhe të panënshtuar këtij procesi zgjedhor me standarde të qarta e të përcaktuara botërore. Nga vorbulli i antivlerave nuk dilet duke qenë peng i parimeve të pavlera, i shpërfilljes së konditave - amanetit fetar e shoqëror, dhe duke injoruar kushtet që duhet t'i përmbushë paraprakisht një lider.

Këtu, duke u nisur nga parimi se e vërteta nuk duhet zvarritur në kohën kur nevoja për ta proklamuar atë është imediate, më duhet tju sjell një përvojë të *hidhur personale*; Po e sjell për hir të Zotit, mëpastaj si dokument historik, **këshillë dhe mësim**.

Përgjatë tre dekadave të kaluara të angazhimit dhe përvojës time akademike dhe fetare, brenda dhe jashtë vendit, më saktë në vendlindjen time në Prizren dhe në fakultete teologjike të universiteteve me renome botërore (*në dy vende të Azisë Juglindore edhe në dy vende të Shteteve të Gjirit*), ku jam takuar dhe kam punuar me individë që kanë ushtruar poste të larta fetare e akademike, për të cilët me keqardhje dhe me shumë përgjegjësi kam konkluduar se janë stafi më i papërgatitur për nga pregaditja administrative e profesionale!

Shumica e imamëve, kryetarëve të këshillave vakufnorë nëpër trojet tona ballkanike dhe gjetiu, shefa të departamenteve të ndryshëm universitarë, dekanë të fakulteteve, kanë qenë pothuajse plotësisht të papërgatitur për funksionin që kryejnë! Kam vërejtë dhe kam përjetu se ata nuk kanë bërë as dhe një ditë të vetme mësim, trajnim a studim për parimet e administrimit, shkathtësitë e udhëheqjes, metodat udhëheqëse dhe vendimmarrëse, për mënyrat e zgjidhjes së krizave dhe të problemeve, mënyrat e formimit të një ekipi pune, metodat e trajnimit të mirëfilltë, etj.

Kjo është një e vërtetë e hidhur të cilën nuk mund ta mohojmë megjithëse dhemb! Këto kurse trajnimi nuk kanë qenë pjesë e programeve akademike në fakultetet (*teologjike, filologjike*) ku kanë mbaruar studimet. Po kështu këto shkathtësi administrative nuk kanë qenë të kërkuara në kuadër të planprogramit akademik, as si lëndë zgjedhore, e aq më pak si lëndë obligative! Mjafton t'u hidhni një shikim indeksit të lëndëve që kanë mësuar dhe të bindeni për mangësitë që kanë!

Kjo është një e vërtetë e pamohueshme. Emërimet e këtyre nëpunësve, imamëve dhe thirrësve (*hoxhallarëve mediokër!*) gjithë ky kuadër arsimor, doktorë e profesorë, që janë bërë autoritete të larta u ngjajnë parashutistëve që lëshohen nga aeroplani! Emërimet e tyre nuk janë bërë në përputhje me asnjë kriter! Shumë prej tyre, siç i kam parë personalisht, nuk dinë as ta hapin kompjuterin pa lëre të aplikojnë metodologji bashkëkohore në mësimdhënie apo të zotërojnë ndonjë gjuhë të huaj, pos gjuhës amtare! Zyrat e tyre janë shndërruar në salla pushimi e çlodhjeje, në qendra shpifjesh e thashethemesh, në kafene llafesh e muhabetesh me ushqim e pije, hapsira të qeshurash kumbuese!

Paramendoni tani se çfarë vendimesh mund të merren në ambiente të tilla administrative, mësimore etj. Janë këto vende

ku merren vendime jetike: ku dikujt i nënshkruhet kontrata e punës e dikujt tjetër i thyhet kurrizi apo i ndërpritet marrdhënia e punës! Etj.

Këtë problematikë dhe padrejtësi të madhe mund ta vëresh lehtë me përmasa drastike që i kam përjetuar dhe që sot po shkruaj rreth saj . Me këtë rast do të doja të përmend disa vetëm sa për ilustrim:

- 1) Çështja e pranimit të gradës dhe titullit shkencor me rastin e angazhimit të parë në një institucion shkencor akademik, pavarësisht se ku ke punuar më herët, ose përvoja akademike paraprake. Po kështu edhe vlerësimi administrativ për pozitën e ushtruar më parë.
- 2) Çështja e përcaktimit të pagës sipas diplomave, kualifikimeve shencore dhe përvojës në mësimdhënie. Ka dallim të madh ndërmjet pagave të profesorëve dhe të doktorëve. Ata, edhe pse bartin titullin e njëjtë ndërkombëtar shkencor, (*M.A., ose Ph.D.,*) dallojnë në paga, për shkak të vendit ku kanë përfunduar studimet dhe shtetësisë nacionale apo pasaportës që kanë! **Çfarë kriteresh janë këto? Çfarë drejtësie është kjo? Ku mbështeten? Cila është baza juridike e këtyre vendimeve të padrejta?** Kush ua jep këtë të drejtë të veprojnë sipas qejfeve dhe tekave të tyre? I indinjuar ju them atyre: Janë ligjet tuaja të pabaza që i diktoni sipas interesit! Ju jeni përgjegjësit për emërimet e padrejta e të pamerituara! Ju jeni shkak i gjithë kësaj dekadence e prapambeturie! Nëse mendoni se sot do t'i shpëtoni fajit për shkak se edhe në vendet ku duhet të ndahet drejtësia janë bërë emërimet mbi këto baza mashtrimi, nepotizmi e interesi, mos harroni se Gjyqit të Allahut nuk i shpëton askush! As ju!

- 3) Mohimi i meritave nuk ndodhë vetëm me marrjen e detyrës por edhe në fundvit, kur bëhet vlerësimi i angazhimit, i kontributit të mësimdhënësve dhe nëpunësve. Asnjë kriter nuk merret parasysh! Pra, pavarësisht se sa shumë ke punuar, sa shumë je lodhur, çfarë suksesi ke arritur, vlerësimi akademik të lartë që ke nga studentët që realizohet online në fund të çdo semestrit akademik; vlerësimi nga autoritetet mbetet i njëjtë -joparimor!
- 4) Avancimi titullar shtyhet dhe zvarritet qëllimshëm! Mohohen mundësitë e pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, pavarësisht rregullores ku qartë precizohet kjo e drejtë e mësimdhënësit përderisa ai është i specializuar për atë fushë dhe u përmbahet kritereve, misionit dhe vizionit të institucionit ku punon! Arsyeja e vetëm që japin është: mungon buxheti! e që nuk është e vërtetë, sepse kjo është e shënuar në kontratën e punës.
- 5) Mohohet mundësia e përkushtimit të tërësishëm për hulumtim shkencor, pengohen dhënie të mirënjohjeve dhe të shpërblimeve për ekselencë akademike, profesorët e nëpunësit privohen nga shpërblimet e merituar, në plotkuptim të fjalës! E nën hijen e tërë kësaj shkeljeje të të drejtave akademike, statutore e humane, ripërtrohet apo nuk ripërtrohet kontrata e punës! Imagjinoni situatën!

Shohim shkelje të shumta nga zyrtarët e drejtuesit administrativë, akademikë e fetarë ndërsa vazhdojnë me jotransparencë, duke mos i dhënë kujt kurrfarë përgjigje! Veprime e vendime personale! Por e gjithë kjo ndodhë për shkak të mungesës së formimit të tyre individual, e kolektiv, për mungesë të kualifikimit të duhur, të shkathtësive të kërkuara, të kritereve e standardeve!... *Pra, fajtor është lidershipi kaotik, skandaloz, i papërgjegjshëm e mosërfillës!*

Në faqet që vijojnë do ti analizojmë disa tema dhe kritere shumë të rëndësishme rreth stileve të leadershipit, personalitetit të liderit të preferuar dhe të suksesshëm me qëllim që të mos përsëriten këto gabime dhe që të mos jemi viktima të këtyre liderëve të dështuar, dhe Allahu e di më mirë.

Këshillë që nuk duhet shpërfillur

Duke u nisur nga ky parim administrativ, nga ky amanet fetar, human e historik, ju këshilloj dhe propozoj sinqerisht që në pozita të tilla (*me peshë fetare, akademike, civile, ushtarake, politike*) të mos emëroni askë që nuk i plotëson kushtet dhe kualifikimet e kërkuara sipas standardeve moderne ndërkombëtare në fushën administrative dhe udhëheqëse, që do t'i përmendim në këtë kapitull! Kriteret e ashpëra të procesit zgjedhor të liderit janë për të mirën tonë të përgjithshme (*fetare, civile, politike, ushtarake apo akademike*)! Kështu realizojmë synimet dhe objektivat që kemi. Kështu zhdukim dallimet ekzistuese mes liderëve dhe vartësve të tyre, e të cilat jo rrallë çojnë dhe në rrënimin komplet të sistemeve e pushteteve! Dhe në fund, Allahu e di më mirë.

1.1. Përkufizimi i personalitetit individual

Pas kësaj pasqyre të rëndësishme radha është të trajtojmë mendimet e hulumtuesve dhe të shkencëtarëve rreth personalitetit të liderit të rekomanduar për post.

Pothuajse të gjithë hulumtuesit janë të pajtimit se termi *personalitet* nënkupton një *strukturë të integruar tiparesh dhe vetish fizike e mendore, të trashëguara (gjenetike) ose të fituara, (të mësuara me studim apo trajnim)*...¹


Pra, me termin “**personalitet**” nënkuptojmë:

*Sasinë kolosale të sjelljeve dhe të veprimeve të jashtme (dukshme, në njërën anë) dhe të ideve, besimeve dhe bindjeve të brendshme (në anën tjetër), si rezultat i të të mësuarit dhe edukimit në një ambient me kultura, besime dhe ide të ndryshme, të gabuara apo qëlluara qofshin, pavarësisht nëse janë shfrytëzuar mirë apo keq. Ky është përshkrimi i shprehjes “**personalitet**”.*

¹Utejbi, Nevvaf bin Sefer bin Muflih, *El-enmat el-kijadije*, vep. cit., f. 71. Shih po kështu: Al Thani, Fejsal bin Xhasim, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, (Rijad: Dar Vuxhuh en-neshr ve etteuzië, 2013), f. 54.

Në vazhdim do të prezantojmë disa përkufizime nga debatet e zhvilluara rreth tyre, për të përzgjedhur më pas atë që e shohim si përkufizim të qëlluar.

Grafiku në vazhdim paraqet disa përkufizime bashkëkohore, prej të cilave kemi përzgjedhur tre¹:



Sigurisht, definicione të personalitetit ka shumë, por mua personalisht këto tre definicione më bëjnë më shumë përshtypje. Vështruar sipas përmbajtjes, definicioni i Morton Prince më duket më i qëlluari, për shkak të përfshirjes së shumicës së komponentëve që përbëjnë personalitetin e njeriut në njërin anë dhe përjashtimit të elementeve të huaja, të cilat nuk janë në

¹Utejbî, Nevvaf bin Musfir bin Muflîh, *El-enmat el-kijadije*, vep. cit., f. 71-73. Shih po kështu: Al Thani, Fejsal bin Xhasim, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep. cit., f. 187-246.

vullnetin dhe mundësinë e njeriut (*gjatësia, ngjyra, gjuha, etj.*) në anën tjetër. Megjithëkëtë, nuk mund të them se ky definicion më ka bindur plotësisht! Përgjatë analizimit të mendimeve dhe trajtesave mbi këtë çështje dhe personalitetin në përgjithësi, kam ardhur tek një definicion tjetër, gjithëpërfshirës, më të pranueshëm dhe më të kapshëm për lidërsipin dhe ky është:

Sasia kolosale dhe komplekse e tipareve të sjelljeve të jashtme (nga njëra anë) dhe ideve, besimet dhe ndjenjat e brendshme me të cilat ka lindur njeriu (nga ana tjetër), kulturat, shkathtësitë dhe dijet e përvojësuar në ambiente të ndryshme, pavarësisht nëse janë pozitive apo negative dhe pavarësisht nëse shfrytëzohen për të mirë apo keq. Ky është definicioni i personalitetit, dhe Allahu e di më së miri!

Nëse kemi kuptuar definicionin e personalitetit dhe elementet përbërës të tij, atëherë dimë dhe për një fuqi, kapacitet gjigand që ka njeriu, për të cilin vetëm Allahu si Krijues e di! Mundësia e njeriut për t'i keqpërdorur këto fuqi do të ishte e madhe po të mos mbikëqyrej nga Allahu! Këtu, natyrshëm, lindin pyetjet:

- Çfarë ndikon pozitivisht e çfarë negativisht në zemrën dhe mendjen e njeriut, kësaj krijese të çuditshme e komplekse?
- Çfarë e shtyn të lëviz sa djathtas, sa majtas?
- Çfarë ndikon në vendimet e tij, të cilat herë janë të qëlluara e herë të gabuara?

Përgjigjet i keni në vazhdim.

1.2. Komponentët dhe parametrat e personalitetit individual


Kjo pjesë ka një lidhje të fuqishme me pjesën paraprake për shkak të aspektit plotësues që paraqet përkitazi me faktorët që ndikojnë në personalitetin individual, qoftë në ndjenja, qoftë në ide e mendime. Pikërisht mbi bazën e këtyre faktorëve bëhet edhe vendimmarrja dhe marrja e qëndrimeve.

Në këtë pjesë do të bëjmë fjalë për komponentët e jashtëm dhe të brendshëm të personalitetit. Nga aspekti i jashtëm dhe formal, personaliteti ka dimensione dhe tregues fiziologjik, sikur që nga aspekti i brendshëm ka dimensione dhe tregues emocional e shpirtëror. Personaliteti ka edhe dimensione shoqërore e humanë nga aspekti i raporteve shoqërore, sikur që ka dimensione dhe tregues logjik e mendor nga aspekti i kualitetit në marrjen e vendimeve. Së këndejmi, e kemi të domosdoshme që gjatë trajtimit të personalitetit, këtyre dimensioneve dhe aspekteve t'u kushtojmë vëmendjen e duhur¹, sidomos kur t'i aplikojmë me rastin e propozimit apo përzgjedhjes së ndonjë personi për një pozitë të caktuar. Kjo për shkak se marrja e vendimit është produkt i bashkëveprimit ndërmjet këtyre tipareve, parametrave dhe treguesve ndërmjet vete².

Për më qartë dhe përmbledhje, shih grafikun më poshtë:


¹Shih: Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 52-56; 71; Utejbi, *El-enmat el-kijadije*, vep. cit., f. 70-72. Shih po kështu: Al Thani, Fejsal bin Xhasim, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep. cit., f. 201-257.

²Shih: Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., f. 63-73; Utejbi, *El-enmat el-kijadije*, vep. cit., f. 85-87. Shih po kështu: Fejsal bin Xhasim, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep. cit., f. 57-64. Shih edhe: Kubejsi, Muhammed Ajjash, *Enmat esh-shahsijjeti ve ishkalat el-kijadeti ve et-terbijjeti fi el-ameli el-islamijji el-muasir*, (Dar Usame li en-nesh ve et-teuzië).



Këto pra janë dimensionet e personalitetit të cilat e udhëheqin njeriun dhe ndikojnë në marrjen e vendimeve të tij. Rëndësia e diskutimit mbi këto çështje lidhet direkt me rëndësinë që ka zgjedhja e një lideri. Para se ta përzgjedhim një lider, na duhet detyrimisht ta analizojmë personalitetin e tij të jashtëm dhe të brendshëm, gjegjësisht të merremi *me bindjet, idetë, dijen, sjelljet, etikën dhe respektin që gëzon dhe të shikojmë se sa përputhen ato mes vete*. Vetëm pas kësaj mund të vendosim për dikë nëse është i denjë ose jo për të na udhëhequr.

Grafiku në vazhdim na ofron shpjegime për rëndësinë që ka përkujdesja për këto dimensione dhe përputhja ndërmjet tyre.



1.3. Teoritë e personalitetit individual

Tiparet dhe komponentët që përmendëm më parë kanë nxitur psikologët dhe ekspertët e lidërshipt të thellohen në studime dhe të përfundojnë me teori që lidhen me stilet e personalitetit individual¹. Kjo ka ndodhur duke bashkuar këto tipare ndërvepruese mes vete. Sistemi i personalitetit individual i detyrohet pikërisht këtij ndërveprimi ndërmjet tipareve. Ky sistem përqendrohet në dy dimensione:

- 1) Dimensioni i parë, i cili përfshin aspektin e brendshëm, dhe atë sipas etikës, tipareve, virtyteve shpirtërore dhe sjelljeve elegante që gjenden tek individit.
- 2) Dimensioni i dytë, i cili përfshin aspektet e jashtme, dhe atë sipas etikës dhe sjelljeve të shturura dhe çoroditëse, pikërisht ashtu siç vepruan tek stilet e lidërshipt, duke i klasifikuar njerëzit se filani është tip introvert, tjetri ekstrovert, dikujt i thanë se është i ekuilibruar e dikujt i çekuilibruar², për dikë thanë se është egoist apo materialist...etj.

Grafiku në vazhdim sjell shpjegime të detajuara.


¹Shih: Peter G. Northouse, *Leadership and Practice*, pg: 19; Tarik Suvejdani & Fejsal Bashurahajli, *Sinaatu el-kaid*, (Mektebetu Xherir, ed. 3, 2004), f. 128-166.

²Shih: Hisham Talib, *Delil et-tedrib el-kijadij*, vep. cit., 63-73; Utejb, *El-enmat el-kijadije*, vep. cit., f. 85-87.



Teoria e modeleve të personalitetit individual ndahen në dy dimensione:

Dimenzioni 1: Aspekti i brendshëm



Dimenzioni 2: Aspekti i jashtëm



Kjo teori i atribuohet psikologut kontrovers, Frojdit (*Sigmund Freud*). Përgjatë hulumtimit tonë përkitazi me mendimet dhe qëndrimet e hulumtuesve dhe shkencëtarëve rreth kësaj çështje të ndjeshme, kemi mësuar detaje dhe analiza të cilat për ne nuk kanë ndonjë vlerë të veçantë shkencore andaj edhe nuk i kemi përfshirë këtu shumicën e tyre. Madje, thënë me modesti, po të mos parashihej nga detyrimi shkencor trajtimi kritik dhe analitik i këtyre studimeve përkitazi me këtë teori të këtij psikologu kontrovers¹, do ta anashkaloja tërësisht, por kodi dhe etika shkencore nuk më lejojnë!

Sipas teorisë së Frojdit², njeriu kalon në disa periudha deri në formimin e personalitetit të vet, duke filluar nga foshnjëria. Më saktë, ai thotë se fëmijët prej lindjes e deri në adoleshencë kalojnë përmes *pesë periudhave apo fazave të zhvillimit*³. Në çdo fazë, *energja e libidos*, ose forca që drejton të gjitha sjelljet njerëzore, bëhet e përqendruar në zona specifike erogjene. Përfundimi i suksesshëm i secilës fazë rezulton në kalimin në fazën e ardhshme të zhvillimit, por dështimi në ndonjë fazë të veçantë mund të çojë në fiksime që mund të ndikojnë në personalitetin e rritur. Frojdi thotë se tërë kjo lidhet me dy instinkte kryesore: instinktin e jetës (*erosin*) dhe instinktin e vdekjes (*thanatosin*)⁴.

¹ <https://www.iep.utm.edu/freud/>

²Shih një kritikë serioze ndaj teorisë së Frojdit e publikuar në linkun e më poshtëm:<https://www.verywellmind.com/freuds-stages-of-psychosexual-development-2795962>. Autori e ka shfletuar këtë portal më 9 maj 2019.

³Për përkthimin e këtyre teorive, përkthyesi është shërbyer me materiale tjera nga fushat përkatëse, në shqip dhe gjuhë tjera.

⁴ Shih artikullin e publikuar në (portalin e Harvardit) linkun e mëposhtëm: https://www.health.harvard.edu/newsletter_article/Psychoanalysis_Theory_and_treatment

Seksi është shprehja kryesore e instinktit të jetës dhe është motivacion për një shumëllojshmëri të mendimeve dhe të sjelljeve njerëzore. Ndërsa instinkti i vdekjes (*thanatos*) përfshin agresivitetin dhe shkatërrimin.

Këto janë ato që përcaktojnë thelbësisht personalitetin dhe sjelljet e njeriut. Bile, sipas disa hulumtuesve perëndimorë, instinkti i jetës (*erosi*) ka rol përcaktues për sa i përket sjelljeve dhe tipareve të personalitetit të njeriut.

Pavarësisht përhapjes, kjo teori është kundërshtuar që nga fillimi, madje edhe nga vet perëndimorët. Shumë shkencëtarë e studiues e kanë konsideruar *teori të dështuar*, ndonëse ka dhe nga ata që e kanë pranuar këtë teori të Frojdit.

Gjatë shqyrtimeve të kësaj teorie, ne gjetëm disa vërejtje serioze, të cilat i kemi përmbledhur si në vijim:

- 1) Teoria e tij objekt studimi ka fëmijët meshkuj, shumë pak femrat.
- 2) Teoria e tij nuk është me mundësi analogjie, nuk matet.
- 3) Profetizon të ardhmen ndërsa këtë e di vetëm Allahu! Të gjitha parashikimet e tij janë të mjegullta, të paqarta. Si mund të dalë me qëndrime të prera për një person duke konkluduar se veprimet jetësore janë kryekput rezultat (pasojë) e përvojës së hidhur paraprake fëmijërore?! A mund të jenë shkaqe mungesa e edukimit në përgjithësi dhe atij islam në veçanti, shoqëria e keqe, rrethi dhe ambienti ku jetojnë...?! Pa dyshim, po.
- 4) Teoria e tij nuk është e mbështetur në eksperiment shkencor por në raste klinike. Më saktë, në gjendjen e disa pacientëve që e kanë vizituar klinikën e tij dhe kanë marrë shërbime prej tij. Pra, nuk janë marrë parasysh rastet e njerëzve të shëndoshë.

5) Siç vihet re, qëndrimet e tij janë mjaftë të mangëta sa i përket çështjes së instinkteve seksuale të njeriut.

Këto janë arsyet pse ne në fakt nuk jemi marrë më shumë me këtë teori. Grafiku në vazhdim, në formë figurative, sjell këto pesë pika të kritikës ndaj teorisë së Frojdit.



Sa u përket komponentëve përbërës të personalitetit të njeriut, sipas teorisë psikoanalitike të Frojdit janë tre¹:

1) ID-i

ID-i është i pranishëm që në lindje, përfaqëson prirjet bazë instinktive dhe biologjike. Ai pretendonte se ID-i vepron mbi

¹Autori referencë ka <https://www.verywellmind.com/what-is-the-pleasure-principle-2795472>, ndërsa në shqip, përkthyesi i është referuar: Terry F. Pettijohn, *Psikologjia – një hyrje koncize*, përkthyer dhe botuar nga fondacioni Soros, Tiranë, ed. 2, 1996, f. 393.

bazën e parimit të kënaqësisë, ku prirjet instinktive kërkojnë kënaqësi të menjëhershme në mënyrë të pandërgjegjshme dhe impulsive.

Kjo mund të jetë e saktë relativisht, ndryshe, as logjikisht, as fetarisht nuk pranohet, sepse ne ditët e para të jetës fëmija, ashtu siç edhe konfirmohet në Kur'an, nuk di asgjë.

﴿وَاللَّهُ أَخْرَجَكُمْ مِنْ بُطُونِ أُمَّهَاتِكُمْ لَا تَعْلَمُونَ شَيْئًا وَجَعَلَ لَكُمُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ
وَالْأَفْئِدَةَ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ﴾ [النحل: 78]

"Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues."
[Kur'ani: Nahl: 78]

Kur fëmija të dalë nga barku i nënës, ai nuk di asgjë, nuk dëgjon, nuk sheh, nuk ka njohuri, nuk ka shkathtësi, nuk di as për mirë, as për keq, nuk bën dredhi dhe nuk ngre kurthe, nuk ka epsh, nuk ka as mendim të mirë as të keq, nuk bën as mirë, as keq, nuk joshet seksualisht. Nëse diçka e josh, ai është ushqimi (qumështi). Asgjë tjetër pos thithjes së gjirit të nënës fëmija nuk di. Kështu konfirmohet në këtë ajet Kur'anor, në të cilin fjala *"la ta'lemune shej'en"* (لَا تَعْلَمُونَ شَيْئًا) ka ardhur në trajtën e pashquar që nënkupton *absolutisht asgjë*. Ibën Kethiri, duke e komentuar këtë ajet, ka thënë: "...Pastaj Allahu xh.sh., ua përmendi robërve mirësitë e Tij ndaj tyre, duke i nxjerrë nga barqet e nënave të tyre pa ditur asgjë, për tua dhënë më pas shqisën e të dëgjuarit me të cilën arrijnë të kuptojnë zërat, shqisën e të shikuarit me të cilën i vërejnë gjërat e dukshme, (ua dha po kështu edhe) mendjet - qendër e të cilave është zemra sipas mendimit më të qëlluar. Është thënë edhe ndryshe, se qendër e saj është truri. Rëndësia e mendjes është se nëpërmjet saj njeriu arrin të dallojë të mirën nga

e keqja. Këto forca dhe shqisa shtohen e forcohen gradualisht, vit pas viti, derisa njeriu të arrijë pjekurinë e vet...¹”

2) EGO-ja

Egoja përbëhet nga një aftësi e ndërgjegjshme për të perceptuar dhe për t'u marrë me realitetin në mënyrë inteligjente. Ajo vepron si ndërmjetës midis ID-it (*duke i larguar dëshirat për kënaqësi të menjëhershme*) dhe superegos (*duke pranuar se disa nga forcat penguese të saj nuk janë racionale*). Egoja vepron në bazë të parimit të realitetit dhe përpiqet të gjejë mënyra të pranueshme nga shoqëria për të kënaqur ID-in.

3) SUPER EGO-ja


Superegoja (*ose alteregoja*) përbëhet nga vlera shoqërore dhe familjare që i janë ushqyer personit. Ajo është në një masë të madhe e pandërgjegjshme dhe frenon dëshirat e ID-it. Ajo përfshin ndërgjegjen (*njohuri për sjelljet gabuara*) dhe idealin e egos (*njohuri për sjelljet e drejta*).

Grafiku i mëposhtëm i shpjegon këto tre elemente të personalitetit sipas Frojdit².

¹Ibën Kethiri, *Tefsiru el-Kur'ani el-adhim*, vol.4, f.590

²Ditëve tona, një ligjërues kontrovers është munduar që këto tri ndarje të teorisë psikoanalitike të Frojdit t'i lidh me tre ndarjet kur'anore përkitazi me neftin: 1- *neftin që urdhëron për të keq*, 2- *neftin qortues dhe*, 3- *neftin e qetësuar*. Sipas opinionit tim një përpjekje e këtillë për të ndërlidhur teorinë e Frojdit me këtë ndarje kur'anore të neftit është e panevojshme sepse nuk mund të tërhiqen paralele krahasuese ndërmjet tyre, dhe Allahu e di më së miri!

Teoria psikoanalitike e Frojdit



Siç mund ta vërejmë, kjo teori është pothuajse e dështuar dhe, nga opinionimi im, e pavlerë. Asgjë shkencore nuk mund t'i atribuohet asaj. Ajo është më shumë mashtrim, ngatërrim, pështjellim, kompleksim të së thjeshtës, shpjegim i diçkasë që njihet nga të gjithë. Problemi këtu ka të bëjë me edukimin e drejtë të fëmijëve. Nëse ne e kryejmë detyrën tonë karshi edukimit të fëmijëve, me përgjegjësi mund të presim rezultate! Ndryshe, nëse kemi çaluar në edukimin e tyre, atëherë fajin e kemi ne vetë! Këto shpjegime të kësaj teorie më duken ikje nga përgjegjësia apo justifikim të dështimit tonë në edukimin e fëmijëve.

Shih ligjëratën e Adnan Ibrahimit "Teoria e tre nefseve tek Frojdi", <https://www.youtube.com/watch?v=3ZaNJ3AsAQM>, shfletuar më 7 maj 2019..

Ka dhe teori të tjera të ngjashme me këtë, **si teoria biologjike, teoria e individualizimit, teoria e tipareve**, për të cilat do të mjaftohemi thjesht me këtë shpjegim, jo më shumë!

1.4. Faktorët që ndikojnë tek personaliteti individual

Përgjatë hulumtimit dhe studimit kemi mësuar se shkencëtarët kanë përcaktuar disa faktorë të drejtpërdrejtë ose tërthortë që ndikojnë në orientimin e duhur apo të gabuar të personalitetit të njeriut. Ata kanë vënë theks të veçantë në *faktorin shoqëror, kulturor, raportet familjare, guximin dhe trimërinë e trashëguar gjenetiksht, frikën, dobësinë e personalitetit*, etj.

Konsiderojmë se, pos këtyre faktorëve, *duhet përmendur edhe dobësimi apo përforcimi i motivit fetar, edukativ, moral e familjar, në ndikimin negativ apo pozitiv tek personaliteti i njeriut*. Prandaj, si shkak i këtyre faktorëve, sot po heqim të zitë e ullirit si shoqëri. *Korrupsioni, shthurja morale, degjenerimi shkencor e intelektual, janë produkt i dobësisë dhe mangësisë së edukimit fetar, të motivit fetar, moral, etik, familjar e shoqëror*. Zaten, kush nuk ka frikë Zotin, ai është në gjendje të bëjë të gjitha të këqijat që i vijnë dore! Kjo është e vërtetë dhe ska vend për komente.

Grafiku në vazhdim na ofron shpjegime për këtë realitet.



Këta janë pra janë faktorët orientues dhe përcaktues të personalitetit të njeriut. Bashkëveprimi ndërmjet tipareve dhe faktorëve sjell deri tek vendimet e brendshme të personalitetit, mbi bazën e të cilave më pas merren vendimet¹. Sigurisht, një lider besimtar mysliman, që ka frikë Allahun për çdo punë që bën, në vetmi e në publik, nuk do të lejojë që faktorët e jashtëm

¹Shih: Ived, Abbas Mahmud, *El-kijadetu ve essimat essevijeh li eshshahsijeh*, f. 26-35; Fejsal bin Xhasim, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, f. 201-257; 277-306.

negativ të ndikojnë në vendimmarrjen e tij! Ai nuk dëmton dhe nuk dëmtohet! Është besnik karshi shtetit, qeverisë dhe eprorit. Orientues të tij të vetëm janë ndërgjegjja dhe mendja e tij, të cilat janë të pashkëputura nga Kur'ani, Sunneti dhe liderët e drejtë, (*mbretër, princër, krye ministra, apo kryetarë*) qofshin. Po kështu u përmbahet edhe fjalëve të dijetarëve të drejtë e të dëshmuar, atyre që urdhërojnë për drejtësi, mirësjellje, që ndalojnë nga e keqja, e irrituara, shëmtuara.

Nisur nga fakti se personaliteti i njeriut është një çështje themelore dhe e ndjeshme në fushën e lidërshiptit, për shkak të faktorëve të jashtëm pozitiv apo negativ që mund të ndikojnë në të, atëherë hulumtuesit nuk kanë reshtur së kërkuari zgjidhje që na hapin sekretet e personalitetit dhe që na mundësojnë ta njohim mirë e më mirë. Për të ardhur deri tek këto zgjidhje, ata janë duke u shërbyer me shkencat e reja nëpërmjet të cilave njohja e personalitetit është më e lehtë.

Pjesa në vazhdim do të na shpalosë detaje më të hollësishme mbi këtë çështje me rëndësi të madhe për ta njohur personalitetin e kandidatit apo të individit të rekomanduar për lider politik, ushtarak, akademik, fetar apo civil.

1.5. Llojet e personalitetit individual

Në pjesën paraprake mësuam për faktorët që ndikojnë në personalitetin e njeriut dhe për dallimin në formimin personal të tij. Përgjatë gjithë historisë janë evidentuar tipe të ndryshëm të personalitetit, të cilëve psikologët u kanë dhënë emra sipas rezultateve të studimeve të bëra ndër vite¹.

¹Shih: Derubi, Sami, *Ilmu et-tibai - El-medresetu el-ferensijeh*, (Egjypt: Dar el-mearif), f. 150-220.

Ndërsa hulumtonim për këtë çështje në fushën e lidërsipit, kemi parë se si shkencëtarët nga fushat e psikologjisë dhe të lidërsipit kanë aluduar tek disa lloje tjera të personalitetit individual, disa prej të cilëve i kanë klasifikuar si lloje të çrregullimit psikik e të tjerat thjesht si lloje të personalitetit¹. Këtë klasifikim e shohim të rëndësisë së veçantë sepse ne, duke testuar dhe studiuar personalitetet për tu njohur me llojet e tyre, karakterin, zgjuarsinë dhe tiparet tjera të kandidatit të propozuar për lider, arrijmë ta njohim më mirë këtë kandidat, rrjedhimisht vendosim nëse është i duhuri apo jo për postin përkatës.

Disa studime tjera janë marrë me aspekte jo më pak të rëndësishëm se këto. Në fakt, ato kanë themeluar shkencë nëpërmjet të cilave ne arrijmë ta zbulojmë fytyrën e vërtetë të personalitetit, ta njohim nga afër dhe më mirë gjithësesi. Këtë shkencë e kanë quajtur *tipologjia*², që mund të quhet edhe *karakterologjia*, shkencë që studion karakterin e njeriut³.

Kur iu kemi kthyer referencave bazë për të mësuar më shumë rreth kësaj shkencë, jemi bindur për rëndësinë që ajo ka në zbulimin dhe njohjen e thellë të personalitetit të njeriut. Kjo për arsye se ne, nëpërmjet kësaj shkencë, përtej dyshimeve arrijmë

¹Shih:http://www.greekmedicine.net/b_p/Four_Temperaments.html.

²Shih:Derubi, Sami, *Ilmu et-tibai - El-medresetu el-ferensijeh*, ve.cit., f. 188-198.

³"Tërësia e veçorive psikike më kryesore, që shfaqen në veprimtarinë e në sjelljen e njeriut në shoqëri dhe që e shquajnë personalitetin e tij; njeri me veçori psikike e morale të caktuara. Me karakter të butë (të fortë). Me karakter të mbyllur. Tiparet e karakterit. Formohet karakteri. Nuk u puqen karakteret., Ajo që e shquan diçka nga të tjerat, veti dalluese e diçkaje. Me karakter objektiv (subjektiv). Me karakter të përgjithshëm (të veçantë). Ka karakter klasor (politik, ideologjik). Karakter shkencor (artistik, pedagogjik). Ka karakter shoqëror (kombëtar, përparimtar)".
<https://fjale.al/karakter>

me ekspertiza bindëse¹ dhe testime të ndryshme të bëra në klinika psikologjike, universitete, laboratorë ushtarakë e shkencorë, ta njohim thelbin e ideve të njeriut dhe t'i analizojmë hollësisht tiparet dhe sjelljet e tij².

Ajo që të donim të shtojmë është se, hapësira për të shtuar shkenca të tjera, të zbuluara tashmë apo që do të zbulohen në të ardhmen, është e hapur. Me këtë rast do të propozonim shtimin e:

- 1) *Grafologjisë*, apo shkencës e cila merret me leximin dhe analizimin e shkrimit dhe firmës (*nënshkrimit*) të njeriut. Është shkencë e rëndësishme e cila ka bazat, teoritë dhe fushat e saja përkatëse.
- 2) *Fizionomisë*, apo shkencës së leximit të fytyrës, (*ferase-s*) siç njihej dikur tek arabët. Edhe kjo shkencë ka bazat, teoritë dhe fushat e saja.
- 3) Përfitim nga ndonjë shkencë e re apo teori e re e cila lidhet me *grupin e gjakut* (Blood Type Personality Theory)³, teori kjo e njohur tek japonezët⁴. Nëpërmjet saj arrihet të njihet dhe përcaktohet identiteti i personalitetit të njeriut.

Pas këtyre propozimeve për këto shkenca e teori të cilat na ndihmojnë ta njohim më mirë dhe më në detaje personalitetin e njeriut, konsiderojmë se është e domosdoshme t'i përmendim këto tipe apo lloje të personalitetit, pavarësisht që janë shumë, për shkak të rëndësisë që kanë. Për ta pasur më të lehtë kuptimin

¹Testimi i llojeve të personaliteteve, <https://www.16personalities.com/free-personality-test>.

²Shih: Derubi, Sami, *Ilmu et-tibai - El-medresetu el-ferensijeh*, ve.cit., f. 188-198.

³Shih: <https://www.dailymedicalinfo.com/view-article>, shfletuar më 23 janar 2020.

⁴Shih: <https://www.tofugu.com/japan/japanese-blood-type>, shfletuar më 23 janar 2020.

e tyre, do t'i listojmë në një tabelë të veçantë, sëbashku do të përmendim edhe termin në anglisht.

Prandaj, mos harroni se para se t'i çojmë lartë dy gishtat e rekomandimit për dikend; duhet të jemi të vetëdijësuar për llojet e personaliteteve në mënyrë që të bëjmë selekcionimin e personalitetit të duhur, dhe Allahu e di më mirë.

Nr.	Personalitetit	Shpjegimi
1.	<p><i>Personaliteti introvert</i> (An introverted personality)</p>	<p>I izoluar me vetdëshirë, interesohet vetëm për punën e vet, nuk është i shoqërueshëm, nuk ambientohet shumë me rrethin, mund të korrë suksese në disa fusha, veçmas në ato që kërkojnë qetësi, përkushtim, izolim.</p>
2.	<p><i>Personaliteti kërkues</i> (Compulsive personality)</p>	<p>I paaftë për të shprehur ndjenjat, i mbyllur, i ndrojtur, i ngurtë dhe i fortë, shumë pak i shoqërueshëm, i pëlqen të jetë principiell ndërsa urren shthurjen dhe çrregullimin. E do punën dhe angazhohet fort por ka probleme me marrjen e vendimeve. Është shumë i drejtpërdrejtë dhe nuk di të bëjë lajka. Nuk u zë besë shpejt njerëzve dhe as nuk i fajëson shpejt ata; i stresuar dhe pa humor¹.</p>

¹Për përshkrimin në shqip të këtyre llojeve të personalitetit, përkthyesi ka shfrytëzuar disa materiale, si: Kilda Gusha, *Trendi në incidencën e rasteve të diagnostifikuara me probleme të shëndetit mendor në Shkodër gjatë viteve 2005-2015*, (Tiranë: Universiteti Evropian i Tiranës, 2018), f. 55-60.

3.	<p><i>Personaliteti psikopatik</i></p> <p>(The Psychopathic personality)</p>	<p>Ndjek tekat dhe dëshirat, i vobektë nga ndjenjat dhe emocionet, as nuk lëshon pe dhe as nuk sakrifikon për askënd. Dallohet për tiparet të liga, si: gënjeshtria, vjedhja, dhuna, mungesa e besimit, mos përmbajtja, djall në formë të njeriut, personalitet në të cilin janë të portretizuara të gjitha tiparet e këqija.</p>
4.	<p><i>Personalitet paranoid</i></p> <p>(The paranoid personality)</p>	<p>Njerëzit me këtë personalitet janë dyshues dhe të ndjeshëm prandaj edhe është e vështirë të ndihmohen. Ata nuk ju besojnë të tjerëve dhe dyshojnë në motivet e tyre. Janë të lëkundur, të irrituar, debatues dhe kokëfortë. Nuk krijojnë miqësi me lehtësi, pasi janë të prirë për skena xhelozie ne marrëdhëniet e tyre seksuale. Shpesh janë të fshehtë, dredhues dhe pa humor.</p>
5.	<p><i>Personalitetit histerik</i></p> <p>(Hysterical personality)</p>	<p>Njerëzit me këtë çrregullim vazhdimisht duket se, luajnë një rol, ndërkohë që janë të paaftë për të qenë vetvetja. Kënaqen me të renë, kërkojnë pa pushim përvoja të reja, entuziazmi u shuhet shpejt dhe me lehtësi mërzhiten dhe mbesin të pakënaqur. Shpesh janë bosh, pa konsideratë dhe kërkues. Përdorin “kërcënime” emocionale, skena zemërimi dhe përpjekje</p>

		suicide për të detyruar të tjerët të veprojnë në përputhje me dëshirat e tyre .
6.	<i>Personaliteti narcistik</i> (Narcissistic/egoistic/self-loving personality)	Narcisizmi është vetëadmirimi i sëmurë. Njerëzit me këtë tip çrregullimi kanë ndjenjën e madhërisme të rëndësisë vetjake dhe preokupohen me fantazitë e sukseseve, pushtetit dhe mendjemprehtësisë intelektuale. Kërkojnë me çdo kusht vëmendje, shfrytëzojnë të tjerët dhe kërkojnë favore duke mos i kthyer ato. Kjo kategori karakterizohet me çrregullimet e personalitetit histerik dhe çrregullime asociale të personalitetit (antishoqëror).
7.	<i>Personaliteti i tipit skizoid</i> (The semi-schizophrenic personality)	Njeri pothuajse skizofren, i çuditshëm, inkurajohet dhe dekurajohet nga gjëra të çuditshme, i duket sikur gjithnjë është i vëzhguar nga të tjerët, i mbyllur dhe me opinion të keq për të tjerët, ka raporte të reduktuara dhe i frikësohet përballjes dhe kritikës.
8.	<i>Personaliteti kufitar, i çregulluar</i> (The Borderline Personality Disorder)	Ky term i referohet personalitetit që në disa mënyra është patologjik duke përfshirë paaftësinë për të formuar marrëdhënie të qëndrueshme, ndjenjën e vazhdueshme të mërzitjes, sjelljet

		dëmtuese si: shpenzime të paarsyeshme, kumar, i pakontrolluar ose vjedhje, gjendje shpirtërore të ndryshueshme, shpërthimet e pamotivuara të zemërimit, pasigurinë për identitetin personal dhe kërcënimet ose veprimet suicidale të përsëritura. Kjo kategori veçohet me çrregullime të personalitetit hysterik, narcistik dhe antishoqëror.
9.	<i>Personaliteti i shmangur</i> (Avoidant personality)	Ikën nga njerëzit dhe shoqërimi me ta. Ngurron në krijim të lidhjeve të reja, ka frikë pranimit dhe refuzimin nga të tjerët, ka frikë nënçmimit dhe ofendimit...
10.	<i>Personaliteti i varur</i> (Dependable/Reliable personality)	Këta njerëz kanë formën më ekstreme të karakteristikave të përshkruara të personalitetit varës. Ata përgjithësisht janë me vullnet të dobët dhe ju bëjnë lëshime në mënyrë pasive dëshirave të njerëzve të tjerë. Disa prej tyre i realizojnë qëllimet duke i bindur njerëzit t'i ndihmojnë, ndërsa protestojnë për paaftësinë e tyre. Në rast se, ata marrohen mund të përkrahen nga bashkëshorti, kanë besim në vetvete, braktisin klasën shoqërore dhe mbesin të papunë për një periudhë të gjatë.

11.	<i>Personaliteti pasiv-agresiv</i> (Passive aggressive personality)	Ky term përdoret për njerëz që u përgjigjen kërkesave me vonesë, qëndrim duarkryq, kokëfortësi, paaftësi të qëllimshme, shkujdesje të stimuluar dhe kritik të paarsyeshëm ndaj njerëzve me autoritet
12.	<i>Personaliteti i thyer, vetëmposhtur</i> (Defeated/Defeatist personality)	Dëfrehet duke qenë i përbuzur nga të tjerët, nuk i beson vetes dhe as kapaciteteve që ka. Iu bën presion tjerëve që të shesh se a kanë durim dhe se sa mund ta durojnë atë.
13.	<i>Personaliteti obsesiv</i> (The obsessive personality)	Interesohen për detaje në kurriz të cilësisë, kërkojnë idealen dhe angazhohen në punë dhe përkushtohen për të në kurriz të shoqërisë. Mbështetet vetëm tek vetja e vet, është ekonomist dhe jo ekstravagant.
14.	<i>Personaliteti depresiv</i> (Depressive personality)	Njeri pa humor, i mërzitur dhe i dëshpëruar gjithmonë. Por dëshpërimi nuk ndikon në punën dhe kryerjen e detyrave. Nuk sheh bardh por vetëm zi.
15.	<i>Personaliteti ekstrovert</i> (Extroverted personality)	Zemërbardhë, gjithnjë në humor, sillet mirë, i do të tjerët, ka vetëbesim dhe u zë besë të tjerëve, merr vendime shpejtë, nuk është i përpiktë në termine, i pëlqejnë

		lavdatat dhe komplimentet, nuk e pëlqen fort punën.
16.	<i>Personaliteti pozitiv</i> (Positive Personality)	Njeri që ka vështrim pozitiv për jetën, i qetë, i buzëqeshur, merr vendimet me maturi, dialogun me urtësi, i dëgjon të tjerët ndërsa flasin dhe diskutojnë.
17.	<i>Personalitet debatues</i> (The Sophist/debater personality)	Vetëm debaton, flet pa ndërprerë, nuk ka një qëllim të caktuar në bisedë, vuan nga vetmia dhe problemet shoqërore, i ekspozuar ndaj depresionit.
18.	<i>Personaliteti i drejtpeshuar</i> (Balanced personality)	Njeri me tipare dhe virtyte, i ekuilibruar, i pranon të tjerët dhe pranohet prej tyre.
19.	<i>Personalitet dyshues</i> (The Suspicious personality)	Paragjykues, ka opinion të keq për të tjerët, u shmanget të tjerëve, nuk i pëlqejnë kritikën, debaton dhe armiqësohet shpejtë, ka dëshirë të dominojë dhe udhëheqë, në fokus ka të metat dhe gabimet e njerëzve.
20.	<i>Personalitet naiv</i> (The Naive personality)	Pashpjegueshëm iu beson njerëzve, i shkujdesur, i pavëmendshëm rreth asaj që ndodh rreth tij, i akuzon të tjerët dhe i kritikon, është shumë i drejtpërdrejtë, madje edhe në çështje personale.

21.	<i>Personalitet i ashpër</i> (The Harsh personality)	I rëndë në raport me të tjerët, zemër vrazhdë, vuan mungesën e mëshirës dhe butësisë, armiqësor, ndëshkon ashpër, me forcë i detyron të tjerët të nënshtrohen, i pëlqen hakmarrja.
22.	<i>Personalitet i dhembshur</i> (The Compassionate personality)	Njeri me zemër të butë, i mëshirshëm me të tjerët, tolerant dhe falës, nuk hyn në debate dhe polemika, nuk armiqësohet me të tjerët.
23.	<i>Personalitet i kapitulluar</i> (The Capitulated/conceded personality)	Njeri që i nënshtrohet të tjerëve, që përshtatet, frikacak, u shkon për shtati të tjerëve, i dobët për ta shfaqur mendimin, i fsheh ndjenjat dhe i paaftë për t'i shprehur e shfaqur ato, i intereson më shumë të tjerët se vetja, nuk ka guxim ta shikojë në sy atë që i flet ¹ .

Konsiderojmë se do të ishte e dobishme sikur me këtë rast të përmendnim edhe disa lloje tjera të personalitetit, si:

¹Shih: Habib, Tarik, Harun, Xhasim, “*Envaou esh-shahsijjeti ve turuku etteamuli meaha*”, https://www.ibtesamah.com/showthread-t_454629.html, shfletuar më 25 dhjetor 2019. Shih po kështu: Tal'at Mensur dhe të tjerë, *Usus ilmi en-nefs el-am*, (Kajro: Mektebetu el-enxhl), f. 337-356; AbduRrahman Ajsus, *Ilmu en-nefsi el-am*, (Egjipt: Dar el-ma'rifeh), f. 10.

Nr.	Personaliteti	Shpjegimi
24.	<p><i>Personaliteti me ndjeshmëri të lartë</i> (Hypersensitive Personality)</p>	<p>Personaliteti i ndjeshëm i ka tre drejtime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) I ndjeshëm karshi vetvetes 2) I ndjeshëm karshi të tjerëve, 3) I ndjeshëm ndaj ambientit që e rrethon apo ku bën pjesë. <p><i>Personaliteti i ndjeshëm karshi vetvetes</i> është ai që nuk i harron mendimet e këqia, i cili vuan nga kokëdhimbja dhe presioni i brendshëm, ka oreks të çrregullt, herë han shumë e herë fare, i stresuar dhe në ankth, e kritikon veten shumë sepse nuk arrin nivelet që pret...</p> <p><i>I ndjeshëm karshi të tjerëve:</i> çdoherë mendon se si e shohin të tjerët, çfarë thonë për të, ndikohet shpejtë, nuk i pranon lehtë vërejtjet. Edhe atëherë kur nuk ka argument dhe provë, ai ka një vendim apo (para)gjykim për njerëzit që i ka përreth.</p> <p><i>Personaliteti i ndjeshëm ndaj rrethit ku jeton</i> është ai që nuk ndihet komod në mesin e njerëzve. Është ai që nuk ndihet i tillë as kur është vetëm madje në një dhomë dhe ka dritë të tepërt apo zëra të lartë, acarohet nga zhurma e befasishme apo lëvizjet e shpejta në trafik. Nuk i do lajmet e këqia. Ndikohet shumë nga letrat</p>

		apo mesazhet që merr në rrjetet sociale... ¹
25.	<i>Personalitet i çrregulluar, me identitete të ndryshme</i> (Split personality disorder, Multiple personality disorder, Dissociative Identity disorder)	Për shkak të një përvoje të hidhur që ka pasur është i shkëputur nga identiteti personal, ndjenjat, idetë, emocionet, kujtimet, veprat. Ky person është nën ndikimin e dy identiteteve të ndryshme mbi veprat dhe sjelljet e tij ² .
26.	<i>Personaliteti hipokrit</i> (The hypocritical personality)	Njeri i cili shtiret sikur është dikush që nuk është. Individ që shfaq të kundërtën e asaj që beson, njeri që thotë se beson ndërsa shpirtërisht mohon ³ , njeri që fsheh armiqësinë ndërsa shfaq miqësinë. Është personalitet me rrezik të madh andaj duhet pasur kujdes prej tij.

¹Shih:Shih:<https://www.psychologytoday.com/gb/blog/communication-success/201711/24-signs-highly-sensitive-person>, shfletuar më 2 janar 2020.

²Shih:<https://www.webmd.com/mental-health/dissociative-identity-disorder-multiple-personality-disorder#1>; <https://www.psycom.net/mchugh.html>, shfletuar më 2 janar 2020.

³Shih: <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar>, lëndën *munafik*, shfletuar më 7 janar 2020.

27.	<p><i>Personaliteti karizmatik</i> (Charismatic-Charming-Attractive Personality)</p>	<p>Ky personalitet dallohet për punë sistematike, për vendosmëri, zgjuarsia, mendjemprehtësi, horizont të gjerë të dijes, pavarësi, analizë të gjërave, kujtesë të fortë, nuk jepet pas gjërave materiale, pavarësi impotencës së lartë, është i përmbajtur, nuk jepet pas sporteve, arteve, muzikës dhe nuk i pëlqen të jetë në qendër të vëmendjes. I dashur dhe i gatshëm për të ndihmuar të tjerët. Modest, vatandashës, i ndershëm, besnik, i fjalës, i besës, i përmbahet terminëve dhe orareve, e do jetën familjare, anon kah ana ushtarake, i dëgjueshëm dhe i pëlqen të jetë i dëgjueshëm. Të tillët janë të brumosur për të qenë liderë, jo diçka tjetër, andaj shoqëria nuk duhet t'i anashkalojë e t'i shpërfillë! Një shoqëri që nuk di si të përfitojë prej njerëzve të tillë, do të ngelë përherë shoqëri e prapambetur¹.</p>
28.	<p><i>Personalitet eksploziv, shpërthyes, depresiv</i></p>	<p>Është njeriu me pamje të qetë, ndjenja të ftohta, zë të ulët, i edukuar dhe i sjellshëm në raport me të tjerët. E ndjek modën me kujdes. Kujdeset për anën fizike. As nuk do tejmase, as</p>

¹Shih: Muhammed Ajjash Kubejsi, *Enmat esh-shahsijjeti ve ishkalat el-kijadeti ve etterbijjeti fi el-ameli el-muasir*, f. 56-59. Ajo që ka përmendur Kubejsi në fakt është rezyme e punës së Dr. Sami Derubit.

	<p>(Exploitative personality / Depressive personality)</p>	<p>nuk urren tejmasë. Ka impotencë të lartë, të zhveshur nga petku i pasionit. Kënaqet me pamje lakuriqe dhe biseda erotike. Sipas tij dashuria është puthitja e dy trupave dhe sekretimi. Dallohet për inovacion dhe sens shkencor. I aftë për të manovruar për të arritur deri tek pozitat e larta. I dhënë pas grumbullimit të pasurisë. I shikon gjërat me llupë, vigjilentë, kupton shpejtë, i pavarur. Është pozitiv dhe objektiv, egoist i shkallës së parë. Në rrjedha me ngjarjet dhe ndodhitë e kohës, aftësi të rrallë shkrimi, ligjërimi e adresimi. Ka vizion më pak impulsiv. Është i çliruar nga principet. Nuk është shoqëror. Ka dëshirë të dominojë mbi njerëzit, është politikan dhe diplomat i klasit të parë. Shumë shpejt i përmbytë gjërat. Nuk ka dëshirë të futet thellë brenda njeriut. Mjaftohet me pesë shqisat dhe nuk i intereson asgjë tjetër, madje as kur zbaton vendime nuk interesohet për emocionet e huaja. Ka dyshime në fe, në gajbijate , moral, sistem. Nuk është shumë atdhedashës. Ndihet i depresionuar dhe sikur i është nënshtruar botës së errët brenda vetes së vet¹.</p>
--	---	--

¹Shih:Derubi, Sami, *Ilmu et-tibai - El-medresetu el-ferensijeh*, ve.cit., f.165-183.

29.	<p>Personaliteti limfatik (Lymphatic personality)</p>	<p>I qetë, i ftohtë, objektiv, i heshtur, i natyrshëm, guximtar, duron sëmundjet, përherë i zënë me punë, ka principe, atë që e thotë e bën, durimtar, vetëmohues, i ruajtur nga mëkatet e gabimet, i pavarur në ide e mendime, vigjilent, tolerant, vizion të gjerë, i kujdesshëm në ushqim e pije, nuk është materialist, sillet si njeri esnaf dhe me virtyte, meriton t'i zihet besë, i përmbahet orareve, optimist¹.</p>
30.	<p>Personaliteti zemëruar (Angry Personality)</p>	<p>Ndikohet shpejt dhe shumë. Ka aftësi t'u përgjigjet emocioneve të tij në mënyrë aktive. Nuk është për projekte të gjata që kërkojnë angazhim të madh e të gjatë. Ndërsa flet, bën gjestikulon me duar. Zërin e ka të lartë e jetën e zhurmshme. Është shumë i dhënë pas ushqimit, pijes dhe dëfrimit seksual. Shpejt pajtohet dhe shpejt hidhërohet. Dashurinë e kthen me dashuri, ka shpirt shoqëror².</p>

Këto janë llojet më të njohura dhe më të rëndësishme të personaliteteve, dhe shpresojmë se janë të mjaftueshme për

¹Shih:Derubi, Sami, Ilmu et-tibai - El-medresetu el-ferensijeh, ve.cit., f.189-190; Muhammed Ajjash Kubejsi, *Enmat esh-shahsijjeti ve ishkalat el-kijadeti ve etterbijjeti fi el-ameli el-muasir*, f.56-59

² Po aty.

vendimmarrësit gjatë rekomandimit apo zgjedhjes së kandidatit të duhur për postin e liderit, dhe Allahu e më mirë.

Analizë dhe replikë:

Vëllai dhe kolegu im, Profesori i nderuar, dr. Muhammed Ajash Kubejsi, ka dhënë një kontribut të çmuar sa i përket çështjes së llojeve të lidhshme prej të cilëve kemi përfituar edhe në këtë libër. Ajo që nuk jam pajtuar me të, me gjithë respektin e madh që kam, ka të bëjë me përkufizimin që ka ofruar për **shkencën e tipologjisë**, të cilën, duke cituar shkencëtarë perëndimorë, Lusin më saktë, e definojnë kështu:

*“Karakterologjia është një mori prirjesh të natyrshme të cilat formojnë strukturën psikologjike të njeriut. Me prirje është për qëllim ato me të cilat lind njeriu, **jo ato që fitohen apo ndryshojnë...**”* Më pas, Muhammed Ajash Kubejsi vazhdon e thotë:

*“Karakterologjia në fokus ka studimin e tipareve të qëndrueshme të personalitetit të njeriut të cilat e përfaqësojnë identitetin e tij të veçantë. **Kjo shkencë nuk ka asnjë lidhje me faktorë të jashtëm, si: feja, mendimi, shoqëria, sjelljet e ndryshueshme përveç në rastet kur shërbehet me to si tregues apo rezultat të llojit të karakterit..**”¹*

Përgjatë analizave, kemi ardhur në përfundim se nuk mund të pajtohemi me mendimin e Lusit dhe Kubejsit për sa i përket karakterologjisë. Në fakt, mund ta pranojmë pjesën e parë të definicionit por assesi pjesën tjetër ku përjashtohet roli i fesë si faktor i jashtëm. Kjo për arsye se në fjalorët dhe enciklopeditë që

¹Shih: Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi eksbi el-vela*, f. 54-58; Muhammed Ajash Kubejsi, *Enmat esh-shahsijjeti ve ishkalat el-kijadeti ve etterbijjeti fi el-ameli el-muasir*, f. 26-29.

kemi konsultuar për kuptimin e termit *tipologji*¹, askund nuk e kemi gjetur këtë shtesë që e kanë bërë Lusi dhe Kubejsi, dhe nuk dimë nga e kanë marrë! Është e pamundur të studiosh personalitetet e të mos flasësh për faktorët e jashtëm mendimin, sjelljen dhe fenë me theks të veçantë. Kjo për fatin se njeriu lind në apo me *fitreh*, **natyrshmëri të pastër, me personalitet të barazpeshuar e të pastër**. Të gjithë e duan të sapolindurin për shkak se është i mirë, i dashur, i këndshëm, pa vërejtje, si engjull, i pafajshëm... Por me kalimin e kohës, kur të jetë rritur e formuar, e shohim tek ndryshon në një person tjetër, në sjellje tjera, në qëndrime dhe mendime. Pyetja: Përse ndodhë ky ndryshim në ide e moral? Përgjigja: Si rezultat i ndikimit nga faktorët e jashtëm: mendimi, shoqëria, kultura qoftë kjo perëndimore, lindore, amerikane, indiane, kineze, arabe, shqiptare, etj. Pra, njeriun nuk mund ta gjykojmë me të lindur sepse ai lind i pastër, me *fitreh*, që Kur'ani e ka përmendur, “ *Drejtohu me përkushtim në fenë e drejtë, krijimtarinë e Allahut, sipas të cilës Ai i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim në krijimtarinë e Allahut. Kjo është fe e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë,*” [Rrum:3],

Gjykimi do të ishte i padrejtë! Vetëm atëherë kur të kemi mundësi ta marrim parasysh idenë, mendimin, kulturën e tij, fenë e tij, vetëm atëherë mund të kemi gjykim të drejtë ndaj tij.

Arsyeja pse po e përmendim këtë ka të bëjë me nevojën e themelimit të një shkence të re të quajtur *karakterologjia* apo shkence e leximit të vijave, fytyrës, shfrytëzimi i grupit të gjakut për ta njohur më mirë dhe më saktë personalitetin e një kandidati të propozuar për një post me rëndësi dhe më pas përzgjedhjen, ose jo të tij. Kur ta kemi studiuar këtë personalitet, ne vazhdojmë tutje me studimin ideve, sjelljes dhe bindjeve të

¹Shihe, krahasoje dhe analizoje këtë definicion me ato që kanë përmendur fjalorët e psikologjisë: <https://www.psychologytoday.com/gb/blog/progress-notes/201904/personality-typology-and-the-secret-knowing-person>.

tij, për të arritur t'i ndajmë idetë dhe bindjet e fituara të këtij njeriu që dikur ka qenë i pafajshëm. **Po kështu nuk mund ta studiojmë edhe thjesht vetëm nga perspektiva e fesë, kjo nuk është e drejtë, apo nga perspektiva mendimit apo shoqërisë, por duhet të mirren parasysh të gjitha ato që theksuam gjërë më tani.** Kjo është ajo që besoj, dhe Allahu e di më së miri!

Këtë të vërtetë e hasim në pothuajse të gjithë fjalorët që kanë definuar karakterologjinë e të cilët nuk e kanë përmendur pjesën e dytë që Lusi dhe Kubejsi e kanë përmendur. Ja, më qartë, definicione të shkëputura prej këtyre fjalorëve¹:

“Studim, analizim ose klasifikim në bazë të llojeve – detaleve në tërësi, ose grupeve.”, dmth: feja, mendimi, morali, etj.

Në një fjalor tjetër qëndron: *“Tipologjia nënkupton klasifikimin e gjërave sipas llojeve të caktuara, - detaleve- si ndarjen e njerëzve në njerëz të mirë dhe të këqij.”*², dmth: me tërësinë e cilësive –të mira apo të keqia që i kanë dhe jetojnë me ta.

Në fjalorin e Kembrixhit qëndron: *“Studimi i llojeve ose sistemi i ndarjes së gjërave në lloje – detale, ku futet edhe feja - .”*³

Siç mund të vërejmë nga këto definicione të njerëzve ekspertë dhe kompetentë, **Tipologjia ose Karakterologjia** është shkencë e cila merret me studimin, analizimin dhe klasifikimin e njerëzve ose krijesave mbi bazën e llojit ose grupeve edhe tipareve tjera. Këtë pjesë nuk e kanë përfshirë dhe Lusi dhe Kubejsi, e po kështu dhe Fejsal bin Xhasim Al Thani, i cili i ka cituar nga

¹Shih:<https://www.merriam-webster.com/dictionary/typology>, “Typology.” *The Merriam-Webster.com Dictionary*, Merriam-Webster Inc., 13 janar 2020.

²Shih:<https://www.vocabulary.com/dictionary/typology>, 13 janar 2020.

³<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/typology>, shfletuar më 13 janar 2020.

Kubejsi tërësisht mendimin e tij pa bërë ndonjë koment a shënim tjetër¹!

Besoj se me kaq do të mjaftonte sepse kjo që kemi prezantuar mendojmë se mjafton për mënyrat e njohjes me llojin e personalitetit të propozuar për lider. Pra, ai që do ta njeh personalitetin e një kandidati të propozuar për një post të caktuar, duhet marrë gjërat me qetësi dhe maturi, jo me nxitim e nguti, duhet zhvilluar analiza dhe teste të personalitetit nëse duam ta zgjedhim kandidatin më të mirë. Këto teste që do t'i sjellim këtu, është një mënyrë tjetër për të mos i bërë padrejtësi askujt.

1.6. Matësit e personalitetit – Testet e preferuara

Në pjesën paraprake u ndalëm tek llojet e personalitetit të cilat duhet t'i kemi në konsideratë në mënyrë që të bëjmë përzgjedhjen e duhur të liderit. Por pyetja që lind këtu është: A mjafton njohuria jonë për llojet e personalitetit për ta zgjidhur problemin e përzgjedhjes së liderit të duhur? Përgjigja: Natyrisht që jo, sepse natyra e postit dhe rrethanave parasheh nënshtrimin ndaj disa testeve dhe pyetësorëve², verbal e me shkrim, intervistave të hapura e të mbyllura, sepse disa kandidatë mund të mos shprehen mirë në shkrim ndërsa e bëjnë verbalisht për mrekulli, për dallim nga të tjerët që nuk e kanë problem shkrimin! Këtu vjen në pyetje shërbimi me shkencat në të cilat aludiam më parë, si: **tipologjia, karakterologjia, fizionomia, grafologjia**, etj. Kështu, fillimisht do të njiheshim me

¹Shih: Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep. cit., f. 54.

²Shih: Tal'at Mensur dhe të tjerë, *Usus ilmi en-nefs*, vep. cit., f. 399-300.

personalitetin, vijimisht do ta studionim nëpërmjet diskutimit, intervistës, testimi, dhe rrjedhimisht do të vendosnim pozitivisht ose jo për të¹.

Kjo është rruga që duhet ndjekur dhe këto janë principet që duhen aplikuar ndërsa duam ta përzgjedhim liderin! Pra, duke vëzhguar tiparet e tyre me të cilat dallohen në fushat e mendimit, psikës, sjelljeve dhe shkathtësive.

Duke qenë se psikologjia ka shënuar zhvillim të madh, janë zbuluar matës dhe standarde shkencorë nëpërmjet të cilëve mund t'i masim me saktësi të madhe tiparet dhe veçoritë e personalitetit.

Rëndësia e këtyre matësve shfaqet në fushat e punëtorëve në rafshin akademik, civil, fetar, ushtarak, dhe politik të organizatave për shkak të lidhjes së tipareve dhe veçorive të personalitetit me lloje të caktuara të sjelljeve².

Shkencëtarët dhe ekspertët kanë përmendur se këto mjete *janë dizajnuar për të matur gjëra të shumta dhe të ndryshme*.

- 1) Disa prej tyre masin **performancën dhe kapacitetin** e të testuarve. Testimi i inteligjencës p.sh. mat kapacitetin e përgjithshëm intelektual.
- 2) Disa teste tjera masin **preferencat e disa individëve** dhe sjelljet e tyre.
- 3) Disa të tjerë prirjet e të testuarve **rreth profesioneve dhe aktiviteteve të caktuara**.
- 4) Disa trajtojnë natyrën dhe dimensionet **e qasjeve dhe bindjeve të individëve** dhe të grupeve kundruall çështjeve të ndjeshme shoqërore.

¹Po aty, f. 400-404.

² Po aty, f. 387-398.

- 5) Disa masin aspekte të caktuara **në familje**, p.sh. anën materiale, raportet e babait me nënën, apo të fëmijës me fëmijën, apo të prindit me fëmijën, etj.
- 6) Disa prej tyre janë thjesht vetëm për të matur **gjendjen shëndetësore dhe fizike** të individëve¹.
- 7) Disa prej tyre kanë të bëjnë me **performancën e punës, misionit** apo rolit të tyre nëpër institucione civile, akademike, fetare, ushtarake, politike etj.

Sa u përket standardeve shkencore dhe universale që duhen plotësuar në këto teste dhe pyetsorë (*për matjen e niveleve të ndryshme të personalitetit*²), duhen marrë parasysh kriteret, principet në vazhdim:

- **Objektivizmi**
- **Diferencimi**
- **Standardizimi**
- **Qëndrueshmëria**
- **Validiteti,**

Këto kriteret për rëndësinë që kanë janë të përmbledhura në grafikun që vijon:

¹Shih: Tal'at Mensur dhe të tjerë, *Usus ilmi en-nefs*, vep. cit., f. 401.

²Po aty, f. 406-407.



Sa i përket të parës, *objektivizmit*, me të nënkuptohet strukturimi njohës dhe mendor me kusht që testi të na japë gradën e njëjtë, dmth: përgjigjja është e njëjtë edhe nëse numri apo lloji i kontrollorëve ndryshon. Njëherit edhe kontrollori duhet të jetë objektiv. Pra, pyetja nuk duhet të ketë më shumë se një opSION të saktë përgjigjeje, sikur që kontrollori nuk duhet të ndërhyjë në përmirësimin e përgjigjes,

Përsa i përket *diferencimit*, testimi duhet të vë në pah dallimet individuale në formë të qartë, ndryshe nuk ka ndonjë dobi! Testimi i lehtë në të cilin nuk shfaqen dallimet individuale nuk konsiderohet matës i saktë, as testimi i vështirë në të cilin nuk shfaqen dallimet nuk konsiderohet matës i mirë. Kjo nënkupton se testi duhet të jetë i drejtë dhe mesatar, as i lehtë, as i vështirë.

Me *standardizim* nënkuptojmë që matësi të jetë i vlefshëm për të gjithë dhe të shërbejë njësoj për të gjithë. Për këtë shkak, testi duhet të dallohet për metodologji të kulluar, formulim të qartë, për shprehje të kuptueshme dhe në përputhje me nivelin e të testuarve.

Qëndrueshmëria nënkupton se niveli i testimit të një individi të caktuar paraqet drejt dhe qartas aftësinë dhe kapacitetin e tij gjatë testimit. Niveli i testimit nuk ndikohet nga faktorë tjerë gjatë kohës sa ndodhë testimi, si p.sh., gjendja emocionale, mënyra e testimit, metoda e vlerësimit. Poashtu, ky testim duhet të japë rezultate të njëjta vazhdimisht, nëse përsëritet matja e tij me individët e njëjtë dhe në rrethana të njëjta.

Validiteti apo saktësia nënkupton se ky test matë aspektin që synohet të matet, jo diçka tjetër. Testimi kufizohet në fushë të ngushtë të profilit ndërsa është me nivel të lartë të veçorisë për matjen e së cilës edhe është vënë...¹


Në vazhdim, ja një shembull tabelor për matjen e personalitetit dhe stilet biheviorste, dhe që ska të bëjë me **inteligjencën, aftësinë, shëndetin mendor** ose **vlerat** :

Ushtrim sipas teorisë DISC të përmendur nga Major General Prof. Dr. William Kohen².

- 1) **Dominimi (Dominance)**
- 2) **Influencimi (Influence)**
- 3) **Qëndrueshmëria (Steadiness)**
- 4) **Bindja (Compliance)**

¹Shih: Tal'at Mensur dhe të tjerë, *Usus ilmi en-nefs*, vep. cit., f. 406-418.

²Shih: Major General William Kohen, *Fennu el-kijadeti*, (Mektebetu Xherir, 2008).



Në vazhdim, lexues të nderuar!, do tua prezantojmë një listë me tipare humane të lidershit. Prej jush kërkohet që ta bëni vlerësimin duke dhënë notat nga 0-5; 0 për tiparet që nuk përputhen aspak me ju, 5 për tiparet që përputhen me ju, ndërsa notat tjera sipas nivelit të përputhjes së tiparit me ju.

Nëpërmjet këtij pyetësoi ne arrijmë ta mësojmë personalitetin e kandidatit pretendent për lider. Kuptohet, ky i fundit duhet të jetë korrekt në përgjigje. Pyetësoi na ofron një imazh më të qartë dhe të dukshëm të këtyre katër tipareve të sipërpërmendura tek kandidati. Më qartë, ai a është njeri që e do **dominimin**, apo është njeri që **ndikon tek të tjerët**, apo është i **qëndrueshëm në**

parimet dhe principet dhe nuk lëviz prej tyre, apo është njeri i bindur dhe i dëgjueshëm ose arrogant dhe i padëgjueshëm.

(TESTI A) – TIPARET E LIDERSHIPIT		0	1	2	3	4	5
1.	Udhëheqës i përkushtuar për rezultate shkencore						
2.	Dëfrehet me shoqërimin e të tjerëve						
3.	I do punët ekzekutive në të cilat shoqërohet me të tjerët						
4.	Ka personalitet \ të fuqishëm						
5.	I dashur dhe lider						
6.	Lider, i cili ka raporte të gjera me njerëzit						
7.	I pranon sfidat						
8.	I shkëlqyeshëm në prononcime						
9.	I do detajet dhe ka durim të madh për punën precize						
10.	Nuk ndihet keq nga të qenit nën vëzhgimin e eprorit						
11.	I shpejtë në marrjen e vendimeve						
12.	I nxit dhe motivon ata që i ka përreth						
13.	Ndonjëherë i thyen rregullat për interes të përgjithshëm në punë						
14.	Shoqërues i mirë						
15.	Kërkon më shumë kompetenca						
16.	Ka besnikëri ndaj institucionit ku punon						

17.	Respekton hierarkinë						
18.	Ndryshimet radikale në organizatë nuk e pengojnë						
19.	Ka dëshirë të ndihmojë të tjerët						
20.	Nuk ka qejf të nxitohet në punë						
21.	Ka dro gabimet sepse e urren qortimin						
22.	Ka dëshirë t'u ndihmojë të tjerëve në menaxhimin e punëve						
23.	I qetë për vete, qetësues i të tjerëve						
24.	Ka dëshirë ta vlerësojë punën vazhdimisht						
25.	Merr pjesë në aktivitete kolektive						
26.	E dëgjon me vëmendje dhe respekt folësin/bashkëbiseduesin						
27.	E do zhvillimin dhe avancimin e vazhdueshëm						
28.	I kujdesshëm me të tjerët nga frika e humbjes së lidhjeve dhe raporteve me ta						
29.	I zgjidh problemet pa shikuar nëse lëndohet dikush a jo						
30.	Kureshtar për t'iu përmbajtur sistemeve dhe rregulloreve						
31.	Fleksibël me të tjerët						
32.	Urdhrat e tij janë të qarta						
33.	I do sistemet, jo urdhërat						
34.	Nuk ngushtohet prej urdhërave						

Kemi përshtypjen se kjo që shpjeguam për matjen e personalitetit dhe principet që duhen ndjekur e aplikuar për të korrur rezultatet e dëshiruara në njohjen e personalitetit të kandidatit të propozuar për post udhëheqës është e mjaftueshme. Allahu e di më së miri!

(TESTI B)- TESTIMI I AFTËSIVE DHE SHKATHTËSIVE TË KOMUNIKIMIT

Udhëzime: Nga opsionet e përshkruara më poshtë, rrumbullakësoni opsionin që mendoni se pasqyron më mirë formën se si ndiheni kur komunikoni me të tjerët. Në disa raste mund të gjeni më shumë se një opsion i cili iu përshkruan juve, mirëpo zgjidhni vetëm opsionin që mendoni se iu përfaqëson më shumë.

1.	Kur jam në një takim, preferoj të ulem në:	
	1) Në krye të tryezës	
	2) Atje ku njerëzit mund të më shohin	
	3) Direkt pranë një personi tjetër	
	4) Me të paktën një vend midis meje dhe personit tjetër	
2.	Kur flas me ndonjë një person:	
	1) Shikoj poshtë ndonjëherë	
	2) Gjatë tërë kohës e shikoj në sy	
	3) Shumicën e kohës e shikoj në sy	
	4) Në vend se ta shikoj atë, shikoj përreth në dhomë	
3.	Kur t'i përshëndes njerëzit që i njoh mjaft mirë:	
	1) I përshëndes pa i shtrënguar duart	
	2) Ua shtrëngoj duart fuqishëm	
	3) I përqafoj	

	4) I përshëndes për dore ngrohtësisht	
4.	Kur jam duke biseduar me njerëz	
	Më pëlqen të afrohem pranë tyre	
	Nuk ndihem rehat nëse qëndrojnë shumë pranë meje	
	Bezdisem nëse më afrohen më shumë se që duhet	
	Nuk më pengon nëse janë pranë meje	
5.	Ecja ime karakterizohet për:	
	1) Ecje të ngadalshme dhe të qetë	
	2) Ecje të gjallë	
	3) Ecje të balancuar	
	4) Ecje të shpejtuar	
6.	Kur të tjerët flasin, unë:	
	1) hulumtoj rreth pikës kryesore	
	2) hulumtoj për ndonjë rrëfim të bukur	
	3) hulumtoj rreth fakteve mbështetëse	
	4) përpiqem t'i kuptoj ndjenjat e tyre	
7.	Kur të mbaj ndonjë fjalim publik:	
	1) E ndryshoj nivelin e zërit për të ndikuar më shumë	
	2) Flas rrjedhshëm e qartë por jo me zë të lartë	
	3) Flas relativisht qetë	
	4) Flas me zë të lartë	

8.	Kur ta shoh ndonjë konflikt a mospajtim, mendothem:	
	1) të ulen gjakrat	
	2) ta shmang atë	
	3) të zhytem në të	
	4) t'i njoh shkaqet që çuan në të	
9.	Kur njerëzit hyjnë në zyrën ose hapësirën time të punës:	
	1) I pyes nëse duan të ulen	
	2) Iu them: uluni!	
	3) I lejoj ta përzgjedhin vendin e uljes	
	4) Ua tërheq ndonjë karrige që të ulen	
10.	Kur jam duke zgjidhur ndonjë problem:	
	1) Unë jam ai që udhëheq debatin	
	2) Dëgjoj atë që thonë të tjerët	
	3) Fokusohehem më shumë tek shkaqet kryesore	
	4) Fokusohehem tek faktet	
11.	Bisedat zakonisht i filloj me:	
	1) Zbulimin se si kalon dita e tjetrit	
	2) Tregimin e një historie	
	3) Kalimin e drejtpërdrejtë në temë	
	4) Përcaktimin e qëllimit të bisedës	
12.	Kur ta marr një vendim:	
	1) Shikoj se si do të ndikohen të tjerët prej tij	
	2) Mbështetem në mendimin tim personal	

	3) Përpiqem t'i bindi të tjerët për vendimin tim	
	4) Mbështetem në mënyra të sigurta të marrjes së vendimeve	
13.	Kur dikush të bëjë një prezantim:	
	1) Kam nevojë që prezantimi të jetë argëtues	
	2) Imagjinoj ndjenjat e tyre	
	3) Përpiqem ta vlerësoj urtësinë e prezantimit	
	4) Bëhem i padurueshëm nëse prezantimi është i ngadaltë	
14.	Kur të njohurit më prekin:	
	1) E mirëpres	
	2) Irritohem	
	3) E ndjejë afërsinë e tyre	
	4) Nuk ndihem i qetë	
15.	Kur dua ta marr atë që dëshiroj:	
	Mund të përfitoj nga kërkesat e të tjerëve	
	Mund të ofroj argument të fortë për kërkesën time	
	Prezantimin e shitjeve e kam për mrekulli	
	Ndihem i qetë dhe kompetent	
16.	Sipas asaj se si më shohin të tjerët:	
	1) Mund ta kontrollojë atë që ata dinë rreth meje	

	2) I lë të tjerët ta dinë se si ndihem	
	3) Jam person privat	
	4) Jam libër i hapur	
17.	Në takim të grupit:	
	1) Anoj kah vlerësimi i ideve	
	2) I lë hapësirë secilit të përfshihet	
	3) Anoj kah bartja e përgjegjësisë në udhëheqjen e debatit	
	4) E dëgjoj me vëmendje atë që duan njerëzit	
18.	Për sa i përket shprehjes publike të ndjenjave të mia personale:	
	1) Gjërat i bëj më interesante	
	2) I vë njerëzit në siklet	
	3) Më ndihmon të bashkëveproj me të tjerët	
	4) Të vë në rrugën e duhur për realizimin e gjërave	
19.	Në takimet e punës, synimi im është:	
	1) Të përcjell idetë dhe mendimet e mia	
	2) Të vë raporte me të tjerët	
	3) T'i bindi të tjerët	
	4) Ta vlerësoj situatën	
20.	Kur tregoj një histori:	
	1) Përqendrohem në situatat personale të personazheve	

	2) I mbaj njerëzit të ulur në buzë të ulëseve të tyre	
	3) Në mënyrë sistematike e ndërtoj një rast	
	4) Hyj drejtpërdrejt në temë	
21.	Sa i përket punës në ekip:	
	1) E mbështes ekipin	
	2) Preferoj ta marr përsipër përgjegjësinë në vend se të mbështetem tek ekipi	
	3) Zemërohem shpejt	
	4) E bashkoj ekipin	
22.	Kur ta bëj ndonjë prezantim:	
	1) Parapërgatitem mirë	
	2) I prek ndjenjat e njerëzve	
	3) Është i fortë	
	4) Është argëtues	
23.	Kur njerëzit të mërziten ose të qajnë para meje	
	1) Preferoj t'i ndali	
	2) Përpiqem t'i këshilloj	
	3) Përpiqem t'i bëj të gëzuar	
	4) Provoj disa mënyra që të dal prej asaj situate	
24.	Thirrjet e mia telefonike	
	1) Janë sa të shkurtra sa të jetë e mundshme	

	2) Janë të fokusuara vetëm në bizneset e përballeshme	
	3) Janë të gjalla	
	4) Janë me tendencë për tu zgjatur	
25.	Nga lista e mëposhtme përzgjidh pesë fjalët që njerëzit preferojnë t'i përdorin ndërsa të përshkruajnë ty:	
	1) Realist	
	2) Tip organizativ	
	3) I dashur	
	4) Motivues	
	5) Racional	
	6) I drejtpërdrejtë	
	7) I ngrohtë	
	8) Entuziast	
	9) Preciz	
	10) Pretendues	
	11) I shoqërueshëm	
	12) I hapur	
	13) I mbyllur	
	14) I fokusuar	
	15) Bashkëpunues	
	16) Emocional	

(TESTI C) - VETËVLERËSIMI I INTELIGJENCËS EMOCIONALE		
Lexoje secilin opsion të mëposhtëm dhe vlerëso se sa të përgjigjet ty. Ji objektiv dhe shmangu përzgjedhjeve mesatare.		Shëno pikët tua: Kurrë = 1 2 3 4 5 6, 7 8 9 10 = Gjithnjë
A	Vetëdija emocionale	
1	Ndjenjat e mia janë të qarta në secilin moment	
2	Emocionet luajnë rol të rëndësishëm në jetën time	
3	Temperamenti im nuk afekton njerëzit përreth meje	
4	Menjëherë arrij ta kuptoj kur e humbas durimin	
5	Temperamenti im afektohet lehtë nga faktorë të jashtëm	
6	Me lehtësi mund ta parashikoj kur mund të zemërohem	
7	Lehtësisht mund të ndahem nga zemërimi kështu që ai nuk ka asnjë ndikim tek unë	
8	E kam të vështirë t'i përshkruaj ndjenjat	
9	Kur jam i mërzhitur, nuk jam i vetëdijshëm për atë që më ndodhë	
10	Zakonisht e kuptoj kur jam pranë humbjes së durimit	

B	Menaxhimi emocional / Vetërregullimi	
1	E pranoj përgjegjësinë për reagimet e mia	
2	Nuk e kam të vështirë t'i përcaktoj qëllimet dhe t'iu përmbahem atyre	
3	Emocionalisht jam person i balancuar	
4	Nuk jam shumë person i durueshëm	
5	Mund t'i pranoj komentet kritike pa u zemëruar	
6	Nuk mund ta ruaj qetësinë gjatë kur jam në stres	
7	Nëse një çështje nuk më prek drejtpërdrejt, nuk merrem me të dhe nuk i jap hapësirë të më shqetësojë	
8	Nuk mund ta kontrolloj veten plotësisht kur jam i zemëruar me ndonjë person	
9	Zakonisht të tjerët e kuptojnë se si ndihem rreth çështjeve	
10	Energjinë time e orientoj kah puna kreative dhe hobit	

C	Ndërgjegjësimi emocional dhe shoqëror	
1	E vlerësoj/kalkuloj ndikimin e vendimeve të mia tek të tjerët	
2	Nuk mund ta shpreh lehtësisht nëse njerëzit përreth meje janë bërë të padurueshëm	
3	E ndiej kur temperamentimi i një personi ndryshon	
4	Jam në gjendje për të ofruar mbështetje kur të tjerët marrin lajme të këqija	
5	Zakonisht nuk jam në gjendje ta kuptoj mënyrën se si të tjerët ndihen	
6	Miq të mi mund të më flasin për sekrete të jetës së tyre private	
7	Vërtetë më mundon kur i shoh të tjerët tek vuajnë	
8	Zakonisht e di kur duhet të flas dhe kur të hesht	
9	Nuk më intereson se çfarë i ndodhë të tjerëve	
10	Jap përgjegjësi për atë që them, jo atë që njerëzit kuptojnë	

D	Shkathësitë sociale	
1	Jam i aftë për ta shfaqur ndikimin	
2	Zakonisht unë ndërtoj raporte solide me njerëzit me të cilët punoj	
3	Nuk më vjen vështirë t'i ndaj ndjenjat e mia të thella me të tjerët	
4	Nuk ia kam zanaat motivimin e të tjerëve	
5	Nuk jam person shumë i gëzuar	
6	E kam të lehtë të zë shoqëri	
7	Njerëzit më thonë se jam tip shoqëror dhe argëtues	
8	Jam i mirë në harmonizimin e dallimeve me të tjerët	
9	Të tjerët mund të mbështeten tek unë	
10	Nuk mund të flas me njerëz që janë të mërzitshëm	

E - Menaxhimi i raporteve sociale

<p>1. Kur të jeni me ndonjë grup të njerëzve, ju preferoni:</p> <ol style="list-style-type: none">1) T'i bashkoheni grupit për të biseduar me ta2) Flet individualisht velëm me njerëzit që i njeh	<p>11. Nga fjalët e mëposhtme, cilat i përdorni më shpesh?</p> <ol style="list-style-type: none">1) I fortë apo i vështirë2) I butë apo i edukuar
<p>2. Zakonisht ndihem i lumtur dhe mirë kur i shoqëroj:</p> <ol style="list-style-type: none">1) Njerëzit që janë realistë2) Njerëzit që imagjinojnë	<p>12. Ideja për ta bërë një listë me gjërat që duhet t'i bëni në vikend:</p> <ol style="list-style-type: none">1) Është e dashur për ju?2) Çështje që e shpërfillni totalisht
<p>3. Cila nga fjalët e mëposhtme ju tërheq më shumë:</p> <ol style="list-style-type: none">1) Analizë2) Bashkëndjej	<p>13. A anoni që të keni lidhje miqësore:</p> <ol style="list-style-type: none">1) Me njerëz të shumtë dhe të ndryshëm2) Të forta me një grup të vogël njerëzish
<p>4. Ndjekja e një orari kohor:</p> <ol style="list-style-type: none">1) Përshtatet me ju2) Është e urryer për ju	<p>14. A preferoni ta keni mik një njeri</p> <ol style="list-style-type: none">1) I cili interesohet vetëm për gjendjen e vet2) I cili çdoherë ka ide të reja dhe kreative
<p>5. Kur të flisni me të huajt:</p> <ol style="list-style-type: none">1) Flisni lirshëm dhe pa komplekse2) Nuk flisni shumë	<p>15. Nga fjalët e mëposhtme cila ju shkon shtati më shumë:</p> <ol style="list-style-type: none">1) Të menduarit2) Ndjenjat

<p>6. Po të ishit trajner, do të preferonit të mbanit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kurse rreth fakteve dhe të vërtetave 2) Kurse që përfshijnë teori dhe mendime 	<p>16. Gjërat që planifikohen paraprakisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Të pëlqejnë 2) Nuk ndihesh mirë dhe komod
<p>7. Cila nga fjalët e mëposhtme të përshtatet më shumë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Parashikim dhe planifikim 2) Mëshirë dhe solidaritet 	<p>17. Në festa e ahengje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ndiheni gazmor gjithmonë 2) Ndonjëherë të mërzitur
<p>8. A preferoni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Aranzhimin paraprak të manifestimeve, ahengjeve, takimeve, apo 2) Ndiheni i lirë për të bërë çfarëdo që duket argëtuese kur koha të ketë ardhur 	<p>18. Si preferoni ta konsideroni veten:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Person praktik, apo 2) Person gjenial
<p>9. A jeni nga ata që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) I njohin njerëzit lehtësisht 2) E kanë të vështirë t'i njohin ata 	<p>19. A preferoni të thirrreni vazhdimisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Person racional, apo 2) Person emocional
<p>10. A e preferoni personin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Modest, që nuk dallon shumë nga njerëzit e rëndomtë, apo 2) Personin që ka një vizion të qartë 	<p>20. A e keni të vështirë të adaptoheni me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ndryshim konstant dhe të vazhdueshëm, 2) Rutinë apo gjendje e pandryshueshme në vazhdimësi

(TESTI –D) ANKETË E VLERËSIMIT TË PUNTORËVE

Kjo anketë është konfidenciale. Rezultatet e përgjithshme do të ndahen me kompaninë ndërsa ato individuale do të mbesin konfidenciale. Ju lutem, lexoni opsionet e ofruara më poshtë dhe, për atë që nuk pajtoni fuqishëm me to, jepni vlerësimin 1-9, ndërsa për të tjerat që pajtoni fuqishëm me to, jepni vlerësimin me 10.

Misioni dhe qëllimi	NUK PAJTOJ FUQISHËM									PAJTOJ FUQISHËM
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Misionin dhe objektivat e organizatës i kam të qarta.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
E kuptoj se si puna ime kontribuon direkt në suksesin e përgjithshëm të organizatës.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Ndiej se puna ime është e rëndësishme për realizimin e objektivave të organizatës.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im vazhdimisht më siguron informacione të reja rreth misionit dhe objektivave të organizatës.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I kuptoj dhe jam i familjarizuar me objektivat strategjike të organizatës.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kryerja e punës me sukses më dhuron një ndjenjë kënaqësie e satisfaksioni	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Vendi i punës	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

I kam të gjitha burimet në shfrytëzim për ta kryer punën time siç kërkohet.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Proceset elementare dhe sistemet kompjuterike janë në vendin e vet dhe të qasshme për mua për ta kryer punën time.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kam informacionet e nevojshme për punën që duhet ta kryej.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Vendi im i punës është i sigurt.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Vendi im i punës është i mirëmbajtur.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Vendi im i punës fizikisht është vend komfort për të punuar.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Raportet me menaxherin	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im gjithnjë më trajton me respekt.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Mund të kontaktoj lehtë me menaxherin.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im më dëgjon kur flas. Idetë dhe mendimet e mia vlerësohen.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im vlerëson kontributin tim.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im vlerëson talentin dhe kontributin tim.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

E respektoj menaxherin si një kompetent profesionist.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im e kupton rëndësinë e mbajtjes së balancit ndërmjet punës dhe jetës personale.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Vëllimi i punës që më kërkohet ta bëj është i arsyeshëm.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Ritmi i punës ma mundëson ta kryej punën suksesshëm.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im është konsekuent/i vendostë sa herë që administron politikat që kanë të bëjnë me punëtorët.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Gjithnjë trajtohem me drejtësi nga menaxheri im.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Jam shumë i kënaqur me menaxherin tim.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri e trajton tërë ekipin me drejtësi.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Favorizimi (trajtimi special) nuk është çështje në rishikimin e pagave, trajnimin dhe zhvillimin ose promovimin në detyrë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kultura	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Organizata i respekton punëtorët.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

E respektoj bordin mbikëqyrës të kësaj organizate.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Lidershipi i kësaj organizate e di punën që janë duke bërë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Drejtorët tanë kryesorë shquhen për shkathtësi të rralla menaxheriale.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Organizata ka pritje racionale nga punëtorët.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Njerëzit që sfidojnë status quo-në janë të vlerësuar.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Mund të mos pajtohem me mbikëqyrësin tim pa pasur frikë se mund të më hakmerret.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Ndihem komod kur ndaj opinionet e mia me të tjerët në organizatë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Ne punojmë për tu bërë më atraktivë, më të zhvilluar, dhe për t'i ruajtur njerëzit me prapavija të ndryshme kulturore.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Njerëzit me ide të ndryshme vlerësohen në këtë organizatë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të gjithë trajtohen drejtë në këtë organizatë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kriteret e vlerësimit të performancës së punëtorëve	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

janë të drejta dhe të përshtatshme.										
Bashkëpunëtorët kujdesen për mua si individ.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Puna në ekip është e inkurajuar dhe praktikuar në këtë organizatë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Lidhja dhe bashkëpunimi ndërmjet ekipit të punës në këtë organizatë janë të fuqishme.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Shancë për rritje/zhvillim	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Politikat e organizatës për promovim dhe avancim janë përherë të drejta.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kam të njëjtat mundësi dhe shanse për avancim në organizatë, si gjithë të tjerët.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I pranoj trajnimet e duhura për ta kryer punën time siç duhet.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im vazhdimisht është i interesuar në zhvillimin dhe avancimin tim profesional.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Menaxheri im më inkurajon dhe mbështet për zhvillim profesional.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Jam i inkurajuar për të mësuar nga gabimet.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Puna ime është sfiduese.										

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Puna ime është stimuluese.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Puna ime shpërblehet.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Unë kam një mbikëqyrës në punë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përputhja ndërmjet punës dhe jetës, stres dhe vendi i punës	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Ambienti në këtë organizatë mbështet balancimin ndërmjet punës dhe jetës personale.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Jam në gjendje për të përmbushur detyrimet e mia familjare dhe profesionale.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Nuk jam i detyruar të zgjedh patjetër ndërmjet vendit të punës dhe familjes.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Puna ime nuk më shkakton stres të papërballuar në jetë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Reagimet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pranoj komente dhe vlerësime të dobishme nga menaxheri im.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Marr komente në baza të rregullta për punën dhe performancën time.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Pranoj komente të cilat më ndihmojnë ta rris performancën time.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kam një shans për të marrë pjesë në përcaktimin e objektivave										
Trajnohem vazhdimisht nga menaxheri im si pjesë e procesit të përmirësimit të performancës	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kur bëj një punë të mirë, pranoj lëvdata dhe vlerësime meritore										
Përqëndrimi në cilësi/kualitet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Njerëzit japin përgjegjësi për kualitetin e punës që bëjnë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kualiteti i produkteve dhe shërbimeve tona është shumë i rëndësishëm për organizatën.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Në këtë organizatë ne kemi standarde të larta të cilësisë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Komunikimi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Informatat dhe njohuritë ndahen në mënyrë të hapur brenda organizatës.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Organizata inkurajon për komunikim.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Menaxheri im bën punë të mirë në ndarjen e informacioneve.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Bordi mbikëqyrës i organizatës komunikon në formë të mirë me pjesën tjetër të organizatës.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kompensimi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Paguhem arsyeshëm për punën që bëj.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Paga ime është konkurruese me punë tjera që mund t'i gjej diku tjetër.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përfitimet e mia janë të krahasueshme me ato që kompanitë tjera ofrojnë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
E kuptoj planin tim të përfitimit/benificioneve	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Jam i kënaqur me të hyrat që realizoj.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Pyetje të hapura:

Me çfarë duhet të fillojmë?
Çfarë duhet të ndalojmë së vepruari?
Çfarë duhet të vazhdojmë së vepruari?

Pyetje demografike:

Mosha:	
Pozita:	
Edukimi:	
Nacionaliteti:	

2. STILET E LIDERSHIPIT

Në fushën e lidershipit rëndësi të veçantë kanë edhe mënyrat se si udhëhiqet e qeveriset. Ekspertët e kësaj fushe kanë shpjeguar se me to synohen sjelljet dhe praktikat e liderit apo menaxherit të organizatës, në raport me vartësit dhe nëpunësit, për t'i realizuar objektivat e kompanisë apo organizatës ku punojnë. Me këtë rast, kanë shtuar, se nuk është për qëllim një organizatë e caktuar, por çfarëdo organizate në çfarëdo fushe akademike, ushtarake, politike, fetare, civile, kulturore, apo afariste e biznesore qoftë¹.

Përgjatë hulumtimit, kemi mësuar se llojet e lidershipit janë të shumta porse disa ekspertë i kanë përmbledhur në tre stile kryesore:

- 1) Lidershipi autoritar (*autokratik, diktatorial apo lidershipi pasiv*). Ky stil në fokus ka liderin.
- 2) Lidershipi demokratik (*human dhe këshillues*). Ky stil në fokus ka vartësit/pasuesit.
- 3) Lidershipi Laissez-Faire (*negativ, kaotik, tolerant, vetëmposhtur*). Ky stil fokusohet tek nëpunësit dhe liria e pakushtëzuar e tij për të vepruar.

Disa studiues dhe hulumtues kanë përmendur edhe stile tjera, si stili *këshillues dhe rekomandues*, për të cilin kemi folur në kapitullin për Musanë a.s. *Pastaj stili trajnues, motivues, delegues*, etj.

¹Shih: Musfir Utejbî, *El-enmat el-kijadijeh...*, vep.cit., f. 10; Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep.cit., f. 65-75; William Kohen, *Fennu el-kijadeti*, vep.cit., f.55

Në vazhdim do të sjellim detaje nga tre stilet e lartpërmendura.


2.1. Lidershipit autokratik apo diktatorial: pikat e forta dhe të dobëta

Në vazhdim do të prezantojmë tiparet dhe karakteristikat e lidershipit autoritar. Me këtë rast do t'i referohemi studiuesit Musfir Utejbis (*Allahu e ruajtë!*), nga punimi i të cilit do të shkëpusim disa fjali me rëndësi.

2.1.1. Tiparet e liderit autokrat

- 1) Fuqinë ligjore e përdor si instrument për t'i bërë presion punëtorëve dhe për t'i detyruar ata në realizimin e punëve dhe të detyrave.
- 2) Duhet të respektohet pa asnjë diskutim. Vetën e paraqet si themel dhe bazë në çdo gjë.
- 3) Sukseset ia atribuon vetes ndërsa dështimet punëtorëve.
- 4) Nuk i zë besë askujt, prandaj ka kontroll të rreptë ndaj të gjithëve.
- 5) Është preciz sa i përket vendimeve dhe urdhërave që jep dhe të cilët insiston të zbatohen në përpikmëri nga punëtorët.
- 6) Fokusohet në kompetencat që ka dhe kryen punën vet, pa pjesëmarrjen e punëtorëve.

Grafiku në vijim i përmbledh këto tipare të liderit autokrat:



Disa studime kanë nënvizuar edhe tipare tjera të lidershipit diktatorial¹, siç do t'i shohim në grafikun më poshtë:

- 1) Menaxhon dhe udhëheq nëpërmjet frikës, kërcënimit, ndëshkimit.
- 2) Ndëshkon shumë, shpërblen pak.

¹ Shih poashtu: Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep.cit., f. 67-68.

- 3) I evidenton problemet, i parasheh zgjidhjet dhe më pas kërkon nga punëtorët apo vartësit t'i zbatojnë ato.
- 4) I ashpër, vulgar, nuk pranon bashkëpunimin me të tjerët dhe refuzon iniciativat.
- 5) Të gjithë ia kanë frikën dhe askush nuk do të hyjë në debat me të. Mbarëvajtja e punëve lidhet me prezencën e tij, ndryshe, në mungesë të tij, shkaktohet rrëmujë e kaos.
- 6) Raportet e tij me nëpunësit kanë vetëm një orientim: realizimin e sa më shumë sukseseve të kompanisë.

Grafiku në vijim i përmbledh këto tipare tjera të lidershit diktatorial.



Me këtë rast është me rëndësi të veçantë të përmendet se jo të gjithë liderët autoritarë kanë tipare të njëjta! Ata dallojnë ndërmjet vete. Më poshtë po sjellim disa prej këtyre dallimeve:

1) Udhëheqje e ashpër dhe e padrejtë

Kjo kategori e liderëve autoritarë njeriun e sheh thjesht si makinë të punës dhe si burim prodhimi. Fakti se ai është qenie humane, se ndikohet nga faktorë psikologjikë e shoqërorë, se lodhet, sëmuret dhe u ekspozohet rreziqeve, nuk paraqet aspak rëndësi për ta. Ky lider autoritar është i zhveshur nga mëshira, ndërgjegjja. Vetëm kërcënon. Ai e shfrytëzon pozitën që ka për të ndikuar tek të tjerët (ose thënë më mirë për t'i shtypur ata) - *si regjimet Komuniste në ish-Jugoslavi, Shqipëri, Korea e Veriut, Kinë, Kuba, Siri, Irak, etj* - . Vendimet i mer kokë më vete, pa u konsultuar më parë me askë.

2) Udhëheqje autoritare e drejtë

Lideri i kësaj kategorie shquhet për vetëbesim dhe metodë të mirë të punës. Fokusi i tij është tek niveli sa më i lartë i produktivitetit. Për dallim nga lideri i padrejtë, ky përdor bindjen si metodë për të ndikuar tek punëtorët. Shquhet për dashamirësi, butësi, por në rast rreziku nga dështimi, ai di të bëhet i ashpër. Nuk i mer vet vendimet por në konsultim me të tjerët, sipas kompetencave që kanë. Është këmbëngulës, racional, ekonomik dhe i sinqertë. Ky model lidërshepi dallon nga ai që përmendëm më parë.

3) Lidërshepi autoritar i manovrueshëm dhe i shkathët

Kjo metodë udhëheqjeje autoritare ka më së paku pushtet të imponuar. Mund të thuhet, rrjedhimisht, se është më i

afërt me stilin demokratik. Lideri bashkëpunon me vartësit apo nëpunësit me dashuri dhe delikatesë. Është shumë fleksibël kur trajton problemet që shfaqen në punë. Ndonëse nuk pranon pjesëmarrjen e punëtorëve në vendimmarrje dhe fjalën e fundit për vendimet e ka vet ai, punëtorët apo vartësit i bën të ndjehen sikur janë pjesë e vendimmarrjes. Ndonjëherë, për t'i bërë të ndjehen kështu, hedh në diskutim një projekt me mundësi ndryshimi, që punëtorët të mendojnë se edhe ata kanë merita për vendimin, ndërsa në fakt ai ka marrë këtë vendim.

2.1.2. Meritat e liderit autokrat

Pavarësisht që ky stil i lidershipit është i papranuar për pjesën më të madhe të njerëzve, ekspertët kanë përmendur disa aspekte pozitive të tij, sikur që përmendin dhe ato negative¹. Në vazhdim ne do të përmendim disa prej tyre:

- 1) Në disa raste, liderët autoritarë kanë rëndësi për shkak se arrijnë ta kthejnë rregullin dhe rendin e përmbysur në një organizatë apo kompani.
- 2) Lideri autoritar quhet ndryshe lideri vetëmohues i cili të shumtën e kohës, të angazhimit dhe energjisë ia kushton punës dhe në disa raste korrë sukses. Është dëshmuar praktikisht se liderët e tillë duke u mbështetur në aftësitë dhe shkathtësitë që kanë, janë më të aftë për të marrë vendime se vartësit.

¹ Shih: Musfir Utejbî, *El-enmat el-kijadijeh...*, vep.cit., f. 30; Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep.cit., f. 67; Peter G. Northouse, *Leadership and Practice*, pg: 19-26.

- 3) Janë antidoti i disa personaliteteve të shthurur, të papërmbytur, që nuk e duan rendin dhe rregullin, që nuk ndreqen me fjalë e këshilla. Studimet kanë konfirmuar se kur vija e pushtetit të jetë e qartë dhe e kuptueshme, ky stil lidershipi është mjet pozitiv për t'i trajtuar nëpunësit apo vartësit dhe si rrjedhojë çon në shtim të prodhimit.


2.1.3. Mangësitë e liderit autokrat

Të metat e tyre janë të shumta. Në vazhdim do të përmbledhim disa sa për ilustrim:

- 1) Punëtorët ndihen të kërcënuar nga lideri/menaxheri dhe nuk janë të kënaqur me punën që bëjnë.
- 2) Krijimi i armiqësisë dhe urrejtjes ndërmjet liderit dhe punëtorëve.
- 3) Rënia e moralit dhe vullnetit për punë
- 4) Punëtorët nuk e duan liderin dhe nuk duan me qejf t'i zbatojnë urdhrat e tij.
- 5) Shpirti inovativ dhe kreativ vdes tek punëtorët.
- 6) Për shkak të mënyrës centraliste të komunikimit: qendër – punëtorë, zhduket mirëkuptimi ndërmjet tyre ¹.

Grafiku në vijim përmbledh të metat e liderit autokrat:

¹ Shih: Musfir Utejbî, *Elenmat el-kijadijeh...*, vep.cit., f. 30; Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep.cit., f. 67; Peter G. Northouse, *Leadership and Practice*, pg: 19-26.



Siç vërejmë nga grafiku, të metat dhe të këqijat e lidërshipt autoritar janë të shumta. Kjo që përmendëm është si një pikë ujë në deti në raport me të këqijat që kanë. Atyre iu faturohen edhe shumë krime makabre, si vrasja e kundërshtarëve dhe oponentëve partiakë, politikë, etj, vetëm sepse e kanë

kundërshtuar liderin, në rastin më të keq mund të vritet ose burgoset, në rastin më të mirë mund të dëbohet dhe të internohet bashkë me familje. Këtë e kemi përjetuar edhe ne, në vendet tona, në Ballkan; në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Bosnjë, në kohën e ish-Jugosllavisë, ku liderët autoritarë vranë e masakruan qindra mijëra njerëz të pafajshëm! Shekulli i kaluar, veçmas gjysma e parë e tij, ka qenë përplotë me liderë të tillë famëkeqë, krimet e të cilëve tanimë janë të dokumentuara në punime të ndryshme, libra, filma dokumentarë, etj. Në Gjermani ishte p.sh., Adolf Hitleri, në Itali Benito Musolini, në Rusi Xhozef Stalini, në ish-Jugosllavinë Josip Broz Tito, në Shqipëri Enver Hoxha, në Serbi Slllobodan Millosheviqi, në Kubë Fidel Kastro, në Korenë e Veriut Kim Jong Un, në Kinë Mao Ce Tung etj¹.

Pasi që ne shqiptarët, boshnjakët, turqit dhe minoritetet e ish-Jugosllavisë ishim viktima të robëruar të kolonizuar, të masakruar, të burgosur, të privuar prej të drejtave tona kombëtare, politike dhe fetare islame për dekada me radhë ndër thundrrën e regjimit monist diktatorial të Titos dhe të Millosheviqit, dhe se shkak i situatës së mjerueshme politike, ekonomike, edukativo-arsimore e shëndetsore në këto 20 vitet e fundit pas luftës në Kosovë, 1999-2021, kemi raste konkrete dhe ndegjojme nga disa ku edhe pas kollapsit të këtyre regjimeve diktatoriale të lartpërmendura flasin se në kohën e komunizmit kemi pasë: sigurim shëndetësor, furnizim me barna të mjaftueshme, rrogat, fabrikat, shtesë për femijë etj – gjëra dhe realitete që nuk mohohen – por duhet të dijmë se gjendja e jonë aktuale mjeruese dhe e tmershme, e papranueshme ku fajtorë janë liderët e dështuar dhe të korruptuar; në asnjë mënyrë nuk na lejohet që

¹ Shih: Për tu bindur, mjafton të shikosh disa nga filmat dokumentarë me këtë tematikë. Për më shumë, shih: Muhammed Ahmed Dervish, *Nadharijat el-kijadeti ve istratexhijetu el-istihoadhi ala el-kuvveh*, (Kajro: Alem el-kutub, 2009), f. 204.

ne ta vajtojmë të kaluarën e atyre sistemeve dhe regjimeve komuniste, sepse ata për t'i mbuluar krimet e tyre u desht ta kompenzojnë disi në shërbim të shoqërisë komuniste dhe të popullit të ndjerë !! Në këtë kontekst është e udhës që për lexuesin, studentin dhe për të gjithë ata që janë të mllefosur nga kjo gjendja e jonë aktuale në Kosovë të sjellim disa krime historike që ishin tmerr e zi për ne dhe ata që kanë përjetuar dhe, që nuk harrohen kurrë. Për këtë realitet të dhimbshëm historik na flet historiani ynë i njohur Kosovar prof.Dr.Hakif Bajrami, ku në mes tjerash thekson:

“...Derisa sa krali i shpërnguli 240,000 shqiptarë, pa kthim në Anadoll e 25,000 në Shqipëri, me shans për t'u kthyer, Tito i shpërnguli 415,000 shqiptarë në Anadoll dhe vetëm 157 në Shqipëri, të cilët po të ktheheshin do ta kalbeshin në burgje, ose do të përfundonin në varr. Sa i takon kolonizimit të Kosovës, Krali i solli 11,000 familje dhe aty kah viti 1938 nxori edhe Ligjin që 0,40 ari tokë duhet t'i ketë shqiptari, kurse serbi mundet t'i ketë jo ma shumë se 45 hektarë, plus male e deri te ndonjë minierë, si Nikolla Pashiqi që e përvetësoi me djalë edhe Trepçën. Tito provoi n'anën tjetër të gjithë shqiptarët t'i "civilizojë", duke ua grabitur tërë pasurinë, për nevoja të kolektivave, duke bërë plane "civilizuese" që në kooperativa djali shqiptar të martohet me vajzën serbe, ndërsa vajza shqiptare të martohet me djalin serbi dhe kështu të krijohet "Kombi socialist jugosllavë", i ngjashëm me veprimin e Kral Aleksandrit kur Serbët, Kroatët dhe Sllovenët i quajti fise, të një populli, e pastaj nga viti 1929 ua humbi emrin dhe "kulturën" për ta krijuar kombin 'civilizues" jugosllav. Në këtë fushatë ishte i sigurt sepse: malazezëve më 1918 ua humbi shtetin, dinastinë dhe kombin, kurse më 1929 serbëve, kroatëve dhe sllovenëve ua humbi emrin e kombit dhe perspektivën..., Dhurata e kralit dedikuar shqiptarëve është 152,000 vjet burgje, kurse dhurata e Titos është 677,856 vjet burgje, me 750,000 dosje personale, ndër ma

të egrat në Evropë, duke montuar procese, duke vendosë pesë herë diktaturë ushtarake, duke i vrarë nëpër eshalone të vdekjes më 1945-1949 mbi 40,000 shqiptarë pa gjurmë, në të gjitha anët e Jugosllavisë federative. Lidhur me këtë po i numërojmë me radhë të zezat e ideuara, folura dhe të bëra me urdhrin e tij, me të vetmin qëllim që të mbetet faraon në “Belli Dvor” të Beogradit, në cilësinë e kralit mizantrop, aty ku natë e ditë serbianët neofashist ia ruajnë varrin edhe sot. Ja faktet se çka i solli Kosovës (Shqiptarëve që ishin nën robëri të tij), ku Adem Demaçi zë vendin e parë në Evropë dhe më gjerë duke kaluar 28 vjet në burgje për mendimin ndryshe dhe për të drejta kombëtare...”¹.

Kemi përshtypjen se kaq mjafton sa për të ilustruar këtë kategori lidershpi. Shkojmë tutje tek stili i dytë.

2.2. Lidershpi demokratik dhe shtyllat e tij

Në fjalorët arabë dhe anglez, demokracia është definuar si më poshtë:

- 1) në rrafshin filozofik, demokracia definohet si: *“Sistem i cili nënkupton vetëqeverisjen e popullit ose më saktë qeverisjen e fukarenjve. Është mënyrë jetese e cila bën të besojë secilin individ se ai ka shansin e barabartë dhe lirinë e plotë që, sikur të gjithë të tjerët, të kontribuojë dhe marrë pjesë në vlerat shoqërore...”*
- 2) Në rrafshin politik, demokracia paraqet *“Një prej formave të qeverisjes në të cilën pushteti i përket popullit...”*, ose

¹ Shih detaje tmerruese në: <https://www.radiokosovaelire.com/prof-dr-hakif-bajrami-kush-ishte-josip-broz-tito-dhe-cfare-qendrimi-mbajti-ndaj-shqiptareve-ne-vitet-1941-1980/>, portali është shfletuar më 7.08.2021

“Sistem qeverisës i cili i jep të drejtën popullit të votojë për përfaqësuesit, si rezultat i të cilit (votimit) formohet edhe shumica (parlamentare).”

- 3) Në rrafshin shoqëror, demokracia është *“Mënyrë jetese e cila bazohet mbi parimin e barazisë dhe lirisë së shprehjes e mendimit...”¹*

Disa fjalorë në anglisht kanë përmendur si kuptime të demokracisë edhe *“zhdukjen e diferencimeve dhe privilegjeve shtresore, të trashëguara e arbitrare. Ose është qeveria pushteti i cilës delegohet nga populli për ta ushtruar drejtpërdrejtë.”²*

Sic dihet prej burimeve dhe referencave se Demokracia përbehet nga dy fjalë të vjetra greke: *demos* (populli) dhe *kratos* (fuqia, pushteti). Me fjalë tjera, demokracia nënkupton pushtetin i cili në fund të fundit është në dorën e secilit qytetar dhe se ai nuk i takon (dhe nuk është monopol në dorën e një) shtrese paralele me pushtetin. Bazuar në këtë, mund të themi se demokracia shkurt nënkupton *pushtetin e popullit* ³.

Ekziston edhe një definicion tjetër i demokracisë, i dhënë nga ish-presidenti amerikan, Abraham Linkoln, i përmendur në fjalimin e tij më 1863, ndërsa mbante fjalimin në Betejën e Getisburgut (Gettysburg): *“Qeveria e popullit, nga populli dhe për hir të popullit...”*, ky definicion më pëlqen shumë.

Në një studim të thellë të nga *Byroja e Departamentit Amerikan të Shtetit* rreth përcaktimit dhe definicionit të Demokracisë, të

¹ Shih: <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar>, shfletuar më 19 mars 2020..

² Shih: <https://www.almaany.com/en/dict/en-en/democracy/>; shfletuar më 26 mars 2020. Shih po kështu edhe fjalorin anglisht: <https://www.merriam-webster.com/dictionary/democracy>, shfletuar më 26 mars 2020.

³ Shih më gjerësisht studimin e gjerë dhe profesional të shokut prof.Dr.Najif bin Nehar el Shemmerij , Qatar University, *el Dijmokratijetu kema hije – Demokracia ashtu si është*, Dar Akl li el Neshr, botim 2, Damask, Siri, fq: 57-64

titulluar *"What is Democracy - Çfarë është Demokracia¹"*, për rëndësinë që ka, po shkëpusim ca inserte, ku demokracia shpjegohet kështu: *"...Qeveria e Popullit, Demokracia, mund të jetë një fjalë e njohur për shumicën, por është një koncept ende i keqkuptuar dhe i keqpërdorur në një kohë kur regjimet totalitare dhe diktaturat ushtarake, ashtu si janë përpjekur të kërkojnë mbështetje popullore, duke lidhur etiketat demokratike mbi veten e tyre..."*

Në përkufizimin e fjalorit, demokracia është *"qeverisje nga njerëzit në të cilët pushteti suprem i është dhënë popullit dhe ushtrohet drejtpërdrejt nga ai ose nga agjentët e tij të zgjedhur nën një sistem zgjedhor të lirë"*. Në frazën e Abraham Lincoln, demokracia është një *"qeveri e njerëzve, nga populli dhe për njerëzit."*

Liria dhe demokracia shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, por të dyja nuk janë sinonime. Demokracia është me të vërtetë një tërësi idesh dhe parimesh për lirinë, por gjithashtu përbëhet nga një sërë praktikash dhe procedurash që janë formuar gjatë një historie të gjatë, shpesh torturuese. Me pak fjalë, demokracia është institucionalizimi i lirisë...,

Demokracitë ndahen në dy kategori themelore, *të drejtpërdrejta* dhe *përfaqësuese*. Në një demokraci të drejtpërdrejtë, të gjithë qytetarët, pa ndërmjetësin e zyrtarëve të zgjedhur ose të emëruar, mund të marrin pjesë në marrjen e vendimeve publike. Një sistem i tillë është qartë vetëm praktik me një numër relativisht të vogël njerëzish-në një organizatë komuniteti ose këshill fisnor, ose njësi vendore të një sindikate pune, ku anëtarët mund të takohen në një dhomë të vetme për të diskutuar çështje dhe për të marrë vendime me konsensus ose shumicë votash.

¹ Kjo faqe prodhohet dhe mirëmbahet nga Byroja e Departamentit Amerikan të Shtetit për Programet e Informacionit Ndërkombëtar. <https://web.archive.org/2017.ait.org.tw/infousa/zhtw/DOCS/whatsdem/homepage.htm>, Editor: Howard Cincotta,

Athina e lashtë, demokracia e parë në botë, arriti të praktikojë demokracinë e drejtpërdrejtë me një asamble që mund të ketë numëruar 5,000 deri në 6,000 persona-ndoshta numri maksimal që mund të mbledhet fizikisht në një vend dhe të praktikojë demokracinë e drejtpërdrejtë.

Shoqëria moderne, me madhësinë dhe kompleksitetin e saj, ofron pak mundësi për demokraci të drejtpërdrejtë...

Të gjitha demokracitë janë sisteme në të cilat qytetarët marrin lirshëm vendime politike sipas sundimit të shumicës. Por sundimi nga shumica nuk është domosdoshmërisht demokratike: Askush, për shembull, nuk do ta quante një sistem të drejtë ose thjesht që lejonte 51 përqind të popullsisë të shtypte 49 përqind të mbetur në emër të shumicës. Në një shoqëri demokratike, sundimi i shumicës duhet të shoqërohet me garancitë e të drejtave individuale të njeriut që, nga ana tjetër, shërbejnë për të mbrojtur të drejtat e pakicave-qofshin ato etnike, fetare, apo politike...Të drejtat e pakicave nuk varen nga vullneti i mirë i shumicës dhe nuk mund të eliminohen me shumicën e votave. Të drejtat e pakicave mbrohen sepse ligjet dhe institucionet demokratike mbrojnë të drejtat e të gjithë qytetarëve.

Diane Ravitch, studiuese, autore dhe një ish -ndihmëse sekretare amerikane e arsimit, shkroi në një punim për një seminar arsimor në Poloni:

"Kur një demokraci përfaqësuese vepron në përputhje me një kushtetutë që kufizon kompetencat e qeverisë dhe garanton të drejtat themelore për të gjithë qytetarët, kjo formë e qeverisjes është një demokraci kushtetuese. Në një shoqëri të tillë, shumica sundon dhe të drejtat e pakicave mbrohen me ligj dhe përmes institucionalizimit të ligjit" .

Këta elementë përcaktojnë elementët themelore të të gjitha demokracive moderne, pa marrë parasysh sa të ndryshme në

histori, kulturë dhe ekonomi..., Në një shoqëri autoritare, praktikisht të gjitha organizatat e tilla do të kontrolloheshin, licencoheshin, vëzhgoheshin, ose përndryshe do të jepnin llogari para qeverisë. Në një demokraci, fuqitë e qeverisë janë, me ligj, të përcaktuara qartë dhe të kufizuara ashpër. Si rezultat, organizatat private janë të lira nga kontrolli i qeverisë..., Grupe të tjera, të shqetësuara për artet, praktikimin e besimit fetar, kërkimin shkencor ose interesa të tjera, mund të zgjedhin të kenë pak ose aspak kontakt me qeverinë...

Shtyllat e Demokracisë

- Sovraniteti i popullit.
- Qeveria e bazuar në pëlqimin e të qeverisurve.
- Rregulli i shumicës.
- Të drejtat e pakicave.
- Garancia e të drejtave themelore të njeriut.
- Zgjedhje të lira dhe të ndershme.
- Barazia para ligjit.
- Procesi i rregullt ligjor.
- Kufizimet kushtetuese të qeverisë.
- Pluralizmi social, ekonomik dhe politik.
- Vlerat e tolerancës, pragmatizmit, bashkëpunimit dhe kompromisit.

Të Drejtat Themelore të Njeriut

- Liria e fjalës, shprehjes dhe shtypit.
- Liria e fesë.
- Liria e tubimit dhe bashkimit.
- E drejta për mbrojtje të barabartë të ligjit.

- E drejta për proces të rregullt dhe gjykim të drejtë..¹

Prej veçorive më të spikatura të këtij stili është se ai mbështetet në tre strumbullarë themelorë të lidershipit:



1) Zhvillimi i raporteve njerëzore


Prej veçorive të raporteve të mira njerëzore është krijimi i një klime shoqërore të shëndetshme në të cilën punëtorët ndihen sikur janë një familje jo një organizatë a kompani. Kjo për shkak të efekteve dashamirëse që raportet e mira kanë në raport me njëri-tjetrin, në afrimin dhe bashkimin e tyre mes vete. Studimet kanë konfirmuar se përkushtimi për aspektin human dhe moral tek punëtorët ndikon në rritjen e prodhimit dhe produktivitetit, nëpërmjet hapave në vazhdim:

¹ Për më gjerë referoju faqes: <https://web-archive.2017.ait.org.tw/infousa/zhtw/DOCS/whatsdem/homepage.htm>, Editor: Howard Cincotta, Byroja e Departamentit Amerikan të Shtetit për Programet e Informacionit Ndërkombëtar.




2) Marrja e përbashkët e vendimeve

Nëpërmjet angazhimit të punëtorëve në marrjen e vendimeve, lideri arrin të njihet me sa më shumë mendime dhe propozime, nga të cilët më pas mund të për zgjedh më të përshtatshmin, që i përgjigjet më së miri objektivave të organizatës, sikurse si na sqaron kjo grafikë vijuese:



3) Delegimi i pushtetit

Duke marrë parasysh detyrat dhe përgjegjësitë e shumta që ka lideri, për t'i menaxhuar ato me sa më shumë sukses, ai përgjegjësitë duhet t'i ndajë me të tjerët. Kjo nënkupton se ai duhet t'i ndajë disa detyra me të tjerët, që duhet t'i kryejnë me kompetencë. Kjo në asnjë rrethanë nuk nënkupton shkarkimin e liderit nga përgjegjësia ¹, sikurse na sqaron kjo grafikë vijuese:



Studiuesit dhe dijetarët e lidërsipit kanë vërejtur që edhe lidërsipi demokratik nuk është pa defekte. Në vijim po i përmendim disa:

Defektet e lidërsipit demokratik

- Shkarkimi i liderit nga disa detyra dhe obligime që i ngarkohen nga qendra kryesore

¹ Shih: Musfir Utejbî, *Elenmat el-kijadijeh...*, vep.cit., f. 30; Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep.cit., f. 67; Peter G. Northouse, *Leadership and Practice*, pg: 19-26.

- Marrja e mendimit të punëtorëve është mënyra jo shkencore dhe që nuk përputhet me burokracinë e liderëve
- Fokusimi tek punëtorët jo detyrimisht ngrit moralin dhe vullnetin e tyre ¹.

Jemi vet dëshmitarë të gjallë që ato definicionet e përmendura në fillim të kësaj teme rreth kuptimit të “ *Lidershipit Demokratik*” po abuzohen në jetën tonë politike, akademike dhe fetare, dhe se definicioni i Abraham Linkol-nit, “*Qeveria e popullit, nga populli dhe për hir të popullit...*” po thuhet ka mbet slogan i zbrazet dhe mashtrues për fat të keq!, dhe se opresionet, shkelja e të drejtave minimale të njeriut, luftërat e pa të drejta, imperializmi, kolonializmi modern, urrejtja qeveritare europiane, amerikane, arabe, aziatike ndaj minoriteteve dhe ndaj besimtarëve musliman në veqanti, racizmi i tyre, xenofobia, islamofobia etj etj, janë argumente dhe prova konkrete të abuzimit real dhe aktual të këtij rendi, sistemi, regjimi shoqëror modern, gjë që sinjalizon tmerrin dhe kaosin bashkëkohor në emër të "demokracisë", ku nuk mundesh të hasish në asnjë shtet në botë me parime të ngjashme demokratike! Multi sisteme, multi mënyra, multi stile, të “ *demokracisë së masakruar*”!!, kështu është halli me ligjet dhe sistemet e mangëta dhe të dobëta njerzore!!

Grafiku në vijim na i përmbledhë këto defekte:

¹ Shih: Musfir Utejbî, *Elenmat el-kijadijeh...*, vep.cit., f. 30; Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep.cit., f. 67; Peter G. Northouse, *Leadership and Practice*, pg: 19-26.



3. LIDERSHIPI KAOTIK (LAISSEZ-FAIRE)

Ky stil është plotësisht i ndryshëm me stilin autoritar sepse pothuajse nuk ka lidërsip fare. Secili pjesëtar i organizatës është i lirë të kryejë detyrën si të dojë. Pasiviteti dhe negativiteti i liderit janë ato që theksohen më shumë, e kjo për shkak se nuk ka një rregull apo ligj sipas të cilit do të qeverisej. Lideri në punë nuk ka rol pozitiv karshi punëtorëve. Ata veprojnë lirshëm si të mos kishte fare lider apo menaxher. Vështruar sipas dobisë dhe kompetencave, konsiderohet stili më i papërshtatshëm. Lideri konsideron se duke i lënë punëtorët e lirë, rriten aftësitë, kapacitetet dhe mjeshtëria e tyre. Një i mençur nuk do ta përvetësonte këtë stil udhëheqje dhe nuk dimë në histori dikush në organizata ushtarake, civile, fetare, akademike, që të ketë aplikuar këtë formë qeverisje apo menaxhimi, ndoshta aty këtu ndonjë rast i rallë. Personalisht, si hulumtues, nuk kam arritur të kuptoj pse ekspertët e kanë futur këtë si stil lidërsipi! Prandaj po e përmend vetëm sa për besnikëri shkencore e metodologjike, sepse thjesht është i padobishëm sipas mendimit tim! Allahu e di më së miri!¹

Në vazhdim do të ndalemi pak tek avantazhet dhe disavantazhet e këtij stili lidërsipi për të kaluar më pas tek një krahasim ndërmjet tre stileve të përmendura. Përsërisim se ky stil lidërsipi nuk duhet të përvetësohet sepse bie ndesh me konceptin Kur'anor dhe profetik për liderin dhe përgjegjësitë e tij në mbarëvajtjen e punëve!²

¹ Shih: Musfir Utejbi, *Elenmat el-kijadijeh...*, vep.cit., f. 30; Fejsal bin Xhasim Al Thani, *El-kijadetu ve etheruha fi kesbi el-vela*, vep.cit., f. 67; Peter G. Northouse, *Leadership and Practice*, pg: 19-26.

² Shih me detalisht rreth këtij lloji të lidërsipi në portalet vijuese:

1


Veçoritë e këtij stili lidërshepit

Ky stil mund të ketë efekte eventuale pozitive nëse lideri i ka rrethanat dhe shkathtësitë përkatëse të lidërshepit të cilat e nxisin për inovacion, avancim personal dhe fitim të përvojave

Suksesi i këtij stili varet nga niveli i lartë mendor dhe shkencor i atyre me të cilët punon lideri

2


Vërejtjet ndaj këtij stili të lidërshepit



<https://www.recursosdeautoayuda.com/sq/udh%C3%ABheqja-laissez-faire/>,
<https://sq.reoveme.com/cfare-eshte-lidërshepi-laissez-faire/> . Shfletimi i portaleve u bë më datë 16.09.2021

Shpjegim me rëndësi

Nga ajo që u tha ma herët, pas analizave tona mund të konkludojmë duke bërë një klasifikim mes stileve të lidërshipt në grafikun që vijon:



Krahasim ndërmjet tre stileve të lidershipit

Stili autoritar:

- a. Lideri vendos për të gjitha sistemet.
- b. Hapat e punës dhe etapat e saj janë të paqarta.
- c. Lideri shpjegon funksionin e secilit anëtar.
- d. Lideri është tejet personal në vlerësime apo qortime.


Stili demokratik:

- a. Të gjitha sistemet janë të miratuara nga lideri dhe pasuesit njëkohësisht.
- b. Përcakton hapat kryesor të punës ndërsa lideri propozon alternativat.
- c. Pasuesit janë të lirë për të përzgjedhur bashkëpunatorin.
- d. Lideri është objektiv sa i përket vërejtjeve dhe lavdatave.

Stili kaotik:

- a. Liri e plotë e pasuesve në miratimin e sistemeve. Pjesëmarrësja e liderit është e kufizuar.
- b. Lideri ofron informacionet kur kërkohen prej tij ndërsa nuk interesohet për diskutimin e tyre.
- c. Lideri nuk ndërhyt në punët e pasuesve.
- d. Lideri nuk merret me lavdata dhe as qortimin e pasuesve.

Grafiku në vijim përmbledh këto stile krahasuese:



Pas kësaj që u tha dhe u shpjegua gjer më tani, besojmë bindshëm që është mjaftë për t'u ditur dhe kuptuar rreth bazave, stileve dhe parimeve të lidërshiptit kur'anor dhe atij bashkëkohor, e që studenti, lexuesi dhe lideri i ardhshëm politik, akademik, civil, ushtarak dhe fetar duhet të dijë dhe të kuptojë, dhe Allahu xh.sh., e di më mirë.

Tani do të kalojmë në kapitullin e pestë dhe të fundit, ku do të trajtojmë disa shembuj bashkëkohorë të lidershit të suksesshëm, me qëllim të pasimit dhe ndjekjes së shëmbëlltyrës së tyre, ndërsa synojmë rimëkëmbjen tonë institucionale, akademike, ushtarake, civile e fetare. Janë liderë, shembuj për të mirë, por jo të pagabueshëm, sepse janë njerëz! Këtë duhet ta kemi parasysh gjithmonë! Së këndejmi, ne marrim më të mirën nga ata, ndërsa atë që e konsiderojmë si jo të qëlluar, e marrim me rezervë, sepse ndonëse janë liderë, edhe ata janë njerëz dhe mund të gabojnë!

Tani shtrohet pyetja e madhe! Po çfarë stil të liderit synon Islami?

Përgjigjja është në këtë përmbledhje të rëndësishme që vijon:

PËRMBLEDHJE ME RËNDËSI TË MADHE

❖ Lideri qe synon Islami:

- Të jetë mysliman (*nëse populli është me shumicë myslimane dhe shtet mysliman, si në Kosovë p.sh., Turqi, Malajzi etj.*) Në shtetet perëndimore liria është e popullit dhe me zgjedhje caktohet lideri, dhe ai i cili fiton me vota të lira, të tjerët e kanë për detyrë ta pranojnë dhe ta respektojnë).
- Të ketë informata shoqërore, respektivisht të jetë në dijeni për gjendjen dhe hallet e popullit, dhe:

Të dallohet për :

- gjallëri dhe angazhim.
- motivim dhe vetiniciativë.
- vetëvëzhgim.
- amanet dhe përgjegjësi.
- etikë dhe kulturë.
- kualifikim dhe njohuri.
- sinqeritet dhe korrektësi në fjalë dhe vepra.
- qëndresë dhe guxim.
- aftësi për zgjidhjen e krizave.
- drejtësi dhe forcë përballë sfidave.
- vendosmëri dhe vetëbesim.
- ofrim të sigurisë dhe mirëqenies për popullin.
- devotshmëri.
- modesti dhe falënderim për Allahun xh.sh.

- vepra të mira.
- mjeshtri dhe aftësi brilante në udhëzimet që jep.
- për vëzhgim të përhershëm të asistentëve të tij.
- fuqi.
- konsultim dhe kuvendim me të tjerët.
- trajnim dhe udhëheqje administrative.
- marrëdhënie të mira.
- planifikim dhe kreativitet.
- idealizëm.
- diplomaci.
- luftim të korrupsionit dhe anarkisë.
- për interesim rreth zbulimeve teknologjike dhe industriale.
- shpallje të kushtetutës dhe ligjit/sistemit qeverisës.
- ndëshkim të keqbërësve dhe shpërblim të mirëbërësve.
- bashkëpunim me vartësit për zgjidhjen e problemeve.
- ikje nga paragjykimi i tyre dhe bazimi në informacione të pakonfirmuara për punëtorët.
- drejtësi dhe vlerësimi objektiv të performancës së tyre.
- përhapje të klimës vëllazërore.
- tolerancë dhe fleksibilitet me vartësit apo punëtorët.
- pajtim të vartësve apo punëtorëve në rast të ngatërresave ndërmjet tyre.
- ruajtje të pasurive të tyre.
- drejtësi sociale duke shpërndarë të mirat materiale sipas pozitive të tyre dhe performancës së tyre.

Të fokusohet në këto shtigje për reforma dhe ndryshime

- **Shtegu fetar:** Reformimin e diskurseve dhe programeve aplikative fetare dhe edukative në të gjitha nivelet nëpër xhamia dhe medrese.
- **Shtegu shoqëror:** Jetësimin e kodit etik kur'anor në të gjitha nivelet individuale e shoqërore, private e publike, politike dhe ekonomike.
- **Shtegu udhëheqës:** Ekzistimin e një lidërshipi të fuqishëm i cili mbikëqyr zbatimin në praktikë të këtij texhdidi (*ripërtëritje dhe reformimi*), dhe garanton sigurinë e dijetarëve, udhëheqësve dhe akterëve në këtë proces.
- **Shtegu arsimor:** Rishikimin, ndryshimin dhe përpilimin e planprogrameve arsimore akademike dhe fetare duke filluar nga ai parashkollor, fillor, i mesëm e deri tek ai universitar, si dhe përfitimin nga përvojat e suksesshme
- nga shtetet si Japonia, Malajzia, Turqia, etj.

Kujdes prej faktorëve që ndikojnë negativisht personalitetin dhe lidërshpin tënd.

- Fuqia e faktorëve të klasës shoqërore (*pozitës dhe prejardhjes*)
- Fuqia e faktorëve trashëgues (*guximi, frika, zgjuarsia, intuita*)
- Fuqia e lidhjeve familjare, (nepotizmi)

- Fuqia e faktorëve kulturorë të fituar dhe përvetësuar (*doket dhe zakonet*)
- Fuqia e faktorëve të korrupsionit administrativ (*dashuria për postin dhe famën*)
- Fuqia e faktorëve të korrupsionit ekonomik (*dashuria për pasurinë dhe marrja e dhënia e ryshfetit*)
- Fuqia e faktorëve të shthurjes fetare dhe intelektuale (*përhapja e ateizmit shekullarizimit*)
- Fuqia e faktorëve të shthurjes morale (*përhapja e të këqijave me të gjitha llojet e tyre*)

Allahu di më mirë, dhe të gjitha falënderimet janë për Allahun .xh.sh.



Kapitulli V:

**PËRMBLEDHJE TË SHKURTRA BIOGRAFIKE DHE
UDHËHEQËSE TË DISA PREJ LIDERËVE MË TË
SUKSESSHËM DJE DHE SOT**

LIDERI I PARË: EBU BEKRI R.A.

LIDERI I DYTË: OMER BIN HATTABI R.A.

LIDERI I TRETË: HALID BIN VELIDI R.A.

LIDERI I KATËRT: OMER MUHTARI

LIDERI I PESTË: ALIJA IZETBEGOVIÇ

LIDERI I GJASHTE: REXHEP TAJJIP ERDOGAN

KARTELA IDENTIFIKUESE TË DISA
PERSONALITETEVE UDHËHEQËSE MË TË
SUKSESSHËM DJE DHE SOT

Personaliteti I:

EBU BEKRI r.a.

(أبو بكر رضي الله عنه)



- Emri/ofiqi** EMRI: *Abdullah bin Uthman bin Amir bin Amr bin Ka'b bin Sa'd bin Tejm bin Murre bin Ka'b bin Luej bin Galib el-kureshij ettejmi*
OFIQI: *Essiddik*
- Lindja/vdekja** Ebu Bekri r.a., ka lindur në Mekkë, plot dy vite e gjysmë pas vitit të (ndodhisë së) elefantit.
Ka vdekur ditën e hënë, në muajin xhumada el-ula, viti 13 pas hixhretit, në moshën 63 vjeçare.
- Historiku i Islamit:** Burri i parë që ka pranuar Islamin qysh në ditët e para të Thirrjes Islame. Shumë burime historike nuk e kanë saktësuar kohën kur ka ndodhur kjo.
- Tiparet e personalitetit:** **Sinqeriteti:** Kishte marrë ofiqin *i sinqerti* si rezultat i besimit në Muhammedin a.s., dhe vërtetimit të asaj që ai kumtonte. I këtillë kishte ngelur gjatë gjithë jetës. Dëshmi të këtij sinqeriteti dhe besimi të paluhatshëm mund të marrim ndodhinë e Israsë dhe Miraxhit, të cilin e kishte konfirmuar kur e kishin pyetur njerëzit

për të ndonëse ende pa e parë Muhammedin a.s. Arsyetimi i tij ishte besimi në fjalët e Muhammedit a.s.: *"I zë besë për lajmet që i vijnë nga qielli sabah e aksham, si të mos i zë besë për këtë!"* - kishte thënë.

Modestia dhe përrulësia: Ishte modest gjatë gjithë jetës së tij, sa ishte qytetar i rëndomtë e edhe atëherë kur mori detyrën e të parit të shtetit islam – Halifes.

Dëshmi të kësaj modestie mund të merret gjesti i tij prej besimtari të devotshëm kur shkante dhe lagjes së vet ua mjelte bagëtitë. Kur e mori pushtetit, dikush kishte thënë: *Ebu Bekri nuk do ta bëjë më këtë!*, ndërsa ai që përgjigjur: *Përkundrazi, do të vazhdoj ta bëj. Unë e lus Allahun që pushteti të mos më ndryshojë!*

Ishte i shoqërueshëm, i dashur, i edukuar...

I ndjeshëm, lotues i madh: Ishte i ndjeshëm, nuk e përmbante veten dot në namaz.

Burrëria dhe serioziteti: Kurrë nuk e kishte konsumuar rakinë, as atëherë kur nuk ishte mysliman. E kishte bërë për ta ruajtur nderin dhe burrërinë.

Tiparet e lidershipit:

Komandant i ushtrisë myslimane: Pas marrjes nën kontroll të situatës së brishtë të krijuar nga fitneja e (sprova, rebelimi i) dezertorëve dhe mohuesve të dhënies së zekatit me arsyetimin se kinse ai paskësh qenë obligim vetëm në kohën e Pejgamberit a.s., Ebu Bekri r.a., iu qas qëllimit sublim dhe objektives kryesore të Islamit, lartësimit të fjalës *la ilahe il-la Allah Muhammedun Resulullah!* për t'i nxjerrë njerëzit kështu nga errësira në dritë.

Tanimë kishte ardhur koha që Islami të tejkalonte gadishullin arabik andaj edhe si rezultat i kësaj nisme filluan çlirimet e para.

Shpenzimi për hir të Allahut: Ebu Bekri r.a., kishte shpenzuar shuma të konsiderueshme parash për të liruar besimtarët nga skllavëria. Më saktë, kishte liruar shtatë skllavër, në mesin e të cilëve edhe Bilalin r.a.

Referencat e biografisë:

Muhammed Munkidh Mahmud Sekkar, *Err-rreudu el-enîk fi ithbati imameti Ebi Bekir essiddik*, (Saudi: Universiteti Ummu el-Kura, 1993).

Muhammed Ali Salabi, *Ebu Bekir essiddik – shahsijetuhu ve asruhu*, (Dar el-ma'rife li en-neshr ve etteuzië, ed. 7, 2001)¹.

Ali Tantavi, *Ebu Bekir essiddik min etteraxhum ve el-a'lam*, (Xhidde: Dar el-menare, ed. 2, 1987).



¹ Ky libër është përkthyer dhe botuar edhe në shqip. **Përkthyesi.**

Personaliteti II:

OMERI, I BIRI I HATTABIT, r.a.

(عمر بن الخطاب رضي الله عنه)



Emri: Umer bin Hattab bin Nufejl bin Abdul Uzza bin Rijah bin Abdullah bin Kurt bin Rezah bin Adij bin Ka'b bin Luej bin Galib bin Fihir bin Malik bin Nadr, i cili është Kurejsh bin Kinane bin Huzejme bin Mudrikeh bin Iljas bin Mudar bin Nizar bin Ma'd bin Adnan, adevij kureshij.

Lindja/vdekja: Ka lindur pas viti të elefantit, 13 vite pas lindjes së Muhammedit a.s. Ndërsa ka vdekur ditën e mërkurë, më 26 dhul hixhe 23 h., pas një sulmi tinëzar nga zjarrputisti Ebu Lu'lue, i cili e kishte ruajtur derisa kur ishte duke e falur namazin e sabahut me xhematë, respektivisht bënte sexhden, e kishte sulmuar me një hanxhar.

Historiku i Islamit: E ka pranuar Islamin në muajin dhul hixhe në vitin e gjashtë të pejgamberisë së Muhammedit a.s. Atëbotë ishte njëzeteshtatë vjeçar.

Tiparet e personalitetit: **Drejtësia:** Omeri r.a., ishte shumë i drejtë dhe, nga aftësia për ta ndarë e të bërë diferencimin ndërmjet të vërtetës dhe të kotës, kishte marrë ofiqin *el-faruk*.

Modestia: Tek Omeri r.a., mund të depërtoje lehtë dhe, madje, edhe ta thërrisje thjesht në emër.

Mbikëqyrja: Omeri r.a., ishte vigilent karshi raporteve me Allahun xh.sh, respektivisht e kishte në hatër përherë mbikëqyrjen nga Ai, sikur që përgjegjësinë për detyrën që iu kishte ngarkuar, jo vetëm në raport me njerëzit, por edhe me kafshët, e kishte në nivelet më të larta. Nga përgjegjësia që ndiente, bënte fare pak gjumë.

Autoriteti: Omeri r.a., dallonte për seriozitetin dhe rreptësinë, për çka edhe djajtë e kishin frikë. Në prani të tij, njerëzit nuk guxonin të bënin gabime. **Transmetohet nga ai se lideri nuk duhet të qëndroj në postin/mandatin e tij më shumë se katër vite, sepse nëse ka qenë i drejtë, populli do të bezdiset prej tij, bëhen monoton, dhe nëse ka qenë tiran/zullumqar, mjafton kjo periudhë katër vjeçare për zullumin e tij, ma shumë nuk ban me qëndrue, duhet të largohet.

**Tiparet e
lidërshipt:**

Përzgjedhja e duhur e bashkëpunëtorëve: Nuk është drejtësi ta akuzosh një vartës dhe ta shfajësosh eprorin e tij dhe të bëhesh i verbër dhe i shurdhër ndaj ankesave të popullit ndaj tij. Omeri r.a., konsideronte se kush emëron një mëkatar (të pandershëm) në një detyrë, me dijen paraprake për gjendjen e tij, është mëkatar i ngjashëm me të. (Nisur nga ky parim) Omer bin Abdul Azizi (një lider i drejtë, i ardhur disa vite pas Omerit r.a.) vendimin e parë që kishte marrë pas ardhjes në detyrë ishte shkarkimi i të gjithë guvernatorëve të padrejtë, të cilët ishin emëruar më parë.

Konsultimi: Kjo që të mos merr vendimet i vetëm. Omeri r.a., madje kishte ndaluar Sahabet r.a., që ta braktisnin Medinen, në mënyrë që të merrte mendimet e tyre për ngjarjet dhe ndodhitë e ndryshme. Sipas *shura-së* (konsultimit), lideri nuk ka të drejtë tua imponojë mendimin e vet dhe aq më pak të shfaqet i padrejtë ose të hakmerret ndaj atyre që mendojnë ndryshe, ngase kështu *shura* nuk do të kishte rëndësi.

Përkujdesja për zhvillimin e fuqisë dhe kapaciteteve ushtarake: Omeri r.a., i kushtonte rëndësi të madhe përgatitjes dhe aftësisë të ushtarëve, sikur që ishte kureshtar për epërsi profesionale.

Burimet:

Muhammed Ali Salabi, *Faslu el-hitab si sireti Umeri bin el-Hattab, Emiiri el-mu'minine: shahsijjetuhu ve asruhu*, (EBA: Mektebetu es-Sahabe, 2002).

Abdusettar Shejh, *Umer bin el-Hattab – el-halifetu err-rashidij el-adhim ve el-imam el-adil err-rrahim*, (Damask: Dar el-kalem, 1976).

AbduRrahman bin Ali, *Menakibu Emiri elo-mu'minine Umer bin el-Hattab*, (Dar Ibn Haldun).

**Insert i shkëputur nga fjalimi i Hoxhës dhe dijetarit të madh Sheikh Hasen Veled ed Dedu, nga kanali televiziv Al Xhazera në Doha-Katar, emisioni (Pa Kufi) –(Bi la hudud), me datën 1.12.2021



Personaliteti III:

HALIDI, I BIRI I VELIDIT, r.a.

(خالد بن الوليد رضي الله عنه)



Emri: Halid bin Velid bin Mugire bin Abdullah bin Amr bin Mahzum bin Jakdha bin Murre bin Ka'b bin Luej bin Galib bin Fihir bin Malik bin Kurejsh bin Kinane.

Lindja/vdekja: Ka lindur në Mekken e Nderuar, në vitin 592 g. Ndërsa ka vdekur në vitin 21 h./642 g.

Historiku i Islamit: Islamin e ka pranuar në vitin e tetë sipas hixhretit, në muajin safer.

Tiparet e personalitetit: **Altruizmi, vetëmohimi dhe sakrifica:** Halidi r.a., ishte besimtar i përkushtuar. Para çdo gjëje, interesohej për kënaqësinë e Allahut xh.sh. rrëfëhet të ketë thënë: *“Më shumë e dua një natë të acartë në një çetë muhaxhirësh duke iu vërsulur me sabah armiqve se një natë të bukur në të cilën hyj dhëndër me një nuse që e dua dhe në të cilën më jepet myzhdeja për një djalë.”*

Guximi: Ky tipar i Halidit është më i madh se që një paragraf mund ta zë ose përshkruaj. Nëse do të duhej ta përmbledhim guximin e tij, atëherë ajo që mund të themi është: mjafton që shëmbëlltyra e tij vazhdon të

jetë model frymëzimi dhe përforcimi për besimtarët gjeneratë pas gjenerate.

Mendimi i thellë strategjik: Mendimet e Halidit nuk ishin produkt çasti. Ai mendonte shumë dhe thellë dhe tek më pas nxirrte një vendim. Rrëfëhet se, sa herë ishte para një vendimi të vështirë, Halidi mendonte thellë, shikonte sa lart në qiell sa poshtë në tokë, qëndronte ashtu për një kohë të gjatë duke menduar, e pastaj merrte vendimin.

**Tiparet e
lidërshipt:**

Guximi dhe intuïta: Halidi dallohej për guximin, gjallërinë, vigjilencën, mendjemprehtësinë, dhe fuqinë e ndikimit. Historianët kanë përmendur aftësinë e tij për të vënë strategjinë e luftës në momentet më kritike dhe këtë duke qenë në betejë. Për të thuhej se zhvillonte luftën siç e shihte të arsyeshme, herë luftonte me aradhe (ushtria e organizuar në radhë dhe rreshta) e herë organizohej në çeta apo kavaleri dhe ashtu e bënte luftën.

Iniciativa dhe aftësia për të vënë strategji në kohë reale: Aftësia e Halidit r.a., për të marrë një iniciative ishte më e shpejtë se që armiku mund ta vërente apo merrte vesh. Bile, ai e befasonte armikun sepse ndërmerre veprime që atyre as që do t'iu kishin shkuar ndërmend.

Motivi i lartë moral: Halidi r.a., për asnjë çast nuk ka neglizhuar rëndësinë e moralit dhe motivit në ushtri, sikur që është interesuar ta rrënojë atë tek pala kundërshtarë me çdo mjet të mundshëm. Halidi r.a., ishte pasqyra ku ushtarët mund ta ndërtonin këtë moral, ta rritnin këtë vullnet, duke i bërë kështu të

besonin në fitore dhe të mos dëshpëroheshin nga frika apo rreziku i humbjes.

Burimet: Halid Ensari, *Iber ve idhat min hajati es-Sahabe: Halid bin Velid*, (Egjipt: Dar el-beshir, 1990).

Bessam el-Aselij, *Kadetu fet'hi biladi esh-sham ve el-Irak*, (Liban: Dar en-nefais, 2012).

Omer bin Ahmed bin Hibeh bin Adim, *Zubdetu-l-haleb min tarihi Haleb*, (Dar el-kutub el-ilmije).



Personaliteti IV:
OMER MUHTARI

(عمر المختار)



Emri: Omer bin el-Muhtar bin Omer.

Lindja/vdekja: Ka lindur në fshatin *xhenzur* në zonën e Xhebel el-ahdar në Berka në vitin 1858 (ose sipas një versioni 1862), ndërsa ka vdekur më 16 shtator 1931. Në fakt, është ekzekutuar me varje nga pushtuesi italian.

Tiparet e personalitetit: **Dituria e gjerë:** Omeri dallohej për dijen e shumtë që kishte fituar në shkencat fetare ani pse nuk kishte lënë pas dore as shkencat tjera jofetare. Dallohej veçanërisht për dijet rreth ambientit dhe shoqërisë ku jetonte. I njihnte mirë traditat, zakonet, karakterin e popullit të vet, historikun dhe ngjarjet e ndryshme të fiseve dhe kabileve.

Personaliteti i fuqishëm: Ky tipar i Omerit është shfaqur me rastin e kundërshtimit të tij për t'iu nënshtruar okupatorit italian dhe atëherë kur bëri thirrje për mobilizim gjithëpopullor kundër tyre. historia ka dëshmuar se thirrjet e tij nuk kanë qenë shterpe, përkundrazi kanë rezultuar të suksesshme.

Përkushtimi shpirtëror: Ishte shumë i dhënë pas adhurimit. Nuk flinte më shumë se tre orë gjatë natës. Zgjohej, merrte abdes dhe vazhdonte të falej deri në kohën e namazit të sabahut. Po kështu nuk kalonte një javë pa mos e lexuar tërë Kur'anin.

**Tiparet e
lidërshipt:**

Guximi: Se Omeri ishte i guximshëm dëshmon jeta dhe veprimtaria e tij. Përkushtimi i tij për të luftuar kundër kolonialistëve francezë në Çad dhe atyre italianë në Libi është një nga qindra dëshmitë për guximin e tij. Po kështu edhe shkresa që i dërgoi Sharif Garjanit, të cilin forcat italiane e kishin detyruar të ndërmjetësonte pa dashjen e tij në marrëveshjen me Omerin për ta ndalur luftën.

Zgjidhja e krizave dhe problemeve: Një ndër punët e mëdha që bënte Omeri ishte edhe pajtimi ndërmjet fiseve dhe kabileve. Nuk ka ndodhur një herë ta ketë marrë një detyrë e të ketë dështuar. Fama dhe reputacioni i mirë që kishte fituar e kishin bërë të pranueshëm për të gjitha fiset dhe kabilet.

Udhëheqja e fisit: Omeri ka marrë pjesë në luftë kundër francezëve në Sudanin Perëndimor. Pas një periudhe të kaluar në beteja, Omeri do ta kalonte një pjesë të jetës duke dhënë mësim dhe duke përhapur fenë e Zotit tek njerëzit.

Burimet: Ali Muhamemd Salabi, *Esh-shejh el-xhelil Omer bin el-Muhtar*, (El-mektebetu el-asrije, 2007).

Isam Abdul Fettah, *Omer bin el-Muhtar ve rixhaluhu*, (Dar en-neshr El-kunuz).

Grup autorësh, *Omer el-Muhtar: neddalun min exhli el-hurrije*, (Egjipt: Dar en-neshr el-Mizan, 2014).



Personaliteti V:

ALIJA IZETBEGOVIÇ – Ish-president i Bosnjës

(Alija Izetbegović)



Emri: Alija IzetbBegoviç

Lindja/vdekja: Ka lindur më 08.08.1925 (18 muharrem 1344) ndërsa ka vdekur më 19.10.2003 (23 shaban 1424).

Edukimi: Aliu ka ndjekur studimet në Universitetin e Sarajevës ku fillimisht ka fituar diplomën e lartë (1950) ndërsa më vonë, në vitin 1962, ka fituar edhe titullin doktor. Në vitin 1964 ka fituar një diplomë tjetër të lartë në ekonomi. Aliu ishte poliglot. Fliste dhe shkruante disa gjuhë të huaja, si: *gjermanisht, frëngjisht, anglisht, dhe kishte njohuri të shkëlqyera në arabisht.*

Tiparet e personalitetit: **Shpirt luftarak:** Shquhej për shpirt luftarak. Asnjëherë nuk hoqi dorë nga principet, bindjet, besimi në fitore dhe vlerat në të cilat besonte.

Dallohej po kështu për **seriozitet, vendosmëri dhe sinqeritet në punë.**

Mendimtar: Aliu ishte intelektual dhe mendimtar i zoti. Pas vete ka lënë vepra me peshë, të cilat, jo vetëm

që kanë pasuruar librarinë islame porse do t'i shërbejnë gjeneratave të ardhshme për kohë të gjatë.

Tiparet e leadershipit:

Modestia dhe asketizmi: Duke folur për kushtet në të cilat jetonte, Aliu shprehet kështu: *"Jetoj në një apartament prej dy dhomash, i cili është pronë e Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Nuk kam shërbëtorë dhe as salltanet. As unë dhe as pasardhësit e mi nuk posedojmë tjetër vetëm se gjëra elementare."*

Mbrapa këtij asketizmi mbase qëndrojnë dy shkaqe:

- 1) Aliu ka ardhur në presidencë si një luftëtar për të drejtën dhe të vërtetën, dhe
- 2) Vazhdimësi e jetës që ka bërë qysh nga fëmijëria. Ai ka përjetuar nga afër problemet me të cilat është ballafaquar vendi andaj luksi dhe salltaneti nuk përkonin me luftën dhe kauzën e tij.

Falja: Aliu ishte shpirtmadh. Nuk ndiente inat e mëri ndaj askujt. Duke folur për këtë tipar të tij, ish-ministri i jashtëm i Bosnjës, Haris Silajxhiç (Haris Silajdzic), thotë: *"Gjatë kohës sa kam punuar me të, kam zbuluar se ai nuk urrente askënd. Respektonte çdo mendim."*

Guximi: Aliu kishte tentuar me çdo mjet diplomatik ta ndalonte luftën, jo pse frikësohej, porse nuk donte të derdhej gjaku i pafajshëm. E kur diplomacia kishte dështuar, Aliu kishte hyrë në luftë. Në një prej prononcimeve të tij kishte thënë: *"Nëse lipset nevoja për ta mbrojtur Bosnjën, myslimanët do të rrokin armët."*

Këto fjalë në fakt shënojnë fillimin e një epoke të re për myslimanët, epokën e çlirimit nga serbët për të cilën paguan shtrenjtë me gjakun dhe shpirtrat e tyre.

Burimet: Muhamemd Jusuf Ades, *Mudhekkirat Alija Izetbegoviç err-rreis essabik li-xhumhuriyeti el-Busneh ve el-Hersek*, (Dar el-fikr el-muasir, 2021).

Alija Izetbeviç, *Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit*¹, (Revista kuvajtiane Nur, 1994)



¹ Ky libër prej më shumë se një dekadë është i përkthyer edhe në shqip. Përkthyesi.

Personaliteti VI:
REXHEP TAJIP ERDOAN – President i Turqisë
(Recep Tayyip Erdoğan)



- Emri:** Rexhep Tajip Erdogan (Recep Tayyip Erdoğan).
- Lindja/vdekja:** Ka lindur më 26 shkurt 1954 në qytetin e Stambollit.
- Edukimi, mirënjohjet dhe shpërblimet:** Shkollimin e mesëm e ka përfunduar për imam, respektivisht e ka kryer shkollën Imam Hatip. Studimet universitare i ka vazhduar në Universitetin Marmara, në fakultetin e shkencave ekonomike dhe tregtare. Ka diplomuar më 1981.
- Ka ushtruar funksione të ndryshme: kryetar partie, bashkiak i Stambollit, kryeministër, tash president i Republikës së Turqisë.
- Tiparet e personalitetit:** **Guximi:** Këtë tipar të tij e dëshmojnë veprimet që ka ndërmarrë, prej të cilave do të veçonim vendimin për të angazhuar në poste publike e politike femra me mbulesë. Po kështu edhe hapësira e krijuar në media për kritikë ndaj tij dhe programit të tij është dëshmi e guximit të tij për tu ballafaquar me ata që mendojnë ndryshe.
- Formimi moral:** Erdogani dallohet për tiparet dhe vlerat që ka, si: guximin, urtësinë, zgjuarsinë,

drejtësinë, korrektësinë, vendosmërinë, qëndrimin në parime, etj.

Ligjërimi: Shkathësinë e të folurit dhe ligjërimin e demonstroi gjatë fjalimeve të tij, pa i referuar vazhdimisht ndonjë letre a ekran. Kjo i jep mundësinë që me audiencën të komunikojë edhe me gjuhën e trupit në një formë të përkryer.

Tiparet e lidërshtipit:

Konsultimi: Erdogani është në konsultim të përhershëm me ekipin me të cilën punon. Vendimet nuk merren në mënyrë individuale. Madje, ajo që dihet është se ai, për një projekt të caktuar, këtë ekip e ngarkon me studimin e çështjeve që lidhen direkt ose jo me projektin në fjalë, në mënyrë që vendimet e marra të jenë të qëlluarat.

Aktivitetet e pandalshme: Vazhdimisht është në kontakt me njerëzit, i viziton, iu flet, drekon me ta, në muajin Ramazan viziton familje të varfra tek të cilat edhe hanë darkën e iftarit. Vendimet që ka marrë, ndonjëherë për shkak të mëshirës që ndjen ndaj shtresës së varfër të popullit, i ka anuluar. P.sh., ka rastisur që të rrafshohet një lagje për tu ndërtuar lagje e re, por kur ka parë familjet e varfra dhe lidhjen e tyre me shtëpitë, e ka anuluar vendimin.

Erdogani është mirënjohës ndaj shokëve dhe miqve me të cilët ka ndarë këtë rrugëtim. Nuk shkëput lidhjet dhe interesohet për fatin dhe gjendjen e tyre.

Nuk merret me propagandë dhe thashetheme: Pas zgjedhjes së tij në krye të Stambollit, mediat patën filluar një sulm të paparë ndaj tij. E akuzonin atë dhe projektin e tij duke gënjyer e shpifur ndaj tij çdo gjë. Siç evokojnë kujtime miqtë, Erdogani e kishte pyetur

ekipin e punës: A do të punojmë apo do të merremi me këto thashetheme? Ata që kalojnë kohën duke dëgjuar thashethemet, nuk do të lëvizin vendi, ndërsa ne do të punojmë!- iu kishte thënë.

Respektimi i kolegëve dhe miqve: Lideri i nderon dhe respekton vëllezërit dhe shokët, nuk zemërohet për shkak të hatave të vogla, sikur që nuk lë angazhim të tyre pa e çmuar e vlerësuar.

Burimet:

<https://www.tccb.gov.tr/receptayyiperdogan/biyografi/>

<https://www.biyografi.info/kisi/recep-tayyip-erdogan>

Rexhep Tayyip Erdogan –Kissatu Zaim (Recep Tayyip Erdogan –Bir Liderin Doguşu), Husein Besliy & Omer Ozbay, al Nasshirun: Aldar al Arabiya lil Ulum, 2012

Rexhep Tayyip Erdogan-Tamuhun va Sultatun (Hirs ve Otorite/Makam), Gayum Pierre, Uvaidat lin Nashr, 2018.



PËRFUNDIM

Falënderimet e përzemërta i takojnë vetëm Allahut xh.sh, që na mundësoj ta përfundojmë këtë studim intensiv tre vjeçar, duke shprehur se do të jetë një udhërrefyes institucional dhe tekst shkollor për rininë tonë muslimane në trojet balkanike dhe diasporë. Nuk pretendojmë se në këtë studim janë përmbledhur të gjitha aspektet e Lidërsipit të preferuar, sepse ajo nuk mundet të bëhet dhe është shumë normale për njeriun dhe studiuesin. Por, prej një gjëje jemi shumë të sigurtë;se parimet, principet, personaliteti, stilet, tiparet, testet, teoritë, llojet e lidërsipit, etj etj, ato pothuajse janë përmbledhur që të gjitha, falë i qofshim Allahut xh.sh,. Shpresojmë se studiuesit e ardhshëm do t'i kompletojnë ato zbrastësira që ne nuk i kemi elaboruar, dhe kështu kompletohet mesazhi ynë human e fetar. Në përfundim të këtij studimi, do të përmendim disa prej rezultateve dhe rekomandimeve më të rëndësishme të tij:

- 1) Studimi ka vërtetuar rëndësinë e hulumtimit komparativ në fushën e lidërsipit si dhe nevojën e padiskutueshme të njerëzve në përgjithësi dhe të myslimanëve në veçanti që këtë çështje ta trajtojnë referencialisht sipas Kur'anit dhe Sunnetit. Lidërsipi për shoqërinë është si koka për trupin!
- 2) Studimi ka dokumentuar kureshtjen e madhe dhe të vazhdueshme të studiuesve dhe të hulumtuesve përëndimorë përkitazi me trajtimin akademik të lidërsipit. Ekzistojnë me dhjetëra punime, tituj të ndryshëm e tërheqës, të cilët, përveç kureshtjes në fjalë, dëshmojnë dhe për nevojën e përmbushjes së plotë sipas visionot kur'anor të kësaj shkence që vazhdon të zhvillohet edhe më tej.

- 3) Studimi ka rezultuar me një të vërtetë shkencore sipas së cilës studimeve dhe teorive perëndimore mbi lidërshtipin u mungon modeli i '**lidentit shëmbëlltyrë**', '**lidentit model**', '**lidentit ideal**', që të pasohet dhe të ndiqet konform urdhërave të tij.
- 4) Studimi ka rezultuar edhe me një të vërtetë tjetër - me mungesën e madhe të trajtesave komparative autoriale në botën arabe, mbi këtë tematikë. Ka punime të përkthyer nga gjuhë të ndryshme por ato nuk mjaftojnë siç mungojnë dhe punimet autoriale.
- 5) Studimet perëndimore në fokus kanë pasur zgjidhjen e problematikës së lidërshtipit dhe rëndësinë e tij në fushën ushtarake dhe civile. Pra, janë përqendruar tek aspekti material e lokal më shumë, veçmas kompanitë, organizatat financiare, etj, ndërsa shumë më pak ose fare nuk janë marrë me lidërshtipin akademik dhe fetar sidomos në rrafshin ndërkombëtar.
- 6) Studimi ka përfunduar me një gjetje interesante sipas së cilës trajtesat e ekspertëve dhe të studiuesve përkritazi me modelet dhe stilet e lidërshtipit, tiparet e kërkua të lidentit, komponentët përbërës të personalitetit të lidentit, faktorët që ndikojnë në personalitetit e lidentit, etj, janë çështje që në një ose formë tjetër, janë trajtuar edhe nga Kur'ani dhe Sunneti qysh herët me shekuj para studimeve bashkëkohore, kuptohet me shprehje të tjera dhe në kontekste të tjerë.
- 7) Studimi ynë komparativ ka konfirmuar rëndësinë e shkencës së lidërshtipit nga prizmi Kur'anor nëpërmjet shembujve Kur'anorë të lidërshtipit që kemi prezantuar, nga fusha të ndryshme ushtarake, motivuese, edukative, fetare, politike, sigurie, ekonomie. Kjo na është mundësuar falë trajtimit që dijetarët përgjatë gjithë

historisë i kanë bërë ajeteve Kur'anore me këtë tematikë, veçmas dijetarët bashkëkohorë.

- 8) Pavarësisht kësaj, studimi ynë ka vërtetuar mungesën e trajtimit të hollësishëm të çështjeve të lidërshiptit nga mësimet përkatëse që mund të përfitohen nga ajetet përkatëse tek shumica e komentuesve të Kur'anit, klasikë e bashkëkohorë, përveç në raste të rralla dhe të pakta.
- 9) Studimi ka vërtetuar rëndësinë e ripërtëritjes së disa koncepteve fetare përkitazi me lidërshiptin, si: *istihlafi*, *imameti*, *temkini*, *halifeja*, etj, përmbajtja e të të cilëve esencialisht nënkupton lidërshiptin dhe lidhjet e drejtpërdrejta me të.
- 10) Studimi thekson meritat e Kur'anit mbi çështjet dhe meseletë mbi lidërshiptin duke ndriçuar faktin se studimet e shekullit të kaluar dhe të këtij shekulli nuk kanë sjellur ndonjë risi që nuk është përmendur drejtpërdrejtë ose tërthorazi në Kur'an. Veçanti e këtyre studimeve mund të jenë materialet, titujt tërheqës, anketat dhe pyetësorët e realizuar për qëllime studimore në disa qendra universitare dhe akademike.
- 11) Studimeve përëndimore për lidërshiptin u mungojnë dimensionet humane, fetare, morale dhe shoqërore, përkatësisht koeficienti emocional, mëshira, drejtësia në raport me pasuesit dhe angazhimi për mirëqenien dhe interesin e përgjithshëm shpirtëror e material. Ndërsa lidërshipti sipas prizmit Kur'anor e profetik i përmban të gjitha këto elemente dhe këto vlera, pavarësisht dallimeve fetare, rracore e gjuhësore.
- 12) Studimi ka dokumentuar hendekun që ekziston mes islamit dhe myslimanëve dhe fajin e këtyre të fundit. Pra, gjendja jonë nuk është rezultat i respektimit të Islamit por i mospërfilljes së tij! Problemi është tek pasuesi, jo tek i pasuari (Islami). Zanafilla e këtij problemi na çon tek

kuptimi sipërfaqësor i fesë, tek leximi i gabuar i Kur'anit dhe i mësimave të tij, tek leximi i gabuar i argumenteve dhe i provave që flasin për Zotin! Për pasojë kemi këtë gjendje të rëndë, këtë humbje të thellë!

- 13) Ky studim shkencën dhe artin e lidërsipit e ka prezantuar në formë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë, duke përdorur tabela dhe grafikone në fund të çdo njësie, të cilat mund të shërbejnë për punëtori të ndryshme, takime shkencore, pako trajnuese të grupmohave dhe profesioneve të ndryshme. Studimi ka konfirmuar se lidërsipi përvetësohet me ushtrime, studime e mësim, duke mos përjashtuar këtu as talentin dhe dhuntitë. Lideri i suksesshëm ka tipare dhe veti fetare, morale, ka cilësi personale të larta dhe aftësi shembullore administruese nga të cilat nuk duhet hequr dorë asnjëherë, në mënyrë që të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e marra në formën më të mirë të mundur.

Përsa u përket **rekomandimeve**, do të veçonim:

- 1) *Dijetarët, edukatorët dhe tefsirologët* duhet të ndajnë kohën më të madhe dhe të angazhohen më shumë duke studiuar ajetet Kur'anore, duke depërtuar thellë në kuptimin e tyre, për të përfituar kështu mësimet me peshë rreth lidërsipit dhe rrjedhimisht, për t'iu bërë ballë sfidave me të cilat ballafaqohemi kudo e në çdo kohë. Kështu mrekullia Kur'anore do të qëndronte e pamposhtur dhe fuqia e Kur'anit për të zgjidhur çdo problem do të bëhej gjithnjë e më e madhe. Gjithçka që na duhet e kemi në Kur'an, ne na duhet vetëm ta zbulojmë! Por, për ta zbuluar, duhet ta studiojmë thellësisht.
- 2) Drejtuesit e lartë arsimorë (të organizatave dhe të institucioneve shkencore dhe fetare) duhet të angazhohen më shumë në ngritjen e kapaciteteve dhe në zhvillimin e

aftësive tek nxënësit dhe studentët duke inkorporuar në plan-programe si lëndë mësimore shkencën dhe artin e lidërshiptit. Institucionet arsimore, nga ato të ulëta deri te ato akademike, nga ana e tyre duhet t'u përgjigjen pozitivisht ideve dhe kërkesave të nxënësve dhe studentëve, t'i trajtojnë me respekt, t'i nxisin dhe motivojnë për të nxjerrë prej tyre një gjeneratë produktive, premtuese, kreative, të aftë për të marrë udhëheqjen kombëtare, fetare e akademike, dhe Allahu e di më së miri!

Për fund, siç e do rendi, e falënderojmë Allahun xh.sh. me zemër që këtë punë ta pranoj prej nesh, dhe të jetë i sinqertë për Të, dhe të na shpërblej për mundin dhe lodhjen në këtë botë dhe në Ahiret me shpërblimet më të mira që Allahu din, dhe me zemër i çojmë salavat të dashurit tonë, Muhammed Mustafasë!

Vel hamdu lil-lahi rab-bil Alemijne

Doha-Katar

21 shtator 2021

BURIMET DHE LITERATURA

1. BURIME NË GJUHËN ARABE

1. AbduRrahman bin Ali, *Menakibu Emiri el-mu'minine Umer bin el-Hattab*, (Dar Ibn Haldun).
2. Abdusettar Shejh, *Umer bin el-Hattab – el-halifetu err-rashidij el-adhim ve el-imam el-adil err-rrahim*, (Damask: Dar el-kalem, 1976).
3. Al Thani, Fejsal bin Xhasim, *El-kijadetu ve etheruhafikesbi el-vela*, (Rijad: Dar Vuxhuhlinneshri vet teuzië, 2013).
4. Ali Muhamemd Salabi, *Esh-shejh el-xhelil Omer bin el-Muhtar*, (El-mektebetu el-asrije, 2007).
5. Ali Tantavi, *Ebu Bekir esssiddik min etteraxhum ve el-a'lam*, (Xhidde: Dar el-menare, ed. 2, 1987).
6. Alija Izetbeviç, *Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit¹*, (Revista kuvajtiane Nur, 1994).
7. Alvan, Abdullah Nasih, *Terbijjetu el-evladfi el-Islam*, (Dar es-Selam li enneshri, ed. 21, 1992).
8. Bessam el-Aselij, *Kadetu fet'hi biladi esh-sham ve el-Irak*, (Liban: Dar en-nefais, 2012).
9. Derubi, Sami, *Ilmu et-tiba' – el-medresetu el-ferensijjetu*, (Egjpt: Dar el-mearif, p.v.b.).
10. Dervish, Muhammed Ahmed, *Nedharijjat el-kijadeti ve istrategjijetu el-istihvadhala el-kuveh*, (Kajro: Alem el-kutub, 2009).
11. Ebu Davud, Sulejman bin Esh'ath bin Is'hak bin Beshir el-Ezdies-Sixhistani, *SunenEbiDavud*, (Egjpt: Dar err-rrisale el-alemije, 2009).

¹ Ky libër prej më shumë se një dekadë është i përkthyer edhe në shqip. Përkthyesi.

12. Ebu Hajjan, Muhammed bin Jusuf, *El-bahru el-muhitfi et-Tefsir*, (Bejrut: Dar el-fikr, 2010).
13. Ebu Muhammed Mekki, Ibën EbiTalib, *El-hidajetuilabulugien-nihajetifilmimeani el-Kur'an ve tefsirihi ve ahkamihi ve xhumelminfununulumihi*, (EBA: Universiteti i Sharikas, 2008).
14. Ebu Sulejman, AbdulHamid, *Ishkalijetu el-istibdad ve el-fesadfiettarih el-islamij*, (Bejrut: El-ma'hed el-alemij li el-fikri el-islamij, 2012).
15. El Shemmeri, Najif Bin Nehar, *el Dijmokratijetu kema hije*, Dar Akl lin en Neshr, Damask, Siri, bot.2. 1918)
16. El-Ajsus, Abdurrahman, *Ilmu en-nefsi el-am*, (Egjipt: Dar el-ma'rife, ed. 1).
17. El-Albani, Muhammed Nasiruddin, *Sahihu el-Xhami es-Sagir ve zijadatihi*, (Bejrut: El-mekteb el-islamij, ed. 3, 1988).
18. El-Albani, Muhammed Nasiruddin, *Silsiletu el-ehadithessahihah ve shej'unminfikhiha ve fevaidiha*, (Rijad: Mektebetu el-mearif, ed. 4, 1988).
19. El-Alusi, Ebu el-FadëlShihabuddines-Sejjid Mahmud el-Bagdadi, *Ruh el-meanifitefsiri el-Kur'ani el-adhim ve esseb'i el-methani*, (Dar el-fikr li ettibaah ve enneshër, p.v.b.).
20. El-Askalani, Ahmed bin Ali bin Haxher, *SherhuSahihi el-Buhari*, ver. Shkenc. Hmadi bin AbdulMekhides-Selefij, (Rijad: Mektebetu err-Rrushd, ed. 3, 1419 h.).
21. El-Astal, Muhammed Ahmed, *El-kijadetufidav'i el-ajat el-kur'anijeh*, (2012).
22. El-Axhlan, Fehd bin Salih, *Esh-shurafiessijasetien-nebevije*, (Britani: El-munteda el-islamij, 2018).
23. El-Azamij, Halil bin Ibrahim, *Adhimukadrihi^ﷺve rif'atume kanetihi inde Rabbihiazze ve xhel-le*, (Xhidde: Dar el-Kible li eth-thekafeti el-islamije, ed. 11).

24. El-Begavi, Ebu Muhammed el-Husejn bin Mes'ud bin Muhammed el-Ferra, *Mealim et-tenzilfitefsiri el-Kur'an*, (Rijad: Dar Tajjibe li en-neshri ve et-teuzië, ed. 4, 1997).
25. El-Buhari, Muhammed bin Ismail bin Ibrhaim bin el-Mugireh, *El-xhamiu el-musnedes-Sahih el-muhtesaruminumuriResulilahiﷺve sunenihi ve ejjamihi*, ver. Shuajb Arnauti, (Bejrut: Dar err-Rrisale el-alemije, 2011).
26. El-Buhari, Muhammed bin Ismail bin Ibrhaim bin el-Mugireh, *El-xhamiu el-musnedes-Sahih el-muhtesaruminumuriResulilahiﷺve sunenihi ve ejjamihi*, ver. Muhibbuddin el-Hatib, (Kajro: El-meketebetuesselefije, 1400 h.).
27. El-Garib, Remzije, *Ettakvim ve el-kijasen-nefsij ve etterbevij*, (Kajro: El-anxhlu el-misrije, 1971).
28. El-Hejthemi, Ebu el-Hasen NuruddinAli bin EbiBekër bin Sulejman, *Mexhmeuezzevaid ve menbeu el-fevaid*, (Kajro: Mektebetu el-Kudsi, 1994).
29. El-Imadij, Ebu es-Suud, Muhamemd bin Muhammed, *TefsiruEbies-Suud – Irshadu el-akliesselimilamezaja el-Kur'ani el-Kerim*, (Bejrut: Daruihjaj et-turath el-arabij, p.v.b.).
30. El-Ixhi, Mahmud bin AbduRahman bin Muhammed bin Abdullah, *Xhamiu el-bejanfitefsiri el-Kur'an*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmije, 2004).
31. El-Kasimi, Muhammed Xhemaluddin, *Mehasin et-te'vil*, (ed. 1, 1957).
32. El-Kebisi, Muhammed Ajjash, *Enmat esh-shahsijejt ve ishkalat el-kijadeti ve etterbijjetifi el-ameli el-islamij el-muasis*, (2010).
33. El-Kurtubi, Muhamemd bin Ahmed, *El-xhamiu li-ahkam el-Kur'an*, (Bejrut: Muessetu err-rrisalem, 2006).
34. El-Kurtubi, Muhamemd bin Ahmed, *El-xhamiu li-ahkam el-Kur'an*, ver. Ahmed el-Berduni dhe Ibrahim Atfish, (Kajro: Dar el-kutub el-misrije, ed. 2, 1964).

35. El-Maverdi, Ebu el-Hasen Ali bin Muhammed bin Habib, *Ennuket ve el-ujun – Tefsir el-Maverdi*, (Bejrut: Dar el-kutub el-arabije dhe Muessesetu el-kutub eth-thekafije, p.v.b.).
36. El-Muthena, AbdulFettah Mahmud, *Iadetu el-bina ve murtekizatu el-hudur: mukavvemat el-bina: el-bina el-imanij, ve el-bina err-rruhij, ve el-bina el-ahlakij – Fikhuettağ'jir ve bina el-umemti el-vasat*, (Katar: Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Islame, 2016).
37. El-Utejbi, Nevvah bin Sefer bin Muflih, *El-enmat el-kijadijetu ve essimat esh-shahsijjetu li-mudiri el-medaris ve alakatuha bi err-rruhi el-ma'nevijeh li el-mual-liminefimuhafedhati et-Taif el-ta'limije – dirasetunmejdanijetun*, (Mekkë: Universiteti Ummu el-Kura, tezë masteri, 2008).
38. El-Vahidi, Ebu el-Hasen Ali bin Ahmed bin Muhammed bin Ali el-Vahidi, *Ettefsir el-besit*, (Universiteti Islam Imam Muhammed bin Suud, 1430).
39. En-Nejsaburij, Nidhamuddin Hasan bin Muhammed, *Garaib el-Kur'an ve regaib el-Furkan*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmije, 1416 h.).
40. Err-Rrazi, Muhammed bin Umer bin el-Hasan bin el-Husejn et-Tejmi, *Mefatihu el-gajb*, (Dar el-fikr li ettibaati ve enneshri ve etteuzië, 1981).
41. Err-Rrejsuni, Ahmed, *Med'halilamekasidi esh-sheriah*, (Mensure: Dar el-kelime li enneshër ve ettuezië, p.v.b).
42. Es-Sa'di, AbduRrahman bin Nasir, *Tejsiru el-Kerimi err-Rrahmanfitefsirikelami el-Mennan*, (Muessesetu err-rrisale, 2000).
43. Esh-Shatibij, Ebu Is'hakIbrhaim bin Musa, *El-muvafekatfiusuli esh-sheriah*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmije, 2004).
44. Et-Taberij, Muhammed bin Xherir bin Jezid, *Xhamiu el-bejanfite'vili el-Kur'an*, (Muessesetu err-rrisale, 2000).

45. Et-TalibHisham, *Delilu et-tedrib el-kijadij*, (Virxhinia: El-ma'hed el-alemij li el-fikrinel-islamij, ed. 2, 1995).
46. Et-Tirmidhij, Muhammed bin Isa, *Xhamiu et-Tirmidhij* (Sunen et-Tirmidhij), (Rijad: Ministria e Çështjeve Islame, Daves dhe Udhëzimit, 2000).
47. Ez-Zehmahserij, Xharullah Mahmud bin Umer, *Tefsiru el-keshshaf*, (Bejrut: Dar el-ma'rifeh, ed. 3, 2009).
48. Grup autorësh, *Omer el-Muhtar: neddalun min exhli el-hurrije*, (Egjipt: Dar en-neshr el-Mizan, 2014).
49. Halid Ensari, *Iber ve idhat min hajati es-Sahabe: Halid bin Velid*, (Egjipt: Dar el-beshir, 1990).
50. Hoxha, Hajredin, *Haritatu ed-davetiilaRabbi el-enamfitefsiri el-Ustadhi Sejjid Kutub li sureti el-en'amë*, (Mitrovicë: Vi-Print, 2015).
51. Ibën Abdullah, Ahmed, *El-kijadetu el-ahlakijjetuminmendhurinislamij – dirasetunnadharijetuntatbikijjetunmukarenetun*, (Rijad: MektebetuMelikFehd, 1436 h.).
52. Ibën Ashur, Muhamemd et-Tahir, *Tefsirettahrir ve ettenvoir*, (Tunizi: Eddarettunisijje, p.v.b.).
53. Ibën Hibbban, *Sahihu Ibni Hibban*, (Egjipt: Dar el-mearif, 1952).
54. Ibën Kethir, Ismail bin Umer, *Tefsiru el-Kur'ani el-Adhim*, (Dar Tajjibe li enneshri ve etteuzië, ed. 3, 1990).
55. Ibën Maxhe, Ebu Abdullah Muhammed bin Jezid el-Kazvini, *Sunen Ibni Maxheh*, (Daruihjaj el-kutub el-arabijje, p.v.b.).
56. Ibën Tejmije, Tekijuddin Ahmed, *Mexhmu el-fetava*, (Mensure: Dar el-Vefa, ed. 1, 1997).
57. Ibën Uthejmin, Muhammed bin Salih, *Tefsiru el-Kur'ani el-Kerim*, (Rijad: Dar Ibën el-Xheuzi, ed. 2, 2000).

58. Ibluva, IbrhimAliSalim, *El-kijadetu el-idarije ve ref'u el-haleti el-ma'nevijefi el-hitabi el-kur'anij*, (Libi: Universiteti i Masratas, ed. 1).
59. Ibrahim Mustafa dhe të tjerë, *El-mu'xhem el-vesit*, (Kajro: Dar ed-Daveh, p.v.b.).
60. Isam Abdul Fettah, *Omer bin el-Muhtar ve rixhaluhu*, (Dar en-neshr El-kunuz).
61. Ivad, Abbas Mahmud, *El-kijadetu ve essimatessevije li eshshahsijjeh*, (Aleksandri; Dar el-ma'rife el-xhamije, 1982).
62. Izetbegoviç, Ali, *Avaikuennehdati el-islamije – mexhmuumekalat*, përktheu në arabisht: Omer Spahiç, (Doha: Xhemijetu Katar el-hajrije, 1996)
63. Jahlef, Uthman, *Ilmu nefsi es-sihhati – el-ususen-nefsijje ve essulukije li essihah*, (Doha: Dar eth-thekafe, 2001).
64. Kohen, William, *Fennu el-kijade*, (MektebetuXherir, 2008).
65. Kutub, Sejjid, *Fidhilal el-Kur'an*, (Kajro: Dar esh-shuruk, ed. 6, 1991).
66. Kutub, Sejjid, *Hasaisettesavvour el-islamij ve mukavvimatuhu*, (Kajro: Dar esh-shuruk, ed. 5, 1995).
67. Kutub, Sejjid, *Mealimfiettarik – El-mustakbel li-hadhaeddin*, (Kajro: Dar esh-shuruk, ed. 9, 1988).
68. Kutub, Sejjid, *Mukavvimatettesavvour el-islamij*, (Kajro: Dar esh-shuruk, ed. 3, 1988).
69. Muhamemd Jusuf Ades, *Mudhekkirat Alija Izetbegoviç err-reis essabik li-xhumhurijeti el-Busneh ve el-Hersek*, (Dar el-fikr el-muasir, 2021).
70. Muhammed Ali Salabi, *Ebu Bekir essiddik – shahsijjetuhu ve asruhu*, (Dar el-ma'rife li en-neshr ve etteuzië, ed. 7, 2001)¹.

¹ Ky libër është përkthyer dhe botuar edhe në shqip. **Përkthyesi.**

71. Muhammed Ali Salabi, *Faslu el-hitab si sireti Umeri bin el-Hattab, Emiiri el-mu'minine: shahsijjetuhu ve asruhu*, (EBA: Mektebetu es-Sahabe, 2002).
72. Muhammed Munkidh Mahmud Sekkar, *Err-rreudu el-enîk fi ithbati imameti Ebi Bekir essiddik*, (Saudi: Universiteti Ummu el-Kura, 1993).
73. Omer bin Ahmed bin Hibeh bin Adim, *Zubdetu-l-haleb min tarihi Haleb*, (Dar el-kutub el-ilmije).
74. *Rexhep Tayip Erdogan-Tamuhun va Sultatun (Hirs ve Otoritel/Makam)*, Gayum Pierre, Uvaidat lin Nashr, 2018.
75. *Rexhep Tayyib Erdogan –Kissatu Zaim (Recep Tayyip Erdogan –Bir Liderin Dogusu)*, Husein Besliy & Omer Ozbay, al Nasshirun: Aldar al Arabiya lil Ulum, 2012
76. Rida, Muhammed Reshid, *Tefsiru el-menar*, (Kajro: ed. 3, 1947).
77. Samuel Hiz dhe William Tomas, *Tevel-li el-kijade: fennu el-kijadeti el-askerijeti ve ilmuha*, përkthyer në arabisht nga: Sami Hashim, (El-muessesetu el-arabijetu li eddirasat ve enneshr, ed. 2, 1989).
78. Sujuti, Xhelaluddin Ebu AbduRrahman, *Esbaben-nuzul – Lubaben-nukulfiesbabien-nuzul*, (Bejrut: Muesesetu el-kutub eth-thekafijeh, 2002).
79. Sherkavi, TalatMensur dhe të tjerë, *Ususilmien-nefsi el-am*, (Kajro: Mektebetu el-anxhlu el-misrije, 1984).
80. Tahir, Hamad Muhammed Nehhal, *El-kijadetu ve el-xhundijjetufiessunnetien-nebevije – dirasetunmeuduijjetun*, (Gaza: Universiteti Islamik, tezë masteri, 2007).
81. Tashtush, HajilAbdulmevla, *Esasijjatfi el-kijadeti ve el-idare, - ennemudhexh el-islamijfi el-kijadeti ve el-idare*, (Jordani: 2008).
82. Turbani, Xhihad, *100 minudhamaiummeti-l-Islam gajjerumexhraettarih*, (Medine: Dar et-takva li enneshri ve etteuzië, ed. 10, 2015).

83. Xhabir, AbdulHamidXhabir, *Nedharijjat esh-shahsijeti: el-bina, eddinamijjat, ennumuovu, turuk el-bahthi ve ettakvim*, (Kajro: Dar ennehdah, 1986).
84. Zuhajli, Vehbe, *Ettefsir el-munirfi el-akideti ve esh-sheriatu ve el-menhexh*, (Bejrut: Dar el-fikr el-muasir, 1418 h.).

2. BURIME DHE REFERENCA NË ANGLISHT

1. **Army Leadership – Be, Know, Do**, HeadquartersDepartmentof the Army- Washington DC, 31 August 1999,
2. Bennis, Waren, **On Becoming a Leader –The leadership Classic**. 2020, NewYork.
3. Bittel, Lester R. &NewStromJohn W, **What Every Supervisor Should Know: The Complete Guide to Supervisory Management**, NewYork:McGraw-Hill, 1990, The 60 SecondLeader
4. Cohen, S, Evans, G.W.Stokols, D. &Krantz, D.S. **Behaviour, Health, andEnvironmentalStress**, NewYork, 1986.
5. Gordon, John, **The PowerofPositiveLeadership**,
6. James M., Kouzes, &Posner.,Barry. Z, **Learning Leadership –The Fivefoundations of becoming an exemplary Leader**,
7. Kobas, S.C. &Maddi, S.R. **ExistentialPersonalityTheory**, In R. Corsini (Ed.) **Current personality theories**. Itasca, I.L. peacock, 1977.
8. Maxwell, John.C., **The 21 Irrefutable Laws of Leadership-Follow them and people will follow you**. Foreword by: Stephen R.,Covey,

9. **Military Leadership – In Pursuit of Excellence** – 6th Edition, Edited by: Robert L. Taylor, William E. Rosenbah, Eric B. Rosenbah, Part 1, 2000.
10. Peter G. Northouse, **Leadership – Theory and Practice**, 7th Edition, Sage Publications, Los Angeles, USA, 2015
11. Plunket, Lorne C & Hale, Guy A, **The Proactive Manager: The Complete Book of Problem Solving and Decision Making**, New York: Wiley, 1982

3. PORTALE DHE FAQE INTERNETI

- 1) Criticisms of the Psychosexual Stages
- 2) http://library.islamweb.net/newlibrary/display_book.php?bk_no=210&ID=233&idfrom=900&idto=904&bookid=210&startrno=4
- 3) <http://majles.alukah.net/t148747/>
- 4) http://mosshaf.com/ar/main?ver=1#?GetSura=31&vers=17&type=tafseer&b=taf_sel
- 5) <http://mugtama.com/articles/item/16305-html>
- 6) http://www.greekmedicine.net/b_p/Four_Temperaments.html
https://www.ibtesamah.com/showthread-t_454629.html
- 7) <http://www.rabtasunna.com/t~4828>
- 8) <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/typology>
- 9) <https://furqan.co/ibn-katheer/16/78>
- 10) <https://www.16personalities.com/free-personality-test>
- 11) <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar>
- 12) <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar>
- 13) <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar/>
- 14) <https://www.dailymedicalinfo.com/view-article>
- 15) <https://www.iep.utm.edu/freud/Internet>
Encyclopedia of Philosophy A Peer –
Reviewed Academic Resource-

- 16) <https://www.maajim.com/dictionary/>
- 17) <https://www.merriamwebster.com/dictionary/democracy>
- 18) <https://www.merriam-webster.com/dictionary/typology>,
"Typology." The Merriam-Webster.com Dictionary,
Merriam-WebsterInc.
- 19) <https://www.merriamwebster.com/dictionary/typology>.
- 20) [https://www.psychologytoday.com/gb/blog/communication
-success/201711/24-signs-highly-sensitive-person](https://www.psychologytoday.com/gb/blog/communication-success/201711/24-signs-highly-sensitive-person)
- 21) [https://www.psychologytoday.com/gb/blog/progress-
notes/201904/personality-typology-and-the-secret-knowing-
person](https://www.psychologytoday.com/gb/blog/progress-notes/201904/personality-typology-and-the-secret-knowing-person)
- 22) <https://www.psycom.net/mchugh.html>
- 23) <https://www.tofugu.com/japan/japanese-blood-type>
- 24) [https://www.verywellmind.com/freuds-stages-of-
psychosexual-development-2795962](https://www.verywellmind.com/freuds-stages-of-psychosexual-development-2795962) ,
[https://www.health.harvard.edu/newsletter_article/Psychoa
nalysis_Theory_and_treatment](https://www.health.harvard.edu/newsletter_article/Psychoanalysis_Theory_and_treatment)
- 25) [https://www.verywellmind.com/freuds-stages-of-
psychosexual-development-](https://www.verywellmind.com/freuds-stages-of-psychosexual-development-)
- 26) [https://www.verywellmind.com/what-is-the-pleasure-
principle-2795472](https://www.verywellmind.com/what-is-the-pleasure-principle-2795472)
- 27) <https://www.vocabulary.com/dictionary/typology>.
- 28) [https://www.webmd.com/mental-health/dissociative-
identity-disorder-multiple-personality-disorder#1](https://www.webmd.com/mental-health/dissociative-identity-disorder-multiple-personality-disorder#1)
- 29) <https://www.youtube.com/watch?v=3ZaNJ3AsAQM>
- 30) <https://www.youtube.com/watch?v=-6sX2OVbDIA>
- 31) https://www.youtube.com/watch?v=XpqqN_2ZCOM&t=200s
- 32) <https://www.youtube.com/watch?v=Zd735vIKEY8>
- 33) www.leadership.com.sa
- 34) <https://www.tcgb.gov.tr/receptayyip Erdogan/biyografi/>
- 35) <https://www.biyografi.info/kisi/recep-tayyip-erdogan>

FJALORTH¹



¹ Fjalorthi është përgatitur nga përkthyesi. Literatura bazë: Ruqaiyyah Waris Maqsood, *Fjalor bazë i Islamit*, përkthyen: Ermal Bega dhe Xhabir Hamiti, (Tiranë: A.C.F.O.S. Books; 2020); Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, (Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë, 2010); Ali bin Muhammed Xhurxhani, *Etta'rifat*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmije, 1983); Deeb Al-Khudrawi, *Dictionary of Islamic terms arabic - english & english - arabic*, (Damas - Bejrut: Al Yamamah); Fjalori arabisht-shqip i Prof. Isa Memishit, versioni online (<https://arabisht-shqip.com/>).

A'rafë: kaptina e shtatë në Kur'an. Është quajtur a'rafë (perdja, muri) sipas rrëfimit të një grupi njerëzish që në Ditën e Llogarisë do të qëndrojnë në një vend të caktuar ndërmjet xhenetit dhe xhehenemit derisa të kryhet gjykimi për të gjithë njerëzit.

Abdullah bin Mes'ud: shok i profetit Muhammed ﷺ.

Abdullah bin Revaha: shok i Profetit Muhammed ﷺ.

Abdullah bin Umeri: shok i Profetit Muhammed ﷺ, i biri i Omerit r.a., dhe vëllai i Hafsasë r.a., gruas së Profetit ﷺ.

Abdurrahman bin Semure: shok i Profetit Muhammed ﷺ.

Ademi: babai i njerëzimit, profet.

Ahlak: moral.

Ajet: shenjë, tregues, citat kur'anor.

Ajshja: Gruaja e Profetit Muhammed ﷺ, vajza e Ebu Bekrit r.a.

Akaid: kredo, besim, shkenca që merret me studimin e besimit.

Aleksandri i Madh: komandant i njohur ushtarak. Ka mendime se është Dhulkarnejni. Shumë popuj e kanë përvetësuar figurën e tij. Edhe historianët shqiptarë thonë se është ilir.

Ali bin Ebi Talib: kushëriri i Profetit Muhammed ﷺ dhe

dhëndri i tij. Ishte prej besimtarëve të parë. Pas Uthmanit r.a., është zgjedhur në krye të muslimanëve.

Alija Izetbegoviçi: (1925-2003) Presidenti i Bosnjë dhe Hercegovinës. Mendimtar i shquar musliman.

Alusi: (1803-1854) Mahmud Shihabuddin Ebu eth-Thena el-Husejnij el-Alusi, dijetar mysliman, autor i tefsirit të njohur *Ruh el-meani*.

As'hab el-uhdud: Besimtarë të përmendur në Kur'an, në kaptinën buruxh (85:4-9), të cilët, për të mos e lënë besimin, kishin sakrifikuar dhe me jetët e tyre.

Asim: (-754) Asim bin Ebi en-Nuxhud, njëri ndër dhjetë lexuesit e njohur të Kur'anit, dijetar mysliman nga Kufa.

Bagdad: kryeqendër botërore e dijeve dhe shkencave dikur. Sot kryeqytet i Irakut.

Begaviu: (1044-1122) Ebu Muhammed el-Husejn bin Mes'ud bin Muhammed, dijetar musliman, autor i një komentari të njohur të Kur'anit.

Bekare: kaptina e dytë kur'anore. Është emërtuar me këtë emër sipas rrëfimit të Musait a.s., me një grup izraelitësh (2:67-73) të cilëve iu kërkohej therja e një lope për gjetjen e një dorasi.

Bela: Fatkeqësi, sprovë.

Belkiza: mbretëresha e popullit sebe', e përmendur në Kur'an (27:23-44) në rrëfimin me Sulejmanin a.s.

Beteja e Hendekut: betejë ndërmjet myslimanëve dhe fiseve arabe të cilat ishin bashkuar për t'iu dhënë fund myslimanëve dhe shtetit islam. Ka ndodhur në Medinë, në vitin e pestë sipas hixhretit.

Beteja e Uhudit: betejë ndërmjet myslimanëve dhe idhujtarëve. Ka ndodhur në vitin e tretë sipas hixhretit.

Betejën e Mu'tes: betejë e ndodhur ndërmjet myslimanëve dhe idhujtarëve arabë, të ndihmuar nga romakët. Ka ndodhur në vitin e tetë sipas hixhretit në vendin që tashmë gjeografikisht është në territor të Jordanisë.

Bixhoz: kumar.

Buhariu: (810-870) Muhammed bin Ismail, dijetar i shquar mysliman, autor i librit më të saktë të haditheve, të njohur sipas emrit të tij Sahihu i Buhariut.

Çështjeve të domosdoshme që duhet ditur nga feja: është koncept fetar sipas të cilit ekzistojnë disa gjëra që duhet t'i dijë secili besimtar. Mosnjohja e tyre nuk nënkupton shfajësim apo shkarkim nga përgjegjësia.

Da've: predikim, thirrje, ftesë në fenë e Allahut xh.sh.

Dahhaku: (-723) Dahhak bin Muzahim, tabiin, dijetar musliman, tefsirolog

Dëshmia e ymetit: koncept kur'anor (2:143) përkitazi me këtë ymet: *"...Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush..."*

Dhulkarnejn: mbret. Rrëfimi i tij përmendet në Kur'an (18:83-98) si model i suksesshëm udhëheqjeje.

Ebu Bekir bin el-Arabi: (1076-1148), Muhammed bin Abdullah el-Arabi, dijetar mysliman nga Andaluzia, tefsirolog, autor i tefsirit *Ahkam el-Kur'an*.

Ebu Bekir: shok i Profetit ﷺ, mashkulli i parë i rritur që i besoi, babai i gruas së tij, Ajshes r.a. Pas vdekjes së Profetit ﷺ, ka qenë halife, duke u bërë kështu halifeja i parë i myslimanëve.

Ebu Davud: (817-889) Sulejman bin el-Esh'ath el-Ezdi es-Sixhistani, dijetar mysliman, haditholog, autor i koleksionit të haditheve të njohur sipas emrit të tij Suneni i Ebu Davudit.

Ebu Duxhane: shok i Profetit Muhammed ﷺ.

Ebu el-Alijeh:

Ebu Rejhan Biruni: (973-1048) Muhamed bin Ahmed, njëri ndër dijetarët më të cituar në historinë islame. Shquhej në matematikë, astronomi, fizikë. Biruni njihet edhe si gjeograf dhe historian.

Ebu Seid el-Hudrij: shok i Profetit ﷺ.

Ehlu el-hil-l dhe akd: organ konsultues, i ngjashëm me *shura*-në por i veçuar me kompetenca ekzekutive. Në të, krahas dijetarëve, bëjnë pjesë edhe pushtetarët.

Ehlu sunneti dhe xhemati: synitët, ithtarët ose ndjekësit e sunnetit; shumica dërrmuese e myslimanëve të botës.

El-emru bi-l-ma'ruf ve en-nehju an el-munker: urdhërimi

për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, parim fetar, institucion shoqëror.

Enes bin Malik: shok i Profetit ﷺ

Ensar: medinasë, shokët e Profetit ﷺ nga radhët e banorëve të Medinës.

Epshe (ar. heva): çdo gjë që e devijon dhe lajthit njeriun.

Esma ve sifate: emrat dhe cilësitë e Allahut xh.sh., pjesë doktrinare e besimit.

Fadile: pozitë e lartë në Xhennet të cilën mund të arrijë vetëm një rob i Allahut xh.sh., dhe që shpresohet ai rob të jetë Profeti Muhammed ﷺ.

Fahruddin Rrazi: (1150-1210) dijetar mysliman, tefsirolog, autor i tefsirit *Mefatih el-gajb*.

Farz: vepër obliguese detyruese nga Zoti në mënyrë shumë të rreptë. Moskryerja e farzit ndëshkohet. “Farzi ajn” është obligim individual, kurse “farzi kifaje” është obligim kolektiv. Farzi, pra është obligim islam kryerja e të cilit është e domosdoshme për secilin mysliman apo myslimane të moshës madhore; ibadet i obliguar.

Fekih: jurist fetar, dijetar i fikhut i cili mund të jep fetva.

Fetva: Dekret; mendim zyrtar juridik, ose vendim i dijetarëve rreth çështjeve të ligjit islam; vendimi lidhur me ndonjë çështje të juridiksionit islam.

Fi dhilal el-kur'an: vepra e njohur e Sejjid Kutubit në të cilën ka shpjeguar kuptimet e Kur'anit.

Fikh: Shkencë fetare mbi të drejtën, e cila i përfshin ceremonitë dhe obligimet fetare, familjare, trashëgimisë, qytetare, penale dhe të drejtën kushtetuese si dhe rregullat lidhur me udhëheqjen e luftës (të drejtën e luftës).

Fisit gatafan: fisi i madh arab.

Fitne: provë, ligësi, joshje, persekutim. Zakonisht përdoret në kuptimin e kryengritjes ose përmbysjeve politike.

Fukaha: shumës i Fekih.

Gajb: e fshehur, e pakapshme, e panjohur për shqisat dhe arsyen. Në këto besohet e nuk mund të njihen. Këtu bëjnë pjesë: melaqet, shpirti, xheneti, xhehenemi, xhinët, shejtani, fati, Dita e Gjykimit etj.

Hadith garib: lloj i hadithit (transmetimi i të cilit veçohet me një transmetues të vetëm).

Hadith kudsij: fjalët e Pejgamberit a.s., kurse kuptimi

dhe domethënia nga Allahu xh.sh.

Hadith: atë që i Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ e ka thënë, si dhe atë që për të dhe sjelljet e tij e kanë thënë shokët e tij; hadithi është burimi i dytë i sheriatit islam; disiplinë shkencore në kuadër të shkencave islame.

Halif: mëkëmbës, trashëgimtar, prijësi suprem i myslimane; trashëgimtar i plotë i Muhamedit a.s. në aspektin shoqëror, ushtarak, politik, ekonomik, por jo edhe në aspektin pejgamberik.

Haruni: profet, vëllai i Profetit Musa a.s.

Himjer: mbretëri e dikurshme në Jemen.

Hisbe: urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, organ shtetëror që merret me urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja.

Hixhret/hixhrij: Shpërngulja e Profetit ﷺ prej Mekës në Medinë në vitin 622; prej kësaj date fillon njehsimi i kalendarit islam; shënohet si njëra prej datave më të rëndësishme në historinë islame.

Hoxha: shkruar, dijetar, mësues; imam.

Hud: Profeti i Allahut. Me këtë emër quhet edhe kaptina e njëmbëdhjetë në Kur'an.

Hulefai rrashidinë: përkthyer në shqip nënkupton liderët e drejtë. Si term përdoret për katër liderët e besimtarëve pas vdekjes së Muhammedit ﷺ: Ebu Bekrin, Omerin, Uthmanin dhe Aliun, *Allabu qoftë i kënaqur me ta!*

P'xhaz: mrekulli, sfidim kur'anor, mrekulli kur'anore.

Ibën Abbasi: kushëriri i Profetit ﷺ, njëri prej dijetarëve të dalluar myslimanë.

Ibën Ashuri: (1879-1973), Muhammed bin Tahir, dijetar mysliman, autor i tefsirit *Ettabrir ve ettenvir*.

Ibën el Xheuzi: (1116-1201), AbduRrahman bin Ali bin Muhammed, dijetar mysliman.

Ibën Hibbani: (884-965), Muhammed bin Hibban, haditholog.

Ibën Kethiri: (1300-1373), Ismail bin Umer, dijetar mysliman, tefsirolog, autor i tefsirit *Tefsir el-Kur'an el-adhim*.

Ibën Uthejmini: (1925-2001), Muhammed bin Salih, dijetar mysliman.

Ibrahim: profet, babai i profetëve, sipas tij emërtohet

dhe kaptina e katërmëdhjetë e Kur'anit.

Ihtisab: shih *Hisbe*.

Imam Hejthemi: (1335-1404), Ali bin Ebi Bekr, haditholog, autor i veprës *Mexbmeu ezzevaid*.

Imam Kasimiu: (1866-1914), Xhemaluddin bin Muhammed Seid bin Kasim, dijetar mysliman.

Imam Kurtubiu: (1214-1273), dijetar mysliman, tefsirolog, autor i tefsirit të njohur *El-xhamiu li-abkama el-Kur'an*.

Imam: prijës, lider. Prijësi i besimtarëve në namaz. Titull i lartë në dijet dhe shkencat fetare.

Iman: besim, besim në një Zot të vetëm absolut, i Cili ka krijuar dhe krijon, ka drejtuar dhe drejton tërë gjithësinë. Besimi në islam përbëhet nga gjashtë shtylla: Besimi i Allahut, i melaqeve, librave, i të dërguarve, i Ditës së Gjykimit dhe i caktimit të Zotit.

Imaret: principatë; kuzhinë humanitare publike, në të cilën përgatitet dhe shpërndahet ushqimi pa kompensim për personat që janë përcaktuar nga themeluesi i atij vakëfi (udhëtarët, skamnorët, nxënësit e medreseve, jetimorja e vendit, etj.).

InshaAllah: “Nëse do Allahu”. Shprehje që përdoret për ta treguar varësinë e vullnetit të njeriut nga i vullneti i Zotit.

Inxhil: libër i Zotit i shpallur të dërguarit të Allahut xh.sh., Isait a.s. (Ungjilli).

Isa: profet i Zotit.

Israilijat: transmetime, rrëfime, këshilla të përcjella nga ithtarët e Librit. Nuk mbështetet në to, por as nuk refuzohen, as nuk pranohen, përveç transmetimeve që përputhen me Islamin dhe mësimet e tij.

Istigfar: kërkim falje për mëkatet e bëra.

Itikad: shih *akide*.

Ithtarët e Librit: të krishterët dhe hebrenjtë.

Ixhma: Konsensus i juristëve myslimanë lidhur me ndonjë çështje juridike, që nuk është zgjidhur në mënyrë eksplicite në Kur’an e as në sunet; burim i tretë i të drejtës islame.

Je’xhuxhët dhe me’xhuxhët: një ndër shenjat paralajmëruese të Ditës së Fundit. Mendohen si një popull i së keqes, të cilët do të shkatërrohen nga me fuqinë e Allahut xh.sh.

Jusufi: profet, i biri i profetit (Jakub), të birit të Profetit

(Ibrahim); kaptina e dymbëdhjetë e Kur’anit.

Kafir: jobesimtar, ai që e fsheh të vërtetën, pasi që ajo i është bërë e qartë atij; ai i cili nuk e do Zotin; qafir.

Karun: me këtë emër në Kur’an njihet Korei i Biblës. Përmendet gjithsej tre herë. Përmendet si i mashtruar pas kësaj bote dhe mosmirënjohës ndaj Allahut xh.sh. Fundi i tij ishte i tmerrshëm.

Kasas: kaptina e njëzetetë e Kur’anit.

Kassas: romancier; tregimtar; kallëzimtar, predikues që në fjalimin e vet fokusohet tek rrëfimet, jo rrallë të pavërteta, që t’i motivojë njerëzit. Predikimi i tyre është i refuzuar.

Kehf: shpellë, kaptina e tetëmbëdhjetë e Kur’anit, e emërtuar sipas njerit prej rrëfimeve të saja kryesore, në të cilën përmenden djem të rinj që u fshehën në shpellë për ta ruajtur besimin.

Keuther: Shumë të mira që Zoti ia ka dhuruar njeriut; emri i kaptinës së 108 të Kur’anit; burimi i Pejgamberit ﷺ në xhenet.

Kijas: analogjia; burimi i katërt i së drejtës islame.

Konfuqionizmi: njëra prej feve tradicionale kineze, e shfaqur në sekujt VI-V para e.r., që bazohet në tre koncepte: rituali, drejtësia dhe dashuria ndaj njeriut.

Kuds: emërtimi arab për Jerusalemin. Quhet edhe *Bejt el-Makdis* apo *Mukaddes*.

Kufr: pabesim; fshehje e së vërtetës për Zotin; mohimi i ekzistencës së Allahut xh.sh.

Kurejshë: fis arab në Mekë, të cilit i përkiste edhe Muhamedi ﷺ.

Leuh mahfudh: pllaka, tabela e ruajtur mirë, vetëm për Allahun e njohur, në të cilën janë të ruajtura të gjitha shpalljet hyjnore, pra edhe Kur'ani – arketipi i tyre. Nga ky vend, Kur'ani iu shpall Profetit Muhammed ﷺ, siç qëndron në kaptinën 88, ajeti 22.

Marrëveshja e Hudejbijes: paqja e parë pas hixhretit ndërmjet myslimanëve dhe idhujtarëve të Mekës, sipas së cilës për dhjetë vite ndërpritej lufta.

Maverdi: (972-1058), dijetar mysliman.

Megazi: përmbledhje e betejave të Profetit ﷺ në një libër.

Mesele: ndodhi që tregohet me gojë; tregim me gojë, zakonisht dëfryes; Çështje, punë; Bisedë;

fjalë...Çështje që diskutohet e debatohet.

Mëkat i madh: konsiderohet mëkati për të cilin është përmendur kërcënim dhe dënim i rëndë. Besimtari duhet të pendohet nga mëkate të tilla, ndryshe, nëse vdes pa u penduar, mbetet në mëshirën e Allahut, i Cili, mund ta ndëshkojë me drejtësi, apo ta falë me mëshirë.

Mihrab: pjesë e thelluar në pjesën së brendshme, në mes të murit të përparmë të xhamisë, në drejtim të kibles, ku qëndron imami, teksa i prin xhematit me rastin e faljes së namazeve të përbashkëta.

Minber: pedestal prej së paku tri shkallëve në anën e përparme të djathtë të këndit të xhamisë, nga i cili hatibi u drejtohet të pranishmëve ditën e premte gjatë faljes së namazit të xhumasë si dhe gjatë namazeve të bajrameve.

Misr: qytet, vendbanim, Egjipti.

Mizan: peshojë.

Muaviu: i biri i Ebu Sufjanit, shok i Profetit ﷺ dhe mik i tij; halife i myslimanëve.

Mufessir: komentues i Kur'anit.

Muhammed el-Emin esh-Shenkiti: (1897-1973), dijetar mysliman, autor i tefsiri *Adva el-bejan*.

Mukatili: (-767), Mukatil bin Sulejman, dijetar mysliman, tefsirolog, autor i njërit rpej tefsireve të para të Kur'anit, në mos të parit.

Murted: renegat i fesë; personi që ka zgjedhur një besim të ri; tradhtar; tekstualisht: murtat.

Musa: profet.

Mus'haf: Kur'ani.

Mustehab: atë që Muhamedi ﷺ e ka porositur që të bëhet; gjëra të caktuara, të cilat e zbukurojnë namazin, por edhe pa të cilat namazi plotësisht do të jetë i saktë.

Muxhahidi: (645–722), Muxhahid bin Xhebri, dijetar mysliman nga gjeneratat e para.

Namaz: forma islame e kthimit të drejtpërdrejtë të njeriut kah Krijuesi i vet; kushti i dytë i islamit. Namazi në gjuhën arabe quhet 'salat'. Namazi është rituali i parë dhe kryesor në islam.

Nasihahat: këshillë fetare, ders, vaz.

Naziat: kaptina e shtatëdhjetenëntë e Kur'anit.

Nebij: Pejgamberi i Zotit. Të gjithë ata që nuk kanë pasur shpallje vetjake, por që kanë vazhduar shpalljen e ndonjë pejgamberi paraprak ose të kohës së tij. Sa për ilustrim po

përmendim Harunin a.s. është 'nebij', sepse e ka ndihmuar Musain a.s.

Nefs: shpirti, fryma; në aspektin e gjerë është shpirti, ndërsa në aspektin e ngushtë është egoja.

Neml: kaptina e njëzeteshtatë e Kur'anit.

Nuh: profet, e shtatëdhjetenjëta kaptinë e Kur'anit.

Omer Muhtari: (1858-1931), luftëtar libian, simbol i rezistencës kundër kolonizuesve italianë.

Omeri r.a.: shok i Profetit ﷺ, halife i myslimanëve pas Ebu Bekrit r.a. Në histori të njerëzimit ka hyrë si njëri ndër liderët më të drejtë dhe njëri prej influencuesve më të mëdhenj në botë.

Resul: i Dërguar; personi të cilin Allahu i madhërisëm e ka zgjedhur që, nëpërmjet tij, t'ia dërgojë mesazhin ndonjë populli apo njerëzimit në tërësi; në përdorimin e përditshëm të myslimanëve, fjala i dërguari i Allahut nënkupton të dërguarin Muhamed ﷺ.

Reshid Rida: (1865-1935), mendimtar mysliman.

Rububijet: pjesë e besimit - Teuhidit, sipas së cilës Allahu ka krijuar çdo gjë dhe se Ai menaxhon me çdo gjë.

Ryshfet: mito.

Sa'di: (1889-1956), emrin e plotë e ka AbduRrahman Nasir Sa'di, dijetar mysliman, autor i tesfirit *Tejsir el-Kerim err-rrahman. Fi tefsiri Kelami el-Mennan.*

Sahabe: shokë të Profetit Muhammed ﷺ.

Salahuddin Ejjubi: (1137-1193), komandant i shquar mysliman, i cili luftoi kundër kryqtarëve. Ka qenë themeluesi i dinastisë ejubite, mbret, nën sundimin e të cilit ishin Egjipti dhe Siria.

Sebe': popull antik që udhëhiqeshin nga mbretëresha Belkisa; kaptina e tridhjetekatër në Kur'an.

Sejjid Kutb: (1906-1966), dijetar dhe mendimtar i njohur mysliman, autor i librit – komentimit kur'anor: *Fi dhilal el-Kur'an.*

Selman Farisiu: shok i Profetit ﷺ.

Sened: zinxhiri i transmetuesve të haditheve.

Sunen: libra që kanë përmbledhur hadithet e Profetit Muhammed ﷺ.

Sunnet: tradita, praktika, zakoni, mënyra e jetës. Përvoja e Profetit ﷺ e cila nënkupton atë që ai e ka vepruar, duke folur, apo e ka

lejuar në heshtje; ibadeti, të cilin ai vazhdimisht e ka vepruar “sunneti muekkede” (suneti i fortë) si dhe ato, të cilat nganjëherë i ka lënë “sunneti gajri muekkede” (suneti jo i fortë).

Shifat: ndërmjetësim. E drejta e Profetit ﷺ ose e ndonjë njeriut, të cilit Allahu ia lejon që të që të ndërmjetësojë tek Allahu në Ditën e Gjykimit për mëkatarët.

Shehid: personi, i cili në luftën e tij të drejtpërdrejtë për vlerat islame dhe të drejtat e njeriut, me vetëdije të plotë e në emër të Allahut e sakrifikon jetën e vet; personi, i cili për shkak të veprave të tij të jashtëzakonshme në këtë botë, u bashkëngjitet pejgamberëve të Allahut në xhenet.

Shejh: dijetar i fesë; plak, i shtyrë në moshë; epror, mësues i fesë.

Sheriat: ligji islam.

Sheukani: (1759-1834), Muhammed Sheukani, dijetar mysliman nga Jemeni, autor i disa veprave.

Shirk: Nënshtrimi dhe adhurimi i kujtdo qoftë tjetër përveç Allahut të madhërishtëm; politeizmi.

Shura: kuvendim, këshillim, konsultë; marrëveshje; institucioni islam për marrjen e

vendimeve të rëndësishme dhe për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme.

Taha: kaptina e njëzet në Kur'an.

Takva: devotshmëri.

Talha bin Ubejdullah: shok i Profetit ﷺ.

Talut: personalitet i përmendur në Kur'an (Bekare: 246-249), mbret i izraelitëve.

Tarik Suvejdani: mendimtar mysliman bashkëkohor.

Tefsir: koment, komentar i Kur'anit.

Teuhid: Njeshmëria e Zotit; tekstualisht: ritual vullnetar, në të cilin madhërohet emri i Allahut dhe potencohet njeshmëria e Tij.

Teurat: Tora: (hebr.) - Libri i Allahut i zbritur të dërguarit të Tij, Musait a.s.

Texhdid: rimëkëmbje, ripërtëritje; lëvizje reformiste, e cila përpiket të rikthejë formën e pastër të Islamit duke iu kthyer Kur'anit dhe Sunetit dhe duke refuzuar ligjet dhe praktikën e mëvonshme.

Tirmidhiu: (824-892) Ebu Isa Muhammed bin Isa, dijetar mysliman, haditholog, autor i njërit prej katër Suneneve - përmbledhjeve të haditheve.

Toka e shenjtë: Bejt el-makdis ose Kudsi në Palestinë (shpjegim i autorit).

Ukbe bin Ebi Muajt: një nga kundërshtarët e përbetuar të Profetit Muhammed ﷺ dhe keqtrajtuesit fizikë të tij. Është vrarë në Betejën e Bedrit. Të gjithë pasardhësit e tij e kanë përqafuar islamin më vonë.

Ulu el-azm: të vendosurit, term që veçon pesë profetë të dalluar: *Nubun, Ibrahimin, Musanë, Isanë dhe Muhammedin a.s.*

Uluhijet: adhurim, ndarje e besimit (*rububijet, uluhijet, esma dhe sifet*). Feja i ka kushtuar rëndësi për shkak se shumica e njerëzve janë njëzëri sa i përket të parës, rububijetit, pra se Allahu është krijues, ndërsa janë ndarë sa i përket adhurimit.

Umejje bin Halef: një nga kundërshtarët më të mëdhenj të Profetit Muhammed ﷺ, pronari i Bilalit r.a., të cilit e torturonte për shkak të besimit. Është vrarë në Betejën e Bedrit.

Ummu Habibe: Remle bint Ebi Sufjan, gruaja e Profetit Muhammed ﷺ, nënë e besimtarëve.

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja: pjesë esenciale e fesë, institucion fetar i cili merret me luftimin e

dukurive negative në shoqëri.
Shih: *El-emru bi-l-ma'ruf ve en-nehju an el-munker*.

Usame bin Zejdi: shok i Profetit Muhammed ﷺ.

Usuli fikh: Burimet e fikhut; shkenca që merret me studimin e burimeve të fikhut dhe me metodat me anën e të cilave nxirren dispozitat (rregullat) e fikhut.

Usulij: studiues i shkencës së Usuli fikhut, fundamentalist.

Uthman bin Affani: shok i Profetit ﷺ, dhëndër i tij, halife i myslimanëve pas Omerit r.a.

Vahj: shpallje, revelatë.

Vakëf: pasuria e lënë testament për qëllime bamirësie, nën kushte të veçanta që gjenden në vakëfname. Kjo pasuri shfrytëzohet vetëm për destinim të caktuar dhe ajo nuk është në dispozicion të lirë të askujt; me pasurinë vakëfnore në Kosovë udhëheq Bashkësia e Kosovës; zyra e vakëfit ka për qëllim Këshillin e Bashkësisë Islame.

Vaxhib: obligim, kategori normative: detyrë që duhet kryer.

Vaz: këshillë, predikim, nasihat.

Vesile: mjet, mjet (vepër) për tu afruar tek Allahu.

Xhafer bin Ebi Talib: kushëriri i Profetit ﷺ.

Xhahil: injorant, i paudhëzuar.

Xhahilijet: injorancë, periudhë kur sundon e keqja, periudha para shpallje së Islamit.

Xhemat: komunitet, grup, besimtarët që falin namazin. Për shkak të lidhjes dhe afërsisë së besimtarëve ndërmjet vete, njihen me këtë emër (Ehlu Sunneti dhe xhemati).

Xhibrili: engjëll, i ngarkuar me detyrën e shpalljes tek profetët.

Xhuma: dita e gjashtë e javës, dita në të cilën besimtarët kryejnë namazin kolektiv të njohur sipas kësaj dite, namazin e xhumasë.

Xhumhuri: shumica, pjesa dërrmuese e dijetarëve që ndajnë mendim të njëjtë.

Ymet: bashkësi, bashkësia e të gjithë myslimanëve.

Zebur: libri që i është shpallur Davudit a.s.

Zejd bin Harithe: shok i Profetit ﷺ.

Zejneb bint Xhahsh: bashkëshortja e Profetit ﷺ, nënë e besimtarëve.

Zekat: detyrim material që jepet për pasurinë në baza vjetore, shtyllë e fesë.

Zemahsheri: (1075-1144)
dijetar mysliman, tefsirolog,
autor i tefsirit të njohur *El-keshaf*.

Zexhaxh: (855-923), gjuhëtar i
njohur mysliman, i lindur dhe
vdekur në Bagdad.

